

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

949.65.01

M82

ZEF MIRDITA

# STUDIME DARDANE



Botohet në bazë të origjinalit:

*Zef Mirdita*

**Studime Dardane**

Prishtinë, 1979



## PARATHËNIE

Dardanët kanë qenë një nga fiset e mëdha e të rëndësishme ilire. Deri vonë problemi i dardanëve dhe i Dardanisë pak ka tërhequr vëmendjen e studiuesve. Por, në ato pak studime ekzistuese, duhet thënë, se nuk kanë munguar edhe mendime të padrejta dhe të paargumentuara rreth shumë çështjeve të rëndësishme të historisë dhe të kulturës materiale e shpirtërore të dardanëve, duke filluar nga çështja e etnogjenezës së tyre. Ato janë ndërlikuar nga mungesa e kërkimeve arkeologjike në trevën e Dardanisë.

Libri «Studime dardane» i autorit kosovar Zef Mirdita, ndriçon historinë e lashtë të fisit ilir të dardanëve dhe përfaqëson një kontribut të vlefshëm shkencor në këtë fushë. Në «Studime dardane» përfshihen gjashtë kumtesa, të lexuara në konferenca e simpoziume të ndryshme. Ato janë: 1) Mbi etnogjenezën e dardanëve; 2) Strukturat politike, shoqërore dhe ekonomike të fiseve ilire në dritën e të dhënave të autorëve të lashtë; 3) Rreth çështjes së lokalizimit e të identifikimit të disa vendbanimeve dardane në kohën pararomake; 4) Çështja e urbanizimit të Dardanisë në kohën e pushtimit romak; 5) Rreth çështjes së romanizimit të dardanëve dhe 6) Çështja e lokalizimit dhe e identifikimit të disa vendbanimeve në Dardani dhe në Dacia Mediterranea në kohën bizantine të hershme.

Në pesë nga kumtesat e përmbledhura në «Studimet dardane» trajtohen problemat e çështje që lidhen drejtpërdrejt dhe vetëm me dardanët. Në studimin e dytë autori ka trajtuar



problemin e strukturës politike, shoqërore e ekonomike në një kuadër më të gjerë, ku janë përfshirë të gjitha trevat ilire.

Në studimet e tij mbi problemet e çështjet e ndryshme rreth dardanëve autori në përgjithësi është përpjekur jo vetëm të parashtrojë mendimet dhe arritjet kryesore të studiuesve të ndryshëm në disa aspekte, por edhe t'i ballafaqojë ato me kërkimet e reja dhe rezultatet e reja, t'i shqyrtojë ato në frymën e një diskutimi kritik.

Në studimin e parë mbi etnogjenezën e dardanëve jepet një pasqyrë mjaft e plotë e mendimeve të dhëna nga dijetarët duke filluar nga parahistoria e protohistoria; këtu gjejmë të radhiten dëshmitë e autorëve të lashtë, provat e kërkimeve të reja gjuhësore, në radhë të parë të onomastikës, dhe në fund materiali arkeologjik. Gjatë shqyrtimit të problemit nëpërmjet të dhënave të mësipërme, autori arrin në një konkluzion logjik dhe të argumentuar se dardanët janë me prejardhje ilire dhe provon paqëndrueshmërinë e pikëpamjes jo të drejtë që u mohonte dardanëve prejardhjen e tyre ilire.

Një vend e vëmendje më e madhe në libër i është kushtuar problemit të strukturave politike, shoqërore e ekonomike të fiseve ilire mbi bazën e të dhënave të autorëve të lashtë. Tre çështjet themelore, të trajtuara secila veçmas, janë shqyrtuar, sipas autorit, në një aspekt të ri. Pikërisht kjo ka bërë që ai të arrijë të japë një mendim të përgjithësuar mbi bazën e autopsisë së burimeve të shkruara dhe kjo pas një analize të gjerë e të thellë të tyre.

Me shumë interes janë edhe kumtesat apo studimet e tjera, të cilat gjithashtu trajtojnë çështje themelore të historisë së dardanëve. Mendime që meritojnë vëmendjen e lexuesit janë dhënë në studimin mbi disa vendbanime të hershme dardane. Fjala është për kundërshtimin e përpjekjeve të disa historia-nëve të huaj, për t'i paraqitur dardanët si «barbarë», si një popullsi që nuk e arriti dot atë shkallë të zhvillimit ekonomik e shoqëror që arritën fqinjët e tyre, duke përfshirë edhe fiset ilire të Jugut, dhe Dardaninë si një trevë me vendbanime fshatare. Midis të tjerave, në studimin e përmendur, lokalizohen qytetet Sintia e Damastion dhe në vendin e penestëve qytezat e Uskanes, Draudakut e Oeneut. Të gjitha këto vendbanime autori arrin t'i lokalizojë në treva dardane.

Çështjen e urbanizimit, të karakterit të vendbanimeve dardane, autori e gjurmon edhe në periudhën pasuese, në periudhën e pushtimit romak. Edhe këtu bëhet një orvatje, me rezultate pozitive, për të dhënë një kuadër sa më të plotë të urbanizimit të Dardanisë dhe madje kalohet edhe më tej




duke shpjeguar karakterin e vendbanimeve në shekujt e parë të erës sonë.

Dy studimet e fundit, ai i «romanizimit» të dardaneve dhe tjetri që trajton edhe çështjen e identifikimit të qytetit Justiniana Prima, janë gjithashtu me vlerë. Dhe kjo është e kuptueshme: për të parin sepse zbulon synimet e Romës, politikën e romanizimit në faza të ndryshme, e cila sido të ketë qenë është bërë në kurriz e në dëm të popullsisë dardane. Për të dytin, çështja e identifikimit të Justiniana Prima, qytetit të themeluar nga Justiniani — kryepeshkopatë në Cariçin Grad apo në Skupi, sigurisht është me rëndësi sepse tregon për një vendbanim të madh e të zhvilluar në Dardani në periudhën e herëshme bizantine. Mendojmë se të njëvlefishme dhe që duan gjurmuar e studiuar më tej janë dëshmitë e materialit arkeologjik dhe të një togu qytezash e kështjellash që tregojnë qartë se dardanët janë ruajtur si një popullsi kompakte për gjithë kohën e lashtë dhe se kanë vazhduar të jetojnë në truallin e tyre edhe pas kohës së hershme bizantine, në mesjetë. Si të tillë ata janë paraardhësit e popullsisë shqiptare, banorë të sotëm të Dardanisë, pjesë e rëndësishme e së cilës ka qenë Kosova.

SKËNDER ANAMALI





## I. MBI ETNOGJENEZËN E DARDANËVE

Territori i Jugosllavisë, nga aspekti morfologjik dhe i ndryshimeve hidrologjike dhe klimatike, në krahasim me vendet e tjera, nuk paraqet një tërësi. Ai është ndarë në gjashtë zona antropogjeografike, që janë: zona e Adriatikut, alpine, panonike, qendrore, jugore dhe kalimtare. Kjo ndarje shfaqet që në shtresat etnokulturore të neolitit<sup>1</sup>. Por, përkundrejt tërësive të përcaktuara, këto zona nuk janë të ndara në mënyrë të përkufizuar me që në to përfshihen edhe zonat fqinje. Ky fakt pasqyrohet më së miri në zonën qendrore të Ballkanit, në të cilën bëjnë pjesë Serbia, Kosova, pjesa lindore e Malit të Zi dhe Maqedonia Veriore, e cila është, edhe pse e rrethuar me male të larta, nëpërmes luginës së Moravës dhe Vardarit, e hapur kah bota egjeane dhe, nëpër luginën e Drinit të Bardhë nëpër rrafshin e Kosovës kah perëndimi, e me luginën e Ibrit dhe të Neretvës që lidhet me territorin adriatik, bie nën ndikimin mesdhetar, që në kohën e neolitit të hershëm<sup>2</sup>. Veç kësaj, çdo zonë është e ndarë në nënzona. Për një ndarje të tillë ndikon edhe vetë konfiguracioni i reliefit. Kështu, bie fjala, vetë zona qendrore e Ballkanit, e cila njëherësh ishte edhe trevë e dar-

---

1 Krh. Alois Benac, *Les groupes neolithiques en Yougoslavie*, në: *Actes du I<sup>er</sup> congrès*, v. II, 185.

2 Krh. A. Benac, *vep e cit.* 195; Vojislav S. Radovanović, *Geografske osnove Južne Srbije*, në: *Spomenica* 17.



danëve, është e ndarë në pjesën qendrore ose Rashkën, në pjesën e Vardarit ose territorin e Maqedonisë dhe në Kosovën, si territor qendror i trevës së dardanëve.

Sidoqoftë, edhe këto nënzona, për shkak të karakteristikave specifike, formojnë tërësi të veçanta dhe njihen edhe me shtresa kulturore specifike. Përsa i përket popullimit dhe jetesës, mund të supozohet se këto territore kanë qenë të banuara që në kohët më të lashta, ndoshta edhe në kohën e paleolitit<sup>3</sup>, edhe pse deri më tash në këtë territor janë zbuluar vetëm pjesërisht disa lokalitete të kësaj periudhe. Por ajo që për paleolitit mund të supozohet në bazë të analogjisë me viset e tjera të Gadishullit Ballkanik, për periudhën e neolitit është më e qartë, megjithëqë njohja dhe sondazhi sistematik i territorit qendror të dardanëve dhe sidomos Kosova, ku gërmimet dhe kërkimet arkeologjike kanë filluar në 50-vjetshin e shekullit tonë<sup>4</sup>, japin një pamje të mjaftueshme. Këto kërkime kanë treguar se kjo pjesë qendrore ka qenë e përfshirë me të njëjtat kultura të neolitit me nuanca specifike kohore dhe dikudiku edhe tipologjike, me disa variante lokale. Kështu grupi etnokulturor i Starçevos në përgjithësi paraqitet në luginat e lumenjve sikundër në Stublinë në Supskoj<sup>5</sup>, Crnokalaçka Bara në Razhnji<sup>6</sup>, Bubanji në Nish<sup>7</sup>, në Kosovë Tjerrtonja në Prish-

3) Që pjesa më e madhe e Gadishullit Ballkanit ishte e banuar në periudhën e paleolitit dëshmojnë gjetjet arkeologjike në Crvena Stijena mbi Trebishnicë, në Kroaci në kodrinën Kushnjakovo, në Krapinë, në Sërbi Risovaça në Arangjelovac, Gradac në Kragujevc e gjetkë; mandej në Thesali, Rumani dhe Bullgari. Krh. A. Benac, *Starije kameno doba*, në: *Kulturna Istorija Bosne i Hercegovine*, Sarajevo 1966, 13; Po ai: *Studije o Kamenom i bakarnom dobu u Sjeverozapadnom Balkanu*, Sarajevo 1964 9-20; A. Benac, — M. Brodar, *Crvena Stijena*, në GZM, N. S. XIII (1957), 21-64; Dragutin Kramberger — Gorjanović, *Pračovjekiz Krapine*, Zagreb 1918.

4) Krh. M. dhe D. Garašanin, *Arheološka nalazišta u Srbiji*, Beograd 1951. M. Garašanin. *Iz prvobitne istorije Kosova i Metohije*, në: *Muzeji 3-4(1949)* 57 ss; R. Galović, *Uvod u praistoriju Kosova i Metohije*, në: *GMKM I* (1956), 207-218.

5) Krh. M. Garašanin, *Praistorija na tlu SR Srbije*, I, 100, D. Garašanin — Arandjelović, *Starčevačka kultura*, Ljubljana 1954.

6) Krh. R. Galović, *Arheološki pregled*, 2 (1960), Beograd.

7) Krh. A. Oršić-Slavetić, *Bubanja, eine vorgeschichtliche Ansiedlung bei Niš*. M.P.K. der Akademie der Wissenschaft IV (1-2, Wien 1940).



tinë<sup>8</sup>, Zhitkovci në Mitrovicë<sup>9</sup>, Gladnica në Graçanicë<sup>10</sup>, Rudniku i Kosovës, Gornje Budrige dhe në Maqedoni Zelenikovë në Shkup<sup>11</sup>. Grupi etnokulturor i Vinçës, i cili ka qenë i përhapur në luginat e lumenjve që derdhen në Savë dhe Danub dhe i cili është karakteristik për neolitin e mesëm dhe atë të vonë është i përhapur në pjesën e gjerë të territorit qendror të Gadishullit Ballkanik. Lokalitet tipik, sipas të cilit e ka marrë edhe emrin i tërë grupi etnokulturor është Vinça<sup>12</sup>, në afërsi të Beogradit, pastaj në Banjicë<sup>13</sup> etj. Në pjesën qendrore të territorit dardan grupi etnokulturor i Vinçës paraqitet në variant të veçantë, i cili është i njohur edhe si variant kosovaromoravian jugor<sup>14</sup>. Lokalitetet e njohura të këtij varianti në Kosovë janë: Tjerrtorja afër Prishtinës<sup>15</sup>, Valaçi<sup>16</sup>, Fafosi<sup>17</sup>, dhe Zhitkovci në territorin e Karagaçit afër Mitrovicës<sup>18</sup> etj; kurse në territorin e Moravës së Jugut janë: Pavlovci afër Vranjës, Ploçniku afër Kushumlisë, Malça afër Nishit etj.

Të gjitha këto lokalitete me shtresëzimet kulturore të Starçevos dhe të Vinçës flasin për aftësitë e mjedisit të hapur për ndikimet e veçanta nga jashtë, që vinin nëpërmes komunikimeve natyrore, për thithjen e arritjeve të kulturës materiale

8 Disa elemente të qeramikës që janë zbuluar në lokalitetin Tjerrtorja (Predionica) e lidhin këtë lokalitet edhe me kulturat neolitike të Azisë së Vogël. Krh. Emil Čerškov, *Arheološka zbirka Muzeja Kosova i Metohije*, në: GMKM I (1956), 368-378.

9 Krh. Nikola O. Tasić, *Zitkovac i neki problemi relativnog hronološkog odnosa neolitskih i eneolitskih naselja na Kosovu i dolini Ibra*, në: Glasnik Srpske Akademije Nauka XI/1, Beograd 1959, 78-80.

10 Krh. J. Glišić — B. Jovanović, *Praistorisko naselje nga Gladnicama kod Gračanice*, në: GMKM II (1957), 223-233.

11 Krh. A. Benac, *Les groupes neolithiques...*, 195.

12 Krh. M. Vasić, *Praistoriska Vinča I-IV*, Beograd 1932-1936; Po ai: *Kroz kulturni sloj Vinče I-II*, në Spomenik SAN, N.S.C/2 Beograd 1950. 1877; Po ai: *Odnos Vinčine plastike prema arčkoj arhaijskoj plastici-Htensko-agrarni kult u Vinči*, në: Glas SAN, N.S.CC III/1 1951, 1-60.

13 Krh. J. Todorović — A. Cermanović, *Banjica, naselje vinčanske kulture* Beograd 1961.

14 Krh. J. Glišić, *Specifičnost kulture vinčarske grupe na Kosovu i Južnom Pomoravlju*, në: GMKM IV-V (1959-1960), 245-254.

15 Krh. R. Galović, *Predionica, neolitsko naselje kod Prištine*, Pristina 1959.

16 Krh. N. O. Tasić, *Praistorisko naselje kod Valaca*, në: GMKM II (1957) 3-63, Po ai: *Završna i straživanja na praistoriskom naselju kod problema relativnog hronološkog odnosa neolitskih i eneolitski naselja na Kosovu i u dolini Ibra*, në: GMKM (1958) 11-49.

17 Krh. B. Jovanović, *Stratigrafija naselja vinčanske grupe kod Kosovske Mitrovice*, në: GMKM VI (1961) 9-78.

18 Shih shënimin 16.



të botës mesdhetare, me fjalë të tjera tregojnë ekzistencën e lidhjeve të ngushta me territorin egjean dhe qikladik. Për një lidhje të tillë, ndër të tjera, flasin figurinat plastike dhe sidomos altari i vogël prej dheu të pjekur, dhe shumë fragmente. Kur këtyre u bashkëngjitet edhe elementi i gjarprit, si motiv plastik i qeramikës së pikturuar, të gjitha këto na bëjnë të ditur se grupi etnokulturor i Vinçës i përket kompleksit mesdhetar, apo anatolian<sup>19</sup>. Si grupi kulturor i Starçevos, ashtu edhe ai i Vinçës, nga aspekti kronologjik, është i përcaktuar relativisht mirë<sup>20</sup>. Një

19 Duke lënë mënjanë B. Gavelen, *Vinçin kulturni i kompleks, në: ZEF VIII-1,12n.23* i cili mendon se në sajë të gjëndjes së tashme të shkencës, veçanërisht të arkeologjisë prehistorike dhe të karakterit të vetë kulturave neolitike, është herët të konsiderohet përfundimisht e zgjidhur; prapëseprapë pjesa më e madhe pajtohet me mendimin se kulturat neolitike në Ballkan kanë origjinën e tyre juglindore, apo nga kompleksi anatolo-egjean, Krh. V. G. Childe, *Danube prehistory*, Oxford 1929; Po ai: *Prehistoric Migrations in Europe*, Oslo 1950; Po ai: *L'aube de la civilisation européenne IV*, edit. Paris 1949; Po ai: *The prehistory of European Society* London 1958; Fritz Schachermayer, *Prähistorische Kulturen Griechenlands*, në: PWRE 1954, cal. 1949 ss; Po ai: *Die ältesten Kulturen Griechenlands*, Stuttgart 1955; K. Bittel, *Grundzüge der Vor-und Frühgeschichte Kleinasiens* 2. edit. Tübingen 1959; M. V. Garašanin, *Hronologija Vinčanske grupe*, Ljubljana 1951; Po ai: *Jedan osvrt na prvobitni istoriju naše zemlje*, në: JG 2 (1948), 65-78; Po ai: *Iz istorije mladjeg neolitika u Srbiji i Bosni*; në: GZM u Sarajevu, N.S. IX (1954) 5-29; Po ai: *Neolithikum und Bronzezeit in Serbien und Makedonien* 29, Bericht der Römisch-germanischer Kommission, Frankfurt/Main 1950; Po ai: *Der Übergang von Neolithikum zur frühen Bronzezeit auf dem Balkan und an der unteren Donau*, në: *L'Europe a la fin de l'age de la pierre*, Praha 1961, 15-43; A. Benas, *Studien zur Stein-und Kupferzeit im Nordwestlichen Balkan*, 42, Bericht der Römisch-germanischen Kommission, Frankfurt/Main 1962.

20 Krh. D. Garašanin — Arandjelović, *Starčevačka kultura*, Ljubljana 1954, V. M. Garašanin, *Hronologija Vinčanske grupe*, Ljubljana 1951, Po ai: *Zur Frage des Beginns der Vinča Kultur*, në: AJ (1954); Po ai: *O poreklu i hronologiji Balkanskog neolita*, në: *Starinar N.S. VII-VIII (1956-57) 29-34*; VI. Milojčić, *Chronologie der jüngeren Steinzeit Mittel-und Südosteuropas*, Berlin 1949, 65-70 ss. Është interesant për t'u theksuar se përcaktimi i kronologjisë absolute me metodën C-14 jo vetëm që ndryshon gati për 1000 vjet nga metoda klasike, por edhe rezultatet nuk janë gjithëkund të njëjta. Kështu psh. në Evropë disa data janë më të larta në krahasim me viset e Mesdheut Lindor, gjë që del kontradiktore siç shihet nga vetë gjetjet arkeologjike të këtyre viseve. Veç kësaj, është konstatuar ndikimi i fushës magnetike të tokës në radioaktivitet në periudha të ndryshme dhe vise të ndryshme, kështu që edhe këtu shihet ndryshimi i vleftës së metodës së përmendur (Krh. M. Vladimír Dumitrescu, *Quelques aspects des synchronismes entre les cultures neolithiques et de la periode de transition vers l'age du bronze de l'Europe Sud-Orientale d'une part et le monde égeo-anatolien, d'autre part*. Corraport. IIème congrés internationale des études Sud-Est Européen, Athènes, 7-13 mai 1970 4).



çështje e cila shtrohet vetvetiu është ajo se cilat ishin vendbanimet etnike që do të bartnin strukturat kulturore të neolitit. Kësaj nuk mund t'i jepet përgjigje me saktësi. Mendohet se këta ishin të karakterit paleomesdhetar ose paleokontinental. Megjithatë, këtu është fjala për një shtresë paraindoeuropiane<sup>21</sup>. Me këtë interpretim arkeologjik mbi substratin etnik të kulturave neolitike dhe rolit të tyre në formimin e shtresave etnokulturore paleoindoeuropiane përputhen edhe rezultatet e ana-

---

21 Krh. A. Benac, *Studije o kamenom i bakarnom dobu...*, 164. Përkundër këtij mendimi Vl. I. Georgievi orvatet të provojë se kulturat neolitike (si psh. Ertöbelli, *Bänderkeramik*, Koros, Starčevo; Karanovo, Bojani, pre-Cucuten etj.) presupozojnë se bartës të tyre duhet të jenë indoeuropianët. Ai përkundër përfaqësve të teorisë së *Schnurkeramik* mendon se Gadishulli Ballkanik ka qënë i banuar që prej kohëve më të lashta nga fise a popullsi indoeuropiane, gjuhët e të cilave janë dalluar me karakteristikat specifike, por jo edhe në elementet esenciale. Këtë hipotezë të vetën Vl. I. Georgievi e bazon në hidroniminë ballkanike, dhe lidhur ngushtë me të është edhe problemi i bartësve të kulturës mikenase, gjegjësisht helene të vonshme dhe minoike të vonshme, bartësit e të cilave do të ishin po ashtu elementet indoeuropiane. (Krh. Vl. I. Georgiev, *Introduzione alla storia della lingue indoeuropee*. Roma 1966; 2. ediz. 356-385; Po ai: *Die Herkunft der Namen der größten Flüsse der Balkanhalbinsel zur Etnogenese der Balkanvölker*, në: BE I, Sofija 1959, 5-16 Po ai: *Die Träger der kretisch-mikenischen Kultur, ihre Herkunft und ihre Sprache I. Teil. Urgriechische und Urillyriker (Thrako-Illyrier)*, në: GSUFF XXIII. 4, Sofija 1937. Mendimin e Vl. I. Georgievit, që substrati gjuhësor çgjean ka qënë i karakterit indoeuropian, Fritz Schachermayeri e kundërshton, edhe pse nuk e mohon lidhjen me indoeuropianët (Krh. F. Schachermayer, *Die ältesten Kulturen...* 151 ss; L. Palmer *Miceneans and Minoans*, 29 ss). Mendimin e Vl. I. Georgievit e përkrah edhe bashkëvendasi i tij, Velizar Velkov, duke cekur se prejardhja e toponimeve të lashta është e karakterit indoeuropian «...der Ursprung der ältesten Ortsnamen erwies sich als indoeuropäisch» V. Velkov, *Die Stadt und das Dorf in Südosteuropa*. Die Antiquae (Raport); Athènes 1970, 7-13 mai 1970, IIème congrès international des études du Sud-Est européen (Separat).

Për rolin e kulturave neolitike të kompleksit ballkanoanatolian në formimin e elementit etnokulturor paleoballkanik bën fjalë edhe Pia Laviosa — Zambotti, *Ursprung und Ausbreitung der Kultur*, 1959. Megjithatë, karakteri joindoeuropian i popullsisë neolitike, bile për sa u përket kulturave neolitike të Danubit të ulët, na duket më se i arsyeshëm, siç e ka cekur me të drejtë R. R. Pittioni: *Die donauländische Kultur ist daher als nicht indogermanisch zu bezeichnen, doch gelin vorläufig noch nicht, sie mit einem bestimmten Volkstum oder einer näher zu umschreibenden Völkerfamilie in Verbindung zu bringen*. (R. Pittioni, *Die urchenichtlichen Grundlagen der europäischen Kultur*, 116. Me fjalë të tjera «...etnosi dhe kultura- siç thekson me të drejtë M. Suiq — nuk janë gjithmonë dy koncepte adekuate sidomos në vëset periferike dhe kufitare, në të cilat edhe sot nuk janë» (Mate Suiq, *Zapadna granica Ilira u svjetju historijskih izvora*, në: Simpozijum, 38.



lizave të materialit gjuhësor. Sipas teorisë së P. von Bradkut<sup>22</sup> shihet se gjuhët indoevropiane, në bazë të tri serive guturale, ndahen në centum (respektivisht në grupin perendimor) dhe satem (respektivisht në grupin lindor). Këto tri seri guturalesh, linguisti danez, H. Pedersen<sup>23</sup> i ka konstatuar të ruajtura si në gjuhën ilire ashtu edhe në gjuhën shqipe. Por kjo teori nuk mundi t'u qëndrojë pengesave që dolën me zbulimin e gjuhës tokarishte dhe lidhjes së saj me grupin baltosllav<sup>24</sup>. Lidhur me këtë, M. Budimir<sup>25</sup>, përveç grupit verior (satem refleks) dhe grupit jugor (centum refleks) ka konstatuar edhe grupin e tretë të gjuhëve indoevropiane, i cili ka ruajtur të tri seritë guturale, dmth përveç velareve, i ka pasur edhe palatalet dhe labiovelaret e gjendej në rajonin anatolian, ku shtriheshin ilirët, trakët, maqedonët dhe fiset e tjera të Azisë së Vogël. Këtë shtresëzim kulturor ai e quan pellazgjik. Kjo mënyrë e shqyrtimit përputhet shumë me rezultatet arkeologjike «të cilat në Egje dhe në Azi të Vogël supozojnë praninë e një elementi paraindoeuropean grek, duke e përcaktuar me një lashtësi të madhe, respektivisht në mijëvjeçarin e tretë»<sup>26</sup>. Substratin gjuhësor indoevropian paragrek M. V. Garašanini e sheh në bashkimin e «kompleksit ballkano-anatolian të periudhës së bronzit»<sup>27</sup>.

Në bazë të kësaj që u tha deri më tash, mund të përfundohet se indoeuropianizimi i Gadishullit Ballkanik ka filluar në periudhën kalimtare nga neoliti në kohën e metaleve, madje nën ndikimin e dukshëm të kulturës së rajonit Deti i Zi — Stepat, materiali i të cilit është i përhapur që nga viset e gjëra të stepave ruse, nëpër rajonin e Danubit të Ulët, e deri në Ballkanin Lindor dhe Qendror<sup>28</sup>. Përveç kësaj, nga sa u tha,

22 Krh. P. von Bradke, *Beiträge zur Kenntnis der vorhistorischen Entwicklung unseres Sprachstammes*, Giesen VI 88. Që kjo ndarje nuk është me vend, shih Vittore Pisani, *Les origines de la langue albanaise, Questions de principes et de methode*, në: St. Alb. I (1964), 67.

23 Krh. H. Pederson, *KZ*, XXXVI (1900), 277.

24 Krh. V. I. Georgiev *Introduzione...* 21-48, 313-314, 322-342.

25 Krh. Milan Budimir, *Grči i Pelasti*, 14ss, Po ai: *Particulae Pelasticae*, në: «ZA» I (1951), 77.

26 Krh. M. V. Garašanin, *Ka jezickoj pripadnosti neolitskog prastanovnistva Balkan*, në: GZM u Sarajevu N. S. XI (1957) 209; B. Gavela, *O ilirskom supstratu na Balkan*, në: *Godišnjak*, CBI III/1, 143-161.

27 Krh. M. V. Garašanin, *Razmatranje o makedonskom Halstatu* në: *Starinar*, N. S. V-VI (1954-55), 38.

28 M. V. Garašanin, *Pontski i stepski uticaj u Donjem Podunavlju i na Balkanu na prelazu iz neolitskog u metalno doba*, në: GZM u Sarajevu, N. S. XV-XVI (1960-61), 5-26.



mund të nxirret përfundimi se në formimin e grupeve etnokulturore indoeuropiane ndikim të rëndësishëm kanë pasur kulturat neolitike<sup>29</sup>. Është interesant edhe fakti se shtresa etnokulturore e neolitit në zonën qendrore të Gadishullit Ballkanik ka zgjatur shumë më tepër se në pjesët e tjera të tij. Në një përfundim të tillë në shpie fakti se pikërisht në pjesën e brendshme të zonës qendrore që e përbën territori i sotëm i KSA i Kosovës, bëhet takimi i grupeve etnokulturore Bubanj-Hum dhe badeno-kostolian me kulturën e hershme të bronzit; sikundër mund të shihet nga materiali i gjetur në lokalitetin e Tjerrtores së Prishtinës, i cili gjendet jo larg Gladnicës<sup>30</sup>.

Me problemin e indoeuropianizimit është e lidhur ngushtë edhe çështja e prejardhjes së dardanëve. Tradita letrare e autorëve të lashtë nuk jep ndonjë mendim të prerë për këtë çështje. Shembull karakteristik i kësaj tradite është Apiani i Aleksandrisë, i cili e shkroi veprën e vet rreth vitit 160 të e.s. Ai e trajton gjenezën e fiseve ilire në mënyrë mitologjike. Ai thotë: «*Bijt e Ilirit kanë qenë Enheleu, Autari, Dardani, Medi, Taulanti dhe Perrebi; vajzat e tij ishin Partha, Daortha, Dasara dhe të tjera, nga kanë rrjedhur taulantët, perrebejtë, enhelejtë, autariatet, dardanët, parthinët, dasaretët dhe daorsët. Thonë se Autari pati bir Panonin ose Pajonin, dhe ky i fundit pati bij Skordiskun dhe Tribalin, nga të cilët morën emrin edhe fiset*»<sup>31</sup>. Në realitet, interpretime të tilla mitologjike në veprat e autorëve të lashtë mund të gjenden jo vetëm për popujt barbarë, por edhe për vetë helenët. Këtu shtrohet pyetja: a paraqiten dardanët si element etnokulturor ballkanik apo anatolian?

Dihet se në territorin e Troadës, në jug të Helespontit, shtrihej një krahinë me emrin Dardania<sup>32</sup>, e cila quhej sipas emrit të qytetit Dardan që gjendej jo larg Ilionit dhe Abidosit<sup>33</sup>. Vetëdija e prejardhjes lindore është shfaqur ndër shumë popuj të vjetër, ndër të cilët në radhë të parë duhet të përmenden romakët dhe maqedonët, dhe madje në sajë të homonimisë së

29 Krh. A. Benac, *Studije o kamenom i bakarnom dobu...* 168.

30 Krh. B. Jovanović, *Badensko-kostalačka grupa i hronologija eneolita u Jugoslaviji*, në: *Starinar*, N. S. XV-XVI (1964-65), 9, J. Glišić, *Pojava ranih bronzanodopskih kultura na Kosovu i Metohiji*, në: *GMKM VI* (1961), 233-244; D. Garašanin, *Quelques elements datant la civilisation de Bubanj-Hum*, në: *AJ. I* (1953), 23 ss.

31 Appian. *Illyr.* IV 2.

32 Krh. Apoll. *rhod I* 931, Appollod. *III* 12; Büchner, *PWRE IV* (1901) col. 2157 ss; Traemer, *PWRE IV* (1901) col. 2163.

33 Strab. *XIII* 587, 595; Diod *XIII* 45; Plin *NH V* 124, 128; Steph. *Byz. s.v.*



toponimeve<sup>34</sup>, oronimeve etj. Nga ky aspekt, edhe dardanët konsideroheshin si pasardhës të trojanëve. Në këtë mënyrë duhet të kuptohet tregimi i Solinit<sup>35</sup>, shkrimtar i kohës së vonë antike, i cili thekson se dardanët janë me prejardhje trojane, por të barbarizuar më vonë. Nga autorët e lashtë vetëm Diodori i lidh dardanët e Gadishullit Ballkanik me ata të Azisë së Vogël, kur thotë se dardanët kishin pushtuar shumë fise të Azisë së Vogël<sup>36</sup>. U theksua se në ç'mënyrë orvateshin popujt e vjetër ta nxirrnin prejardhjen e tyre trojane dhe Tremeri vërente se «*grekët, epirotët, maqedonët dhe romakët nuk do- nin që të kishin si bashkatdhetarë barbarët e egër*»<sup>37</sup>. Pikërisht për këtë arsye lindën mitet, të cilat flasin për bredhjet e Dardanit prej Krete, Argolide dhe Troje<sup>38</sup>.

Emigracionet dhe imigracionet kanë shkuar prej veriut në jug dhe anasjelltas. Vetë pozita e Gadishullit Ballkanik, jo vetëm që i bën të mundshme, por edhe i shpejton këto lëvizje, pa marrë parasysh shkaqet e tyre. Për këto emigracione prej Gadishullit Ballkanik në Azi të Vogël flet edhe Straboni: «*Edhe brigët janë në të vërtetë brygë, njëfarë fisi trak, si- kurse migdonët dhe bebrikët, dhe majdobithinët dhe bithinët dhe thinët, e, do të thosha edhe mariandinët. Këta të gjithë e kanë braktisur krejtësisht Evropën, kurse myzët pjesërisht kanë ngelur*»<sup>39</sup>. Nga kjo mund të konkludohet lehtë se ndër- mjet popujve të Azisë së Vogël dhe Gadishullit Ballkanik ka pasur marrëdhënie të ngushta dhe këto marrëdhënie, në aspek- tin kohor, përcaktohen që në parahistori<sup>40</sup>. Përveç kësaj, këto lëvizje i provojnë edhe ngjashmëritë e emrave trojanë me ata ilirë. Ky fakt nuk dëshmon lëvizjen prej Azisë në Evropë, por anasjelltas. Shtegtimet prej Azisë në Evropë do të shpjego- nin në një anë bredhjet e Eneut dhe të heronjve të tjerë tro- janë siç janë Paridi, Hektori, Priami, Anhisi dhe Asaraku, të cilët kishin prejardhje ballkanike dhe dardane<sup>41</sup>, dhe në anën tjetër bredhjen e Kadmit, birit të mbretit fenikas, të Agenorit

34 Strab. XIII 590.

35 Solin. II 51 (p. 43 15-18) «*Italicus excursus per Liburnos quae gens. Asiatica est, procedit in Dalmatiae pedem, Dalmatia in litem Illyricum, in quo sinu Dardani sedes habent, homines ex Troiana pro- sapio in mores barbaros efferati*».

36 Diod. V. 48.

37 Thraemer, PWRE IV (1901), col. 2177.

38 Krh. Thraemer, PWRE IV (1901), col. 2163-2180.

39 Strab. VII 3, 2.

40 Shih n. qo fq. 34.

41 Krh. Ludolf Malten, *Aineias*, në: Archiv für Religionsge- schichte XXIX (1931), 33 ss.



dhe Telefasës, i cili është konsideruar si themelues i Tebës në Beoti dhe që solli në Heladë kultin e Dionisit nga Egjipti<sup>42</sup>. Por dhe Georg Cipeli<sup>43</sup> ka pasë vërejtur se ky teban, simbol i dyndjes fenikase prej Egjiptit, apo Fenikisë, ka sjellur kulturën dhe mjeshtërinë e përpunimit të metalit. Prej këtej gjoja paska kaluar në Lihnid dhe në Buthua, e mandej është bërë mbret ilir. Me bashkëshorten e vet, Harmoninë, Kadmi kishte pasur disa fëmijë, ndër të cilët edhe Ilirin. Ky element flet në të mirë të lëvizjeve jo nga jugu për në veri, por anasjelltas. Për lëvizjet e dardanëve nga veriu për në jug flasin edhe toponimet e ngjashme në Itali, Iliri, Peloponez dhe në Azi të Vogël. Kështu, për shëmbull, Straboni<sup>44</sup> përmend në Dardani dy fise dardane: galabrët dhe thunatët, analogjia e të cilëve gjendet në jugun e Italisë: galabrët sipas të cilëve quhet edhe krahina e sotme Kalabria dhe Daunët në Apuli<sup>45</sup>. Është vësh-tirë të besohet se kjo ngjashmëri ka qënë e rastit, kur dihet se territoret e Kalabrisë dhe të Apulisë i kanë banuar fiset ilire, mesapët dhe japigët, të cilët ishin vendosur atje nga terri-toret e Ballkanit<sup>46</sup>. Në këtë dyndje të elementit kulturor ilir në Gadishullin Apenin me siguri ka marrë pjesë edhe elementi etnokulturor dardan. Plini Plak<sup>47</sup> e përmend fisin dardan, të cilin e ka shkatërruar Diomedi.

Kur dhe pse kishin ndodhur këto lëvizje të elementëve etnokulturore ballkanike, ndër të cilat edhe të dardanëve?

42 Herodot, II 49.

43 Krh. Georg Zippel, *Die römische Herrschaft in Illyrien bis auf Augustus*, 15 ss.

44 Strab. VII, 5, 7.

45 Plin. NH III 103-104.

46 Lidhja gjenetike e mesapëve dhe e japigëve me ilirët e Ballka-nit duket në emrat ilirë, të cilët gjënden në mbishkrimet isase dhe filialet e saj. Kështu, p.sh. emri Drossos, i cili gjendet në mbishkrimet e Isës dhe Tragurionit po ashtu paraqitet edhe në mbishkrimet mesape në trajtë drossihi; madje Blatios (Issa) është emër i një prijsi nga Apulia, kurse në mbishkrimet mesape është dëshmuar emri blatves blaves. Është sidomos karakteristik emri Sallas, që gjendet përveç në mbishkrimet e Isses dhe Tragurionit, edhe në mbishkrimin e njohur nga fshati Lumbarda, në Korçull, i cili te mesapët është i njohur në trajtën *Salaihi, Salahiai, Sallonas, Salluntum* (krh. *Saleentinoi*), shih: Duje Rendiq-Mioçeviq, *Iliri u natpisima grckih kolonija u Dalmaciji*, në: VAHD LIII (1950-52), Pjesa juglindore e Gadishullit Apenin ka qënë e banuar me japigët dhe mesapët, të cilët janë ilirë (shih: Fanula Papazoglu, *Srednjobalkanska plemena u predrimsko doba*, 103, n. 12); H. Krahe, *Die Sprache der Illyrier*, I. Die Quellen, 12-37: Po ai: *Lexikon altillyrischer Personennamen*, 161; V. Pisani, vep. e cit. në: St. Alb, I (1964), 66.

47 Plin NH III 104.



Tremeri thekson: «...një pjesë e këtyre dardanëve është ndarë dhe ka kaluar në Azi të Vogël, te frigët<sup>48</sup>». Disa këtë lëvizje e lidhin me dyndjet e dorëve, që bëhen në mbarim të shekullit XIII dhe në fillim të shekullit XII p.e.s.<sup>49</sup>.

Por, kohëve të fundit mbizotëron gjithnjë më tepër mendimi se në këtë të ashtuquajtur «dyndje egjeane» ilirët nuk kanë luajtur rolin vendimtar. Në qoftë se pranohet mendimi i përmendur, sipas të cilit drejtimi i këtyre lëvizjeve të popujve i është shmangur pjesës qendrore të Ilirisë, dmth Shqipërisë Veriore, Malit të Zi, Dalmacisë Jugore dhe Qendrore, Hercegovinës, Bosnjës Jugore dhe Rrafshit të Dukagjinit e Sanxhakut<sup>50</sup>, atëhere do të thotë se drejtimi i këtyre lëvizjeve ka shkuar nëpër pjesët më lindore të Gadishullit Ballkanik<sup>51</sup>. Në kundërshtim me këtë mendim, Milutin V. Garashanini mendon se lëvizjet «egjeo-dorike» kanë shkuar kah pjesa perëndimore e Dardanisë, ose nëpër territorin e sotëm të KSA të Kosovës: «Në dyndjen e madhe egjeane — në pjesën e saj të drejtuar nga jugu, rol të dukshëm ka pasur Ballkani Perendimor dhe viset e Kosovës së sotme. Nga kjo edhe mund të konsiderohet, së paku në mënyrë hipotetike, se një pjesë e mirë e formave tipike të qeramikës, që janë më vonë karakteristike për paionët, së bashku me trajtat e caktuara metalike, ka depërtuar nëpër Kosovë kah jugu, duke lënë me siguri anash rrugën e Moravës».<sup>52</sup> Nga vetë konteksti i përmendur shihet se edhe ky mendim është hipotetik. Këtë hipotezë e përforcon edhe më tepër materiali arkeologjik i periudhës kalimtare nga bronzi në hekur, që vjen nga Kosova, pra nga territori qendror i dardanëve. Me fjalë të tjera, ky material arkeologjik ka një veçanti të shënuar, që e dallon prej atij që lidhet me lëvizjet egjeane. Ky fakt flet edhe më tepër në të mirë të tezës se ky territor nuk ka qenë përfshirë nga elementi i dyndjes egjeane dhe njëherit konfirmon lashtësinë e hershme të formimit etnokul-

48 Shih Thraemer, PWRE IV (1901), col. 2177.

49 Krh. Dabinović, *Otkad postoji kmetstvo*, Zagreb, 1940, 33 VI. Milojević *Die dorische Wanderung im Lichte vorgeschichtlichen Funde*, në: Arch. Anzeig. (1949-1950), 13 ss.

50 Krh. B. Čović, *Osnovne karakteristike materijalne kulture Ilira na njihovom centralnom području*, në: Simpozijum 97.

51 Shih A. Benac, *O učešću Ilira u Egejskoj seobi*, në: AR IV-V, JAZU, 329.

52 Krh. M. V. Garašanin. *Istočna granica Ilira prema arheološkim spomenicima...* në: Simpozijum I, 145.



turor të ilirëve në këtë rajon<sup>53</sup>. Përveç kësaj, që në kalimin nga periudha e bronzit të vonshëm në atë të Halshtatit, ekziston një strukturë shoqërore e formuar, me karakter ilir. Si pikë kufitare në mes këtyre dy periudhave më karakteristike është varreza e Bërnicsës së Poshtme, që gjëndet në Kosovë. dhe e cila, në sajë të mënyrës së varrimit të të vdekurve, formës dhe rregullimit të varreve, i takon grupit të kulturës së fushave me urna. Në sajë të analizës së materialit të varrezave të kësaj periudhe, në territorin e Kosovës mund të dallohen disa faza kulturore e ndër të tjera gjëndet edhe riti i djegjes të të vdekurit. A. Benac<sup>54</sup> ka treguar se kremimi i të vdekurve nuk mund të lidhet kurrsesi me dyndjen egjeane. Kështu, pra, varrezës së Bërnicsës së Poshtme i bashkohen, përveç Badovcit në Rudnik (përkatësisht Kishnica në afërsi të Prishtinës), Karagaçi në Mitrovicë (përkatësisht fshati Zhitkovc) dhe varreza në fshatin Varosh, në afërsi të Ferizajt, Gornja Strazhava, 9 km. në veri të Prokuplës<sup>55</sup>, pastaj në Paraçin dhe Rutevc në afërsi të Aleksincit<sup>56</sup>, mandej edhe varrezat në territorin e Moravës<sup>57</sup>. Edhe pse të gjitha këto gjetje arkeologjike vijjnë vetëm nga varrezat dhe jo nga vendbanimet, prapëseprapë mund të njihen bartësit e tyre, të cilët janë, pa mëdyshje, dardanët. Materiali i këtyre lokaliteteve tregon në mënyrë bindëse jo vetëm se është i formuar elementi etnik, por edhe se ekziston një diferencim i strukturës shoqërore, dmth një diferencim i fiseve dardane. Varreza e Bërnicsës së Poshtme, nga aspekti kronologjik, përcaktohet në mbarim të fazës së kulturës së fushave të urnave<sup>58</sup>, gjerësisht në mbarim të periudhës së hershme dhe në fillim të periudhës së mesme të bronzit dhe ajo sipas sistemit kronologjik të Reineckut A2-C<sup>59</sup>, kur duket qartë stabilizimi etnik në Ballkan, kurse sipas M. V. Garashaninit<sup>60</sup> kur fillon dyndja e madhe egjeane. Por, kjo nuk do të thotë se mund të mirret si *terminus post quem* i gjenezës së dardanëve.

53 Për specifitetin e materialit arkeologjik nga kalimi prej periudhës së bronzit në atë të Halshtatit dhe për diferencimin e saj nga materiali egjean më ka tërhequr vërejtjen kustosja e Muzeumit Krahinor të Prishtinës Natasa Šlavković-Djurić.

54 Krh. A. Benac. *O učešću Ilira u Egejskoj seobi...* 327.

55 Krh. D. Krstić, *Gornja Stražova kod Prokuplja*, në: AP. IV 73 ss.

56 Krh. M. V. Garašanin, *Neolithikum und Bronzezeit...*, 68, n. 364 dhe 365.

57 Krh. M. G. Garašanin, AP. IV, 57 ss.

58 Krh. D. Srejšović, *GMKM IV-V (1959-60)*, 83-135.

59 Krh. M. V. Garašanin, *Neolithikum und Bronzezeit...*, 66 ss.

60 Po ai: 82 ss.

22578





Në një përfundim të tillë na shtyn edhe zanafilla e tumave të përmendura, të cilat gjenden në territorin e gjerë të Ballkanit Perëndimor, duke filluar prej Glasinacit, nëpër territorin dardan dhe paion, e deri në Maqedoninë e Epërme. Kjo tregon se bartësit e «kulturës së tumave» janë të karakterit ilir nga territori i Ballkanit perëndimor<sup>61</sup>. Aq më tepër, shfaqja e tumave në territorin qendror ilir është e kohës së bronzit të hershëm, respektivisht e mijëvjeçarit II p.e.s.<sup>62</sup>. Por, që në shekullin XII-XI p.e.s. përfundon formimi i elementit etnokulturor, që njihet me emrin e përbashkët «ilir»<sup>63</sup>.

Si fazë e parë e sigurt, me kulturë materiale të diferencuar qartë mund të mirren pa dyshim varrezat e Shiokos, Dubiçakut dhe shtresa më e re e vendbanimit Hisari afër Suharekës<sup>64</sup>. Pastaj, në rrafshin e Kosovës mund të numërohen kalatë në Kamenicë, Teneshdoll, Bellaçevc, Cernicë, Strezovc, Binçë, Suka e Cërmjanit dhe, jo larg Prizrenit, Vlashnja dhe Vërbnica. Kalasë së Bellaçevcit mund t'i bashkangjitet edhe materiali sporadik i gjetur te Samodrazha<sup>65</sup>. Përveç kësaj kulture specifike të kështjellave, kulturat në territorin qendror ilir, pra, edhe në territorin e dardanëve, duke filluar prej periudhës së Halshtatit, i takojnë grupit Bubanj-Hum. E. Çerškovi thekson: «Mund të supozohet se këto kështjella kanë lindur në një epokë të hershme, kanë vijuar zhvillimin e tyre gjatë gjithë periudhës së bronzit, për t'u bërë në kohën e Halshtatit tipe mbizotëruese të vendbanimeve njerëzore»<sup>66</sup>. Mandej në qera-

61 Krh. I. Mikulčić, *Pelagonija u svetlosti arheoloških spomenika od egejske seobe do Augusta*, 19-23.

62 Krh. B. Čović, *Osnovne karakteristike materijalne kulture... në: Simpozijum I*, 101; M. dhe D. Garašanin, *O problemu ranog brončanog doba u Zapadnoj Srbiji i Bosni*, në: GZM u Sarajevu, N. S. XIII (1958), fq. 14-16; M. V. Garašanin, *Iskopavanje u Ražani*, në: Glasnik SAN V/1, 197-198; M. dhe D. Garašanin, *Neue Hügelgräberforschungen in West-Serbien*, në: AJ II (1956), 14-18; Lj. Dašić, *Preistorijsko naselje na Širokom*, në: GMKM II (1957), 249 ss.

63 Krh. B. Čović, *Mladji praistorijski period*, në: *Kulturna Istorija Bosne i Hercegovine* 94, ss.

64 Krh. N. Slavković—Djurić, *Ilirski tumuli kod Suve Reke*, në: GMKM IX (1964), Prishtina 1965, fq. 537-549. Në këtë pjesë të KSA të Kosovës është sidomos lokaliteti prehistorik në Shiroko, afër Suharekës, i cili me tiparet e veta karakteristike u përket të gjitha periudhave që prej prehistorisë, periudhës së hershme të bronzit, asaj të Halshtatit, Latenit e deri në kohën e kulturës provinciale romake, që pa dyshim bën të nxirren dy përfundime: 1. Banimi i vazhduar i këtyre viseve që nga prehistoria e deri në kohën e pushtimit romak e tutje dhe 2. mundësitë gjeografike për banim dhe për prodhimtari.

65 Krh. E. Čerškov *Rimljani na Kosovu i Metohiji*, 15.

66 Po aty.



mikë ekziston një përqindje sekondare e dukurive stilistike dhe tipologjike, që janë identike në rajonin qendror ilir. Kjo është në realitet forma klasike e Halshtatit. Elemente më karakteristike janë enët e cekëta me buzë të kthyera përbrenda dhe të zbukuruara me rrathë të dhëmbëzuar. Një mënyrë e tillë zbukurimi nuk është gjetur ende jashtë territorit dardan dhe merret si element përcaktues etnokulturor, që gjendet kryekëput në territorin e Kosovës, duke filluar prej Shtipit në Maqedoni, e në veri deri në Mitrovicë, përkatësisht deri në Samodrazha; pastaj në tërë territorin e Rrafshit të Dukagjinit (Prizren-Pejë), kurse kah lindja — në luginën e Moravës deri rreth Vranjës. Rrotulla e dhëmbëzuar del nga përdorimi rreth shekullit V p.e.s. Këtë lloj qeramike me dekor të dhëmbëzuar, si në territorin e Paionisë, ashtu edhe në atë të Dardanisë, e zëvendëson qeramika e hollë La Tène e punuar me çark, e cila kronologjikisht përcaktohet në gjysmën e parë të shekullit V p.e.s.<sup>67</sup>.

Mirëpo, problemi i gjenezës së dardanëve megjithatë mbetet ende i paqartë. Shtrohet pyetja: 1) A janë dardanët bartës të kulturës së tumave, e cila sipas karakterit të saj është ilire; 2) Ose, ndoshta janë ardhës në këtë territor? Pra, a janë dardanët ilirë apo janë filiza të elementit etnik paleomesdhetar, siç i trajton Gërگا Novak?<sup>68</sup>.

Çështja është e lidhur ngushtë me problemin e domethënies së emrit ilir.

Pa marrë parasysh se të dhënat e autorëve të lashtë janë të papërcaktuara në kohë dhe që këto fise i njohin fare pak ose aspak, fiset e Ballkanit qendror, sidomos në aspektin etnik, prapëseprapë emrat «dardan», «ilir» që i përmendin këta autorë duhet të kuptohen më tepër në domethënie etno-gjeografike se sa etnopolitike<sup>69</sup>. Dihet se koncepti «ilir» i takonte një fisi të vogël, i cili shtrihej prej Epidaurit (Cavtati i sotëm) e deri te Lisi (Lëzha) dhe të cilët Plini Plak<sup>70</sup> dhe Pompon Mela<sup>71</sup>

67 Krh. I. Mikulčić, vep. e cit. 18.

68 Krh. Gërگا Novak. *La nazionalità dei Dardani*, në: AASJE, knj. IV/1 (1929) 82-88.

69 «Është konstatuar fakti se koncepti *Illyris* te autorët grekë është shprehje thjeshtë e natyrës gjeografike, me të cilën ata i kanë quajtur fqinjët e tyre veriperëndimorë». (Shih: M. Suić, *Istočna jadranska obala u Pseudo Skilavovu Periplu*, Rad JAZU 306, 136; Po ai: *Simpozijum*, I. Sarajevo 1964, 258 ss dhe 268.

70 Plin. NH III 164: «...eo namque tractu fuere Labeatae, Senedi, Rudini, Sasaei, Grabaei proprieque dicti Illyri et Taulanti et Pyraei».

71 Pomponius Mella II 3: «Partheni et Dassaretæ prima eius teneat: sequentia Taulanti, Enchelaei, Phaeaces. Deinde sunt quos proprie Illyricos vocant: tum Pyraei, et Liburni, et Istria...».



i njohin si «*Illyri proprie dicti*» (ilirë të mirfilltë)<sup>72</sup>. Ky emër është përhapur gjeografikisht në tërë Ballkanin, duke i përfshirë të gjitha fiset e tjera që kishin një bazë të përbashkët në kulturën materiale, e sidomos në atë shpirtërore e posaçërisht në gjuhë<sup>73</sup>.

Për shkak të mungesës së të dhënave nga lashtësia të gjitha trajtimet e deritanishme për përkatësinë etnike të dardanëve bazohen kryesisht në të dhënat e materialit gjuhësor dhe arkeologjik. Problemi kryesor është çështja e substratit etnik të Gadishullit Ballkanik në kohën e formimit etnik të ilirëve në të. Që me kohë K. Paçi<sup>74</sup> ka vërejtur mbi bazën e ngjashmërisë së emrave, se në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik, dmth. në territorin e mëvonshëm të ilirëve, kanë banuar trakët, të cilët i kishin ngushtuar ilirët. Sipas këtij mendimi, lëvizjet ishin bërë kah lindja, nga i kanë shtyrë më tej në lindje myzët e frigët<sup>75</sup>, Kështu pra, përsa i përket çështjes së prejardhjes etnike të dardanëve, ekzistojnë mendime të kundërta, të cilat mund të përmbliidhen në dy teza diametralisht të kundërta në mes tyre e këto janë: 1) dardanët nuk ishin ilirë dhe 2) dardanët ishin ilirë.

Ndër ata që e mohojnë prejardhjen etnike ilire të dardanëve janë rumunët G. G. Mateescu<sup>76</sup> dhe R. Vulpe<sup>77</sup>, bullgarët D. Deçevi<sup>78</sup> dhe Vl. I. Georgievi<sup>79</sup>, kurse prej kroatëve K. Novaku<sup>80</sup>.

72 Mbi problemin «*Illyerii proprie dicti*» shih R. Katičić, *Illyri proprie dicti*, në: ZA XIII-XIV (1964), 87-97.

73 *Wie viele andere Namen grösserer Völker, so ist auch der Illyrier aus einer anfänglich Sprache der Illyrier nur kleinen Keimzelle hervorgegangen.* H. Krahe, *Die I Die Quellen 3*; «*Der Name Illyrier haftete also ursprünglich einem Stamesverband an, der sich von der mitteldalmatischen Küste bis Epirus erstreckte, aber er griff, durch geschichtliche Ereignisse veranlasst, immer weiter nach Norden und Osten auf andere verwandte Stämme über, ein Vorgang, der in der Völker-geschichte nicht vereinzelt dasteht und z.B. bei den Slawen viele Analoga findet*». A. Mayer, *Die Sprache der alten Illyrier*, I, 167.

74 Krh. C. Patsch, *Thrakischen Spuren an der Adria*, në: JOAI X (1907) col. 169-173.

75 Megjithatë Karl Paçi dardanët nuk i konsideron për ilirë shih: *Dardani*, në: PWRE IV (1901), col. 2155-2157.

76 Krh. G. G. Mateescu, *I Traci nelle epigraphi di Roma*, në: *Ephem Dacoro I* (1923), 57 dhe sidomos 92-94.

77 R. Vulpe, *Gli Illiri dell'Italia imperiale Romana*, në: *Ephem Dacoro III* (1925), Roma, 162 ss.

78 Krh. D. Detschew, *Die thrakischen Spracherste*, 118.

79 Krh. Vl. I. Georgiev, *Introduzione alla storia delle lingue indoeuropee*, 175.

80 Krh. G. Novak, *La nazionalità dei Dardani...* 72-89.



G. G. Mateescu deri diku i afrohet mendimit të K. Paçit, duke theksuar se Dardania ishte e banuar më tepër nga elementi trak se sa ilir: «(...)mund të provojmë lehtë karakterin trak të atdheut të veteranit të tretë të mbishkrimit nga Scupi, i cili gjendet në pjesën jugore të Dardanisë, të banuar prej dardanëve, që janë, si duket, më shumë trakë, se sa ilirë»<sup>81</sup>. Nga kjo shihet qartë se teza e tij bazohet në të dhënat e materialit epigrafik, i cili është në përgjithësi i shekullit II dhe i gjysmës së parë të shekullit III të e.s. dhe, në përgjithësi, prej territorit të Remezianës, Naisit dhe Scupit, pra, të pjesës lindore të territorit dardan, ku është e mundshme të ndeshet me elementin trak, së paku për sa i përket materialit onomastik. Një përfundim të ngjashëm, duke përdorur të njëjtën metodë të bashkatdhetarit të vet, duke shfrytëzuar të njëjtin material të shekullit II dhe III të e.s. dhe gati të të njëjtit territor, nxjerr edhe R. Vulpe. Ai thekson se dardanët ishin sa ilirë aq dhe trakë, pra «etnikoni dardan mund të karakterizohet sa ilir aq edhe trak»<sup>82</sup>. Të njëjtin mendim ka edhe linguisti bullgar D. Deçevi. Ai, në sajë të emrave të përveçëm, mendon se Dardania gjatë prehistorisë ishte e banuar prej trakëve<sup>83</sup>.

G. Novaku u mohon prejardhjen ilire dardanëve. Gjithashtu ai mohon identitetin e ilirëve të Glasinacit, si bartës të kulturës halshtatiane me dardanët. Ai, në sajë të të dhënave të autorëve të lashtë të cilët veçmas përmenden ilirët e veçmas dardanët në një anë, dhe duke i lidhur dardanët e Troadës me dardanët e Ballkanit në anën tjetër, konkludon se dardanët nuk ishin ilirë, por popull më vete, i cili kishte qëndruar deri në kohën e Justinianit (527-565), kur «në atdheun e tyre, në të cilin edhe kishte lindur, themelon qytetin Justiniana Prima»<sup>84</sup>. Si K. Paçi ashtu edhe G. Novaku mendon se «trakët e po ashtu edhe ilirët ishin të përhapur gjatë tërë territorit verior të Gadishullit Ballkanik, që nga Deti i Zi e deri te Deti Adriatik dhe nëpër pjesën veriperëndimore të Azisë së Vogël, diku

81 (...) Documenteremo facilmente anche il tracismo della patria del terzo veterano della nostra iscrizione, Scupi, situata nella parte meridionale di Dardania, popolato dai Dardani, che sembrano piuttosto Traci che Illiri». G. G. Mateescu, vep. e cit. 92.

82 «...non è sufficiente l'ethnicon Dardanus il quale può designare tanto un Ilirico quanto un Trace...» R. Vulpe, vep. e cit. 162.

83 «Das Überhandnehmen der thrak. PN in den Inschriften aus Daradanien zeigt dass dieses Land in der Vorillyrischen Zeit von Thrakern besiedelt war». D. Detschew, vep. e cit. 118.

84 Shih Grga Novak, *La nazionalità dei Dardani...* 88-89.



në mes të mijëvjeçarit II dhe I p.e.s.<sup>85</sup> dhe se ilirët kishin depërtuar në Ballkan në kohën e dyndjes egjeane dhe i kishin shtyrë trakët në pjesën lindore të tij<sup>86</sup>. Prandaj, përfundon se dardanët ishin ai popull që dallohej prej ilirëve historikë, por edhe ishin të afërm me banorët e Azisë së Vogël të kohës së bronzit dhe u përkasin popullatave paleomesdhetare. Faktikisht, shihet se këto përfundime janë tepër të përgjithësuara. Ato bazohen kryesisht në material linguistik<sup>87</sup> dhe në hipotezat e parahistorianëve, të cilët mendojnë se bartësit e kulturave neolite në Danubin e Poshtëm ishin trakët dhe se bartësit e kulturave të periudhave të bronzit ishin indoevropianët, kurse trakët, të cilët ishin po ashtu indoevropianë, nuk ishin bartës të kulturave eneolite. Megjithatë, asnjë prej këtyre zgjidhjeve G. Novaku nuk i jep si absolute, por vetëm si metoda për zgjidhjen e një problemi të koklavitur<sup>88</sup>.

Mendimi i Vl. I. Georgievit dallohet prej të tjerëve. Ai i konsideron dardanët si dakomyzë me një mbishtresë ilire, por me elementë të dukshme trake në Dardanië Lindore. Mendimin e vet e bazon në praninë e toponimeve me sufiksa-*dava* (*deva-dova*) «*qytet*»-bria «*qytet*» dhe — para «*lumë*». Prandaj, sipas mendimit të tij, emrat gjeografikë me sufikset e përmendura tregojnë përhapjen e dako-myzyëve në trevën e Gadhullit Ballkanik, në pjesët lindore të Moesia Superior në kohërat e mëvonëshme, gjegjësisht Dardanisë, Dacia Mediterranea dhe Dacia Ripensis<sup>89</sup>. Këtij grupi, sipas mendimit të tij, do t'i përkisnin, në mes të tjerash, edhe tribalët. Dardanët pra, sipas tij, do të ishin elementë ballkanikë që pjesërisht, së bashku me myzët dhe frigët, kishin kaluar prej Dardanisë

85 Shih G. Novak, Vinko Pribojević, *O podrijetlu i zgodama Slavena* 33 (Uvod).

86 Krh. G. Novak, *La nazionalità dei Dardani...* 78, 79, 88.

87 Krh. C. Patsch, *Thrakische Spuren...* 169-173; W. Tomaszek, *Die alten Thraker*, 25; P. Kretschmer, *Einleitung in die Geschichte der griechischen Sprache*, 171 ss, 185, N. Jokl, *ERL VI*, 46; *ner*, në Ebert's Reallexikon der Vorgeschichte, në: AASJE... II/11924 151-161.

88 «Edhe pse asnjë prej këtyre dy konstatimeve nuk janë mjaft të forta, ato prapëseprapë tregojnë rrugët e reja, të cilat megjithatë Vinko Pribojević, *O podrijetlu i zgodama Slavena*, 38 (Uvod).

89 Shih Vl. I. Georgiev; *Introduzione alla storia...* 167, 175, 176; Po ai, *Vprosi na blgarskata etimologia*, 89-99.



në Azi të Vogël, në pjesën veriperëndimore të Troadës<sup>90</sup>. Vl. I. Georgiev këto dyndje i lidh me lëvizjet e «*dyndjes egjeo-dorike*» përafërsisht rreth gjysmës së parë dhe gjysmës së dytë të mijëvjeçarit të dytë, për arsye se dardanët paraqiten në dokumentet egjiptiane si banorë të Azisë së Vogël ndërmjet shekujve XV-XIII p.e.s. Por, ardhja e dardanëve, e migdonëve bie afërsisht në mijëvjeçarin e dytë p.e.s., duke u lëshuar prej Ballkanit qendror kah Trakia. Nga kjo edhe del ruajtja e gjuhës trake si substrat<sup>91</sup>.

Ivica Degmexhiq është e mendimit se dardanët janë të afërt me dardanët e Troadës, të cilët prej andej janë vendosur në Gadishullin Ballkanik pas vitit 284 p.e.s., duke pushtuar territorin që më parë u takonte paionëve. Ata janë ilirizuar gjatë kohës së dyndjeve të ilirëve kah lindja. Këso dyndjesh me dhunë pati shpesh në Dardani. «*Në këtë proces — thotë Ivica Degmexhiq — edhe lumi i madh i dardanëve, i cili më parë quhej me emrin paion Axios dhe të cilin Homeri e lavdëron, ka marrë emrin ilir — Vardarios*»<sup>92</sup>.

Të gjitha mendimet e përmendura bazohen, si u cek më lart, kryesisht në materialin gjuhësor, deri diku edhe në materiale arkeologjike, të cilat deri pas Luftës II Botërore ishin shumë të mangëta dhe, më në fund, edhe në bazë të të dhënave të autorëve të lashtë.

Por kërkimet më të reja gjuhësore në përgjithësi japin rezultate dhe mendime të kundërta me ato që u përmendën më sipër. Sipas Radosllav Katiçiqit<sup>93</sup> fiset e Ballkanit Qendror do t'i përkisnin për nga aspekti onomastik, territorit juglindor ilir. Në këtë zonë ai vë edhe Dardaninë, e cila më vonë bie nën ndikimin e territorit të mesëm dalmat, duke shprehur këtë *expressis verbis*: «*Duket se Dardania në fushën e Kosovës së sotme i ka takuar edhe më parë kësaj zone onomastike, (juglindore, Z. M.). Më vonë bie nën ndikimin e fortë të trevës së*

---

90 «...I Dardani transmigrarono parzialmente insieme con i Misi (e i Frigi) della Dardania (nella penisola Balcanica), verso l'Asia Minore nordoccidentale (nel territorio della Troada)». Po aty, 156, 204.

91 Po ai, 168-169.

92 Krh. Ivica Degmedžić, *Sjeverna i Istočna granica Ilira*, në: Simpozijum II, 58.

93 Krh. Radoslav Katičić, *Die illyrischen Personennamen in ihrem südöstlichen Verbreitung*, në: *Ža XII/L* (1962), 92-120, Po ai: *Das mitteldalmatisch. Namengebiet*, në: *Ža XII/2* (1963) 255-292.



mesme dalmate»<sup>94</sup>. Nga gjithë sa u tha, del i qartë përfundimi se bartësit e kësaj gjuhe në këtë territor ishin ilirët dhe gjuha e tyre mund të quhet ilire<sup>95</sup>. Veç kësaj, bartësit e kësaj gjuhe ilire ishin bashkëkohësit e qytetërimit kreto-mikenas<sup>96</sup>, nga mijëvjeçari II p.e.s siç dokumenton mjaft bindshëm Milan Budimiri<sup>97</sup>. M. V. Garašanini<sup>98</sup> në sajë të analizës së materialit përfundimet e veta i nxjerr në përputhje të plotë me rezultatet e përmendura të studimeve gjuhësore. Madje, edhe nga hapësira ky element gjuhësor ilir shtrihet në një territor të gjërë gjeografik siç provon B. Hronzy<sup>99</sup>, duke i deshifruar tabelat e argjilit nga Knososi. Këtë konstatim të B. Hronzyt e provon edhe prania e toponimisë identike në territorin anatolo-ballkano-egjean<sup>100</sup>. F. Shahermajer konstaton se ky substrat egjean është shumë më i pranishëm në trevën ilire se sa në atë thrakase<sup>101</sup>. Që ky substrat paragrek është i karakterit

94 «Es schient nur, dass die Dardanier auf dem heutigen Kossovo haben. Später sind sie unter starken mitteldalmatischen Einfluss gekommen». R. Katičić, *Liburner, Pannonier und Illyrier*, në Studien Brandenstein (1898-1967), Innsbrucker Beiträge zur Kulturwissenschaft, Innsbruck, 367.

95 «Nur das südöstliche Namengebiet kann also mit voller Berechtigung illyrisch genannt (nënvizuar Z. M.) werden und die Träger dieser Namengebung dürfen uns vorerst als Illyrier gelten, nur ihre Sprache kann Illyrische seien (nënvizoi Z. M.)». R. Katičić, *po aty; Po ai: vanja i jeziku starosjedilaca ilirskih provincija*, në: Simpozijum I, 23; F. Papazoglu, *Dardanska ilirsskih provincija*, në: ZFF VII-1 (1964), 49-75; Po a jo: *Srednjobalkanska plemena u predrimsko doba*, 167 ss. 96 Si n. 27, 28, 33.

97 Krh. M. Budimir, *Grci i Pelasti*, 20 ss; Po ai: *Iliri i Prailiri*, në: VAHD LVIII (1952) 11-12; Po ai: *Ilirski problem i leksička grupa Teuta, jezika*, në GJALB 2 (1965), 5-13.

98 Krh. M. V. Garašanin, në: GZM u Sarajevu, N. S. XI (1957), 209 ss.

99 «Au point de vue ethnologique, il est interessant d'observer que plusieurs des noms des deux premiers alinéés de l'inscription, rappellent les noms des localités illyriens... C'est ainsi que le nom de Baton, Bato, albanais Batush... Stabáya, rappelle le nom de Stoboj...» B. Hronzy, *Histoire de l'Asie antérieure de l'Inde et de la Crete*, 301.

100 Krh. Paul Kretschmer, *Glotta XXXII* (1953), 168 ss; Fritz Schachermayer, *Die ältesten Kulturen Griechenlands*; 239-249; Po ai, PWRE (1954), col. 1994 ss.

101 «Aus dem wenigen was wir vom illyrischen wissen geht freilich hervor, dass in die, dem Sprachkreis das ägäische Substrat stärker durchgeschlungen hat als etwa in trakischen...». Fritz Schachermayer, *Die ältesten Kulturen...*, 168.



indoeuropian e tregon edhe fakti se koha e formimit dhe e diferencimit etnik ilir, i cili tashmë është vendosur në Gadishullin Ballkanik<sup>102</sup>, bie rreth vitit 2000 p.e.s. Këtu edhe jetojnë fatin e tyre historik. Rezistenca e tyre kundër romakëve ishte e pashoqe, sepse këta nuk u asimiluan. Për një shtrirje kaq të lashtë të ilirëve në Gadishullin Ballkanik flasin edhe emrat, të cilët mbarojnë me «issa» dhe «issos» që janë dëshmuar në tërë Gadishullin Ballkanik siç janë: Lissus, Cissus, Gissus, Naisus, Idassa, Issa, Assos, Molossos, Orgessos, Panayassos etj.<sup>103</sup>. Ndër të tjera, ky fakt flet qartë edhe për rolin e elementit paleoballkanik në formimin e etnisë ilire.

Në përfundime të tilla na sjellin edhe analizat e mëtejme të materialit gjuhësor, i cili trajtohet sipas metodologjisë së sotme. R. Katiçiqi ndër të tjera thekson: «*Pa marrë parasysh faktin sa është i kushtëzuar zhvillimi relativ i shoqërisë së cilës i shërben ajo gjuhë, jo vetëm që është e nevojshme për shkak të të dhënave të gjithanshme, por edhe duhet që në parim të jetë e mundshme të përcaktohen marrëdhëniet e përbashkëta të kohës historike dhe linguistike (...) Metodot e hulumtimeve të tilla ende nuk janë përpunuar sa duhet saktë, kështu që orvatjet kërkimore kanë mbetur në trajta shumë primitive dhe në sajë të një situate të tillë u janë hapur dyert koncepteve aprioristike të ndryshme, sikundër janë nordizmi dhe mediteranizmi, të inspiruara me aktualitetin e tepërt të mentalitetit politik»<sup>104</sup>. Më këtë konstatim u është dhënë deri diku edhe përgjigja mendimeve të linguistëve, të cilët dardanëve ua mohojnë karakterin ilir.*

Edhe përkundrejt materialit onomastik joilir<sup>105</sup> në fondin gjuhësor të Dardanisë, prapëseprapë i gjithë territori dardan për nga karakteri gjuhësor dhe formula onomastike i përket

---

102 Krh. A. Benac, *Studije o kamenom i bakarnom dobu...* fq. 168; Po ai: *Prediliri, Protoiliri i Prailiri*, në: Simpozijum I, 59/94; M. V. Garašanin, *Istocna granica prema arheološkim spomenicima*, në: Simpozijum I, 135-176, 260 s, 283 ss.

103 Krh. H. Krahe, *Die alten balkanillyrischen geographischen Namen*, 9-11.

104 Shih R. Katičić, *Recension mbi librin «Giacomo Devoto, Origini Indeeuropee»*, në: *Filologija V* (1967), 206.

105 «*Mundësinë problematike, të mos themi kurfare, të materialit të tillë e ka vërejtur që moti edhe vetë Jokli, i cili e ka shfrytëzuar me shumicë në punimet e veta të hershme»*. M. Budimir, *Grci i Pe-lasti...* 19.



zonës jugore ilire. Formula tripjesëshe onomastike të cilën Duje Rendiq-Mioçević (Duje Rendiq-Miočević) e konstaton në Dalmaci<sup>106</sup> është dëshmuar edhe në materialin epigrafik të Dardanisë<sup>107</sup>. Ndër të tjera, kjo lidhje e përgjithshme jo vetëm jugore ilire, por edhe me materialin gjuhësor të Dalmacisë së mesme me territorin e Dardanisë, shihet edhe në ngjashmërinë e antroponomisë së sunduesve dardanë siç janë: *Longarus, Bato, Monunius dhe Etuta*<sup>108</sup>.

I gjithë materiali onomastik i gjetur në territorin e dardanëve mund të ndahet<sup>109</sup> në dy grupe emrash: 1) grupi lindor, në të cilin ekziston edhe elementi onomastik trak dhe i cili përfshin territorin ndërmjet Shkupit, Kumanovës dhe Nishit dhe 2) grupi perëndimor, në të cilin përfshihet territori i Kosovës dhe, çka është më karakteristike, në të është dëshmuar onomastika e pastër dardane, e rrjedhimisht ilire.

Por, edhe përkundrejt mundësisë së ndarjes së materialit onomastik të territorit dardan, në zonat e përmendura gjeografike dhe, me gjithë praninë e dukshme të materialit onomastik, i cili nuk është ilir, prapëseprapë vetë ky fakt nuk mund të mohojë përkatësinë ilire të etnosit dardan. Sipas parimeve të linguistikës moderne, konstatimi i përkatësisë së ndonjë emri të një zone onomastike të cekur nuk provon edhe përkatësinë etnike të zonës përkatëse gjuhësore<sup>110</sup>. Madje, edhe përfaqësuesit më të dalluar që e mohojnë përkatësinë ilire të

---

106 Krh. Duje Rendiq-Miočević, *Ilirske onomastičke studije I*, në: ŽA X (1-2) 1960, 163-171; ŽA XIII-XIV (1964) 101-110; Po ai: *Ilirska onomastika na latinskom natpisima Dalmacije*, në: VAHD LII. Prolog III, 67 ss; Po ai: *Illyrica, Zum Problem der Illyrischen onomastischen Formel in römischer Zeit*, në: AJ. II (1956) 39-51.

107 Krh. Borka Josifovska, *Jedan neobjavljeni epigrafski spemnik iz Sopista*, në: GZFFUS 16 (1964), 147; E. Čerškov, *Rimljani na Kosovu i Metohiji...* 61 ss.

108 Krh. R. Katičić, *Suvremena istraživanja...*, Simpozijum I, 21-22.

109 Krh. F. Papazoglu, *Dardanska onomastika*, në: ZFF VIII-1 (1964), 49-75, Po ajo: *Srednjobalkanska plemena...*, 167 ss, R. Katičić, *Suvremena Istraživanja...*, 22.

110 «Dabei kann nicht genug hervorgehoben werden, das durch die Feststellung der Zugehörigkeit eines Namens zur Namengebung eines bestimmten Gebiets noch nichts über seine sprachliche Zugehörigkeit gesagt ist». R. Katičić, *Zur Frage der keltischen und panonischen Namengebiet im römischen Dalmatien*, në: Godišnjak, GBI. III/1, 54.



etnosit dardan në bazë të materialit të tillë onomastik, nuk kanë mundur t'i shmangen faktit që një numër emrash janë bërë pronë e territorit të gjerë ballkanik, pa marrë parasysh përkatësinë etnike të bartësve të këtyre emrave<sup>111</sup>. Situata është e ngjashme edhe në territorin e dardanëve<sup>112</sup>.

Nga e gjithë kjo që u tha del përfundimi se fuqia e argumenteve të bazuara në materialin onomastik, në përcaktimin e prejardhjes etnike të ndonjë vendbanimi është nga më të dobëtat «për arsye se emrat përhapen më tepër se sa përkatësia

---

111 Krh. G. G. Mateescu, *vep. e cit.* 79, 144, 203 ss; R. Vulpe, *Vep. e cit.* 137, 138, 142, 145, 155, 170, 176, 203, 209.

112 Megjithqë G. G. Mateescu nuk ka pasur për qëllim të përkufizojë dhe as të shqyrtojë etnogjenezën e dardanëve, gjë që shihet ai, prapëseprapë vjen në përfundim, siç është edhe cekur, në bazë të materialit epigrafik në Nish (Naissus), Remziana (Bela Planka), Scupi (Shkup) pra të pjesës lindore të Dardanisë, ku natyrisht edhe është e mundshme që të ndeshemi me një simbiozë të elementit trako-ilir. Por, në tërë veprën e tij shihet qartë vështrimi aprioristik i problemit me një notë të dukshme, që në çdo mënyrë të provohet përkatësia etnike trake e këtyre viseve. Kjo mund të shihet edhe nga zgjedhja e materialit onomastik për provimin e tezës së vet. Sa për shembull po cekim mbishkrimin nga Naissusi, të cilin e ka marrë dhe G. G. Mateescu, *vep. e cit.* 93; I (ovi) o (ptimo) m (aximo) paterno Aepilofio Sanc (tinius?) Oriens, Cor (nelia) Mide, P. Ael (ius) Cocaius vet (eranus leg (ionis) VII CL (audiae) Sev (eriane) ex voto posu (erunt) Maximo et Aeliano co(n) s(ulibus), në: Jahreshefte des österreichischen archäologischen Instituts III (1900) Beibl. 131, nr. 30 (Prej tashit: JOAI). Më në fund edhe vetë fakti që ky dedikant është ushtar i legjionit VII Klaudian tregon se ky është i huaj, dmth. peregrin ose siç konkludon me të drejtë F. Papazoglu (në ZEF VIII-1/V 1964 66): «Më shumë ka të ngjarë që fjalët, të cilat rrjedhin pas Aepilofio shënojnë një vend në Lindje, ku gjendej tempulli i këtij hyu dhe nëpër të cilin dedikanti ndoshta ka kaluar me rastin e ndonjë fushate». Qëndrimi aprioristik i G. G. Mateescu në orvatjen që në çdo mënyrë të provojë karakterin trak të dardanëve shihet edhe nga fakti se ka shfrytëzuar edhe asi materiali onomastik, i cili është gjetur edhe jashtë territorit administrativ të Dardanisë edhe të viseve xehetare, ku elementi i huaj etnik, në veprimtarinë xehetare ka qënë më se i pranishëm, gjë që në çdo mënyrë ia dobëson vlerën argumentimit të tij. Krh. R. Katičić, *Suvremena istraživanja...* 23; A. Mócsy, *Die Bevölkerung von Pannonien bis zu den Markomannenkriegen.* 165, 180/1, 186/51 ss 163/1; A. Mayer, *Die Sprache der alten Illyrier*, I; A. Holder, *Altceltscher Sprachschatz* — I-III, Leipzig 1896-1914; D. Deçevi, *Die thrakischen Sprachreste*, Wien, 1957; H. Krahe *Lexikon altillyrischer Personennamen*. Heidelberg, 1929 etj. Emra të tillë dhe të ngjashëm të përbashkët në materialin onomastik mund të provohen edhe në kohën e sotme historike gjë që është fryt i zhvillimit të përbashkët shpirtëror dhe i proceseve të emigracionit.



etnike»<sup>113</sup>. Megjithatë, duket se shfaqja e materialit onomastik të huaj në territorin e Dardanisë dhe sidomos në pjesët më lindore të saja, duhet të shpjegohet me faktin e fqinjësisë së elementit etnik trak dhe me formimin e Dakisë Aureliane, respektivisht me transportimin e një pjese të banorëve të Dakisë në në Dacia Mesdhetare të mëvonshme, e cila përfshinte një pjesë të mirë të territorit veriperëndimor të Dardanisë. Ky element i huaj mund të lidhet pa dyshim edhe me fushatën e Krasit kundër dakëve në vitin 29 p.e.s. dhe kundër bastarnëve, të cilët duke ikur prej tij, kalojnë në viset e bregut të djathtë të Danubit, ku edhe pushtojnë tokën e tribalëve si edhe «dardanët, të cilët jetojnë në tokën e tyre (respektivisht të tribalëve, Z. M.)»<sup>114</sup>. Edhe emrat specifike, analogjia e të cilëve nuk mund të provohet dhe që mund të dëshmojnë jashtë Dardanisë, tregojnë për praninë e elementit etnik parailir, cili ishte faktor me rëndësi në ndikimin dhe në formimin etnik dhe sidomos në formimin e onomastikonit dardan. Ky element kohëve të fundit po identifikohet si substrat pellazgoanatolian, idiomat e të cilit, sipas Karl Oshtirit<sup>115</sup> janë ruajtur në të folmet para-ballkanike, respektivisht në të folurit e ilirishtes dhe të trakishtes.

Por, megjithë praninë e emrave me karakter joilir në një pjesë të territorit të Dardanisë, prapëseprapë mund të thuhet pa kurrfarë ngurrimi se nuk mund t'i mohohet karakteri ilir etnosit të vendbanimeve dardane, për arsye se, siç konkludon me të drejtë Fanula Papazoglu: «I marrë në përgjithësi,

113 Krh. R. Katičić, *Diskusija*, në: Simpozijum II, Sarajevo, 1966 (1967) 67. Me fjalë të tjera, me rastin e përdorimit të materialit të tillë duhet të kemi parasysh tri komponentë elementare, të cilat i ka cekur Fr. Ribezzo, e këto janë: «1. Kuadri bindës historik; 2. Ndarja e konkordancave që mund t'i përkasin substratit paraetnik dhe 3. Me numrin e tyre dhe cilësitë ato duhet t'i tejkalojnë konkordancat e rastit, të cilat mund të ndeshen kudo». ap. M. Suić, *Simpozijum II...*, 85. Veç kësaj, edhe vetë përputhja e një grupi dukurish mund të ndeshet në leksikon e popujve të shumnduershëm, në mes të të cilëve s'është thënë të ekzistojnë lidhje etnike, siç e ka treguar, N. Vuliqi me shëmbuj të qartë: Segestani në Persi dhe Segestika në Paioni, Partët në Iran dhe Partinët në Iliri. Një dukuri e ngjashme mund të shihet edhe në antroponimi. (Krh. N. Vulić, *Dardanci*, në: Glas SKA CLV (1933), 65; Po ai: *Die Ortsnamenkunde in der Urgeschichte*, në: WPZ IX (1922), 81 ss; Po ai: *La nationalité des Peoniens*, në: Musée Belge XXX (1927), fq. 107 ss; Po ai: *Dardanci*, në Glas SKA CXIV (1925) 90 ss; Po ai: *La nationalité des Dardanes*, në: Actes du III congrés d'études Byzantines, Athènes 1932, 164.

114 Cass. Dio LI 23, 3.

115 Krh. Karl Oštir, *Beiträge zur alarodischen Sprachwissenschaft* 84, 131.



materiali (onomastik — Z. M.) të cilin e kemi përmbledhur më sipër, tregon se Dardania duhet të konsiderohet si zonë onomastike e veçantë. Fakti se emrat ilirë, gjenden në tërë territorin e Dardanisë dhe se numri i tyre është mjaft i madh dhe të dëshmuar vetëm në Dardani, tregon se onomastika ilire në Dardani ka qënë autoktone dhe jo e marrë nga jashtë<sup>116</sup>.

Në qoftë se i shtojmë këtij konstatimi edhe antroponiminë e sunduesve dardanë, e cila, sipas strukturës, në thelb hyn në leksikun e gjerë të thesarit ilir, atëhere vështirë se mund të mohohet karakteri ilir i etnosit dardan.

Në krahasim me materialin onomastik, materiali toponomastik është më i ndërlikuar<sup>117</sup>. Ndërlikimi tij shihet në faktin se identiteti i toponimeve me elementin trak duket mjaft dhe në ato vise të Dardanisë, në të cilat është dëshmuar onomastika thjesht ilire<sup>118</sup>. Edhe më! Është i njohur fakti se edhe gjuhëtarët<sup>119</sup> nuk kanë mendim të njëjtë mbi problemet e njëjta. Me këtë pa dyshim dobësohet vlera e argumenteve të nxjerra nga ky material, dhe, në anën tjetër, shihet se nga çfarë aspekti niset secili autor.

Është cekur fakti se Vl. I. Georgievi<sup>120</sup>, në bazë të toponimeve, të cilat mbarojnë në prapashtesat *-dava* (*-deva*, *-dovā*) «*qytet*», *-para* «*lum*» dhe *-bria* «*qytet*» është munduar të argumentojë karakterin dak të dardanëve me një mbishtresë ilire. Sipas Strabonit<sup>121</sup>, del se dakët dhe getët flasin një gjuhë. Megjithatë, dihet se këto prapashtesa, përveç këtyre dome thënieve<sup>122</sup> kanë edhe të tjera. Kështu *-dava* (*-deva*, *-dovā*) në iranishten e vjetër do të thotë «*largoj*», në hindishten e vjetër *-deva-h* «*zot*»<sup>123</sup>, madje *-para* në avestishten «*hua*»<sup>124</sup> ose «*bregdet*», «*breg lumi*», «*kufi*», «*mbarim*»<sup>125</sup>.

Megjithatë, duhet të theksohet fakti, të cilin e ka vërejtur që moti edhe J. A. Evansi<sup>126</sup>, se vetëm te Prokopi shihet

116 Shih F. Papazoglu, ZFF VIII-1 (1964), 73.

117 Shih n. 109, 48.

118 Shih n. 106, 48.

119 Mjafton të përmenden vetëm disa: H. Krahe, A. Holder, A. Mayer, D. Detschew (shih vep. e cit).

120 Krh. Vl. I. Georgiev, *Introduzione...* 175-176; Po ai: *Vprosi na balgarskata etimologia*, 89-99.

121 Strab. VII 303-304.

122 Shih Ch. Bartholomae, *Altiranisches Wörterbuch*, col. 688.

123 Shih Walde-Pokorny, *Vergleichendes Wörterbuch der indogermanischen Sprachen* 1, 733.

124 Po aty.

125 Walde-Pokorny, *Vergleichendes Wörterbuch...* II, 39.

126 Krh. J. A. Evans, *Antiquarian researches in Illyricum I-IV*, 47-48.



gërshetimi gjuhësor i elementeve iliro-trake-dako-romake në emrat e lokaliteteve dardane dhe maqedone. Kjo tregon pa dyshim se Prokopi s'e ka njohur mirë etnogeografinë e rajoneve për të cilat shkruan. Madje, me të drejtë ka vërejtur Nikolla Vuliq<sup>127</sup> se përcaktimi kronologjik i prejardhjes së këtyre toponimeve është jo i sigurt, sidomos kur dihet se vepra e Prokopit «*De aedificiis*» është e vitit 558 të e.s. prandaj nga ajo vështirë se mund të nxirret ndonjë perspektivë e kohës, madje në bazë të shumë pak elementeve: tre-katër prapashtesa dhe përcaktimi etnik i bartësve të këtyre toponimeve. Formohet bindja vetvetiu se Vl. I. Georgievi në argumentimin e vet nuk kalkulon substratin etnik paleoballkanik të territorit dardan dhe trak. Kjo e dobëson pa dyshim fuqinë e argumenteve të përfundimeve të nxjerra nga ky lloj i materialit toponomastik. Ndër të tjera, materiali toponomastik është në thelb më konservativ se materiali tjetër gjuhësor. Kjo shihet edhe nga fakti se në emërtimin e disa toponimeve më shpesh ndikon edhe vetë karakteri i vendit, me ç'rast grupimet etnike të ndryshme të njëjtin toponim e përkthejnë prej një gjuhe në një tjetër<sup>128</sup>.

Përveç onomastikës dhe toponomastikës, material linguishtik me rëndësi është pa dyshim edhe emri etnik. Së bashku me emrin dardan, si emër i përbashkët i fiseve dardane përmenden dhe kalabrët dhe thunatët, për të cilët Straboni thotë: «...dardanë janë edhe galabrët të të cilët... gjendet një qytet i lashtë dhe thunatët, të cilët kufizohen në lindje me medët, fis trak»<sup>129</sup>. Dimitër Deçevi<sup>130</sup>, duke u orvatur që dardanët t'i nxjerrë si

127 Krh. N. Vulić, *La nationalité des Dardanes...*, 164; Po ai: *Dardanci*, në: Glas SKA CLV (1933), 65 ss.

128 «Kështu për sh. Deti i Zi në të gjitha gjuhët që fliten në brigjet e tij quhet njësoj dhe të gjitha këto terma kanë domethënie të njëjtë... Është i njohur në rrethinën e Dubrovnikut lokaliteti i quajtur Asamum (disa mendojnë se ky është Slano/Z.M.). Në të njëjtin vend përafërsisht gjendej vendbanimi që në dokumentin mesjetar quhet Lapide. E njëjtë është latinisht dhe ka domethënie gur. Ky është ruajtur deri më sot në trajtën Lapad. Mundemi pra, pa frikë të identifikojmë Asamumin ilir në Lapadin latinisht, për arsye se emri ilir është i afërt (i gjirit, gjermanisht: verwandt) me indishten e vjetër asman (gur) dhe lituanishten asmuo (gur). R. Katičić, *Problemi i proučavanja ilirskog jezika*, në: *Književnik* nr. 19, III/1 Zagreb, 1961, 45.

129 Strab. VII 5, 7.

130 «Die dardanische ovnatai, sind von den thrakischen ovnoi zu trennen. Mann kann daraus folgern, dass die Dardaner ursprünglich Thraker waren». D. Detschew, *Die thrakischen...*, 203. Por W. Tomaschek, *Die alten Thraker*, I, 24 emrin Thunatai e nxjerr prej fjalës shqipe THYENTE me domethënie — me thye, me këputë, me përkulë — lat. *fracti, rupti, conversi*».



elementë trakë, gjen si provë për këtë emrin etnik thunatai, të cilin ai e nxjerr nga trakishtja thynoi. Megjithatë, ky emër është dëshmuar si emër etnie edhe në Italinë e Jugut në trajtën Dauni<sup>131</sup> dhe Calabri<sup>132</sup>, ku pa dyshim, vështirë se mund të jetë i pranishëm elementi trak. Më në fund, edhe vetë emri dardan mund të lidhet shumë lehtë me emrin e fisit dardi në Italinë e Jugut<sup>133</sup>.

Nga territori i dardanëve në fondin leksikor hyjnë edhe disa fitonime, të cilat janë ruajtur në trajtën e glosave. V. Tomasheku<sup>134</sup> thotë shprehimisht se nga gjuha e tyre na janë ruajtur vetëm dy fitonime, të cilat i ka marrë Pedan Dioskuridi nga Anabarza, i kohës së Neronit, në veprën e tij «*Mbi bimët shëruese*»<sup>135</sup>. Këto janë: *aloitis* (një bimë e malit, e cila është përdorur për qetësim, një lloj narkoze), *Absentium rusticum* (një lloj pelini) dhe Pseudo Apulei në veprën e tij, po ashtu «*Mbi bimët shëruese*» përmend: dardani *caliam* (po ashtu një lloj bime e malit)<sup>136</sup>. S'është e thënë që të gjitha këto fitonime me karakter shërues doemos të jenë të fondit gjuhësor ilir, por disa, siç thekson me të drejtë D. Deçevi<sup>137</sup>, janë me prejardhje greke. Megjithatë, disa janë të mendimit se janë të karakterit dardan, dmth. ilir<sup>138</sup>. Këto fitonime, sidoqoftë nuk mund të provojnë përkatësinë etnike ilire të dardanëve, se «*në çdo gjuhë ka huazime dhe në bazë të një ose të dy fjalëve të këtij lloji nuk mund të përcaktohet karakteri i një populli*»<sup>139</sup>.

Territori i Dardanisë, edhe pse me elemente specifike dhe variante lokale, formon një tërësi me territorin boshnjako-maqedon i cili, sipas materialit arkeologjik, i takon me siguri kul-

131 Plin. NH III 103.

132 Plin. NH III 103. H. Krahe, *Balkanillyrische geographische Namen* 103, 112, emrin e tyre ia njeht etnosit ilir.

133 Plin, NH. III 104.

134 Krh. W. Tomashek, *Die alten Thraker* I, 25, II 26.

135 Ped. Diosc. III 3-4 te Pseudo Apulen, 16 (HS 51), 19, 25 (HS 57); «A Graecis dicitur aloe Gallica, alii gentiana, alii Cironion, Dardani aloitis Romani Gentiana, alii comitale. A. Graecis dicitur aristolochia; alii adra riza-Dardani sopitis (...) Eegypti sopoep...» cit. apo D. Detschew, *Die trakischen...* 13, 487, 542.

136 Cit. te A. Mayer, *Die Sprache der alten Illyrier...*, 176 «*Dardanischer Name einer Bergpflanze*».

137 Krh. D. Detschew, vep. e cit. 13, 487, 542.

138 Krh. A. Mayer, vep. e cit. 176; M. Budimir, *O etničkom odnosu Dardanaca prema Ilirima*, në: JIČ. III (1937), 23.

139 Krh. F. Papazoglu, *Srednjobalkanska plemena...* 168.



turës halshtatiane<sup>140</sup>. Në këtë grup përfshihet edhe rajoni i Vardarit dhe i Moravës, për të cilin janë karakteristike varrezat ilire (tumat), që për nga koha shkojnë deri në periudhën e bronzit të hershëm<sup>141</sup>, respektivisht në gjysmën e parë të mijëvjeçarit të dytë dhe gjatë gjithë kohës së periudhës së mesme të bronzit. Këto shtrihen në jug deri në Maqedoninë e Epërme, kështu që përfshijnë edhe territorin e Dardanisë<sup>142</sup>, bartës të cilave kanë qenë pa dyshim ilirët<sup>143</sup>. Duke marrë parasysh shtrirjen e tyre në tërë territorin qendror ballkanik, konstatohet qartë uniteti kulturor i këtyre viseve<sup>144</sup>.

Është e qartë sidomos pamja e periudhës së Halshtatit, dmth. e periudhës së dytë të hekurit, nga e cila janë gjetur edhe materiale në vende të ndryshme të territorit dardan. Material karakteristik me prejardhje halshtatiane është zbuluar në varrezën e Bërnicsës së Poshtme të Kosovës<sup>145</sup>. Ky material është i rëndësishëm edhe për njohjen e formimit të kulturës klasike ilire në këto vise (shekulli VIII-V p.e.s.) me elemente tipike lokale<sup>146</sup>. Për shkak të gjetjeve identike, e ngjashme me këtë varrezë është varreza e Gornja Strazhavës<sup>147</sup>, afër Prokupljes, urnat e së cilës kanë të njëjtat karakteristika të rrethit të kthyer në anën e mbrendshme, por me përmasa më të mëdha se sa ato në Bërnicsën e Poshtme. Madje materiali i Badovcit, i Karagaçit në Mitrovicë të Kosovës, i fshatit Varosh afër Feri-

140 M. V. Garašanin, *Istočna granica Ilira...*, në Simpozijum I 147, Për lidhjen e kësaj kulture halshtatiane me etnosin ilir nuk ka arsye dyshimi: «Që nga pozita e kësaj kulture është e qartë se bartësit e saj definitivë para së gjithash ishin ilirët, popull i grupit gjuhësor indoeuropian, pasardhësit e të cilëve janë shqiptarët e sotëm». Jirži Neustupni, *Praistorija čovečanstva*, Sarajevo 1960, 375.

141 Krh. M. dhe D. Garašanin *O problemu ranobronzanog doba u zapadnoj Srbiji i Bosni*, në: GZM u Sarajevu, N. S. XIII (1958 14-16; B. Čović, *Osnovne karakteristike materijalne kulture Ilira...*, 99; Po ai: *Pogrebni običaji praistorijskih stanovnika glasničkog područja*, në: GZM u Sarajevu, N. S. VIII (1963), 42-46.

142 Krh. Mikulčić, *vep. e cit.* fq. 19. Përndryshe, mbi problemin e tumave, të konstruksionit të tyre dhe të karakterit htono-religjioz me të njëjtin rol në bartësit e ndryshëm etnikë të këtyre riteve funerale shih: F. Robert, *Thymélé*, 247-248.

143 Krh. M. Fluss, PWRE, Suppl, V. col. 328; G. Kacarov, *Car Filip II Makedonski*, 24 ss.

144 Krh. M. V. Garašanin, *Iskopavanje u Ražni*, në: Glasnik SAN V/1, 197-198; Po ai: AJ, II, 14-18; Po ai: *Istočna granica Ilira...* 147.

145 Krh. D. Srejšević, *Praistorijska nekropola u Donjoj Brnjici*, në GMKM IV-V (1959-60), 83-137.

146 F. Papazoglu, *Srednjobalkanska plemena...* 206.

147 Krh. D. Krstić, *Gornja Strazava kod Prokuplja*, në: AA IV (1962) 73.



zajit, i Rutevcit të Aleksincit<sup>148</sup> dhe tumat në Medvexhe afër Lebanit, kronologjikisht janë të kohës së mbarimit të periudhës së bronzit. M. V. Garašanin thotë se rajonin e Lebanit «e kanë banuar pa dyshim dardanët»<sup>149</sup>. Këtij grupi, për shkak të identitetit të materialit, i takojnë tumat e Shirokës dhe Dubicaçakut, afër Suharekës, gjetjet e të cilave janë me prejardhje të periudhës halshtatiane të zhvilluar dhe kanë karakter ilir, kurse «përkatësia etnike e popullsisë së këtij rajoni në kohën e hekurit është në kuptim të ngushtë të fjalës dardane»<sup>150</sup>, Nga materiali ilir i periudhës halshtatiane, variant i posaçëm lokal kosovaro-maqedon janë bylyzykët e Janjevës<sup>151</sup>.

Edhe përkundër materialit të paktë arkeologjik, prapë-prapë mund të identifikohen bartësit e këtyre objekteve, e këta janë, sipas mendimit të përgjithshëm, dardanët, përkatësia ilire e të cilëve është e padyshimtë. Edhe ato elementë të veçanta në inventarin arkeologjik të këtij rajoni në lidhje me pjesët e tjera të territorit qendror të Gadishullit Ballkanik janë vetëm dëshmi se pjesa e ngushtë e Dardanisë me Paioninë dhe me disa pjesë të rajonit të Moravës Jugore dhe Vardarit formojnë një tërësi në vetë<sup>152</sup>. Me këtë, njëkohësisht tregohet edhe kompleksi i caktuar etnik. Që elementi etnik në këtë territor, në

148 Krh. J. Todorović — A. Simović, *Praistorijska nekropola u selu Rutevcu kod Aleksinca*, në: Starinar N. S. IX-X. (1958-59), 267-271, R. Galović, *Praistorijsko naselje kod Aleksinca*, në: Zbornik radova Narodnog Muzeja u Beogradu II (1959), 329-345.

149 Krh. D. Garašanin, *Iskopavanje tumula u Medvedji kod Lebana*, në: Starinar N. S. IX-X (1958-59), 263-265.

150 Krh. N. Slavković — Djurić, *Ilirski tumuli kod Suve Reke*, në GMKM IX (1964), 549.

151 Krh. R. Galović, *Halštatski depo iz Janjeva*, në: GMKM IV-V (1959-60), 255-269. Mbi datimin e këtyre bylyzykëve nuk ekziston një mendim i përbashkët. Disa mendojnë se kjo depo është e kohës së mesme të bronzit. Krh. M. Grbić, *Godišnjak SKA XLIII (1934)*, Beograd 246-247, kurse të tjerët i datojnë me Halshtatin e vonë, Halshtati C (Krh. D. Garašanin, *Studije iz metalnog doba Srbije, IV ostava iz Janjeva na Kosovu*, në Starinar, N. S. IX-X (1958-59), 41; Po ajo: *Katalog metala*, Narodni Muzej Beograda, Praistorijska I. 1954, 35 ss). Kurse M. V. Garašanini gjetjet e metalta në Pomoravle i lidh me Halshtatin e plotë, e këto gjetje përfaqësojnë variantet lokale të kulturës ilire të periudhës së zhvilluar halshtatiane në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik. Për provimin e këtij mendimi M. V. Garašanini, *Jedna skica hronologije metalnog doba Srbije*, në: J. G. III-IV (1951), 45-69.

152 Krh. M. V. Garašanin, *Istocna granica Ilira... në Simpozijum I, 147*; M. dhe D. Garašanin, *Arheološka iskopavanja u selu Radanju, na lokalitetu «Krvi Dol» kaj selo Tarinci* në: Zbornik na Štipskiot naroden Muzej I (1958-59), 9 ss; D. Garašanin, *Les Illyriens dans la region Morava-Vardar à la lumiere des nouvelles fouilles archeologiques*, në: Actes... II, 293.



periudhën e katërt të hekurit (kah mbarimi i shekullit IV p.e.s.) është ruajtur edhe përkundrejt elementit të huaj në krahasim me Maqedoninë, e cila në atë kohë është helenizuar krejtësisht, mund të shihet në bazë të kulturës materiale që, për hir të së vërtetës, duhet të thuhet se është mjaft nën ndikimin e huaj. Por, «në brendi të vendit (kryesisht territori i Kosovës, Z. M.) një pjesë e mirë e elementit të lashtë autokton jeton edhe më me kulturën e dardanëve në viset e rajonit qendror të vendit».<sup>153</sup> Në bazë të këtij elementi të huaj të kulturës materiale në territorin e dardanëve, Vl. I. Georgiev thekson elementin etnik dako-get<sup>154</sup>. Por, siç ka provuar M. V. Garashanini, ilirët shfaqen me kulturën materiale që në epokën e lashtë halshtatiane. Kjo pasqyrohet më së miri në territoret e Paionisë dhe të Maqedonisë me qytetërimin ilir në Dardani<sup>155</sup>. Me këtë rast nuk mund të shmangen marrëdhëniet me fqinjët, kushtet e njëjta në të cilat janë zhvilluar këto grupime etnike të dallueshme ndërmjet tyre. Por, me gjithë materialin ende të pamjaftueshëm nga territori dardan, M. V. Garashanini hedh poshtë me këmbëngulje identitetin e qytetërimit dardan me atë dako-get të periudhës së Latenit III. Mirëpo, ai nuk i përjashton edhe elementet e përbashkëta në qytetërimet e këtyre dy popujve, të cilat në territorin e dardanëve mund të kuptohen edhe si import nga territori i skordiskëve<sup>156</sup>. Ky identitet i kulturës materiale, që shfaqet përgjithësisht në viset kufitare të territorit dardan, është i kuptueshëm për shkak të pranisë së elementit të huaj etnik. Kjo dukuri nuk provon se është bartëse e së njëjtës kulturë në të gjitha periudhat historike dhe në situata të ndryshme kohore<sup>157</sup>. Mate Suiq thekson me të drejtë: «Çështja e importit është gjë normale në kufijtë e ndikimeve kulturore.

153 Krh. M. V. Garašanin, *Ka kronološkom sistemu gvozdenog doba*, në: ZFF VIII-1 (1964), 45.

154 «La cultura di Dardania, almeno durante gli ultimi secoli prima della nostra era e in stretto con la civiltà dacogetica del medesimo tempo». Vl. I. Georgiev, *Introduzione alla storia...* 167, n. 59.

155 Khr. M. Garašanin, *Razmatranja o makedonskom halštat-u. Materijalna kultura, hronologija, etnički problem*, në: *Starinar* N. S. V-VI (1954-55) 38 ss.

156 «...aux Dardaniens, tribu indigène d'origine illyrienne, (nënvizoi Z. M.) et que les objets du caractère de La Tène celtiques pourrait aussi ne représenter que des importations provenant du territoire habité par les Scordisque», M. V. Garašanin, *Contribution à la connaissance de la civilisation des Dardaniens à l'époque de la Tène*, në: *ŽA VIII* (1958), 128; *Po ai: Ka problematici kasnog Latena u Donjem Pomoravlju*, në: *NZ MS*. 18 (1957), 89-93.

157 Krh. Mate Suić, *Zapadne granice Ilira...*, në *Simpozijum II*,



Ato nuk determinojnë as etnosin e as kufijtë etnikë. Çdo bashkësi primitive merr prej ndikimeve të huaja atë që mund ta asimilojë ose ta përdorë».<sup>158</sup>

Me sa u tha më sipër imponohet vetvetiu përfundimi se bartës të kulturës së pjesës qendrore të Gadishullit Ballkanik që përfshin Kosovën, Rrjedhjen e Epërme të Vardarit, Moravën Jugore, Moravën Perëndimore, territorin e Nishavës dhe të Timokut, që prej mbarimit të periudhës së bronzit dhe gjatë kohës së hekurit, La Tenit e tutje, kanë qenë ilirët<sup>159</sup>, të cilët autorët e lashtë i kanë quajtur me emrin e përbashkët dardan. Megjithatë, nuk mund të përjashtohet mundësia se këta kanë qenë të përzier me trakët në anën lindore të kufijve të tyre.

Gërگا Novaku, siç thamë më parë, është orvatur që t'ua mohojë dardanëve prejardhjen ilire<sup>160</sup>. Përveç të dhënave të tjera, ai është përpjekur që për këtë qëllim të shfrytëzojë edhe të dhëna nga autorët e lashtë. Ai, duke i analizuar këto burime, përfundon duke thënë se në realitet «Straboni është i pari, i cili dardanët i konsideron ilirë».<sup>161</sup> Në sajë të një analize të tillë dhe në sajë të disa argumenteve gjuhësore, ai konkludon se dardanët janë element etnik ballkano-anatolian, krejtësisht të ndryshëm nga ilirët, të cilët janë elementë indo-evropian dhe që kishin ardhur në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik kah fillimi i mijëvjeçarit të parë, respektivisht në kohën e Halshtatit.

Mirëpo, në qoftë se analizohen fragmentet e veprave të autorëve të lashtë, do të shihet se nuk është i vetmi as i pari Straboni që dardanët i konsideron ilirë. Nga analiza e tekstit të Strabonit del se burimet që ka shfrytëzuar ky flasin për dardanët si ilirë.

Straboni<sup>162</sup> tregon se si ardianët kanë pësuar disfatë nga romakët dhe kanë qenë të transferuar në brendi të vendit, ku, për shkak të ashpërsisë së vendit, janë zhdukur krejtësisht. Mandej vijon dhe thotë se të njëjtin fat kishin pasë edhe fiset e tjera, që më parë ishin shumë të forta. Kështu, nga sulmi i

158 Krh. Mate Suić, *po aty*, 87.

159 Përveç literaturës së parashtruar shih edhe: M. dhe D. Garašanin. *Arheološka nalazišta u Srbiji*, 116.

160 Krh. M. dhe D. Garašanin, *po aty*, 116 ss; M. Garašanin. *Istočna granica Ilira...* në: Simpozijum I, 150. N. Vulić, *Kelti u našoj zemlji*, në: Glas SKA CXX (1926), 57-77; M. Fluss, *PWRE XV Suppl.* col. 2363.

161 Gërگا Novak, *La nazionalità dei Dardani*, 74; «Strabone e il primo scrittore, che ha annoverato i Dardani tra gli Iliri».

162 Strab. VII 5, 1.



galëve thyhen skordiskët dhe bojët, kurse nga ilirët autariatët; ardianët e tribalët e pësojnë nga trakët. Në një vend tjetër, Straboni, duke folur për shtrirjen e përgjithshme të fiseve, në Ballkan, në mes të tjerash, thotë se gjatë Bregdetit Adriatik gjendet toka e ardianëve, kurse në mes, Paionia, e cila shtrihet në një rajon malor. Në të dy anët e saj, në kufi me Trakinë, gjenden Rodopet, pas Hemit, mal shumë i lartë «dhe në anën tjetër, në veri, shtrihen viset ilire, pastaj toka e autariatëve dhe e dardanëve»<sup>163</sup>. Nga këto dy të dhëna shihet qartë se Straboni i konsideron ilirë, edhe pse në këtë konstatimin e fundit mund të vërehet një kundërthënie. Në realitet, nga vetë konteksti veçohen autariatët dhe dardanët. Por, vetë fakti se këtu veçohen edhe autariatët prej ilirëve, të cilëve nuk mund t'u mohohet prejardhja ilire, madje në kohën e tij ata edhe nuk ekzistonin më, tregon se Straboni kishte shfrytëzuar vepra më të lashta. Vetë kjo flet se dardanëve ua kanë njohur përkatësinë ilire edhe shumë autorë të lashtë. Kundërthënien fiktive, të përmendur e shpjegon Straboni vetë, për arsye se, sa herë që flet për dardanët, ai i përmend gjithmonë së bashku me fiset ilire më të njohura dhe më të forta.

Edhe Appiani, shkrimtar i kohës së Hadrianit, dardanët i konsideron ilirë. Është interesant që në gjenealogjinë e heronjve eponime të «fiseve ilire»<sup>164</sup> ai përmend vetëm disa fise ilire madje edhe ato të cilat në kohën e tij nuk ekzistonin më, kurse të tjerët, psh ato në pjesët perëndimore të Gadishullit Ballkanik, gjatë bregdetit Adriatik, nuk i përmend. Në veprën e tij «*Illyriké*» ai thotë «*ilirët janë të shumtë, dhe për ta ende flitet, siç është e natyrshme, në një hapësirë aq të madhe*»<sup>165</sup>. Në një vend tjetër, duke folur mbi sakrilegjin me rastin e grabitjes së tempujve nga ana e keltëve, ai i përmend dardanët kur thotë: «*fiset ilire dhe sidomos skordiskët, medët dhe dardanët, të cilët u vërsulën kundër Maqedonisë dhe Heladës dhe grabitën shumë tempuj, si edhe atë të Delfit...*»<sup>166</sup>. Appiani i përmend gabimisht skordiskët, të cilët me siguri janë fis kelt, dhe medët, të cilët janë trakë në rrjedhjen e mesme të Strumicës, me ilirët. Këta së bashku me ilirët në vitin 88 p.e.s. plaçkitën tempullin e Zeusit dhe në vitin 83 p.e.s. tempullin e Apolonit në Delfi. Kjo është edhe shënjë e pakujdesisë së

163 Strab. VII 5, 1.

164 Appian, *Illyr.* 4, 2 (shih nr. 32, 9).

165 Appian, *Illyr.* 4, 3.

166 Appian, *Illyr.* 4, 5.



tij në shfrytëzimin e burimeve, veti kjo që është karakteristikë e të gjithë autorëve të lashtë.

Appiani në këtë drejtim dallohet. Është interesant se pakujdesia e Appianit vërehet edhe në përdorimin e burimeve edhe për ngjarjet më të afërta për të, si është p.sh. përshkrimi i luftërave të Augustit në Ilirik. Këtu del në shesh fakti se ai as që është munduar t'i përcaktojë mirë operacionet luftarakë. E kur dihet se edhe në shfrytëzimin dhe në zgjedhjen e burimeve Appiani ka qenë eklektik, atëhere mund të kuptohen të gjitha kontradiktat e brendshme dhe kontaminacionet prej të cilave vuajnë tekstet e tija<sup>167</sup>. Por, edhe përkundër këtij kontaminacioni dhe kontradiktave për sa i përket përkatësisë etnike të fiseve të ndryshme, Appiani, duke folur për faktin se Antoni, në vitin 36 p.e.s. e dërgon ushtrinë për dimërim, në një anë për t'u pasuruar dhe në anën tjetër për t'i sulmuar parthinët (fis ilir në afërsi të Epidamnit, i cili e përkrahte Brutin) dhe pjesën tjetër të ushtrisë kundër dardanëve (po ashtu fis ilir), të cilët pa ndërprerje invadonin Maqedoninë<sup>168</sup>, duke lënë të kuptohet se dardanët i konsideron ilirë.

Përveç Strabonit dhe Appianit, për përkatësinë ilire të dardanëve flasin edhe Nikolla i Damaskut<sup>169</sup>, Mantissa proverbiorum<sup>170</sup>, mandej Paradoxographus i Vatikanit<sup>171</sup>. Të gjithë autorët e tjerë, kur flasin mbi dardanët, i veçojnë këta nga ilirët. Të tillë janë Polibi<sup>172</sup> dhe Livi<sup>173</sup>. Kjo ndarje e ilirëve prej dardanëve nuk do të thotë ende se këta dallonin nga pikpamja etnike nga ilirët<sup>174</sup>. Kjo vlen edhe për të dhënat e Polibit, i cili, sipas mendimit të G. Novakut<sup>175</sup>, ishte ndër njohësit më të mirë të viseve fqinje të Maqedonisë.

Pas një analize të kujdesshme dhe të gjithanëshme të burimeve të shkruara, arrihet në përfundimin se zhvillimi histo-

167 PWRE 1/2, col. 234; J. Dobiasz, *Studie Appianove knize illyrske*. 13 ss.

168 Appian. *Emph.* V 75. 320.

169 *Fragmenta historicarum graecarum* II A, fr. 107 J, ed. C. Müller Parisii 1874.

170 *Paraemiographi Graeci* III, 27, ed. Leusch 1871.

171 *Rerum naturalium scriptores Graeci*, ed. O. Keller I, 1877, 112.

172 Polyb. II 6. XXVIII 8.

173 Liv. XXVI 25, XXVIII 8, XXII 32, XXIII 19, XL 57 etj.

174 «Nga heshtja e tyre nuk mund të nxirret përfundimi që dardanët janë etnikisht diçka tjetër në krahasim me ilirët. Kjo për shkak se po të kishin ndonjë gjë për ta thënë për etnosin e tyre ata do ta thoshin». N. Vulčić, *Narodnost cara Justinijana*, në Glas SKA CLX/1934, 77.

175 Krh. G. Novak, *La nazionalità dei Dardani...* 75.



rik i ilirëve për autorët e lashtë ishte në periferi të interesit të tyre. Disa, sikundër janë Tukididi, Teopompi, Diodori dhe Justini i përmendin ilirët vetëm si fqinjë të Maqedonisë dhe i përmendin vetëm atë që sa implikohen në zhvillimin historik të Maqedonisë, kurse të tjerët sikurse Polibi, Livi, Dion Cassi ilirët i përmendin në lidhje me invadimin e romakëve në Ballkan. Përveç kësaj, koncepti «ilir» te autorët antikë paraqet vetëm një emër të përbashkët me karakter etnogjeografik, pa marrë parasysh ndonjë fis të caktuar. Për këtë, më së miri mund të bindemi nga një dëshmi që e gjejmë te Appiani. Duke folur mbi luftërat që romakët zhvillonin kundër maqedonëve në vitin 168, para e.s. në kohën e sundimit të mbretit maqedon Perseut, ai thotë se aleati i tij ishte «Genci, mbreti i një fisi tjetër ilir»<sup>176</sup> respektivisht «mbreti i një fisi ilir të afërt të maqedonëve»<sup>177</sup>. Edhe pse Appiani ishte i pakujdesshëm në shfrytëzimin e burimeve, prapëseprapë si prokurator provincial i Perandorisë Romake, kishte njohuri për mbretin e fundit ilir Gencin, me thyerjen e të cilit i ishte dhënë grusht vdekjeprurës formacionit shtetëror të ilirëve të jugut. Është theksuar se ilirët përmenden në veprat e autorëve të lashtë vetëm kur ata gjenden në sferat e interesit të fuqive të jashtme. Shembull të qartë për këtë kemi Tit Livin, i cili emrat e fiseve ilire, dhe kryesisht ato, të cilat ishin në mënyrë direkte të përziera në hesapet e pushtesve romakë, për herë të parë i përmend, madje pas luftës së dytë iliro-romake: «Këtu, nga tribuna (Anici — Z. M.) shpall, me miratimin e këshillit, se vullneti i Senatit dhe i popullit romak është t'i linte të lirë ilirët dhe t'i hiqte trupat nga gjithë qytetet, nga kështjellat e fortesat, se jo vetëm do të ishin të lirë...»<sup>178</sup>

Nga kjo mund të konkludohet qartë se kanë ndikuar ngjarje të jashtme në situatat e caktuara te autorët e lashtë për trajtimin e ilirëve në veprat e tyre. Siç thekson me të drejtë Borivoje Çoviqi (Borivoje Covič), ilirët janë marrë në shqyrtim vetëm kur «(...) kanë pasur nevojë për plotësimin e pamjes të një rajoni gjeografik ose për të dhënë një skicë të shkur-

176 Appian. *Illyr.* 4, 9.

177 Appian. *Macedon.* 18.

178 Liv. XLV 26, 13-15; «Ibi pro tribunali pronuntiavit de sententia consuli Senatū populūque Romanū Illyrios esse liberos,(..) sed etiam immunes fore I ssenses et Taulantios Dassaretiorum, Pirustas, Rhizontas, Olcinatas, quod incolumi Gentio ad Romanos defecissent. Daorsis quoque immunitatem dare, quod relicto Caravantio cum armis ad Romanos transissent. Scodrensibus et Dasarentibus et Selepitanis ceterisque Illyris vectigal dimidium eius, quod regi pependissent impostum...»



tër mbi ngjarjet që kishin ndodhur në të kaluarën»<sup>179</sup>. Veç kësaj, ekzistonin dy koncepte rreth Ilirisë: njëri grek dhe tjetri romak. Edhe ky fakt ka ndikuar pa dyshim në formimin e mendimeve jo të njëjta te autorët antikë në çështjen e aspektit të shtrirjes gjeografike të Ilirikut. Sipas konceptit grek, Iliriku ka përfshirë rajonet që në perëndim kufizoheshin me detin Adriatik, në veri me Danubin, në jug me malet Keraune dhe në lindje me Maqedoninë dhe me malet e Sharrit<sup>180</sup>. Sipas konceptit romak, ai ka përfshirë Paioninë, Recinë, Dalmacinë, Malin e Zi, dhe Shqipërinë<sup>181</sup>.

Megjithatë duhet të theksohet se Iliriku është koncept i përbashkët etnogjeografik, i cili përfshinte fiset që shtriheshin prej veriperëndimit nëpër pjesën qendrore dhe jugperëndimore të Gadishullit Ballkanik dhe jo pa ndonjë karakteristikë themelore të përbashkët, është fjala për të njëjtën gjuhë ose kulturë materiale dhe shpirtërore. Vetëm kështu mund të kuptohet edhe fakti që me këtë emër përfshiheshin edhe fiset më pak të rëndësishme, të cilat autorët e lashtë i njihnin më pak<sup>182</sup>. Këtë e miraton edhe shënimi i emrave të tyre fisnore përkundër vendbanimeve fisnore ilire, të cilat janë shënuar si pasojë e implikimeve të jashtme politike, qoftë Maqedonia apo Roma, ose qofshin pasojë e marrëdhënieve të tyre ndërfisnore, të zotuara në mënyrë jetike për ruajtjen e pavarësisë së tyre, ose për zgjerimin e kufijve territorialë. Këto rrethana kanë ndikuar që disa fise ilire të jenë më të njohura për autorët e lashtë për shkak të aspektit territorial, po edhe për arsye të marrëdhënieve të tyre shoqërore-politike. Kjo është pasqyruar edhe në emërtimin dhe në njohjen e emrave të disa grupimeve të dalluara, siç është rasti me dardanët, ardianët, autariatët, enhelejt, taulantët etj. Madje të dhënat e autorëve

179 Krh. B. Cović, *O izvorima za istoriju Autarijata*, në: *Godišnjak CBI V/3*, 103.

180 Ptol. II, 16, 1; Appian, *Illyr*, 4, 6, 9, 29; Strab. VII, 5, 1.

181 Plin. NH III 22, 26.

182 «Die Verhältnisse der illyrischen Völker sind besonders dadurch überaus schwierig weil die Geographie der vielen kleinen Stämme noch unklar ist und, weil die alten Schriftsteller sehr oft von einzelnen Stämmen unter dem Gesamtnamen Illyrier sprechen» J. G. Droysen, *Das dardanische Fürstentum, Kleine Schriften zur ältesten Geschichte I*, 89: «Die Griechen verstanden unter Illyrien das Land welches im Süden von den keraunischen Bergen, im Westen vom adriatischen Meere und den Ostalpen, im Norden von der Donau, im Osten vom Schar-Dagh begrenzt wurde». G. Zippel, *vep. e cit.*, 5; «...die illyrischen Stämme von den Schriftstellern meistens nur mit den allgemeinen Namen» Illyrier «bezeichnet werden». C. Schutt, *Untersuchungen zur Geschichte der alten Illyrien*, 20.



të lashtë, pa marrë parasysh të kujt janë dhe për të cilat grupime etnokulturore është fjala, mund të kuptohen drejt vetëm si emërtime gjeopolitike e më pak si emërtime thjesht etnike. Jashtë këtyre rrethanave historike-politike, çdo mendim tjetër mund të sjellë përfundime me përmasa të mëdha dhe koncepte diametralisht të kundërta, sikundër është fjala për konceptin «ilir»<sup>183</sup>. F. Papazoglu, edhe pse në mënyrë tërthore, pranon se ai «është emër i një fisi ose emër i përbashkët me të cilin grekët i kanë quajtur fqinjët veriorë»<sup>184</sup>, dhe hedh poshtë mendimin se koncepti «ilir» përbën një emër të përbashkët me karakter etno-gjeografik. F. Papazoglu, duke u nisur prej propozimit të përmendur dhe, megjithëse pranon mendimin se ilirët nuk kishin pasur zhvillim historik unik, gjë për të cilën ndër të tjera flet ndarja e burimeve të shkruara në dy grupe<sup>185</sup>, orvatet prapëseprapë që në mënyrë artificiale, por jo edhe me argumente bindëse, (për arsye se të gjitha argumentet e saj pak a shumë janë të bazuara jo vetëm në të dhëna fragmentare të autorëve të lashtë, por edhe në përcaktimin e kohës së këtyre fragmenteve jo të përcaktuara) të argumentojë se koncepti «ilir» e merr domethënien e vet historike në formacionin shtetëror të dinastisë së Bardhyllit, dmth. në zhvillimin e kontinuitetit historik të Ilirisë së Ju-

183 «Kaum noch erwahnenswert und später Verfasser selbst zurückgenommen ist die missbrauchliche Verwendung des Illyrier-Namens durch V. Georgiev in dessen Schrift Die Träger kretisch-mykenischen Kultur ihre Herkunft und ihre Sprache. I. Teil: Urgriechische und Urillyrier, II. Teil: Italiker und Urillyrier (Sofia 1937: 38) Folgeschicht der Kelten und Illyrier» — ZcPn. 20 (1936) 315-322, 489-522; 21 (1940), 55- 1669. Darin wird der Versuch unternommen, Illyrier mit Hilfe von angeblich auf diese zurückgehendem Eigennamen in fast ganz Europa (bis nach Spanien und den Britischen Inseln hin) nachzuweisen; selbst bei der Ausbildung des Keltentums soll eine illyrische Komponente beteiligt gewesen sein». (Nuk ka nevojë të përmendet shpërdorimi i emrit ilir, edhe autori vet V. Georgiev është tërhequr. Ai e pa gabimin e bërë në veprën e vet. Pasoja më të mëdha pati para së gjithash punimi i J. Pokornyt. Në këtë punim autori orvatet të provojë, nëpërmes të emrave personalë me gjasë ilirë, që ilirët ishin shtrirë gati në tërë Evropën (deri te ujdhesat spanjole dhe britanike); Sipas tij, ilirët kanë pjesë në formimin e gjuhës kelte»). (H. Krahe. *Vom Illyrischen zum Alteuropäischen*, në: LXIX 3, 205-206.

184 «...nom d'une tribu ou denomination commune appliquée par les Grecs à leurs voisins du Nord-ouest...» F. Papazoglu, *Les origines et la destinée de l'Etat illyrien*, në: «Historija» XIV/2 (1965) od 150; Po ajo; *Poreklo i razvoj ilirske drzave*, në: Godišnjak CBIV/3. 128.

185 Krh. F. Papazoglu, *Historia*, XIV/2, 148: Godišnjak CBIV/3, 128.



gut. I gjithë ky argumentim i shërben autores për heqjen e disa mbretërve ilirë nga procesi historik i dardanëve dhe për inkuadrimin e tyre në kuadrin e Ilirisë së Jugut<sup>186</sup>. Këta janë Monuni, Grabi etj.

Në qoftë se pranohet ky mendim i F. Papazoglut për domethënien etnopolitike të konceptit «ilir» vetëm në kuadrin e formacionit shtetëror të Ilirisë së Jugut, si të sqarohet atëhere fakti i njohur se me këtë koncept, në kohën romake, përfshihen jo vetëm ato fise që shtrihen gjatë Bregdetit Adriatik dhe që prejardhja e tyre ilire nuk mund të vihet në dyshim, por edhe ato fise që shtriheshin në brendi deri në Danub, siç mund të shihet në sajë të të dhënave të autorëve të lashtë?<sup>187</sup>. Mandej nuk duhet lënë pa përmendur fakti se ata, duke i shfrytëzuar veprat e autorëve të lashtë më të vjetër, të cilat kanë humbur — përdorin shpesh herë shprehjet «thonë» «tregojnë» — dhe në këtë mënyrë e transmetojnë traditën. Veç kësaj, si të kuptohet kontaminacioni dhe përçarja e fiseve të ndryshme ilire, të cilat për një kohë të gjatë ishin autonome? Këtë fakt e thekson edhe vetë F. Papazoglu<sup>188</sup>. Që kjo vërejtje është me vend, shihet edhe nga mënyra e ardhjes në fron të mbretëreshës Teuta. Ajo, për të hipur në fron, detyrohet të lejojë piraterinë në det pa kurrfarë pengesash, ndërsa krerëve fisnorë u jep liri, kështu që ndërhyrja e tyre ndihet jo vetëm në marrëdhëniet e tyre të brendshme, por edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare. Kjo shihet më së miri edhe nga përgjigja që mbretëresha Teuta u jep delegatëve romakë, vëllezërve Koruncan, të cilën na e transmeton Polibi, kur thotë: «(...) mbretërve nuk u lejon ligja që t'i pengojnë ilirët që në mënyrë private të pasurohen me të mirat e detit»<sup>189</sup>.

Nga gjithë sa u tha, mund të nxirret përfundimi se dalin të pasuksesshme orvatjet e mohimit të prejardhjes ilire të etnisë dardane në sajë të të dhënave fragmentare të autorëve të lashtë<sup>190</sup>, të cilat janë kronologjikisht të pacaktuara dhe

186 Që *Monumi* nuk mund të ketë qenë mbret dardan, siç është menduar deri vonë, është provuar edhe në bazë të materialit numizmatik nga Shqipëria. Po ashtu, edhe sistematizimi i tij kronologjik pikërisht në bazë të materialit numizmatik nga Shqipëria nuk përputhet me atë që e jep F. Papazoglu. Krh. H. Ceka, *Probleme të numizmatikës ilire*, 10 ss.

187 Appian, *Illyr*, 4, 1. (*Grekët i quajnë ilirë të gjitha ato fise, që jetojnë mbi Maqedoninë dhe Thrakinë, duke u kufizuar me Kaonët dhe thesprotët deri te lumi Istros*); Strab. VII 5, 1 etj.

188 Krh. F. Papazoglu, *Historia* XIV/2 (1965). 149.

189 Polyb. II, 8, 8.

190 Dihet p.sh. që veprës së Appianit i mungon kreu 28 d.m.th., pikërisht ai që flet për ilirët. Krh. PWRE I/2, col. 234 ss.



mjaft kontradiktore. Kjo provon faktin se njohuritë e tyre për ilirët dhe fiset e tyre ishin shumë të mangëta, dhe dijet e tyre për ta vinin vetëm nga marrëdhëniet me Maqedoninë dhe Romën. Koncepti ilir nuk mund të kuptohet ndryshe, por vetëm si emër i përbashkët, me të cilin përfshihen edhe dardanët. Por, dihet se përveç emrit të përbashkët autorët e lashtë kanë përdorur edhe emra të veçantë, për çdo fis që shtrihej në veri të Helladës, për çka gjejmë dëshmi te Appiani, kur thotë: «(...) *jo vetëm ilirët, por edhe paionët (respektivisht paionët, Z. M.) në afërsinë e të cilëve gjenden edhe retët edhe norikët, edhe myzët që gjenden në Evropë dhe të gjitha fiset që kufizohen me këto dhe jetojnë në anën e djathtë të atij që lundron nëpër Histros (Danub Z. M.), dallohen prej së larti poshtë prej helenëve dhe secilin e quajnë me emrin e tij të veçantë, por viset e të gjithë këtyre i quajmë me emrin e përbashkët «ilir»*»<sup>191</sup>.

Për këtë arsye, bie poshtë mendimi i G. Novakut, sipas të cilit, dardanët do të veçoheshin prej ilirëve halshtatianë. Vërtet, ka një varg autorësh, të cilët dardanët i trajtojnë veçmas, si bie fjala Dion Kasi dhe Zonara<sup>192</sup>, të cilët flasin për konfliktet ndërmjet dardanëve dhe Maqedonisë, «*së cilës ia shkretojnë fushat, por të cilët jetojnë në veri të ilirëve dhe të maqedonëve*». Ciceroni<sup>193</sup>, Cezari<sup>194</sup> dhe shumë të tjerë, i përdorin më pak këta emra, me domethënie etnike e më shumë me domethënie politike. Dhe, me të drejtë Nikolla Vuliq konkludon se «*kjo nuk ka të bëjë me pozitën etnike të dardanëve*»<sup>195</sup>.

Duke marrë parasysh krejt sa u tha për prejardhjen etnike të dardanëve, del se ata kanë qenë ilirë me një substrat etnik paleoballkanik, i cili sipas M. Budimirit do të ishte substrat pellazg. Megjithatë, fakti që dardanët përmenden në veprat e autorëve nga mbarimi i shek. V, nuk e mënjanon konstatimin e mësipërm. Kjo edhe mund të kuptohet kur dihet se e tërë tregtia e grekëve me fqinjët veriorë është bërë kryesisht nëpër Danub. Interesi i tyre për «barbarët», që ishin fqinjë të tyre

191 Appian, *Illyr.* 4, 6.

192 Zon. IX. 15, 4 (Dion Cassius).

193 Cicero Pro P. Sextio 43.

194 Caesar. Bell. civ. III 4; Interesant është të ceket se G. Novaku merr të dhënat e Pseudo Skylakut. Por, është e njohur se të dhënat e tij kanë të bëjnë me bregun lindor të Adriatikut, e kurrsesi me bregdetin e Gadishullit Ballkanik. Scylacis Cariandensis, *Periplus 22 ss* (ed. *Geographi Graeci Minores I*, Parisiis 1855).

195 Krh. N. Vulić, *Dardanci*, në: Glas SKA CLV (1933), 73.



veriorë, ishte i rastit dhe i përkohshëm. Siç thotë R. Katiçiq: «Shkruanin për ta nëse kishin konflikte ushtarake, nëse merreshin me piratëri në det ose nëse kishte diçka me interes rreth dokeve të tyre të çuditshme»<sup>196</sup>. Veç kësaj, u pa nga aspekti arkeologjik se nuk mund të pranohet mendimi sipas të cilit territori i dardanëve ishte ilirizuar në kohët e vonshme, dmth. në kohën e sundimit të romakëve apo të maqedonëve. Vetë fakti që dardanët ishin të rrethuar nga fiset ilire bën të pamundshme ruajtjen e tyre si element mesdhetar, siç mendon G. Novaku, përballë dyndjeve të mëdha të indo-europianëve<sup>197</sup>. Dhe, disa komponente të përbashkëta, të cilat mund të konstatohen te trakët dhe te dardanët, mund të provojnë vetëm bazën e përbashkët të zhvillimit të tyre, dmth. kushtet e njëjta apo të ngjashme të zhvillimit të tyre historik, e kurrsesi prejardhjen e përbashkët etnike. Kjo më së miri mund të shihet në dukurinë e kulturës shpirtërore dhe të konceptit fetar, siç është, bie fjala, adhurimi i kalorësit trak, që përfshin një territor të gjërë edhe jashtë territorit trak. Po ashtu, edhe në bazë të adhurimit të hyut trak Zberturdo, i cili është dëshmuar edhe në territorin dardan, si në Ljubence afër Shkupit<sup>198</sup>, apo Zbeltiurdi në Kaçanik<sup>199</sup>, nuk mund të arrihet në përcaktimin e përkatësisë etnike trake të adhuruesve të këtij hyu, me që dihet se shumë popuj i kanë përvetësuar dhe i shtinë në panteonin e vet perënditë e huaja.

Mandej, sikundër që «fiset e një gjuhe nuk prodhojnë me-demos qeramikën e një tipi dhe anasjelltas»<sup>200</sup>, po ashtu edhe shtrirja e emrave të ngjashëm ose të njëjtë nuk mund të tregojë asgjë të përcaktuar rreth përkatësisë etnike të bartësve të tyre<sup>201</sup>. Më në fund, se në çfarë shtrembërimesh mund të arrihet në sajë të ngjashmërisë së emrave ose në sajë të emrave të njëjtë, dhe në elementin etnokulturor të njëjtë, shihet nga rasti i J. G. Drojzenit (J. G. Droysen-it)<sup>202</sup>, i cili në bazë të ngjashmërisë së emrit Bato, konkludon se dezidiatët ishin të bashkuar me dardanët në kryengritjen e madhe ilire kundër romakëve të viteve 6-9 të e.s., gjë që nuk mund të pranohet kurrsesi.

196 Krh. R. Katičić, *Književnik*, br. 19, III/1, 40; B. Čović *Godišnjak CBIV/3*, 110.

197 Krh. M. Budimir, *JIC III* (1937), 17.

198 CIL. III. 8191.

199 *Spomenik Srpske Kraljevske Akademije LXXI*, 55, n. 179.

200 Krh. R. Katičić *Književnik*, br. 19 III/1, 53.

201 Krh. N. Vulić, *Dardanci*, në: *Glas SKA CXIV* (1925), 90 ss; Po ai: *Dardanci*, në: *Glas SKA CLX* (1933), 63 ss.

202 Krh. J. G. Droysen, *Geschichte des Hellenismus*. III/2, 27, n. 1.



Është interesant se përfaqësuesit e argumentimit të karakterit etnik trak për dardanët shfrytëzojnë materiale që s'përfaqesin asgjë. Kjo më së miri shihet te G. G. Mateescu<sup>203</sup>, i cili në bazë të mbishkrimeve nga Shkupi, bie fjala atij, në të cilin lexohet se njëfarë *T. Aur. Gaius (Flavia) Scupis* ka qenë «*natione Bessus*», ka dashur të konkludojë se i tërë territori i Shkupit, ka qenë trak. Por, të gjitha kërkimet e deritanishme, që janë bërë lidhur me këto probleme tregojnë dobësinë e një konkludimi të tillë induktiv, duke i ballafaquar me të drejtë një varg shembujsh të ngjashëm nga lokalitetet e ndryshme, në të cilat përmendet emri dardanus<sup>204</sup>, nga shihet se njëfarë *Jacinti* paska qenë grek<sup>205</sup> dhe u quaka *Dardanus*; madje *Messia Dardana quasillaria* (skllavja Messia, e quajtur Dardana)<sup>206</sup>, apo *M. Cocceius Messicus*<sup>207</sup>, dmth myzë me emrin kelt të prindërve<sup>208</sup>, ose *Dardanus Aurelius Paetinia (nus)*<sup>209</sup> dhe *M. Aurelius Dardanus (domu) Ulpia Serdica*<sup>210</sup> etj. Nuk mund të mënjanohet se të gjitha këto dëshmi epigrafike janë të shekullit II të e.s. apo të vitit 195 të e.s. Kryesisht, pra, është fjala për ushtarët e liruar, apo ata të cilët e kishin mbaruar shërbimin ushtarak dhe emrat e të cilëve gjendeshin në listën e Viminacit. Ata mund të rekrutoheshin prej viseve të ndryshme, sidomos kur dihet se të gjithë kryesisht i përkisnin legjionit VII Klaudian. Të gjithë këta ushtarë që e kishin mbaruar detyrimin ushtarak mund të vendoseshin në Dardani dhe të arrinin deri diku ta ndryshonin relacionin strukturor të popullsisë së vendit, por me këtë nuk mund të shpjgohet dhe zgjidhet i tërë problemi i ndërlikuar etnik i territorit dardan dhe i popullsisë së tij. Në qoftë se marrim parasysh që në fondin e këtij materiali epigrafik ka edhe emra nga vendburimet e xeherorëve, në të cilat, përveç elementit autokton, kanë jetuar edhe të huajt, madje edhe të atyre viseve të cilat kanë qenë jashtë territorit administrativ dardan në kohën e romakëve (dhe është konstatuar se këtë material me shumicë e ka shfrytëzuar G. G. Mateescu), atëhere del në shesh qartaz

203 Krh. G. G. Mateescu, vep. e cit. 93.

204 Krh. N. Vulić, Glas SKA CXIV (1925), fq. 90 ss; Glas SKA CLV (1933) 70-71; F. Papazoglu, ZFF VIII/1 71; Po ajo: *Srednjo-ballkanska plemena...*, 187.

205 CIL od VI 6346.

206 CIL VI 6343.

207 CIL III 3546.

208 A. Holder, I, 1056.

209 CIL VI 32559.

210 CIL VI 32628.



baza e dobët e përfundimeve që nxirren prej materialit të përmendur.

Por, në qoftë se rajoni I dhe II, dmth viset perëndimore të Dardanisë i karakterizon onomastika thjesht ilire, qoftë antroponomia qoftë toponimia në krahasim me rajonin III dhe IV, dmth viset lindore të Dardanisë ku përveç onomastikës dhe toponomastikës ilire, ndihet prania e elementit trak (këtu duhet pa tjetër të mirren parasysh viset më lindore të Dardanisë, ku simbioza e të dy elementëve të ndryshëm etnikë është më se normale) dhe prania e emrave të përgjithshëm dhe karakteristikë ilirë<sup>211</sup>, atëherë shihet sheshazi se materiali gjuhësor i territorit dardan nuk mund të ndahet prej atij të përgjithshmit ilir. Kjo mund të kuptohet në mënyrën që vetë dardanët janë me prejardhje etnike ilire edhe për shkak të pozitës së tyre gjeografike specifike, e cila bën të mundshme që në disa forma të jetës politike dhe shoqërore të dallohen prej ilirëve në përgjithësi. Ky dallim, që ekzistonte ndërmjet fiseve ilire dhe dallimi në aspektin gjuhësor, kohëve të fundit po del në shesh gjithënjë e më shumë. Ky fakt po kushtëzon që gjithnjë më tepër të braktiset mendimi tradicional mbi gjuhën unike në territorin e gjërë që prej lumit Po në Itali, e deri në Maqedoni dhe në Danub të lindje. Kështu po arrihet në tërësitë gjuhësore të caktuara. Lidhja e tyre po konstatohet në territorin ilir<sup>212</sup>. Hans Krahe, duke studjuar hidroniminë e Evropës, ka ardhur në përfundim për ekzistencën e një gjuhe të lashtë evropiane», e cila ende nuk është klasifikuar në gjuhët e veçanta të mëvonshme, dhe që është e vërtetuar jo vetëm me hidroniminë e lashtë, por edhe me një varg karakteristikash të përbashkëta gramatikore dhe me një shumicë fjalësh»<sup>213</sup>. Ky konstatim ka shumë rëndësi, për arsye se sjell një dritë të re

211 Krh. R. Katičić, *ŽA* 12/1 (1962); *ŽA* 12/2 (1963), 255-192; *Suvremena istraživanja...*, 22-23; F. Papazoglu, *ZFF* VIII/1, 49-68; *Historia*, XIV/2, (1965), 164; *Srednjobalkanska plemena...*, 173-184.

212 Krh. R. Katičić, *ŽA* 12 (1962), 95-120; *ŽA* 12/2 (1963), 255-292; *Suvremena istraživanja...*, 9-58; H. Krahe, *Das Venetische, seine Stellung in Kreise der verwandten Sprachen*, Heidelberg, 1950; Po ai: *Sprache und Vorzeit*, Heidelberg, 1954; Po ai: *Vom illyrischen zum Alteuropäischen...* 201--212; J. Untermann, *Die venetischen Personennamen*, Weisbaden, 1951; Duje Rendić-Miočević, *Onomastičke Studije sa teritorije Liburna*, në Zbornik Instituta za historijske nauke u Zadru, 1955, 125-141.

213 «Die Existenz des Alteuropäischen, das noch nicht in die späteren Einzelsprachen gegliedert war, wird nicht allein durch die alte Hydronymie gewährleistet, sondern zusätzlich durch eine ganze Reihe von gemeinsamen Merkmalen der Grammatik und das Wortschatzes», H. Krahe, *Vom illyrischen zum Alteuropäischen*, 210.



në ngjashmëritë dhe në identitetet e materialit gjuhësor jo vetëm të territorit dardan, por edhe të gjithë Gadishullit Ballkanik, i cili është, «si pjesa më e madhe e vendeve evropiane, vetëm një rajon me plot relikte dhe pasardhës të hidronimisë së lashtë», dhe i cili «ishte, të thuash, në të njëjtën mënyrë provincë e Europës së lashtë»<sup>215</sup>. Veç kësaj, nuk është e tepërt të theksohet fakti se edhe vetë karakteri i gjuhës trake është ende i paqartë<sup>216</sup>.

Prandaj, me rastin e shfrytëzimit të materialit gjuhësor duhet të mirret parasysh ekzistenca e substratit paleoballkanik, që është i përhapur në tërë territorin e pellgut mesdhetar dhe prania e të cilit është dëshmuar gjithku, pra edhe në Ballkan, element etnik me të cilin dardanët ilirë janë asimiluar ose pjesërisht i janë larguar. Për ekzistencën e këtij substrati etnik paleoballkanik flet edhe shënimi i Agatharhidit nga Knidi, që thotë se dardanët kanë pasur më se njëmijë duloj, njësoj si ardianët, të cilët kanë pasur edhe nga tremijë prospelatë<sup>217</sup>. Një nga komponentët karakteristike të këtij elementi etnik paleoballkanik-mesdhetar ka qenë edhe hareja, gëzimi, kënga dhe muzika, veti, që sipas Strabonit<sup>218</sup>, kanë qenë dukuri të përditshme te dardanët.

Nga e gjithë kjo që u tha vetvetiu imponohet përfundimi se dardanët janë me prejardhje ilire, me një element etnokulturor të dukshëm paleoballkanik dhe me gërshetime të elementit thrak në skajet lindore të territorit të tyre. Më në fund, pjesa dërmuese e shkencëtarëve, të cilët merren me problemin, që trajtuam, përkrah prejardhjen ilire të dardanëve.

---

214 «Die nordwestliche Balkanhalbinsel war also mit anderen Wörtern wie die meistens Länder Europas eine Gebiet mit vielen Resten und Nachkommen der alten Hydronymie, war sozusagen ebenfalls alteuropäische Provinz», H. Krahe *vep. e cit.* 209.

215 D. Detschewi konsideron se trakishtja është një gjuhë etruskoide e ngjashme (gjerm. verwandt) me paragreken, e cila është indo-europianizuar nën ndikimin e skitëve iraniane (Krh. D. Detschew, *Charakteristik der thrakschen Sprache*, në: BE. v. II (1960), 147-213).

216 Atheneus VI 272 d; IV 271 e.

217 Strab. VII 2, 7.



## II. STRUKTURAT POLITIKE, SOCIALE DHE EKONOMIKE TË FISEVE ILIRE NË DRITËN E TË DHËNAVE TË AUTORËVE TË LASHTË

Sado që për këto çështje deri më tani është shkruar mjaft, qoftë nga aspekti arkeologjik e numizmatik, qoftë nga aspekti filologjik apo historik, prapëseprapë lidhur me disa aspekte të çështjeve të cekura gjendemi ende në sferën e hipotezave. Një gjendje të këtillë e ka shkaktuar në një anë mungesa e materialit arkeologjik, i cili ende nuk është i mjaftueshëm nga tërë treva gjeografike e njohur, ku shtriheshin fiset ilire, dhe nga ana tjetër fragmentariteti i të dhënave të autorëve të lashtë. Këto dy momente pa dyshim ndikojnë në shtruarjen dhe në konceptimin e çështjeve themelore të strukturave politike, sociale dhe ekonomike të fiseve ilire. Por, megjithatë, në kuadrin e mundësive që na ofrojnë të dhënat e autorëve të lashtë, sado edhe pjesërisht, është e mundshme që të jipen disa veçanti, por edhe elemente të përbashkëta të strukturave për të cilat do të bëhet fjalë këtu. Dhe në qoftë se do të ndihet nevoja e pashmangshme, në mungesë të materialit tjetër dhe për hir të qartësisë, do të shfrytëzohen edhe rezultatet e disiplinave të tjera ndihmëse si të arkeologjisë, numizmatikës dhe të epigrafisë.

Që në fillim u tha se mungesa kryesore e të dhënave të autorëve të lashtë shihet në fragmentaritetin e tyre, në pa-



saktësinë dhe në fantazinë në përshkrimet dhe në tregimet e tyre. Për një gjë të tillë kanë qenë të vetëdijshëm edhe vetë ata. Kjo mund të shihet më së miri nga fjalët e logografit Hekatej nga Mileti i shekullit VI p.e.s. i cili, ndër të tjera, shprehimisht thotë: «*Hekateu nga Mileti flet kështu: Këtë po e shkruaj siç mendoj se është e vërteta. Se ç'ka tregojnë grekët, e shumta e tyre është qesharake, siç më duket*»<sup>1</sup>. Madje edhe atëherë kur ata flasin për ilirët, për fiset e tyre dhe sidomos për marrëdhëniet e tyre me botën e jashtme, gjithmonë flitet në kontekstin e politikës maqedone, apo romake. Dhe pikërisht, shikuar nga ky aspekt, kuptohet qartë mosvijmësia e historisë së fiseve ilire që na përshkruajnë autorët e lashtë. Veç kësaj, veprat e këtyre autorëve, të cilat na flasin për ilirët në kontekstin e politikës maqedone, për nga koha janë më të lashtat. Ç'është më e rëndësishme ndryshe nga autorët romakë, që janë për nga koha më të rinjtë, dhe në veprat e tyre për ilirët flitet në kontekstin e politikës romake dhe si pasqyrim i praktikës së politikës së përditshme, këta autorë shfrytëzojnë edhe burimet më të lashta. Me fjalë të tjera, autorëve romakë nuk u intereson e kaluara e lashtë. Atëherë, a duhet të na befasojë fakti pse te disa autorë të lashtë, në një kohë të caktuar, emrat e disa fiseve ilire nuk përmenden, ose pse ndonjë tjetër paraqitet papritmas në një kohë të caktuar historike? Përveç mungesave të cekura duhet theksuar edhe fakti, që ata në sqarimin e së kaluarës jo vetëm të popujve të vet, por edhe të barbarëve, përdorin kryesisht mite dhe legjenda. Mjafton që këtu si shembull të përmendet Apiani i Aleksandrisë dhe shpjegimi i tij gjenealogjik i fiseve ilire<sup>2</sup>. Lirisht mund të thuhet se një metodë e tillë e ndriçimit të lashtësisë së cilitdo popull ose të cilitdo fisi ka qenë karakteristike e gjithë autorëve, pavarësisht nëse është fjala për autorët grekë apo romakë. Nuk duhet harruar fakti se tyre, ose siç thotë me të drejtë H. Kuhni se «*sa më vonë që kanë shkruar autorët për marrëdhëniet e lashta agrare romake, aq më fantastike janë përfundimet e nxjerra nga bujqësia*

1 FHG I: «*Hekateios Milesios hode mynthetai tade grafo hos moi dokei alethea eimai gar Hellenon logoi poloi to kai geloioi, hos emoi fainontai eisin*».

2 App. Illyr. IV: «*Kai tode moi malista, polla mytheunton hetera kai Miadon, kai Taulanta, kai Perraibon genesthai kai thygateras, Partho kai Daortho kai Dassaro, kai heteras. Hothen eisi Taulantioi te kai Perraiboi kai Enhelees, kai Autarieis kai Parthenoi, kai Dassaretioi kai Darsoi*».



e kohës së tyre, përfundime këto që japin tërësisht një tablo jo të saktë»<sup>3</sup>. Veç përfundimeve fantastike dhe elementëve mitologjiko-legjendare, në veprat e autorëve të lashtë ndeshemi edhe me të dhëna kontradiktore. Kjo më së miri, mund të vërehet kur bëhet fjalë për topografinë e fiseve ilire, treva gjeografike e të cilëve shtrihej në afërsinë imediate të botës greke. Këtë pasaktësi mund ta konstatojmë madje edhe te ata autorë të cilët për nga koha i takojnë epokës së Augustit. Kështu p.sh. Plini Plak<sup>4</sup>, kur flet për konventin salonitan, ai vetëm e parashtron, duke mos u munduar ta përmirësojë saktësisht nga pikëpamja gjeografike. As te Straboni<sup>5</sup> nuk kemi situatë më të mirë. Ai madje nuk i përmbahet as renditjes alfabetike, siç bën Plini Plak. Si shembull ilustrativ të kësaj kontradikte mund të marrim rastin e shtrirjes gjeografike të ardianëve. Lidhur me këtë është diskutuar mjaft<sup>6</sup>. Pas një analize të gjithanshme të burimeve të shkruara, që bëjnë fjalë për ardianët në një interval kohor prej shek. IV-II p.e.s., shtrirjen e tyre në trevën bregdetare mund ta ndjekim deri në vitin 135 p.e.s., kur, për shkak të kryengritjes, konsulli romak Serv Fulv Plaku, arriti që me ndihmën e 1000 këmbësorëve dhe 500 kalorësve, t'i mundë dhe me dhunë t'i transferojë në brendi, larg detit. Edhe të dhënat e Plinit Plak<sup>7</sup>, që flasin se ardianët gjendeshin në konventin naronitan tregojnë që për nga koha këta duhet të inkuadrohen pas kësaj periudhe. Kjo shihet qartë nga fakti se si Plini ashtu edhe Varroni, në veprën e të cilit Plini mbështetet, ardianët i paraqesin si plaçkitës të hershëm të Italisë.

Veç faktit se të dhënat e autorëve të lashtë nuk duhet të shfrytëzohen (nga aspekti kronologjik) horizontalisht, por as në mënyrë skematike, duhet pasur parasysh se me të dhënat për nga koha të ndryshme duhen pritur edhe lëvizje rajonale të

3 Krh. H. Kuhn, *Opšta privredna istorija*, 41.

4 Plin. NH III 14-143: «Salona... Petunt in eam iura... Delmatae, Deuri, Ditiones, Maezaei, Sardeates... nunc soli prope noscuntur Cerauni, Daersi, Daesitiatas, Docleatae, Deretini, Deremistae, Dindari, Glinditiones, Melcumani, Naresii, Scirtari, Siculotae, Vardaei».

5 Strab. VII 5, 3 — «Ethne d'esti ton Pannonion Breukoi kai Andizetioi kai Ditiones kai Perustai kai Mazaioi kai Daisitiatai, hon Baton hegemon, kai alla asemotera, mikra ha diateinei mehri Dalmatias, shedon de ti kai Ardiaion, ionti pros naton».

6 Krh. F. Papazoglu, ZFF VII-1, 1963, 71-84; M. Zaninović. Godišnjak CBI IV/2, 1966, 72, shën. 136 (këtu gjendet e tërë literatura e hershme lidhur me këtë çështje).

7 Plin. NH III 142-144: «Populatoresque quondam Italiae Vardaei non amplius quam XX decurris».



ndonjë fisi<sup>8</sup>; duhet pasur parasysh se edhe emrat siç janë Delmatë, Dardanë, Autariatë, Desidatë, Labeatë, Dokleatë, Histre, Ardianë etj. duhen kuptuar si emra të përbashkët me karakter etno-politik në kuadrin e të cilëve përfshihen edhe shumë fise të tjera ilire të njohura ose të panjohura<sup>9</sup>.

Sidoqoftë kontradiktat të cilat i hasim tek veprat e autorëve të lashtë mund të sqarohen në qoftë se materiali arkeologjik i një zone të caktuar përputhet me të dhënat e autorëve të lashtë siç është, bie fjala, rasti me materialin arkeologjik të autariatëve të shek. VI apo të shek. V p.e.s.<sup>10</sup>.

Megjithatë duhet të kemi gjithmonë parasysh faktin që disa forma të kulturës materiale të një zone të caktuar dhe të përkufizuar etnogjeografik mund të kalojnë në trevën e ndonjë fisi tjetër. Këtë e provon edhe rasti i autariatëve në periudhën e II-III Reinecke, apo i Halstatt-it CD. Kjo dukuri është shprehje e një uniteti kulturor, siç është rasti me trevën e Bosnjës, të Sërbisë jugperëndimore, me pjesët e Malit të Zi dhe të Sanxhakut, duke përfshirë këtu edhe trevën e Shqipërisë deri te lumi Mat<sup>11</sup>. Megjithatë shtrirja e këtyllë e kulturës së përmendur nuk do të thotë që autariatët shtriheshin në tërë trevën.

Dhe pikërisht në dritën e asaj çka u tha më sipër, të dhënat e autorëve të lashtë mund të na ndihmojnë për të sqaruar dhe kuptuar drejt shumë dukuri të jetës politike, sociale dhe ekonomike të fiseve ilire.

Një element tjetër serioz që e vështirëson shfrytëzimin e të dhënave të autorëve të lashtë është çështja e nocionit «ilir». Sipas Pompon Meles<sup>12</sup> dhe Plinit Plak<sup>13</sup>, i cili, duke folur për konventin naronitan, ndër të tjera përmend edhe «Illyri proprie dicti», (ilirët e mirëfilltë). Ka kohë kur M. Suiqi<sup>14</sup>, nën

8 Krh. R. Katičić, *Godišnjak CBI XIV/13, 1977, 5-82.*

9 Krh. N. Vulić, *Glas SKA CXIV/1925, 78/ss.* Megjithatë nuk na duket i arsyeshëm dhe as bindës mendimi i M. Zaninoviçit *Godišnjak CBI IV/2, 1966, 72* shënimi 136) i cili emrat e cekur i konsideron si gjeografikë, e jo fisnorë. Në të njëjtën mënyrë ka menduar përpara edhe M. Garašanin-i (shih: *Istorija Crne Gore I, 92, 110*). Kjo nuk mund të pranohet sidomos kur është fjala për ardianët dhe për dardanët, të cilat janë organizuar politikisht, pavarësisht nga forma e jashtme e tyre.

10 Krh. R. Gandeveva, *Moralische und soziale Charakteristik... Actes Ie, vol. II, 128.*

11 Krh. M. Garašanin, *Glas SANU CCLX/1, 1974, 20*, shënim 87.

12 Pomp. Mella II, 3, 56: «... quos propriae Illyrios vocant...»

13 Plin. NH 142-144: «...eo namque tractu fuere Labeatae, Senedi, Rudini, Sassaei, Grabaei proprieque dicti Illyri...»

14 Krh. M. Suić, *Rad JAZU 306, 1955, 137-138.*



ndikimin e mendimeve të disa autorëve të lashtë dhe në sajë të analizës së veprës së Pseudo Skilasit, të njohur si «Periplus», pat menduar që ky nocion «ilir» nuk ka përfshirë në fillim edhe fiset tjera në veri. Por megjithatë ai thotë se ky nocion është thjesht i karakterit gjeografik; kështu i quanin grekët fqinjët e tyre që shtriheshin në veriperëndim të Gadishullit Ballkanik.

Të tjerët mendojnë<sup>15</sup>, se në përhapjen e këtij nocioni në tërë pjesën veriperëndimore dhe në atë qendrore të Gadishullit ballkanik rol të rëndësishëm ka pasur historia politike. Me transferimin e qendrës së vjetër politike, (konkretisht këtu mendojmë në mbretërinë e Bardhyllit e cila më vonë njihet si mbretëri e ardianëve), ky emër është bartur në veri.

Edhe pse nuk mendojmë të merremi më gjerësisht me këtë problematikë, megjithatë mendojmë që një metodë e tillë përgjithësuese në sqarimin e nocionit «ilir» dhe të shtrirjes së tij gjeografike, nuk mund t'u bëjë ballë kundërshtimeve që imponohen.

Me fjalë të tjera, mendojmë që si gjeografi Pompon Mela, ashtu edhe polihistoriani Plini Plak nuk janë interesuar aq fort për problematikën etnike ilire sa për strukturat e tyre politike e shoqërore, dhe shtrirjen e tyre gjeografike. Nga ana tjetër vetvetiu shtrohet pyetja e shtrirjes së saktë gjeografike të këtyre «Illyri proprie dicti», nën emrin e të cilëve me siguri përfshihen edhe shumë emra të një numri të madh të fiseve të tjera ilire. Kur themi kështu kemi parasysh faktin që autorët e lashtë nuk i kanë kushtuar kujdes përcaktimit të saktë të shtrirjes gjeografike të fiseve ilire<sup>16</sup>. Madje do të ishte i vështirë aplikimi i një etnominimi të këtillë në një trevë kaq të madhe gjeografike, duke përfshirë kështu një numër të madh fisesh, etnikisht krejtësisht të dalluara, sikur këto fise të mos kishin pasur një bazë të përbashkët etnokulturore dhe gjuhësore. Kuptohet se këtu nuk e mohojmë apriori rolin politik, por, siç thotë me të drejtë edhe M. Garashanin<sup>17</sup>, ky paraqet vetëm një nga komponentet në përhapjen e këtij emri.

Megjithë vështirësitë evidente që lidhen me shfrytëzimin

---

15 Krh. R. Katičić, *ŽA XIV/1964*, 177. F. Papazoglu, *Historia XIV/1965*, 162: «*Le prestige du nom illyrien était tel, qu'il prevalut dans le nouveau royaume*», respektivisht në: *Godišnjak CBI V/3*, 1967, 135. «*Prestiz ilirskog imena bio je takav da je on preovladalo u novoj ujedinjenoj kraljevini*».

16 Shih. shën. 4.

17 Krh. M. Garašanin, *Glas SANU CCLX/1*, 1974, 46.



e veprave të autorëve të lashtë, të dhënat e tyre na janë më se të nevojshme, në rend të parë për rikonstruimin dhe për njohjen e historisë politike, sociale, ekonomike dhe të dukurive të tjera kulturore e shpirtërore të fiseve ilire.

## A. Strukturat politike

Që në fillim u tha se shënimet e para për ilirët të autorët e lashtë janë të lidhura me ngjarjet dhe me marrëdhëniet e tyre me maqedonët. Por, meqë është karakteristikë e përgjithshme e tyre të kopjuarit e njëri-tjetrit, është e vështirë të përcaktohen të dhënat e tyre nga pikëpamja kohore.

Me që në shek. VII e VI p.e.s. ilirët ndërmarrin aksione të shpeshta plaçkitëse në Maqedoni dhe në Delf, ata bëhen objekt i interesimit të autorëve të lashtë. Kështu, lajmet e para për ta i gjejmë te logografët kur këta flasin për enkelejtë, veprat e të cilëve, për fat të keq, nuk janë ruajtur<sup>18</sup>. Për ta flet edhe Herodoti<sup>19</sup>.

Në gjysmën e dytë të shek. V para e.s., duke folur mbi luftën civile që në vitin 436 para e.s. shpërtheu në Epidamn, Tukididi i përmend taulantët, popull ilir<sup>20</sup>, dhe flet për përzienjen e tyre në këto ngjarje. Mandej ai flet edhe për lidhjen e aleancës ndërmjet ilirëve e lynkestëve (në vitin 423 p.e.s.) dhe e cila ishte e drejtuar kundër Maqedonisë. Duke qënë kështu të bashkuar, ata mundën Perdikën, mbretin maqedon, dhe aleantin e tij Braziden, strategun spartan<sup>21</sup>.

Me fuqizimin e Maqedonisë, mbretërit e saj orvaten të zgjerojnë fuqitë e tyre edhe në trevat fqinje. Realizimi i këtyre dëshirave has në rezistencën e fortë të fiseve ilire. Pikërisht këto ngjarje janë shkakut pse në shek. IV p.e.s. për ilirët flitet edhe shkruhet aq shumë.

Në realitet, meqë në vitet 400/399 ilirët u bënë ballë me sukses dhe ua ndalën hovin pushtues mbretërve maqedonë, ata tani nga mbrojtja ata kalojnë në sulm dhe kështu

18 Krh. G. Zippel, *Die römische Herrschaft in Illyrien bis auf Augustus*, 12 ss., R. Katičić, *Godišnjak CBI XIV/13*, 1977, 5 ss.

19 Herod. V 61, IX 43.

20 Thucid. IV 124-125.

21 Thucid. IV 124-125. Lidhur me këto ngjarje shkruan edhe Diod. XII 30, 2-5; 31, 2-3.



marrin inisiativën në duart e veta. Sipas Diodorit të Sicelisë<sup>22</sup>, në vitin 393 p.e.s. edhe pse faktikisht këto ngjarje janë zhvilluar në vitin 383 p.e.s., ilirët dëbojnë Amintën III, mbretin maqedon. Në këtë aksion të suksesshëm ilirëve u ndihmon shumë edhe lufta për pushtet që shpërthen para Arhelaut /413-399 p.e.s./, turbullira këto që kanë vazhduar deri në kohën e Amintës III /382-370 p.e.s./. Në këtë kohë djali më i ri i Amintës III, Filipi, që më vonë njihet si Filipi II, që merret peng, u dorëzohet tebanëve<sup>23</sup>. Luftërat e pandërprera dhe të rënda të maqedonëve me trakët dhe me ilirët, për të cilat na bën fjalë Justini<sup>24</sup> shënojnë periudhën e aktivitetit intensiv të ilirëve në ngjarjet dhe në mosmarrëveshjet e brendshme të mbretërisë maqedone. Por, sundimi i Aleksandrit II /369-365 p.e.s./ është edhe koha e konsolidimit të brendshëm të Maqedonisë dhe e zhvillimit të qetë në planin e jashtëm. Mirëpo edhe gjatë kësaj kohe Maqedonia u paguan tagra ilirëve<sup>25</sup>. Megjithatë situata nuk u përmirësua as në kohën e pasardhësve të tij, në radhë të parë në kohën e Alorit e pastaj të Perdikës, të cilët kanë ardhur në pushtet me dhunë. Kështu, Perdika pëson një disfatë të rëndë prej ilirëve<sup>26</sup>. Vetëm me ardhjen e Filipit II /359-336 p.e.s./ situata shndërrohet në dobi të Maqedonisë. Pasi në vitin 359 p.e.s. ai nënshkruan paqen me athinasit<sup>27</sup>, fillon të përgatitet për t'u liruar nga barra e rëndë ilire. Për këtë arsye ai i propozon mbretit ilir, Bardhyllit, paqe, por me kusht që ilirët t'i lirojnë të gjitha qytetet e Maqedonisë. Meqë ilirët nuk e pranojnë një propozim të tillë, Filipi II, në vitin 358 p.e.s. u bën luftë ilirëve dhe i mund. Pas kësaj ngjarjeje këta detyrohen t'i braktisin viset e pushtuara gjer te liqeni i Lyhni-dit<sup>28</sup>. Filipi II nuk u ndal me kaq, por i vazhdoi luftërat dhe pushtimet në trevën ilire. Kështu, po atë vit ai sulmon dardanët<sup>29</sup>. Edhe pse burimet na flasin për konflikte të pandërprera të ilirëve me maqedonët, prapëseprapë ilirët kurrë më nuk do ta rifitojnë fuqinë dhe epërsinë e kohës së para Filipit II.

Së këndejmi del qartë se cila trevë e ilirëve është objekt i

22 Di•d XIV 92, 3 XV 19, 2 XVI 2, 1.

23 Di•d. XVI 2, 2.

24 Iustin. VII 2, 6.

25 Iustin. VII 5, 1.

26 Di•d. XVI 2, 4-6; Polyæn. IV 10, 1.

27 Di•d. XVI 4, 2.

28 Di•d. XVI 4, 4-7; 8, 1.

29 Iustin. VIII 6, 3.



vështrimit të autorëve të lashtë. Por në sajë të këtyre të dhë-  
 nave është e qartë se deri në kohën e Filipit II, kur edhe për  
 herë të parë përmendet nocioni «mbreti ilir», ilirët na paraqiten  
 politikisht të organizuar në sistemin fisnor. Për një rend të tillë  
 dëshmojnë edhe materialet arkeologjike nga Shqipëria, si qyteza  
 e Gajtanit e cila është një qendër fisnore<sup>30</sup>, respektivisht në  
 Tren<sup>31</sup>, e jo vetëm këtu, por edhe në trevën e gjerë historike  
 të fiseve ilire, pra në tërë trevën veriperëndimore e qendrore  
 të Ballkanit. Për një sistem të tillë na dëshmon edhe varrimi  
 në tumat që është karakteristik për ilirët, si p.sh. në Kuçi i  
 Zi<sup>32</sup>, Barç<sup>33</sup>, Mat<sup>34</sup>, Çinamak<sup>35</sup>, dhe gjetkë në trevën e gjerë të  
 fiseve ilire, kudo që ata jetonin. Dëshmi më karakteristike e  
 rendit të këtyllë politiko-social janë varret e Trebenishtës<sup>36</sup>. Të  
 dhënat e materialit arkeologjik të trevës ilire të kësaj periudhe  
 na paraqesin, tanimë, një shoqëri me struktura të diferencuara.  
 Por, megjithatë, po ashtu shihet qartë se pjesa më e madhe  
 e Ballkanit qendror dhe veriperëndimor mbetet jashtë interesit  
 të autorëve të lashtë.

Për pjesën veriperëndimore, konkretisht për brezin bregdetar  
 të Adriatikut, edhe pse në mënyrë të përgjithësuar, flitet  
 në veprën e gjeografit Skymni nga Kios (184/183 p.e.s.) të cilit i  
 mvishet vepra «Periegesis», autori i së cilës nuk na është i njohur  
 dhe ka jetuar kah fundi i shek. II p.e.s., e për këtë arsye  
 quhet edhe Pseudo Skymnos. Vepra e këtij autori të panjohur  
 është shkruar si duket në vitet 145/110 p.e.s.<sup>37</sup>. Autori i kësaj  
 vepre, pa dyshim, ka shfrytëzuar edhe burimet e kohërave më

30 Krh. S. Islami — H. Ceka, *St. Alb.* I/1964, 98, S. Islami, *Iliria* II/1972, 9, shënim. 6; Po ai: *Iliria* IV/1976, 74; M. Garašanin, *Praistorija na tlu SR Srbije*, I/1973, 361. II/1973, 525, Po ai: *Istorija Crne Gore*, I/1967, 118-134; *Kulturna Istorija Bosne i Hercegovine*, Sarajevo 1966, 96, 124; A. Stipčević, *Iliri*, Zagreb, 1974, 218.

31 Krh. M. Korkuti, *L'agglomeration préhistorique de Tren*, 341 vv.

32 Krh. Zh. Andrea, *BA*, 1969, 27-36.

33 Zh. Andrea, *BA*, 1971, 31-40.

34 Krh. S. Islami — H. Ceka, *St. Alb.* I/1964, 101 ss.

35 Krh. B. Jubani, *BA*, 1969 37-47; *BA* 1970, 41-57; Po ai: *Traits communs dans les rites d'inhumation chez les Illyriens de la region de l'Albanie*, 89-111! (Këtu gjendet e tërë literatura e njohur lidhur me këtë çështje nga treva e RPS të Shqipërisë).

36 Krh. V. Lahtov, *Problem Trebeniške kulture*, Ohrid 1965; K. Kilian, *PZ*, 50 Bd. 1975, 29-73; M. Garašanin, *Praistorija na tlu SR Srbije*, I, 361 ss; II, 471-472; 526-527; Po ai: *Istorija Crne Gore*, I, 80 ss; *Kulturna Istorija BiH*, 91 ss; A. Stipčević, *vep. e cit.* 99.

37 Krh. *Lexikon der Antike*, I/4, 198.



të hershme të Hekateut, Eforit, Timeut, Herodotit, Eratostenit dhe Teopompit. Madje është me rëndësi edhe fakti, që në këtë vepër nuk përmendet asnjë ngjarje pas shek. IV p.e.s. Veç të tjerash, me rëndësi është se kjo vepër, përveç brezit bregdetar, përfshin edhe një pjesë të brendsisë së Gadishullit Ballkanik. Në «Periegezën» e tij, ndër tjera, lexojmë: «Thonë se rreth bregdetit të Adriatikut banojnë një mori barbarësh pothuaj një milion e pesëqind mijë banorë (...). Pas kësaj shtrihet toka e Ilirisë me popullatë të madhe. Thonë se popullata ilire është e madhe, nga e cila disa jetojnë në brendi duke punuar tokën, kurse të tjerët në brigjet e Adriatikut. Disa prej tyre i nënshtrohen pushtetit të bazilejve, disa monarkëve kurse të tjerët vetësundohen»<sup>38</sup>.

Nga kjo që u tha mund të nxjerrim dy konstatime, edhe pse të karakterit të përgjithshëm: 1 — se në të gjitha të dhënat e autorëve të lashtë, që u përmendën deri më tash, për herë të parë përmendet sundimi bretëror në shekullin IV p.e.s., dhe 2 — këto të dhëna, nga një anë lidhen kryesisht me ngjarjet historike që kanë të bëjnë me Maqedoninë dhe nga ana tjetër, siç janë ato të Pseudo-Skymnit, janë të karakterit «loci communes». E gjithë kjo dëshmon qartë se nuk duhet të përgjithësohen dhe se për shfrytëzimin e tyre duhet të jemi tepër syçelë dhe kritikë. Që ato të shfrytëzohen sa më mirë, nevojitet të shfrytëzohen vertikalisht për nga aspekti kronologjik e nga aspekti territorial, horizontalisht, kuptohet në qoftë se është e mundshme, edhe në kombinim me të dhënat e materialit arkeologjik.

Me gjithë vështirësitë e pashmangshme, që janë pasojë e natyrës së të dhënave të autorëve të lashtë, të cilët flasin për dukuritë politike dhe strukturat sociale e ekonomike të ilirëve, prapëseprapë është e domosdoshme dhe me interes të madh që të ndriçohen strukturat e përmëndura politike të ilirët.

Por, sado që deri më tani është shkruar dhe studiuar shumë, sidomos për shtetin e Ilirisë së jugut, rezultate këto që

38 Pseudo-Scymn. 375-377: «Ton kolparhistorusi ton Adriatikon ton barbaron plethos ti perioikein kylko hekaton shedon myriasi pentekonta te horan aristen nemomenon kai karpimen», respektivisht 415-422: «He d'Illyris meta tauta parateinusa ge / ethen periehei polla plethe gor syhno / ton Illyrion legusin einai kai ta men / auton katoikeinten mesogeion nemomena, / he de ton paralion ontos ephein Adriu, / kai tina men auton besilikais e eksusiai / hypeko einai, tina de kai manrhiais, / ha d'autonomeisthai...»



rrjedhin dhe nga punime magjistrale<sup>39</sup>, prapëseprapë në literaturën e sotme shkencore ndeshemi gjithnjë në një anë me disa dilema të caktuara, që kanë të bëjnë me fizionominë dhe karakterin e shtetit ilir, dhe, nga ana tjetër, me praninë e konsiderueshme të koncepteve që kanë qenë karakteristike për shekullin XIX në trajtimin e dukurive politike-shoqërore të tyre. Kjo pa dyshim vërehet në përdorimin e terminologjisë politiko-sociale të shekullit XIX kur bëhet fjalë për realitetin socio-politik të fiseve ilire.

Këtu nuk kemi për qëllim të ndalemi rreth problemit të gjenezës së formacionit shtetëror të ilirët, sepse, siç u cek më sipër, lidhur me këtë ekziston një literaturë e gjerë<sup>40</sup>. Megjithatë, ne edhe përkundrejt rezultateve të dukshme në këtë fushë, ndeshim pyetje, siç janë: «a është shteti ilir i tipit mesdhetar», ose «a është ajo organizatë fisnore apo mbifisnore», apo sundim i ndonjë bashkësie fisnore (siç ishte te maqedonët)?» ose «ky nuk është kurrëfarë shteti, por vetëm lidhje fisnore? Pse atëherë nuk flitet për shtetin e delmatëve ose të desidiatëve? Edhe ata kanë luajtur të njëjtin rol, megjithatë, ata na paraqiten si fise»<sup>41</sup>.

Një nga arsyet e gjithë këtyre dilemave qëndron, në një anë në qëndrimet dhe në pikënisjet e ndryshme lidhur me këto probleme të specialistëve të shkencave parahistorike dhe klasike apo të filologëve dhe të historianëve, kurse nga ana tjetër edhe në trajtimin e trevës ilire si një territor unik në aspektin kulturo-social e deri diku edhe politik, edhe pse

39 Krh. J. G. Droysen, *Geschichte des Hellenismus*, III/2, 43 ss; Po ai: *Das dardanische Fürstentum*, 89; B. G. Niese, *Geschichte der griechischen und makedonischen Staaten*, 77; G. Zippel, *Die römische Herrschaft*, 6 ss; C. Schütt, *Untersuchungen zur Geschichte*, 69; A. Gitti, *Ricerche delle storia Illirica*, 183-204; Po ai: *La politica dei re iliri* 7-14; N. G. L. Hammond, *The Kingdoms in Illyria*, 239 ss; M. H. Holaux, *Les romains en Illyrie*, 76 ss; Po ai: *The Romans in Illyria*, CAH vol. VII, chap. XXVI, 3 827; F. Papazoglu, *Historia*, XIV/1965, 143 ss; Po ajo: *Politička organizacija*, I 1 ss; Po ajo: *Poreklo i razvoj ilirske države*, 123 ss; M. Garašanin, *Glas CCLX/1*, 1974, 1 ss; H. Ceka — N. Ceka, *Le développement de l'état chez Illyriens*, 139-146; S. Islami, *L'état Illyrien, sa place et son role dans le monde méditerranéen*, 71-87; D. Rendić — Miočević HZ XIX-mendimet për shtetin ilir në historiografinë jugosllave shih më gjerësisht: A. Hadri, *Historiografia jugosllave për shtetin Ilir*, Kuvendi I Studimeve ilire, I Tiranë..... Studime Ilire I, 1978, Prishtinë, 305-312.

40 Shih. shën. 39.

41 Krh. A. Benac, *Godišnjak* CBI XII/10, 1974, 269.



te Pseudo-Skymni<sup>42</sup>, siç pamë më sipër, ballafaqohemi me ndarjen e kësaj treve në atë bregdetare dhe të brendësisë me forma dhe struktura të ndryshme politike, madje edhe me mënyra të ndryshme të prodhimit. Duke pasur parasysh pikërisht këtë fakt, dilemat e çekura më sipër rreth formës dhe karakterit të shtetit ilir na duken të tepruara. Sidoqoftë, faktori i shteteve mesdhetare-helenistike në ndikimin e formave politike të atyre vendbanimeve ilire, që ishin në fqinjësi të drejtpërdrejtë me to, jo vetëm që nuk duhet të mohohet, por as të nënçmohet. Prandaj mendojmë që historia e trevës ilire, si për strukturat politike, sociale dhe ekonomike, si për dukuritë shpirtërore, e jo vetëm për kulturën materiale, duhet të studiohen në tërësi e jo në forma të mbyllura. Mendojmë që vetëm atëherë mund të nxjerrim deri diku një tërësi të caktuar.

Në dritën e kësaj që u tha do të orvatemi (kuptohet me mundësitë që na ofron materiali ekzistues), të përqëndrohemi në disa dukuri të strukturave politike-sociale dhe ekonomike.

Përsa i përket strukturës politike të fiseve ilire, të dhënat e autorëve të lashtë, duke i plotësuar me ato të materialit epigrafik, na bëjnë të mundshme, që të tërë trevën e banuar me fiset, të cilat në kohërat historike njihen me emrin e përbashkët «ilirët», ta ndajmë në dy pjesë politiko-territoriale. E para është ajo që përfshin territorin e Ilirisë së Jugut dhe një pjesë të madhe të trevës së dardanëve, pra e cila ishte në afërsi imediate të botës kulturore e politike helenistike, kurse pjesa tjetër që përfshin atë të Ballkanit veriperëndimor me pjesën tjetër bregdetare, duke përfshirë trevën prej Neretves në veri dhe një pjesë të Ballkanit qendror.

Vetëm me këtë mënyrë është e mundshme të ndriçohen dhe të kuptohen shumë dukuri të strukturave politike, që janë karakteristike për Ilirinë e Jugut dhe për trevën e dardanëve, respektivisht për pjesën veriperëndimore dhe për qëndroren.

Duke u nisur nga të dhënat e Pseudo-Skymnit<sup>43</sup>, që kanë të bëjnë me gjendjen politike të fiseve ilire, ndeshemi, siç pamë me tri forma të pushtetit politik, e këto janë: 1. bazilejtë (lat. regia), 2. monarchia dhe 3. autonomesthai (lat. propriae leges), vetësundim. Edhe pse këto të dhëna të Pseudo-Skymnit, siç u tha më sipër, janë të karakterit «loci communes», (të karakterit të përgjithësuar) gjë që vështirëson përcaktimin se për cilat vise të ilirëve është fjala, prapëseprapë me rëndësi

42 Shih, shën. 39.

43 Shih, shën. 39.



është të theksohet se format e pushtetit të bazilejve, dhe të monarkëve, paraqiten në shekullin IV p.e.s. edhe te autorë të tjerë, të cilët shkruajnë për marrëdhëniet iliro-maqedone. Por, shtrohet pyetja: a mund të aplikohet dhe të interpretohet funksioni i «mbretit» ose i nëpunësit, i cili në kohërat historike ka zgjatur një vit, si ushtrues i riteve të shenjta me atë të «mbretit» të fiseve ilire?

Edhe pse duhet të kemi parasysh faktin se Iliria e Jugut dhe Dardania<sup>44</sup> kanë qenë në kontakte të përhershme me botën helenistike, prapëseprapë ato i kanë ruajtur edhe vetitë e tyre të caktuara si në jetën politike, ashtu edhe në dukuritë e tjera shoqërore dhe ekonomike<sup>45</sup>. Megjithatë, duhet theksuar, se gjuha greke ka qenë instrument komunikimi si në diplomaci, ushtri ashtu edhe në oborret e helenizuara<sup>46</sup>. Përkundrejt këtij fakti, në oborrin e mbretërve ilirë është shfrytëzuar ndihma e përkthyesit<sup>47</sup>, që do të thotë se ajo nuk është zhdukur nga përdorimi, si mjet komunikimi, as në shtresat e larta politiko-shoqërore ilire. Ndonëse kjo dukuri është e pamohueshme, prapëseprapë ndikimi helenistik në strukturat politike nuk mund të mohohet.

Që në shekullin V p.e.s. forma bazë e strukturës politike te tesprotët, molosët, taulantët dhe kaonët ishte koinoni<sup>47a</sup>, nocioni i cili te autorët e lashtë i përgjigjet lidhjes fisnore në krye të së cilës ishte demokracia ushtarake, kurse te molosët dhe antintanët përmendet kujdestari i mbretit, te parauejt madje edhe mbreti<sup>48</sup>. Materiali epigrafik nga Bylis, Amantia<sup>48a</sup> dhe qytete të tjera të Ilirisë së Jugut, të cilat kanë qenë të ngjashme me qytetet greke<sup>49</sup>, na i bën të njohura edhe format

44 Deri vonë është menduar se dardanët ishin larg ndikimit të botës helenistike (krh. F. Papazoglu, *Srednjobalkanska plemena*, 205, 336, shën. 4). Por gërmimet arkeologjike të bëra kohëve të fundit, përveç të tjerave, ashtu edhe në Gadimjen e Epërme, Hisar në Suharekë, Černićë dhe gjetiu, dëshmojnë kontaktet intensive ekonomike me botën helenistike, të cilat, pa dyshim, nuk kanë mbetur pa ndikuar edhe në jetën politike. Megjithatë, duhet pasur parasysh se qeramika e karakterit helenistik, është prodhim i vendit. Sidoqoftë kjo tregon mjaft për praninë e elementit helenistik në këto treva.

45 Krh. C. Schneider, *Kulturgeschichte des Hellenismus*, II, 508.

46 Liv. XLIV 23, 3-4; 30-, 1: Polyb. XXIX 3, 9.

47 Polyb. XXVIII 8, 9: «...akusas ta para tu Genthiiu palin eks autes epempe ton Adaion kai syn tuto ton Glaukian, hena ton somatofylakon, kai triron ton Illyrion dia ten dialektion eidenai ten Illyrida».

47 a Krh. P. Lévêque; *Le monde hellénistique*, 31.

48 Thucid. II 80.

48 a Krh. S. Anamali, *Iliria*, 2, 1972, 90 ss.

49 Krh. S. Islami, *Iliria*, IV/1, 1976, 80 ss.



e tjera të strukturave politike, siç ishin prostates<sup>49a</sup>, të cilat përmenden edhe nga autorët e lashtë. Këto me siguri kanë paraqitur parinë e familjeve bujare, të cilat në lidhjen fisnore ishin «primi inter pares» («të parët në mesin e të barabartëve») Procesi i formave politike të ilirët në mbarim të shek V dhe në fillim të shek. IV p.e.s. ka qenë i ngjashëm me të popujve fqinjë, që ka qenë karakteristik për rendin fisnor. Kjo shihet nga terminologjia që përdorin autorët e lashtë kur flasin për organet e pushtetit politik të fiseve të Ilirisë së Jugut, siç ishin arhe, ose ta pragmata, respektivisht koinon, ose symahia, basileus etj. që për nga forma janë identike me ato të botës greke, edhe pse nuk është e domosdoshme të përputhen plotësisht për nga përmbajtja<sup>50</sup>. Mandej këto struktura politike, për të cilat bëjnë fjalë autorët e lashtë, kanë qenë karakteristike për ilirët në përgjithësi. Kështu, p.sh., që në shekullin IV p.e.s. nocioni ethnoi Illyrioi kishte një domethënie të gjerë politike me të cilën nënkuptohej bashkësia e gjerë politike, e jo ndonjë fis i caktuar<sup>51</sup>. Përveç basilejve, si element të strukturave politike në veprat e autorëve të lashtë përmenden edhe «miqt' e mbretërve», respektivisht «filloi»<sup>52</sup> element, pra, thjesht helenistik<sup>52a</sup> pastaj «principes gentis»<sup>53</sup> apo «principes Illyriorum»<sup>54</sup> «mëkëmbësit»<sup>55</sup> «dualizmi»<sup>56</sup> dhe «dinastët»<sup>57</sup>.

Në sajë të asaj që u tha deri më tani shtrohet pyetja se çfarë pozite politiko-juridike ka pasur bazileu ose reksi (mbreti)? Pa dyshim se gjithë organet e sipërpërmendura janë shprehje e qartë e ndikimit të elementeve shtetërore-juridike helenistike në organizimin politik të ilirëve. Edhe pse ky shtet ilir i ka pasur të gjitha organet që janë karakteristike për një shtet, politikisht të organizuar, siç janë ushtria, administrata civile, prerja e monedhave, diplomacia, aparati fiskal, i cili ka

49 a Krh. Lévêque; *Le monde hellénistique* 31, 33.

50 Krh. H. Ceka — N. Ceka *Le développement de l'état illyrien*, 141.

51 Krh. F. Papazoglu, *Godišnjak CBI* V/1, 1976, 128, 131, 132.

52 Polyb. XXIX 13, 2; Liv. XLIV 27, 11; 30, 3; XLV 26, 13-15.

52 a Krh. P. Lévêque, *Le monde hellénistique*, 55.

53 Liv. XLIV 31, 9.

54 Liv. XLIV 32, 4.

55 Iustin. XXXIX 4, 8; *nec non et Illyriorum reges lateri eius (sc. Philippi, Z. M.) Haerentes adsiduis precipibus promissa exigebant*. Arrian Anab. I, 5-6.

56 Polyb. II 2, 4; X 41, 4; Liv. XXVI 24, 9; XXVII 30, 13; XXVIII 5, 7; XLIX 30, 2-4; 32, 3.

57 Polyb. IV 29, 7; 55, 1-4; V 4, 3; 13, 5; 14, 5, 23, 1-10; XXI 11, 6-8; 21, 3; XXXII 9, 4; Cass. Dio fr. 40, 1.



mbledhur tatimet<sup>58</sup>, a mund të thuhet se pushteti i mbretit ka pasur karakter absolutist, të cilin është orvatur ta forcojë edhe me anë të marrëdhënieve me fqinjët, madje shpeshherë edhe me martesat dinastike<sup>58a</sup>, siç ishte rasti i Gencit me mbretërinë dardane? Ai vërtet ka lidhur paqë, ka shpallur luftë, ka udhëhequr negociatën diplomatike qoftë vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të vet, siç mund të shihet në rastin e negociatave ndërmjet Gencit dhe Perseut<sup>59</sup>. Megjithatë, pa mëdyshje mund të thuhet se ai ka qenë personalitet përfaqësues sidomos në marrëdhëniet me botën e jashtme. Por në qoftë se e analizojmë pozitën e Teutës dhe të Gencit, atëherë këtu ndeshim dy faza të zhvillimit të pushtetit mbretëror.

Vetë mënyra e ardhjes së Teutës në pushtet nuk mund të shpjegohet saktësisht. Mund të supozohet se ajo ka ardhur në pushtet në mënyrë legale ose me forcë. Hypja e mbretërve ilirë në pushtet me dhunë nuk është e panjohur. Një shembull të tillë e kemi lidhur me ardhjen e Bardhylit në pushtet, i cili zëvendësoi Siraun (fundi i shek. V dhe fillimi i shek. IV p.e.s.), të cilin autorët e lashtë e quajnë cub, apo latro dhe i cili nga përkatësia sociale i ka takuar shtresës më të ulët<sup>60</sup>. Analiza e të dhënave të autorëve të lashtë<sup>61</sup>, prapëseprapë na bën të mendojmë me arsye se kjo grua energjike dhe plot vullnet për të sunduar, ka ardhur në pushtet përmes trashigimisë legale. Kështu mendojnë edhe disa historianë të shekullit tonë<sup>62</sup>. Ndërkaq, sipas mendimit të disa të tjerëve, pushteti i saj ka qenë i kufizuar, kishte më tepër karakter përfaqësues<sup>63</sup>. Në favor të këtij mendimi flet në një anë përgjigjia e saj delegatëve romakë: «...Se ligjet nuk i lejojnë mbretit që t'i pengojë ilirët të pasurohen në mënyrë private nga të mirat e detit»<sup>64</sup>, apo se «Teuta ka ushtruar punët me miqtë besnikë»<sup>65</sup>. Nga kjo shihet qartë se pozita juridiko-politike e kë-

58 Polyb. XXIX 13, 2; XLIV 27, 11; Liv. XXV 26, 13-15; XXX 28, 1-2. XLIX 30, 4, XLV 26, 13-14; 27, 11; Iustin, XXIV 4, 11.

58 a Polyb. XXIX 13, 2; Liv. XLIV 30, 4.

59 Polyb. XXVIII 8, 9; Liv. XLII 26, 2-6; 29, 11; 37, 2; 45, 8.

60 Cice. De officiis II, 11: «Itaque propter aeqabilem praede partitionem et Bardylis Illyrius latro, de quo est apud Theopompum. magnas opes habuit».

61 Polyb. II 4, 7; App. Illyr. VII; Cass. Dio frag. 43 (Zon VIII 19).

62 Krh. A. Gitti, *La politica de Iliri*, 38. shën. 50; S. Islami, *Iliria*, III/1975, 9.

63 Krh. A. Gitti, *Nota a due passi di Polibio*. 264-271; A. Stipčević, *Iliri*, 164.

64 Polyb. II 8, 8. Lidhur me këtë shih dhe CAH VII, chap. XXVI, 4, 832 ss G. Walser, *Historia*, II/4, 1953, 310 ss.

65 Polyb. II, 4, 7.



tyre «miqve besnikë të mbretërve» ka qenë jo vetëm e rëndësishme, por edhe e pavarur.

Ndonëse autorët e lashtë nuk na japin asnjë të dhënë lidhur me ekzistencën e organit të këshillit të pleqve, të cilët do ta kufizonin pushtetin e mbretit, ose do t'i miratonin vendimet e tij, prapëseprapë këta «miq të mbretërve» kanë mundur të jenë anëtarë të këtij këshilli mbretëror, siç ka qenë rasti në shtetet helenistike<sup>66</sup>. Këta miq të mbretit funksionojnë edhe në kohën e Gencit (180-168 p.e.s.) e shërbejnë dhe në punët e diplomacisë<sup>67</sup>.

Por nga vetë fakti se pranë mbretërve kanë ekzistuar edhe një sërë strukturash të tjera politike, për të cilat është folur, shihet qartë se pushteti politik i mbretërve ilirë jo vetëm që ka qenë i kufizuar, por edhe struktura e pushtetit të tyre të brendshëm ka qenë rregulluar në sistemin federativ<sup>68</sup>. Në një përfundim të tillë mund të arrihet lehtë, nëse analizohet teksti i diktatit L. Anicit, lëshuar në Shkodër në vitin 168 p.e.s. Në të, në mes tjerash, lexojmë: «Atëherë Anici, pasi pushtoi Epirin dhe vendosi ushtrinë nëpër qytete të rëndësishme për të dimëruar, u kthye në Shkodër, në Ilirik, ku kishin arritur nga Roma pesë delegatë dhe, pasi ishin thirrur nga të gjitha provincat të parët, mbajti me ta kuvendin. Këtu nga tribuna shpalli se senati romak dhe populli romak vendosi që ilirët të jenë të lirë dhe se trupa do të tërhiqen nga të gjitha qytetet, fortifikatat dhe kështjellat dhe që izejasit, taulantët, pirustët dhe daorsët, si edhe banorët e Rizonit dhe të Ulqinit, jo vetëm të jenë të lirë por edhe të lirohen nga pagesat e të gjitha tagrave. Pastaj e ndau Ilirikun në tri rajone: njëri është ai për të cilin kemi folur më lart, i dyti ka përfshirë të gjithë labeatët, kurse i treti (i ka përfshirë) agravonitasit, banorët e Rizonit dhe ulqinakët me fqinjët e tyre<sup>69</sup>. Vetë fakti i ekzistencës nga një anë i dualizmit në pushtet, dhe nga ana tjetër prania e dinastëve dhe të «principum gentis» tregon qartë se kemi të bëjmë me një unitet shtetëror formal, të cilin e karakterizonin

66 Krh. S. Islami, *Iliria*, III/1975, 9.

67 Polyb. XXIX 3, 6-9; 11, 1; Liv. XL 42, 3; XLIV 25, 34.

68 Liv. XLV 26, 13.

69 Liv. XLV 26, 12-15; «*Pacata Epiro divissisque in hiberna copiis per opportunas urbes, regressus ipse in Illyricum Scodrae, quo quinque legati ab Roma venerant, evocatis ex tota provincia principibus conventum habuit. Ibi pro tribunali pronuntiavit de sententia sancillii senatum populumque Romanum Illyrios esse liberos iubere: praesidia ex omnibus oppidis, arcibus, castellis sese deducturum. Non solum liberos, sed etiam immunes fore Issenses et Taulatios, Dassaretiorum Pirustas, Rhizonitas, Olcinatas, quod incolumi Gentio ad Romanos defecissent.*»



antagonizmat, luftat për pushtet<sup>70</sup> dhe vrasjet. Kjo pa dyshim reflektohej në të gjitha përmasat pikërisht në kohën kur Genci orvatej të sundonte në mënyrë absolute mbi shtetasit e vet, siç mund të shihet edhe nga vetë titullatura e tij «Gentius rex Illyriorum»<sup>71</sup>, respektivisht «Genthio ton Illyrion basilea»<sup>72</sup>. Kjo titullaturë tregon se mbreti në sajë të kompetencave speciale ka mundur të vendosë vetë<sup>73</sup>. Pranë tij ishin edhe anëtarët e familjes<sup>74</sup> «miqtë»<sup>75</sup>, me ndihmën e të cilëve kishte mbytur edhe të vëllanë, Platorin<sup>76</sup>, që t'i mirrte pushtetin.

Njëra nga pasojat e sundimit të tij absolutist ishte edhe tradhtia e bashkësunduesve dhe e dinastëve të tij në kohën më kritike të sundimit të tij, d.m.th. në kohën e konfliktit me romakët.

Marrëdhënie të tilla të paqëndrueshme midis mbretit dhe dinastëve, të cilët faktikisht kanë mundur të ndërrohen<sup>77</sup>, nga një anë, dhe në mes mbretit dhe «principes gentium» nga ana tjetër, i kanë përshkuar strukturat politike gjatë tërë kohës së luftërave iliro-romake<sup>78</sup>. Në realitet, një antagonizëm në mes pushtetit qendror dhe vendbanimeve të vogla fisnore, ku të gjithë anëtarët e një mesi njihnin njëri-tjetrin dhe të cilët kanë pasur interes të përbashkët, ka qenë karakteristikë e përgjithshme e periudhës së sundimit të shteteve helenistike<sup>79</sup>. Romakët, të cilët ishin pragmatikë në politikën e jashtme, e kanë shfrytëzuar këtë gjendje me mençuri<sup>80</sup>. Kështu, për shembull, disa nga dinastët ata i shpallnin për mbretër, kurse të tjerët i përkrahnin në pushtet, duke e forcuar kështu pozitën e tyre politike. Këtu kemi të bëjmë me sunduesit e qyteteve autonome, të cilët quhen edhe polydinastai<sup>81</sup>, dhe me përfaqësuesit e aristokracisë fisnore, të ashtuquajturit principes gentis,

70 Polyb. XXIX 13, 2; Liv. XLIX 30, 2-24; 32, 3.

71 Liv. XL 42; XLII 26, 2; 29, 11; XLIII 94, 4; XLIV 23, 1.

72 Polyb. XXIX 13, 1; XXX 22, 1.

73 Krh. C. Schneider, *op. cit.* II, 508.

74 Liv. XLIV 30, 7; Polyb. II 5, 6.

75 Polyb. II 4, 72.

76 Liv. XLIV 30, 32.

77 Polyb. II 18, 1.

78 Polyb. IV 29, 7; 55, 1-4; V 4, 3; 13, 5, 14, 5; 23, 1-10.

79 Arian. Anabasis VII 9. Krh. O. Neurath, *Istorija antičke privrede*, 71.

80 Polyb. XXI 11, 6-8; 21, 3; XXXII 9, 4.

81 Polyb. V 4, 6; Krh. CAH vol. VII, chap. XXVI, 2, 826 ss.



të cilët i kanë ruajtur pozitat e veta sidomos në aktivitetin ekonomik, në prerjen e monedhave dhe në jetën politike. Me fjalë të tjera, qytetet së bashku me rrethinën e tyre dhe bashkësitë fisnore, në sajë të pavarësisë së tyre ekonomike, e cila shprehej, siç u tha, edhe në prerjen e monedhave, si në Bylis dhe Scodra<sup>82</sup> ashtu edhe te labeatët<sup>83</sup> e daorsët<sup>84</sup>, bëhen qendra politike që ishin karakteristike jo vetëm për tërë rajonin<sup>85</sup>, por edhe gjatë tërë kohës së historisë së tyre.

Një situatë e tillë vazhdon edhe gjatë sundimit romak, i cili nuk ndryshoi asgjë në format e strukturave politike të ilirëve, vetëm se pas disfatës katastrofale që pësoi Genci, mbreti i fundit i ilirëve, dhe, siç shihet qartë nga vetë diktati i Scodres, ata e ndanë tokën e ilirëve në tri krahina apo tërësi administrative: «Inde in tres partes Illyricum divisit»<sup>86</sup>.

Edhe pse këtu është fjala vetëm për trevën e shtetit të ardianëve, prapëseprapë, siç u tha, struktura politike e fiseve ilire, marrë në tërësi, nuk u asgjësua. Të njëjtat struktura vazhduan të funksionojnë edhe në brendi të Gadishullit Ballkanik. Kjo tregon se romakët jo vetëm që nuk kanë shkuar kah asgjësimi dhe shkatërrimi i gjendjes politike me të cilën u ballafaquan, por janë orvatur që t'u përshtaten strukturave politike ekzistuese. Me fjalë të tjera, ata i njohin dhe i përqafojnë strukturat politike, shoqërore dhe ekonomike vendase. Madje edhe me rastin e themelimit të municipeve, popullsia vendase, jo vetëm që është dominuese, por edhe, siç thotë me të drejtë M. Garashanini: «pjesa më e madhe as që është romanizuar, respektivisht ka fituar të drejtën qytetare romake, madje edhe atëherë kur në vetëqeverisjen e qytetit ka vendin udhëheqës»<sup>87</sup>. Elementi i princepsit, përfaqësues i shquar fisnor, i njohur që në kohën e Gencit, madje edhe përpara, dëshmohej edhe në materialin epigrafik të periudhës romake. Kështu, p.sh., në Rjeçane, në territorin e dokleatëve, janë zbuluar dy mbishkrime në të cilat përmendet princeps, i pari i bashkësisë së dokleatëve, njëfarë: Agirro

82 Krh. H. Ceka, *Questions de numismatique*, 131 ss, 150 ss.

83 Krh. B. Jubani, *St. Alb.* 1. IX. 1972, 69 ss.

84 Krh. Dj. Basler, *GZM u Sarajevu*, n.s. XXVI, 1971, 333 ss;

D. Rendić — Miočević, *HZ XIX-XX/ 1966-67*, 295 ss.

85 Krh. S. Islami, *Iliria*, IV/1, 1976, 86 ss.

86 Liv. XLV 26, 15.

87 Krh. M. Garašanin, *Istoriya Crne Gore*, I, 151.



Epicadi f (ilio), principi k (astelli) Salthus<sup>88</sup>, kurse tjetri, po ashtu në Rjeçane, në të cilin përmendet: Caius Epicadi f (ilius) princeps civitatis Doclatium<sup>89</sup>. Të dhëna të tilla, që flasin për ekzistencën e princepsve në trevën e gjerë ilire, madje edhe në Gadishullin Ballkanik në përgjithësi, janë dëshmuar mjaft. Si shembuj po përmendim vetëm disa: në fshatin Breza, në verilindje të Sarajevës, përmendet njëfarë: Valens Varron (is) f (ilius) princeps Desitiati (um)<sup>90</sup>, pastaj te skordiskët, fis iliro-kelt<sup>91</sup> te Slankameni /Acumincum/: F. Flavius Proculus pr (inceps) praefect (ectus) Scord (iscorum)<sup>92</sup> etj. Të gjitha këto të dhëna flasin për ruajtjen e rendit fisnor te ilirët edhe pas pushtimit të vendit të tyre nga romakët. Treva e këtyre princepsve, apo praefecti, siç quhen ndryshe, paraqet një njësi, bashkësi, të njohur me emrin civitas, territori i të cilit është ruajtur — respektuar së bashku me qendrën e tij të rëndësishme. Për një respekt të tillë ndaj këtij territori kemi dëshmi edhe te autorët e lashtë. Kështu, Tit Livi, duke folur për Scodren, ndër të tjera, thotë: «Scodra në krahinën e labeatëve, një qytet më i fortifikuar ku tepër vështirë mund të shkellet»<sup>93</sup>. Në përgjithësi mendohet se romakët në fillim ushtrimin e detyrës së princepsit, ose të prefektit ua kanë besuar të huajve, por më vonë, rëndomtë këtë detyrë e kanë ushtruar vendasit që kanë gëzuar ius municipiale.

88 *Spomenik SKA LXXI/55*, 1931 nr. 341: Agirro Epicadi f(ilio), principi k(astelli) Salthua / et Temeiae Glavi f(iliae). Fecit Epicadus f(ilius). / Ut primum aetatis compleverunt tempora vitae / et genitor fato conditus est tumulo / protinus inscripsit pietas nomen matris (quae) / ut legerent cuncti genitoris nomina saepe. / Hoc decet ut nati componant ossa parentum / et cineri sedem substituat pietas. / (shih edhe te D. Sergejevski, *GZM u Sarajevu*, n. s. XVII/1962, 101, nr. 1).

89 *Spomenik SKA LXXI/55*, nr. 242; Caius Epicadi f(ilius) princeps / civitatis Doclatium hic situs. / Hoc fieri iussit genitor sibi et suis, Set fili eius Plassus, Epicadus, Scerdis, Verzo et summa adiecta / efficit istud opus. Est pietas natiqve / hoc auxsisse (siç) videntur et decorant facto et docent esse pios, (shih. edhe te D. Sergejevski. Po aty, 101, nr. 2.)

90 Krh. N. Vulić, Glas SKA CLV/781933 16: VLPIAEI F/p ROCUL (ae) AN XX II VALENS VARRON (is) F. PRINCEPS DESITIATI (um) ET AELIA EVSTA (...) CENO pa?...; G. Cremosnik und D. Sergejevski, *Novitates Musei Sarajevoensis*, 8-9, nr. 9.

91 Krh. A. Mócsy, *Die Bevölkerung*, 78.

92 Krh. G. Alföldi, *Bevölkerung und Gesellschaft*, 50, 53, 55, 97, 144, 156, 159, 176 ss. A. Mócsy, *Die Bevölkerung*, 46, ss, 78, 107, 111, 114, 262; Po ai: *Pannonia and Upper Moesia*, 70, 134 ss. 141 s 159, 175; Po ai: *Historia*, VI/1975, 488 ss.: M. Garašanin, ZEF VII-1 1963, 50, shën. 26.

93 Liv. XLV 31. 2: «Scodra Labeatium gestis munitissima longe et difficilis aditu».



Me interes është të ceket se këto bashkësi të popullsisë vendase, të njohura si civitates, përbëheshin edhe prej njësive administrative politike më të vogla, që quheshin decurio, për të cilat na njofton edhe Plini Plak «Viribus descriptis in decurias»<sup>94</sup>. Për këto dukuri na njofton edhe materiali epigrafik anëmbanë trevës ilire. Mendimi i përgjithshëm është se këto decuriae janë vetëm «interpretatio romana» të rendit administrativ fisnor, pikërisht ashtu siç kanë bërë edhe me kultet e vendasve dhe me dukuritë e tjera shpirtërore. Sipas K. Paçit<sup>95</sup>, anëtarët e dekurive ishin farefis dhe të një gjinie. Për këtë konstatim K. Paçi bazohet në mendimin e J. G. v. Hahnit<sup>96</sup>, i cili shprehimisht thotë se institucioni i gjinisë, apo i farefisnisë të shqiptarët është njëri nga më të lashtët, kurse sipas disa të tjerëve<sup>97</sup> dekuritë janë vëllezëri të vogla dhe se pesë deri gjashtë dekuritë formonin një katoikia<sup>98</sup>. Si duket këto katoiki i përgjigjen nocionit të oppidum-it, siç mund të shihet qartë nga përkthimi latin i veprës së Strabonit, si edhe nga letra e P. Vatinit, dërguar Ciceronit në vitin 45 p.e.s., ku në mes të tjerash thuhet: «Viginti sunt oppida Dalmatarum anti-que quae sibi ipsi asciverunt, amplius sexaginti»<sup>99</sup>. S'do mend se këto dekurie janë një dëshmi e pakontestueshme që flasin për ekzistencën e organizimit politik fisnor të ilirët gjatë tërë kohës së historisë së tyre të shkruar, dhe ky organizim ka vazhduar të funksionojë edhe gjatë sundimit romak të vendit të tyre. Në krye të këtyre civitates gjendeshin praefecti, të cilët njëherit ishin edhe (siç mund të shihet nga mbishkrimet) krerë civilë dhe ushtarakë. Këta prefektë janë dëshmuar në tërë trevën e Gadishullit Ballkanik<sup>100</sup>.

Siç mësojmë nga Plini Plak<sup>101</sup>, Illyricum-i ka qenë i ndarë në tri konvente, të cilat faktikisht janë krahinat më të mëdha

94 Plin, NH III 142.

95 Krh. C. Patsch, *GZM u Sarajevu*, X/1898, 362; Po ai: *WMBH VI/1899*, 154 ss.

96 «Der Geschlechtverband ist ind der Riça, eben so wie in ganz Albanien weit inniger und angedehnter als im Albanien... das Geschlecht ist der Inbegriff aller Agnaten und die durch Weiber begründete Verwandtschaft ist ohne politische Bedeutung». J. G. v. Hahn, *Albanesische Studien*, I, 152.

97 Krh. B. Gabričević, *VAHD LV/1953*, 103-119.

98 Strab. VII 5, 5.

99 Cic. Ad. famil. V. 10, 3.

100 CIL V 1838, 1839; CIL IX 2564, 5363; Krh. C. Patsch. *GZM u Sarajevu*, X/1898, 363; Po ai: *WMBH VI/1899*, 154 ss. *VII/1900*, 33 ss. M. Rostovzev, *Storia economica e sociale*, 280 s, 370, 496.

101 Plin. NH III 142-144.



juridiko-administrative me qendra në Scardona, Salona dhe Naronā. Kurse me krijimin e provincës së Maqedonisë<sup>101a</sup>, pjesa e trevës ilire në jug të Lissusit hyn në pjesën administrative të kësaj province, madje treva e dardanëve bëhet pjesë përbërëse e provincës Moesia Superior<sup>101b</sup> deri në vitin 297 të e.s. kur edhe për herë të parë Dardania përmendet si njësi juridike më vete. Këto njësi juridiko-administrative përbëheshin prej numrit të madh të dekurive. Në kuadrin e këtij sistemi politik dhe të strukturave të tij ekzistojnë edhe concilium-et, detyra e të cilëve ishte në fakt që të kontrollojnë administratën shtetërore lidhur me lutje, ankesa dhe vendime të caktuara<sup>102</sup>.

Në brendi të Gadishullit Ballkanik, konkretisht në Dardani, edhe në kohën e kulmit të sundimit romak, janë ruajtur njësi thjesht të karakterit klanor-fisnor, të cilat si grupe të mbyllura gjinore formonin vendbanime të caktuara. Për grupe të tilla gjinore, karakteristike edhe për strukturat shoqërore të arijasit, të cilat në «Rigvedat» përmenden si viç i cili i përgjigjet fjalës latine «vicus», dmth. «bashkësia fshatare»<sup>103</sup>, në Dardani na dëshmon materiali epografik, si p.sh. miles ex Dardania ex vico Tito<sup>104</sup>, Aurelius Moca natus in Dardania vico Zatidis<sup>105</sup>, miles ex vico Perdica<sup>106</sup>, vicus Clavadinus<sup>107</sup>.

Mund të thuhet lirisht se struktura të tilla politiko-administrative kanë vazhduar të funksionojnë gjer në shekullin V e.s. Dihet se pas reformave të mëdha administrative, të nisura që në kohën e Dioklecianit dhe të intensifikuara gjatë sundimit të Konstantinit të Madh, Iliriku përbëhej prej 14 provincave. Nëntë prej tyre, të cilat ishin të rendit të dytë, administroheshin prej praeses-ve, kurse pesë të tjerat, të cilat për Perandorinë romake kishin rëndësi të madhe, administroheshin prej konsujve, prokonsujve, respektivisht korektorëve<sup>108</sup>. Kri-za ekonomike e kishte kapluar edhe Ilirikun. Kjo ishte dukuri

101 a Krh. F. Papazoglu, *Makedonski gradovi*, 7, 42, 45, 50, 53 56, 315.

101 b Krh. J. Marquardt, *Römische Staatsverwaltung*, I, 302; A. Premierstein, *JOAI* I/1898, 173.

102 Krh. C. Patsch. *GZM u Sarajevu*, XXVI/1914, 73 ss.

103 Krh. H. Kunov, *vep e cit.* II, 14-18; M. Rostovzev, *vep. e cit.* 242; 371.

104 CIL VI 32605-2845.

105 CIL V 894.

106 CIL VI 32606-2846.

107 *ŽA*. XVI/1966, 266 ss.

108 *Not. Dignit. Or.* III, 117-125; Krhs. J. Ferluga, *Vizantijska uprave...* 9-11; W. Ensslin, *PWRE* Suppl. VIII, 1956, s.v. praeses.



e përhershme e kësaj kohe si pasojë e një gjendje jo të sigurt, nga një anë për shkak të dyndjeve të pandërprera të barbarëve në këto treva dhe, nga ana tjetër, për shkak të çpopullimit të këtyre trevave, si dhe për shkak të kryengritjeve të shpesh-ta, që ishin shprehje e qartë e një gjendjeje të rëndë ekonomike që kishte mbërthyer këtë trevë. Gjithë këto elemente kanë ndikuar që Iliriku të mos e gëzojë më atë rëndësi që kishte prej shekullit të I-III e.s. për Perandorinë. Prandaj në Ilirik tani administronin prases-ët. Në kuadër të njësisë administrativo-politike të Ilirikut tani përfshiheshin: Thesalia, Epiri i Vjetër dhe i Ri, Dakia Mediterranea, Mesia I, Dardania, Praevalis dhe Macedonia Salutaris<sup>109</sup>. Ndryshe nga konsujt dhe prokonsujt ose korektorët, që zgjidheshin prej qarqeve të senatorëve, këta praesesë, gjegjësisht hegemoni tani zgjidheshin prej strukturave të kalorësve.

## B. Strukturat sociale

Meqë gjatë trajtimit të çështjes së strukturave politike është folur pjesërisht edhe për strukturat sociale të ilirëve, këtu do të ndalemi vetëm në disa dukuri që janë tepër karakteristike, sidomos për disa vendbanime ilire. Për fat të keq, edhe këtu duhet të pajtohemi me faktin e mungesës së burimeve të shkruara. Kështu, bie fjala, «*Historia e skllavërisë*» e Theopompit ka humbur, si edhe komedia e «*Dulodidaskalos*» e Ferekratit, i cili ishte bashkëkohës i Perikliut dhe «*me nostalgji e përkujton kohën kur nuk ka pasur skllavër*»<sup>110</sup>. Kur dihet se të gjitha burimet që disponojmë dhe të cilat pak a shumë na njohin me strukturat sociale janë kompilacion i dorës së tretë dhe të katërt, atëherë kuptohet fare mirë përse çështja bëhet edhe më e vështirë. Si shembull mund të merret Atheneu (shek. II e.s.) i cili, duke folur për disa dukuri sociale të ilirët, shprehimisht thotë se të dhënat i ka marrë prej Theopompit nëpërmjet Hermiposit (peripatetikut nga Smirna, i cili jetoi rreth vitit 200 para e.s.<sup>111</sup> dhe pos tjerash ka shkruar edhe veprën, «*Mbi jetën e shtatë të mençurve*» («*Pitagorës e Aristotelit dhe nxënësve të*

109 Not. Dignit. Or. III 117.

110 Krh. M. Djurić, *Komentar Aristotelovoj politici*, 280, shën.

111 Krh. *Lexikon der Antike*, I Bd. 2, 219.



tyre, pastaj Gorgies dhe Izokratit dhe miqëve të tyre). Edhe ky thotë vetë se të dhënat i ka marrë prej Periandrit nga Korinthi, po ashtu njeri nga shtatë të mençurit<sup>112</sup>.

S'do mend se një gjendje e tillë e vështirëson edhe më përcaktimin kohor të disa dukurive të jetës sociale jo vetëm të fiseve ilire, por në përgjithësi edhe të bashkësive të gjëra shoqërore në zonën mesdhetare.

Megjithatë edhe kjo çështje duhet shqyrtuar në kuadrin e botës helenistiko-romake. Kjo nuk do të thotë kurrsesi se strukturat sociale mund të përgjithësohen për tërë trevën gjeografike të fiseve ilire, kur dihet se duhet t'i kemi parasysh veçantitë dhe karakteristikat gjeografike, pastaj kushtet politike e ekonomike, të cilat nuk kanë qenë të njëjta kudo që jetonin fiset ilire.

Përveç shtresave të larta shoqërore, përfaqësuesve të pushtetit politik, aristokracisë ushtarake fisnore, në burimet e shkruara bëhet fjalë edhe për elemente të tjera të rëndësishme dhe tejet interesante të strukturave shoqërore, si p.sh. për *prospektatë*, *dulojtë dhe oberatët*. Kështu Agatarhidi nga Knidi (gjeograf dhe historian që jetonte në oborrin e Ptolemeut, kah viti në 10 libra, dhe *Europiake* në 49 libra me të dhëna historike<sup>113</sup>, na i transmeton të dhënat nga vepra e Theopompit *Filipikaj historiai*, II, e cila për nga koha u takon viteve 350-358 p.e.s. Duke folur për ardianët, ai thotë se këta kanë pasur 300 000 prospelatë, të cilët i kanë shfrytëzuar si helot<sup>114</sup>.

Por, duke pasur parasysh se në këtë kohë ardianët shtriheshin përgjatë bregdetit Adriatik, dhe bujqësia në jetën ekonomike të tyre në këtë kohë ka qenë e dorës së dytë, pa kurrfarë mëdyshje mund të pranohet mendimi i A. Mócsyt<sup>114a</sup> se fragmenti i Theopompit ka të bëjë me autariatët e jo me ardianët. Sipas Strabonit<sup>114b</sup>, autariatët na paraqiten pikërisht në këtë kohë si popullsia më e madhe në mesin e ilirëve, kurse në një vend tjetër Atheneu, kur flet për dardanët, thotë se këta kanë pasur më se 1000 duloj të cilët në kohë paqeje kanë

112 Krh. Fr. Chamoux, *Grcka civilizacija*, 84, 440; G. Novak HZ I/1948, 145.

113 Krh. *Lexikon der Antike*, I. Bd, 1, 78.

114 FGH II, 40: «*Ardiaioi de — fesi — kektentai prospelaton hosper helionton triakonta miriadas*».

114 a Shih. shën. 270.

114 b Strab. VII 5, 11.



punuar tokën, ndërsa në raste nevoje shkonin me zotërit e tyre në luftë<sup>115</sup>.

Edhe pse të dhënat që flasin për një numër kaq të madh janë të pabesueshme dhe të ekzagjeruara, ndaj është vështirë të shfrytëzohen, prapëseprapë kjo tregon se këta autorë të lashtë nuk i kanë njohur mirë marrëdhëniet reale prodhuese, që kanë qenë karakteristike për bashkësitë shoqërore të organizuara në sistemin fisnor. Veç kësaj, dihet fare mirë që faktori i skllavit të fiset ilire nuk ka luajtur rol të rëndësishëm në jetën ekonomike<sup>116</sup>. Por që të kuptohet sa më mirë çështja e dukurisë shoqërore të dulojve, respektivisht prosperatëve, madje edhe e oberatëve, është më se e nevojshme që kjo shqyrtohet në një vertikale historike.

Dihet mirë që një bujqësi intensive nuk kërkon shfrytëzimin e fuqisë së skllëvërve, pikërisht për shkak të produktivitetit të tyre të ulët. Ndryshe nga aktivitetet tjera ekonomike, që ishin karakteristike për qytet e zejet të ndryshme në Greqi<sup>117</sup>, aktivitetet kulturoro-shpirtërore, shërbimet në aparatit shtetëror, siç ishte rasti në Romë, në Lindje skllëvërit nuk kanë pasur rëndësi për bujqësinë<sup>118</sup>. Ai paraqitet me shfaqjen e latifundistëve<sup>119</sup>. E njëjta situatë është edhe në Greqi.

Është e njohur se në kohën arkaike në Greqi tokën e kanë punuar anëtarët e familjes. Madje edhe vetë fshatari — argati nuk ka qenë i favorizuar në punët e bujqësisë. Një shembull ilustrativ për këtë e kemi te Hesiodi i cili bashkëkohësve të vet u rekomandon: «(...) them se fuqia punëtore e fshatarit-argat është e dobët»<sup>120</sup>.

Në dritën e këtyre të dhënave, mund të shihet qartë se elementi i skllavit, jo vetëm në kohën arkaike, por as më vonë nuk ka luajtur kurrfarë roli të rëndësishëm në bujqësi<sup>121</sup>.

---

115 Athen. VI, 272 d: «Dardaneis fesi dulus kektesthai, ton men hilius, ton de kai pleius tuton d'hekaston en men eirene georgiin, en polemo de lohizesthai hegemonā nemontas ton idion despoten».

116 Krh. M. Garašanin, *Istorija Crne Gore*, I, 93.

117 Herod. II 167: *Helenët (...) dhe thrakasit, skitët, persianët, lidasit dhe gati të gjithë popujt e huaj njerëzit të cilët merren me ndonjë zeje, po ashtu dhe fëmijët e tyre i konsiderojnë për diçka më të ulët se sa shtresat e tjera; kurse ata të cilët nuk merren me zeje, e sidomos ata të cilët merren me punët ushtarake, i konsiderojnë si më të lartë».*

118 Krh. O. Neurath, *op. cit.* 29, 57, 78, 149.

119 Krh. H. Kunov, *vep. e cit.* II, 19.

120 Heziod, *Poslovi i dani*, versi 604 (sipas përkthimit të A. Bazala).

121 Krh. O. Neurath, *vep. e cit.* 78.



Me fjalë të tjera nocioni skllav «ka të bëjë me strukturat qytetaro-zejtare, të cilat, sipas Aristotelit, paraqesin një turmë zejtarësh dhe punëtorësh me një hordhi sklleverish.<sup>122</sup>

Por edhe përkundrejt kësaj, shtrohet pyetja: cilët ishin këta prospelatë te autariatët, dulojtë te dardanët, apo oberatët te ilirët? Te Aristoteli lexojmë se penestët e Thesalisë dhe helotët e Lakedemonisë ishin element i papunësisë dhe i turbullirave edhe pse punonin tokën<sup>123</sup>. Megjithatë, çështja në vetvete është shumë e vështirë. Kjo vështirësi rrjedh në rend të parë nga interpretimet e ndryshme të burimeve. Prandaj nuk duhet të thjeshtohet çështja dhe të kënaqemi me një konstatim të përgjithshuar. Aq më tepër kjo vlen kur dihet se edhe qëndrimet ndaj sklleverve, ndaj pozitës së tyre juridiko-ekonomike dhe politike kanë qenë të ndryshme. Hulumtimet rreth çështjes së skllavërisë në kontekstin e botës helenistike, të bëra në gjysmën e dytë të shekullit tonë, kanë treguar se në periudhën parahelenistike kanë ekzistuar rreth dhjetë nocione për fjalën «skllav» si: «shërbëtor» «kmet», «bari»<sup>124</sup>, «pjesëtar i familjes», «fëmijë», «kallfë», «ndihmës», «shërbyes», «copë». Të gjitha këto nocione, për nga aspekti juridik, tregojnë njeriun jo të lirë<sup>125</sup>, kurse fjala *dulos*, prej shekullit V-II p.e.s. siç mund të shihet edhe nga kushtetuta e Gortynes, është në përdorim vetëm në trevën jonike, ndërsa jashtë kësaj treve kjo zëvendësohet me *oiketēs*, që do të thotë «pjestar i familjes», apo «*fqinjë*»<sup>126</sup>. Kjo domethënë është tepër e rëndësishme, sidomos për çështjen në shqyrtim, me të cilën do të merremi edhe këtu.

Me interes është për t'u cekur se kjo fjalë nuk është indo-europiane<sup>127</sup>. Dhe, me që rrënja *dul* gjendet në shumë emra vetiakë të Azisë së Vogël, kurse në Greqi në këtë funksion askund nuk është dëshmuar, mendohet se prejardhjen e ka

122 *Po aty* 79-80.

123 Arist. *Polit.* II 2, 13, 6, 2-3 (sipas përkthimit Lj. Crepa-  
ja c).

124 *Odisea*, XIV 102.

125 Krh. C. Schneider, *vep. e cit.* II, 167.

126 Krh. M. Lambertz. *Glotta*, VI/1915, 15, shën. 2. Ekzistenca  
e *oiketai*, *duloi* si shërbëtor shtëpiak, respektivisht personal dëshmohet  
edhe te Herod. VI 63, 67, 70; Ksenof. *Hellanika*, III, 1, 27; Polyb.  
IV 81, 7; V 29, 9; 35, 5.

127 *Glotta*, VI/1915, 1; E. Kretschmer *Glotta*, XVIII/1930, 74.



nga Azia e Vogël<sup>128</sup>. Me këtë rrënjë paraqiten emrat tek krisherët si apelativë prej *dule Hristu* në emrin vetiak Dulas i vitit 527 i e.s.<sup>129</sup>. Ekziston mendimi se kjo do të jetë e karakterit trakofrigas me domethënie «shtëpi», «pjesëtar i familjes», «fqinjë» «skllav»<sup>130</sup>. Por në sajë të glosës së Hesychiut: *dulos he oikia e ton epi to auto syneulesin ton gynaikon* — dolodomeis oikogeneis<sup>131</sup>, shihet qartë se përputhet me domethënien e fjalës «shtëpi». Ka mundësi që domethënia «shtëpi», për *dulos* është shfaqur në Azi të Vogël përmes «pjesëtar i familjes» në «skllav». Megjithatë, M. Lambertzi<sup>132</sup> lejon supozimin që domethënia *dulos* «skllav» të zëvendësohet me *oikos* «shtëpi», dhe një zëvendësim i tillë i është njohur Hyponaksut nga Efezi (rreth vitit 540 të e.s.), i cili ka qenë i ndjekur prej tiranit Athenagorës Komosa në Klaozomenë, dhe duke jetuar atje, i përzier me barbarë, e ka humbur pastërtinë e dialektit jonik<sup>133</sup>. Të gjitha këto të dhëna të rëndësishme flasin në dobi të mendimit se domethënia e fjalës *dulos* përputhet me domethënien e fjalës «shtëpi», respektivisht «pjesëtar i familjes», edhe pse në greqishten e vjetër fjala *dulos* nuk e ka domethënien «shtëpi»<sup>134</sup>. Në favor të kësaj domethënie shkon edhe domethënia e fjalës etruske në trajtë të apelativit dhe e cila shumë shpesh gjendet në përmendoret e mbivarrezave dhe lidhet me fjalën greke *tholos*. Kjo fjalë përmendet shumë herë edhe në *liber linteus* të Zagrebit, një çarçaf në të cilin ka qenë e mbështjellë një mumje egjiptiane. Kjo fjalë greke identifikohet me fjalën *dulos* nga Azia e Vogël, që të dyja me domethënien «shtëpi», e në këtë rast «shtëpia e të vdekurve», «shtëpia e të ndjerit». Përhapja e kësaj fjale duhet kuptuar si huazim nëpërmes jonëve të Azisë së Vogël në trajtën *dulos* të dorët sikurse *bule*, dorisht *bola*, kurse në dialektet tjera ajo është përhapur përmes *koinesë*<sup>135</sup>.

Me sa u tha më lart del përfundimi se fjala *duloi* të dardanët nuk mund të kuptohet si kategori sociale, siç është fjala

128 *Glotta*, VI/1915, 7; *Glotta*, XVIII/1930, 74.

129 *Glotta*, VI/1915, 9.

130 *Glotta*, XVIII/1930, 74.

131 Cit. ap. *Glotta*, VI/1915, 1.

132 *Glotta*, VI/1915, 4, 13.

133 *Glotta*, VI/1915, 4.

134 *Glotta*, VI/1915, 3, 13.

135 *Glotta*, VI/1915, 13.

136 *Glotta*, XVIII/1930, 75.



skllav. Në një përfundim të tillë na shtyn edhe procesi i përgjithshëm i skllavërisë në botën helene.

Nga aspekti kohor ky proces ndahet në dy faza: 1. periudha pararomake, dmth. helene dhe 2. romake. Deri sa në fazën e parë skllavërit përbëheshin kryesisht prej trakëve, sorianëve, popujve rreth Detit të Zi dhe barbarëve, në fazën e dytë, si pasojë e pushtimeve të suksesshme të legjioneve romake, skllavërit janë jo vetëm me prejardhje të ndryshme, por skllavëria bëhet, sidomos pas vitit 200 p.e.s., edhe institucion shtetëror. Kjo dukuri tani është karakteristike jo vetëm te romakët, por edhe te grekët, siç na dëshmon diploma e Delfit, e cila flet për skllavërit e liruar<sup>137</sup>. Veç kësaj, është e nevojshme të theksohet edhe fakti se, sidomos në Greqi, ka ekzistuar jo vetëm mbrojtja juridike e skllavit, por ai ka mundur të zotërojë edhe njëfarë pasurie<sup>138</sup>. Me një fjalë, elementi i skllavit në këtë kohë nuk paraqet ndonjë faktor të rëndësishëm në bujqësi. Madje duhet të kemi parasysh edhe dukurinë, e cila ishte karakteristike në Greqi për shekullin IV p.e.s., se përveç fshatarëve të lirë ka pasur edhe gjysmë të lirë, d.m.th. jo të lirë nga aspekti juridik. Dhe që toka të punohet sa më mirë ajo u është dhënë këtyre dy kategorive të fundit<sup>139</sup>. Dhe, kur dihet se Agatharhidi nga Knidi përmes Atheneut shfrytëzon të dhënat e Theopompit të shekullit IV p.e.s., besojmë se nuk jemi larg së vërtetës në qoftë se konstatojmë se këta *duloj* te dardanët do të ishin më parë qiramarrës, të cilët edhe pse juridikisht nuk ishin të lirë, ekonomikisht ishin të pavarur. Si të tillë, kanë shërbyer bashkë me anëtarët e familjes në ushtrinë e dinastëve. Megjithatë, numri i tyre nuk ka mundur të jetë aq i madh, siç na e japin autorët e lashtë<sup>140</sup>. Kjo që u tha për elementin *duloj* vlen pa dyshim edhe për *prospelatët* tek autariatët.

Edhe çështja e përkatësisë së tyre etnike nuk paraqet ndonjë vështirësi të madhe. Sidoqoftë, nuk mund të pranohet shpje-

137 Krh. C. Scheider, *vep. e cit.* II, 1, 8.

138 Idem. 174 ss.

139 Krh. O. Neurath, *vep. e cit.* 19.

140 F. Papazoglu, *ZFF VII* — I/1963, 43-44; Po ajo: *Srednjobalkanska plemena*, 83, 371, 372 shën 170 mendon se këta *duloj* më së afërti i përgjigjen pozitës së klientëve romakë. S. Islami (*Iliria*, IV/1, 1976, 77, shën. 43) i konsideron si element ekonomikisht të varur. Kurse P. Lisičar (*Crna Korkira*, 119) e konsideron si strukturë e veçantë sociale e ngjashme me çifçinjtë (kmet). A. Stipčević (*Iliri*, 168) mendon se këtu kemi të bëjmë me të zënit e skllavërve, dmth. se *te disa fise ka pasur bujq të cilët kanë qenë në pozitën sociale të nënshtruar në krahasim me shtresat e pasura të aristokracisë fisnore*.



gimi se si këta duloj (te dardanët) dhe prospelatët (te autariatët), etnikisht ishin diçka krejtësisht tjetër nga dinastët e tyre, siç mendon A. Mócsy<sup>141</sup>. Ai, në realitet mundohet të shpjegojë dhe ta argumentojë mendimin e tij duke u nisur nga dukuria e shndërrimit të pushtetit politik të një elementi në dëm të elementit tjetër. Pikërisht, ashtu siç ishin të mundur tribalët prej autariatëve, edhe këta të fundit ishin të mundur prej keltëve. Edhe K. Paçi<sup>142</sup>, në mungesë të materialit të mjaftueshëm arkeologjik dhe të burimeve të tjera të përshtatshme, mendonte se i tërë Gadishulli ballkanik ka qenë i banuar prej trakëve, të cilët, më vonë, i kanë nënshtruar fiset ilire. Sipas këtij mendimi del sikur këta duloj, ose prospelatët, etnikisht do të kishin prejardhje të huaj. Por nga analiza e materialit arkeologjik dhe burimet tjera të natyrës së ndryshme nuk del e qëndrueshme teza trake e K. Paçit, edhe pse mendimi i tij aty-këtu vërehet sot e kësaj dite goftë në shkrimet e autorëve jugosllavë<sup>143</sup> dhe të atyre të huaj<sup>144</sup>. Pikërisht në sajë të rezultateve të materialit arkeologjik dhe në mbështetje të analizave të materialit gjuhësor nga treva ilire, konceptet e përmendura nuk mund të përligjen. Prandaj *dulojtë*, ose *prospelatët* janë element vendas, autoktonë.

Përsa i përket strukturës sociale në kohën romake, mund të thuhet se ajo nuk është ndryshuar aspak. Që më parë është cekur se romakët në qëndrimin e tyre kundrejt vendeve dhe popujve të pushtuar kanë qenë jo vetëm të kujdeshëm, por janë munduar që format shoqërore-ekonomike të këtyre popujve t'i ruajnë, duke u dhënë vetëm një interpretim juridik romak. Për njohjen e këtyre strukturave sociale në periudhën romake pa dyshim rëndësi të madhe ka vepra e M. T. Varronit (116-27 p.e.s.)<sup>145</sup>. Ai, si duket, si legat i Pompeut, ishte në Ilirik në vitin 67 p.e.s., si pjesëmarrës në luftërat kundër piratëve detarë<sup>146</sup>. Kështu ka pasur mundësi që të paktën pjesërisht, të

141 Krh. A. Mócsy, *Zur Geschichte*, 86, 88.

142 Krh. C. Patsch, *GZM u Sarajevu*, XVIII/1906, 464-467; Po ai: *Historische Wanderung*, 43 ss.

143 Krh. A. Dabinović, *Otkada postoji kmetstvo*, 24/27, 99.

144 Krh. G. Alföldy, *Bevölkerung*, 47; J. J. Wilkes, *Dalmatia*, 4, 23, 27, 164. Këtu është fjala për daorsët, edhe pse për përkatësinë ilire të tyre nuk ka arsye të dyshohet (Krh. Z. Marić, *Godišnjak CBI X/8*, 1973, 109-126; Po ai: *GZM u Sarajevu*, n. s. 1975, 5-50).

145 M. Terentii Varronis, *De re rustica libri tres*.

146 Krh. *Lexikon der Antike*, I, Bd. 4, 326.



njihet me gjendjen sociale dhe ekonomike të kësaj treve<sup>147</sup>. Dhe me që edhe vetë ka qenë latifondist, ai në veprën e vet jep këshilla se si duhet të punohet toka. Kështu ai në veprën e vet, ndër të tjera, thotë: *Të gjitha tokat i punojnë ose skllëvërit ose njerëzit e lirë qoftë kur punojnë (tokën) vet, siç vepronjë pjesa më e madhe e të varfërve me fëmijët e vet, qoftë edhe me njerëz të paguar, kur me ndihmën e njerëzve të lirë kryhen punët e rënda si vjeljet ose korrjet, edhe këta ne i quajmë obaerati (punëtorët) dhe të tillë ka shumë edhe tani në Azi dhe Egjipt, po ashtu edhe në Ilirik»<sup>148</sup>.*

Nga këto të dhëna shihet qartë se M. T. Varroni flet për dy strukturat sociale kryesore që i përbënin: 1. *fshatarët e lirë* dhe 2. *skllëvërit*.

Përsa i përket grupit të parë, ai përbëhet prej tri kategorive, që janë: a — *pauperculi* (të varfërit, apo pronarët e vegjël), të cilët së bashku me fëmijët e tyre punojnë tokën, — b. *mercenari*, të cilët paraqiten si fuqi punëtoare stinore dhe kryejnë punët më të rënda të bujqësisë, siç janë vjeljet, kositjet, korrjet dhe bluarja e drithrave, dhe në fund — c. *obaerati*, të cilët paraqesin elementin e atyre strukturave, të cilat për shkak të borxheve, kanë rënë në pozitën e skllavërisë. Edhe pse dy kategoritë e para deri diku janë të kuptueshme, kjo e fundit, *obaerati*, është vështirë të determinohet dhe të përkufizohet.

Vetë Varroni thotë: *«Iique quos obaeratos nostri vocitarunt et etiam nunc sunt in Asia atque Aegypti et in Illyrico complures»<sup>149</sup>*. Shtrohet pyetja: cilët ishin këta obaerati dhe çfarë strukturash sociale paraqitnin? Sipas disave, ata paraqesin popullsinë fshatare, e cila, për t'u paguar borxhet zotërinjëve të vet, ka qenë e detyruar të punojë si argat (pa pagë) së bashku me fëmijët e vet<sup>150</sup>. Ka edhe të tillë që mendojnë se këta *obaerati* mund të identifikohen me fshatarësinë e varur

147 S'do mend se nën nocionin Illyricum të MT Varroni duhet nënkuptuar komanda ushtarake ilire, e jo një tërësi etnike gjuhësore. Me fjalë të tjera provinca romake Illyricum paraqet vetëm një rajon operativ ushtarak, e jo një njësi administrative-juridike. Por me që dihet se Illyricumi në vitin 27. p.e.s. i është dorëzuar Senatit, ai atëherë fillon të quhet Dalmatia (Dio, L III 12, 8), për shkak të luftërave që bëheshin me delmatët. Por edhe pse teksti i tij ka të bëjë vetëm me trevën e Dalmacisë, prapëseprapë mund të mirret, me një kujdes më të madh edhe për trevën e gjërë të ilirëve të kësaj periudhe.

148 M. Terentius, Varro I, 17.

149 Po aty.

150 Krh. R. Gandev, *Moralische und soziale*, 131.



të trevave trake se ishin në pozitë të bujqëve të skllavëruar, të ngjashëm me dulojt e dardanëve. Por një identifikim i tillë është vështirë të pranohet. Veç kësaj, edhe vetë paralelja kohore, d.m.th. me shek. IV p.e.s. disi është tepër e guximshme e vështirë se mund të pranohet edhe shpjegimi i domethënies së fjalës, që pa dyshim shkaktonte vështirësi të konsiderueshme. Sipas F. K. Savignyt<sup>152</sup>, kjo fjalë duhet të shkruhet jo si *Obaeratii* por si *Operarii*. Forcellini<sup>153</sup> thotë se për një mendim të tillë nuk ka kurrfarë arsytimi. Por, megjithatë, ai nuk merr kurrfarë qëndrimi të prerë, pasi përdor të dy trajtat «*obaeratii*» dhe «*operarii*». Është me interes të përmendet se kjo kategori sociale përmendet edhe te Plini Plak<sup>154</sup>, gjë që nuk duhet të na befasojë, pasi dihet se, siç u tha edhe më parë, Varroni ka qenë një nga burimet e tij më të rëndësishme. Por, te Plini Plak përdoret në funksionin «*aere diruti*» d.m.th. njerëz të nënshtruar erarit (thesarit) të shtetit romak (*Aerarium populi Romani*)<sup>155</sup>. Sipas A. Dabinoviçit, fjala është për njerëz të cilët kanë kaluar nga pronësia shtetërore (*ager publicus*) në atë private, prandaj meqë në kohën e Varronit prona tokësore të tilla, «*ager publicus*» nuk ndaheshin më, atëherë mendohet se këtu kemi të bëjmë me fshatarët në «*ager publicus romanus*», të cilët tani quhen *Obaeratii*<sup>156</sup>. Një interpretim i tillë vështirë se mund të vlejë edhe për trevën ilire kur kihet parasysh fakti se këtë trevë romakët e kanë njohur më tepër si vend të pasur me xeherore se sa si vend bujqësor. Është cekur disa herë se te ilirët elementi i skllavërisë në bujqësi nuk ka qenë faktor i rëndësishëm në ekonominë e tyre, pavarësisht nga trajtat e ndryshme dhe mënyrat e interpretimit. Prapëseprapë shpjegimi që e jep Forcellini<sup>157</sup> dhe disa të tjerë, që nën nocionin «*obaeratii*» respektivisht «*operarii*», duhet kuptuar si kategori sociale, e cila ka paguar borxhin e vet

151 Krh. B. Gerov, *GSUFF* 50/2, 1955, 19.

152 Krh. A. Dabinoviç, *op. cit.* p. 22; F. K. Savigny, *Ueber des römischen Kolonat*, Berlin 1928; M. I. Rostovzeff, *Studien zur Geschichte des römischen Kolonat*, Archiv für Papyrusforschung, I, Leipzig, 1910.

153 LTL IV, p. 331: «...*nomen proprie... absolute adhibitum de eo, qui aere alieno obstrictus, operam suam agriculturæ præstare cogitur... Quidam codd, habent obaeratos, sed, præstantiores obaerarios, alii tamen legendum putant operarios*».

154 Plin, NH XXXIV. 1.

155 Krh. A. Dabinoviç, *vep. e cit.* p. 22.

156 *Po aty*.

157 Shih shënim 153.



me punë në fushë së bashku me anëtarët e familjes së vet, është më se i pranueshëm.

Nga vepra e Varronit njihemi edhe me atë strukturë sociale e cila merrej me blegtori. Në këtë degë të prodhimtarisë rol të rëndësishëm ka pasur gruaja. M. T. Varroni nuk mund të mos befasohet, por edhe ta admirojë qëndrueshmërinë e gruas ilire, e cila është e fortë, e lirë dhe jo e turpshme; kurse në punë aspak nuk mbetet pas meshkujve<sup>158</sup>. Në bisedë me bashkëbiseduesin e vet, Tremeliun, i cili i tregonte se i ka parë gratë në Liburni të ngarkuara me dru, por që në duar përpa disa mbanin nga një e disa nga dy fëmijë<sup>159</sup>, ai i përgjigjet se gratë ilire aq lehtë lindin sa që kur vjen koha për të lindur, anohen pak në një skutë dhe bëjnë fëmijën sikur e gjejnë e jo e lindin<sup>160</sup>. Prandaj nuk është për t'u habitur pse një romak, duke ditur dobësinë dhe shëndetligësinë e grave romake, ka qenë i mahnitur jo vetëm me një pozitë të tillë të gruas ilire, por edhe me qëndrueshmërinë e vitalitetin e saj: ato janë «*matres familias*» me kuptim të «zonjës së shtëpisë», e cila pozitë është e strukturave të lira sociale blegtorale<sup>161</sup>. Sidoqoftë, pozita shoqërore e gruas ilire ka qenë tepër e volitshme dhe mund të thuhet se ajo ka qenë e barabartë me mashkullin. Nuk mund të shpjegohet ndryshe (në mes tjerash) sundimi i Teutës pikërisht në një kohë aq kritike për ilirët. Madje Atheneu<sup>162</sup> na flet (duke përfolur Theopompin), për emancipimin dhe lirinë e gruas ilire, e cila ka ngrënë dhe pirë me meshkujt në gostira dhe ahengje, apo çonte dollinë për mysafirët. Me vendosjen e pushtetit romak në trevën ilire, struktura sociale nuk pëson aspak ndonjë ndryshim. Romakët, të prirur nga pragmatizmi politik, e kanë ruajtur gjendjen e përparshme të strukturave sociale, duke u dhënë vetëm interpretimin juridik romak. Vetëm në këtë mënyrë Roma ka mundur të zbatojë politikën e jashtme, qëllimi kryesor i së cilës ishte që ta shfrytë-

158 M. T. Varronis, II, 10: «*Quae in opere multis regionibus non cedant viris, ut in Illyrico passim videre licet*».

159 M. T. Varronis, II, 10, 8; *Ut te auddi dicere, inquit cum in Liburniam venisse te vidisse matres familias, eorum adfere ligna et simul pueros, quos alerent, alias singulos, alias binos, quae ostenderent fetos nostras, quae in copiis iacent dies aliquot, esse eiuncidas ac contemendas*».

160 Po aty.

161 Këtu nuk do të bëhet fjalë për gratë liburniane dhe për pozitën shoqërore të tyre, me që për këtë çështje është folur gjërë e gjatë (Krh. M. Suić, *Nekoliko etnoloških podataka o antičkim Ilirima*, 99-110).

162 Athen. X 443 ab 60.



zotë sa më shumë pasurinë nëntokësore të tërë trevës ilire<sup>162a</sup>. Duke filluar prej Vespazianit<sup>163</sup>, Trajanit<sup>164</sup> e tutje, Roma fillon të themelojë në viset e pushtuara koloni dhe municipiume, me qëllim që ta thyejë qëndresën e popullsisë vendase. Popullsia që jetonte në rrethinën e këtyre qendrave është trajtuar si *incolae*<sup>165</sup> (që e punonin tokën me pagë), apo mercenare. Dhe derisa popullsia e kolonive shërbente në legjione, ajo e municipiumeve, si *peregrin*, shërbente në trupat ndihmëse<sup>165a</sup>.

Me zhvillimin e sistemit të latifundeve, struktura sociale pëson ndryshim<sup>166</sup>. Pozita gjithnjë e më e rëndë sociale e ekonomike e kolonëve pati si rrjedhim braktisjen e tokës dhe ikjen e tyre prej pronarëve. Prandaj, duke filluar prej shek. IV e.s., perandorët, për të penguar këtë dukuri, janë orvatur që me masa të ndryshme ligjore t'i lidhnin këta kolonë me tokën<sup>167</sup>. Të njëjtin fat kanë pësuar edhe fshatarët e lirë<sup>168</sup>. Një pozitë e tillë nuk i ka dalluar ata aspak nga skllëverit.

Edhe pse në qendrat urbane struktura sociale ka qenë e diferencuar dhe deri diku ishte në pozitë më të mirë, prapëseprapë pozita sociale e strukturave që punonin në xeherore dhe gurore ishte identike me të skllëverve. Këtë na dëshmojnë të dhënat e Florit<sup>169</sup>, i cili thotë se Augusti i dha urdhër Viviut, mëkëmbësit të Dalmacisë, që ta detyronte popullsinë vendase për të punuar në minierat e xeherorëve.

## C. Strukturat ekonomike

Nga kjo që u tha deri më tani mund të krijohet një tablo e përgjithshme e karakterit të problematikës ekonomike dhe të strukturave të saja te fiset ilire. Megjithatë, duhet thënë se

---

162 a Krh. G. Novak, HZ I/1948, 150 ss; E. Pašalić, *GZM u Sarajevu*, n. s. IX/1954, 68; M. Garašanin, *Istoria Crne Gore*, I, 107, 145, 154. Për këtë shih edhe CAH VII, chap. XXVI, 4, 832 ss; G. Wasler, *Historia*, II/4, 1953 310 ss.

163 Krh. M. Rostovzev, *vep. e cit.* 275.

164 Krh. Z. Mirdita, *Eine Inschrift aus Ulpianum*, 161-166.

165 Dig. L. 16, 239, 2.

165 a PWRE XXIV/2, 1925. s. v.

166 Shih shën. 152.

167 Cod. Instin. XI 53, 1.

168 Cod. Instin. XI 53 (52).

169 Flor. I, III, 25.



mbi këto struktura, në krahasim me ato politike e sociale, autorët antikë na sjellin të dhëna mjaft të pasura. Në bazë të këtyre të dhënave si dhe atyre nga materiali epigrafik, tabllolja e strukturave ekonomike na paraqitet më e qartë dhe e shumëllojshme.

Përveç bujqësisë dhe blegtorisë, fiset ilire merreshin edhe me degë të tjera të ekonomisë, siç ishte xehëtaria, zejet e ndryshme, tregtia etj. Kuptohet se një veprimtari e shumëllojshme ekonomike ka kushtëzuar edhe zhvillimin intensiv të tregtisë. Veç të tjerash, në zhvillimin e saj kanë kontribuar, nga një anë pozita gjeografike e territorit ilir dhe mundësitë natyrore për komunikim me krahinat fqinje, dhe nga ana tjetër zhvillimi i gjithanshëm i jetës qytetare, e cila, sidomos në shek. IV p.e.s., bëhet faktor i rëndësishëm i jetës ekonomike. Veç kësaj, duhet të kemi parasysh edhe pasuritë natyrore të trevës ilire, të cilat jo vetëm që kanë ndikuar, por edhe kanë intensifikuar e shpejtuar mënyrat e prodhimit. Në rend të parë duhet përmendur xehëtaria.

Roli i rëndësishëm i qytetit në ekonominë e pellgut mesdhetar — sidomos të grekët, fillon që në kohën e Mikenës<sup>170</sup>. Sistemi i kolonizimit dhe themelimi i vendbanimeve të reja, apo i emporeve kryesisht për gjatë bregdetit, ka ndikuar në diferencimin e strukturave sociale. Ndarja e punës pati si rrjedhim intensifikimin e tregtisë, të zejtarisë dhe të formave të tjera të jetës ekonomike.

Themelimi i kolonive greke përgjatë bregdetit Adriatik, si Dyrrachium (627) Apollonia (588) Isa (397/390)<sup>171</sup> dhe emporët e tyre, s'ka dyshim se ka ndikuar në pozitën politike, sociale dhe ekonomike të vendbanimeve ilire. Dhe që në shek. IV p.e.s., sidomos në trevën e Ilirisë së Jugut, kemi qytetin e zhvilluar, i cili nuk ndryshon aspak nga ai i lashtësisë, si në pikëpamje ekonomike dhe politike<sup>172</sup>. Lirisht mund të thuhet se

170 Krh. O. Neurath, *vep. e cit.* 45.

171 Krh. G. Novak, *Stari Grci na Jadranskom moru*, 145-221; Po ai: *Kolonizatorsko djelovanje Dionizija Starijega*, 111-128; Po ai: *Das griechische Element in Dalmatiens Städten*, 117-125. Mbi ndikimin e grekëve në Adriatik shih sidomos: R. L. Beaumont, *JHS*, vol. LVI/1936, 159-204.

172 Krh. P. Lisičar, *Crna Korkira i kolonije antičkih Grka na Jadranu*, Skopje 1951; S. Islami *Iliria*, II/1972, 7-23; F. Prendi, *Iliria*, IV/1976, 81-100.



e njëjta situatë ka qenë edhe përgjatë tërë bregdetit të Adriatikut<sup>173</sup>, madje edhe në brendi të Gadishullit Ballkanik<sup>174</sup>.

Njëra nga qendrat e tilla të rëndësishme ishte edhe Damastioni. Straboni thotë se ai ishte i pasur me minerale, sidomos me argjend<sup>175</sup>. Edhe pse ende nuk është caktuar saktësisht<sup>176</sup> se ku gjëndej, prapëseprapë në rastin tonë konkret është e rëndësi të theksohet se ai gjëndej diku në trevën ilire. Rëndësia ekonomike e këtyre qendrave urbane pasqyrohet edhe përmes monedhës, e cila qarkullonte në atë kohë. Ajo tregon për zhvillimin intensiv të tregtisë, sidomos të këmbimit të prodhimeve bujqësore-blegtorale nga brendia e vendit me mallin luksoz, i cili prodhohej në këto qendra si edhe me ato përtej detit. Këtë e dëshmon edhe qeramika e Apulisë që është gjetur në brendi të Gadishullit Ballkanik<sup>177</sup> e jo vetëm në vendet bregdetare. E dihet se kjo qeramikë prodhohej në Apuli prej shek. VIII-V. p.e.s.<sup>178</sup>. Gjetjet e pasura të monedhave në brendi të vendit, si në Apolloni dhe Durrachium<sup>179</sup> po ashtu edhe në Damastion<sup>180</sup> flasin qartë për prodhimin e mallrave të ndryshme dhe nxjerrjen e tyre në treg<sup>181</sup>. Në bazë të të dhënave të Pseudo-Aristotelit<sup>182</sup> dhe të Strabonit<sup>183</sup>,

173 Krh. M. Suić, *Antički grad na istocnom Jadranu*, Zagreb, 1976; M. Garašanin, *Istorija Crne Gore*, I, 193-240.

174 *Kulturna Istorija Bosne i Hercegovine*, 178-185; M. Mirković, *Einheimische Bevölkerung und römische Städte*, 811-884.

175 Strabo VII 7, 7.

176 Krh. J. M. F. May, *The Coinage of Damastion...* London 1939; R. Katičić, *Godišnjak*, CBI XIV/13, 1977, 47-49; Z. Mirdita, *Rrethi për problemin të lokalizimit...*; shih këtu....

177 Krh. N. Ceka — L. Papajani, *Monumentet*, 1/1971, 43; S. Islami *Iliria* IV/1, 1976, 76.

178 Krh. P. Lisićar, *vep. e cit.* 36-39; *Apulska keramika na istočnoj jadranskoj obali*, Zadar 1972.

179 Krh. H. Ceka, *Questions de numismatique*, 21 ss.

180 Krh. J. M. F. May, *The Coinage of Damastion...*, London 1939.

181 Është interesant një shënim i Strabonit, i cili thotë se dalmatët nuk e përdorin monedhën, e kjo dukuri është karakteristike për shumë barbarë (Strabo, VII 5, 5, «...to de me hresthai nomismasi pros men tus en te paralia taute edion, pros allus de ton barbaron polus koinon»). Megjithatë, dihet se në këtë trevë është gjetur edhe monedha e kohës republikane. Madje, edhe pse dihet se Straboni për përshkrimin e bregdetit Adriatik ka shfrytëzuar Theopompin, Eforin, Timeun etj. prapëseprapë nuk mund të kuptohet për cilët barbarë është fjala. Vetëm në qoftë se mendohet për fiset që jetonin në brendi të Dalmacisë, se tjerat fise bregdetare, si bie fjala daorsët, kanë prerë monedha të veta. (Krh. Dj. Basler, *GZM u Sarajevu*, n.s. XXII/1971, 333 ss; I. Marović, *Godišnjak* CBI XIII/11, 1976, 221 ss.)

182 Pseud. Arist. *De mirabilibus auscultationibus* 844 b 138.

183 Strab. VII. 5, 11.



ku thuhet se ardianët nuk kanë importuar kripë dhe se nuk janë përzier me popujt tjerë, shihet se ka qenë e zhvilluar tregtia me kripë. Tregtia ka qenë veprimtari e rëndësishme ekonomike te ilirët gjatë tërë kohës së sundimit romak. Kështu, në veprën e autorit Anonim të njohur me titullin *Descriptio totius mundi et gentium*<sup>184</sup> (përshkrimi i tërë botës dhe i popujve), i cili për nga koha i takon mesit të shek. IV e.s., lexojmë se djathi dardan ka qenë shumë i njohur. Sipas mendimit tonë, tradita e përpunimit të këtij djathi ruhet edhe sot e kësaj dite me prodhimin e djathit të Sharit. Kurse për Dalmacinë Anonimi thotë se ajo ka eksportuar tri prodhime kryesore: drurin, djathin dhe hekurin. Po ashtu në Romë është importuar edhe djathi i dokleatëve, i cili ka qenë shumë i njohur<sup>185</sup>.

Monedha është e rëndësishme edhe për njohjen e veprimtarisë bujqësore dhe blegtorale. Simbolika e shtypur në faqe të monedhës, si, për shembull, parmenda, kallinjte e rrushtë<sup>186</sup> flet qartë për zhvillimin e bujqësisë e vreshtarisë. Këto dëshmi i konsiderojmë shumë të rëndësishme. Ato e plotësojnë mungesën e të dhënave të autorëve të lashtë.

Lidhur me bujqësinë ilire<sup>187</sup> kemi të dhëna të përgjithshme në veprën e Pseudo-Scynimit<sup>188</sup>, i cili shprehimisht thotë se ato fise që jetojnë në brendi merren me bujqësi. Nga të dhënat arkeologjike del se bujqësia në brendi të Gadishullit Ballkanik kishte një traditë të gjatë, e cila fillonte që në kohërat parahistorike. Kështu, në Butmir, në shpellën e Hrustovaçës (të Sanski Most), pastaj në Ripaç, është gjetur grurë i karbonizuar, gurë blues, farë fasuleje dhe e bishtajave të ndryshme, mbeturina të rrushit e të shumë frutave tjera, që tregojnë se popullsia e kësaj treve është marrë me bujqësi<sup>189</sup>. Madje edhe vetë Agatharhidi i Knidit, duke folur për dulojtë

184 Anonymi *Descriptio totius mundi et gentium* A 51, A 53.

185 Plin. NH XI 42 (97).

186 Krh. H. Ceka, *Questions de numasmatique*, 91 ss; P. Lisičar, *vep. e cit.* 39 ss.

187 Më gjerësisht për bujqësinë te ilirët, shih: K. Kurz, *Sbornik Historicky*, 16/149-171.; A. Stipčević. *Iliri*, 137 ss.

188 Shih, shën. 38.; Strab. VII 5.

189 Krh. G. B. Managetta, *GZM Bosne i Hercegovine* VIII/1896, 43-48; K. Maly, *GZM Bosne i Hercegovine* XVI/1904, 165-170; A. Benac, *GZM u Sarajevu*, n.s. VI/1951, 271-279. (Këtu gjendet tërë literatura për këtë çështje).



te dardanët, ose për prospelatët te autariatët<sup>190</sup>, flet për një bujqësi e cila, edhe përkundrejt ekzagjerimit të shifrave, ka qenë degë e rëndësishme e jetës ekonomike të kësaj pjese qendrore të Gadishullit Ballkanik. Lidhur me bujqësinë ka rëndësi edhe dukuria e ndarjes së tokës, e cila ka qenë karakteristike për delmatët. Sikundër mësojmë nga Straboni<sup>191</sup> dhe Stefan Bizantini<sup>192</sup>, delmatët e kanë ndarë tokën për çdo tetë vjet me anëtarët e klanit dhe të fisit. Me që Straboni për këtë trevë ka shfrytëzuar të dhëna të veprave të autorëve të ndryshëm si Theopompi, Timeu, Efori, mund të shihet se kjo dukuri është e hershme e jo e kohës së Strabonit<sup>193</sup>. Madje ndarja periodike e tokës nuk ka qenë e panjohur për botën antike. Kështu në Spartë Likurgu parashihte që toka të ndahet pas disa viteve të caktuara<sup>194</sup>. Këtë urdhër të Likurgut e ka rishikuar mbreti spartan, Agisi<sup>195</sup>, duke urdhëruar që toka e pushtuar t'u ndahet në pjesë të caktuar spartanëve. Duke mos hyrë në hollësi, duhet theksuar se edhe në Romë është ndarë toka shtetërore «ager publicus», respektivisht «ager adsignatus», në Itali madje edhe në pronë private, kurse ajo në provinca, e cila është konsideruar si element fiskal, u është dhënë pronarëve të rinj të tokës, ose u është lënë atyre të përparshmeve<sup>196</sup>. Edhe nga diktati i Scodrës i L. Aniciut mësojmë se tek ilirët toka është dhënë edhe me qira, gjë që ia ka vështirësuar shumë jetën popullsisë që banonte në rrethinën e saj<sup>197</sup>.

Vetvetiu shtrohet pyetja: ç'duhet kuptuar me okteni, tetësh, dukuri që ka qenë karakteristike për tërë pellgun mesdhetar<sup>198</sup>. Me fjalë të tjera, kjo ka të bëjë me ndarjen e një toke pjellore, e cila do të kalonte për çdo tetë vjet prej duarve në duar. Secili që ka kaluar nëpër trevën e delmateve, ka pasur mundësi të vërejë se ajo është një rajon kodrinor-malor, që është më i përshtatshëm për blegtori se sa për bujqësi.

190 Shih shën. 115.

191 Strab. VII 5, 5: «*idion de ton Dalmateon to dia oktaeteridos horas anadasmon poieisthai*».

192 Steph, Byzan. *Ethnika*, 285, 5.

193 Krh. G. Novak, HZ I/1948, 145.

194 Plut. Licurg 17.

195 Plut. Agid 9.

196 Krh. I. M. Rostovtzev, *Storia economico e sociale*, 14 ss.

197 Liv. XLC 18.

198 Krh. M. Budimir, VAHD LIII, 1952, 12.



Kjo vlen edhe për Duvanjsko Polje, ku gjendej Delminiumi<sup>199</sup>. Andaj, nëse e marrim parasysht faktin se delmatët shtriheshin përgjatë bregdetit të Adriatikut, ç'prej lumit Titius (Krka) në veri e deri në Naron (Neretva) në jug, pastaj në pjesën e Boshnjës qendrore dhe jugperëndimore<sup>200</sup> atëherë s'do mend se këtu është fjala për kullota e ndoshta edhe për pyje. Vetë Straboni<sup>201</sup> thotë se emri i qytetit Delminium do të thotë kulloja për dele, kurse Flori<sup>202</sup> shkruan se delmatët kryesisht jetojnë nëpër pyje. Nga gjithë kjo që u tha, na duket plotësisht i drejtë konstatimi i M. Suiq<sup>203</sup>, se në këtë rast kemi të bëjmë me ndarjen e kullotave e jo të tokës së punuar. Arsyetimin për këtë ai gjen në disa shembuj të qyteteve bregdetare të Dalmacisë të kohërave më të reja, kur sistemi i ndarjes së kullotave ka qenë i përcaktuar edhe me Statute. Kështu, bie fjala, statuti i qytetit Pag përcakton rregullat dhe normat për ndarjen e kullotave çdo tetë vjet. Megjithatë, një dukuri e tillë nuk mund të përgjithësohet për tërë trevën e fiseve ilire.

Një nga degët e rëndësishme në ekonominë e fiseve ilire ka qenë edhe blegtoria. Përveç të dhënave që na jep simbolika e monedhave, në faqet e të cilave është e shtypur dhia, apo dreri, edhe pse në realitet janë monedha që janë prerë në Issa dhe Faros, pa mëdyshje mund të konstatohet se kjo popullsi është marrë me blegtoria. Për këtë degë të prodhimit kemi të dhëna të shumta edhe në vepra të autorëve të lashtë. Kështu, Stefan Bizantini<sup>204</sup>, duke cituar Hekateun, thotë se krahina e Adrisë është e pasur me kulloja, ku kafshët pjellin dy, tri e shpeshherë edhe pesë keca në vit. Pseudo-Skimni<sup>205</sup> na njofton se toka është shumë pjellore dhe se bagëtia pjell binjakë, kurse Straboni<sup>206</sup> shkruan për luftërat e ashpra ndërmjet

199 Rreth lokalizimit të Delmiumit ka mendime të ndryshme. C. Patsch (GZM BiHa, XVI/1904, 307-346) mendonte se Duvno duhet të identifikohet me Delminium-in. Kohët e fundit. M. Zaninović-i (*Godišnjak CBI V/3 1967*, 5 ss) mendon se ai duhet të ubikohet në Gradinën te Gaj-i mbi vetë Duvnën. I fundit i cili është marrë me këtë problematikë është edhe I. Bojanovski. Sipas tij Delminiumi duhet të lypet në Prisoj (Krh. I. Bojanovski, *Dolabelin sistem, cesta*, 233-244. Këtu edhe gjendet e tërë literatura e njohur rreth kësaj çështjeje).

200 Krh. M. Zaninović, *Godišnjak CBI IV/2, 1966*, 33 ss

201 Strab. VII 5, 5: «...*Delminion de megale polis, hes eponymon to ethnes, mikran d'epoiese Nasikas kai to pedion moloboton*»; Strab. VII 5, 4; 5, 10.

202 Flor II, 23: «*Delmatae plerumque sub silvis agunt*».

203 Krh. M. Suić, *Nekoliko etnoloških podataka*, 103-104 shën. 19.

204 Steph. Byzan. s.v. Adria.

205 Pseudo-Scym. 317; Pseudo Aristot, *De Mirab. auscult.* 128

206 Strab VII 5, 11.



autariatëve dhe ardianëve rreth burimeve të njelmëta, të cilat mund të identifikohen me trevën e Konjicës<sup>207</sup> në Bosnjë, me çka shihet nga rëndësia e këtyre kriporeve për blegtorinë e këtyre fiseve. Në veprën Mbi historinë e kafshëve që i mvishet Aristotelit, flitet për mbrojtjen e kafshëve siç janë derrat, njëthundërakët, lopët, gomarët, delet, dhitë, pulat etj.<sup>208</sup> Edhe M. T. Varroni në veprën e vet flet për numrin e madh të buajve dhe të buallicave në Dardani<sup>209</sup>, kurse në Iliri janë mbajtur shumë delet. Te ilirët ka qenë e njohur edhe bletaria dhe prej mjaltit taulantët kanë prodhuar një lloj pijeje<sup>210</sup>.

Ilirët kanë kultivuar edhe hardhinë e rrushit. Mendohet se këtë ilirët e kanë marrë prej grekëve<sup>211</sup>. Por, siç u cek më sipër, në Ripaç janë gjetur dëshmitë e hardhisë së rrushit<sup>212</sup>, kështu që shifet qartë se kjo është kultivuar edhe në brendi të Gadishullit Ballkanik shumë përpara kontakteve greke me këto vise. Pavarësisht nga çështja e prejardhjes së hardhisë së rrushit (edhe pse A. Stipčevići<sup>213</sup> mendon se këtë ilirët e kanë njohur para kontakteve të tyre me grekët) vera ka qenë pije të cilën ata e kanë konsumuar me shumicë. Kështu Polyaeeni<sup>214</sup> tregon se si keltët i kanë mundur me dinakëri autariatët duke ua helmuar verën dhe ushqimin tjetër, të cilin, pasi e konsumuan u dehën dhe u helmuan. Kështu edhe Atheneu<sup>215</sup>, duke u mbështetur në Theopompin, thotë se ilirët kanë prodhuar shumë pije.

Përveç gjuetisë e peshkatarisë dhe veprimtarive të tjera shtëpiake, për çka na flasin edhe veglat e punës<sup>216</sup>, veprimtari e rëndësishme e ilirëve, si edhe e popujve të tjerë mesdhetarë ka qenë edhe piratëria. Lidhur me këtë ekziston një literaturë e gjerë. Kështu H. J. Delli<sup>217</sup> mendonte se piratëria te ardianët ka qenë e organizuar dhe me të ata kanë prekur edhe

207 Krh. *Istoriya Crne Gore*, I 91.

208 Pseudo Aristot. *De animalium Historia* 1, 499b; 20, 522b; 18, 572b; 28, 606b; Pseudo Aristot. *De mirab. auscult.* 835b, 75; 182; 844b, 138. Plin. NH III 46 (106): «Sues in Illyrico quibusdam locis solidas habent nuguales».

209 M. T. Varronis II, 1; II, 10.

210 Pseudo Aristot. *De mirab. auscult.* 832a 22.

211 Krh. G. Novak, HZ I/1948, 145, 150.

212 Krh. A. Benac, *GZM u Sarajevu*, n.s. VI/1951, 271-279.

213 Krh. A. Stipčević, *Iliri*, 138.

214 Polyaeen. VII, 42.

215 Athen. X 443ab 60.

216 Krh. A. Stipčević, *Diadora*, II/1960/61, Zadar, 1962, 135-177.

217 Krh. H. J. Dell, *Historia*, XVI/1967, 344-358; CAH VII, chap.



interesat imperialiste të Romës. Për këtë veprimtari të ilirëve na flasin mjaft edhe autorët e lashtë, të cilët thonë se kanë qenë shumë të shkathët në det<sup>218</sup>. Kështu Tit Livi thotë se: «ilirët, liburnët dhe istrët kanë qenë të egër dhe shumica prej tyre kanë qenë në zë për keq për shkak të piratërisë»<sup>219</sup>. Duroni, pasi në vitin 180 para e.s., kthehet nga Iliria në Romë, në raportin e vet ndër të tjera, thotë se iniciator dhe shkaktar i piraterisë ishte vetë mbreti Genc<sup>220</sup>. Siç mund të shihet nga kjo që u tha, një nga burimet e pasurimit të mbretit dhe të shtresave të tjera të larta të fiseve ilire ka qenë pikërisht piratëria. Shikuar nga ky aspekt, mendojmë se deri diku mund të kuptohet edhe përgjigja e Teutës përfaqësuesve romakë, vëllezërve Koruncan<sup>221</sup>.

Por njëra nga degët më të rëndësishme të ekonomisë, që nga koha e parahistorisë e deri në lashtësinë e vonë, ka qenë pa dyshim xehetaria. Straboni<sup>222</sup> na flet për xeherorët e argjendit në afërsi të të cilave gjendej qyteti Damastion. Ari ilir ka qenë shumë i njohur në Romë. Te Plini Plak<sup>223</sup> lexojmë se byzylykët prej ari në Dardani i mbanin edhe meshkujt, prandaj këtu quhen dardanë. Në një vend tjetër, kur flet për Dalmacinë, po ky autor thotë: «Në qoftë se punon fati, këtu mund të gjendet ari në sipërfaqe të tokës, kështu që në kohën e sundimit të Neronit në Dalmaci ndonjë ditë është gërmuar edhe nga 50 funti»<sup>224</sup>.

Sasia dhe shkëlqimi i arit ilir, (siç shihet nga Ligji XII i tabelave),<sup>225</sup> jo vetëm që janë shumë të çmueshëm, por edhe është ndaluar që të vdekurit të varrosen me të. Kjo i ka shtyrë edhe poetët romakë të thurrin vargje për të. Kështu M. V. Martialis (38/41 — 104 e.s.), duke iu drejtuar njëfarë Makrit, thotë: «Do të shkosh, o Makro në Salonë, që shtrihet në breg të detit, banor fatlumë i tokës së pasur me flori»<sup>226</sup>,

218 Polyb. II 8, 8; Appian, *Illyrike* 3.

219 Liv. X 4, 2: «*Illyrii Liburnique et Istri, gentes ferae et magna ex parte latrociniis maritimis infames*».

220 Liv. XL 42, 1.

221 Polyb. II 8, 8.

222 Strab. VII 5, 7.

223 Plin. NH (XXXIII 3612): «(...) habent in lacertis iam quidem et viri, quod ex Dardanis venii-itaque et Dardanium vocabitur».

224 Plin. NH (XXXIII 4621): «*Inventur. (sc. aurum) aliquando in suma telure protinus, rara felicitate, ut nuper in Dalatia principatu Neronis singulis diebus etiam quinquagenas libras fundens*».

225 Krh. Zakon XII Tablica X 7., në: Stojan Jasić, *Zakoni staroga i Srednjoga vijeka*, Beograd 1968.

226 M. V. Martialis, *Epigramaton libri*, X, 78, vers 1-5: «*Ibis litoreas Macer Salonas /...../ Felix auriferæ colone terræ*».



kurse epiku P. Papin Stati, (i shekullit të parë e.s., i cili vdes në vitin 96 të e.s.) duke kënduar për xeherorët e floririt të Dalmacisë, ndër të tjera thotë: «Shkëlqen bungu të cilin me bollëk e zbukuron metali dalmatin, ai që shkëlqen (sc. floriri) në brigjet dalmatine»<sup>227</sup>. Nga këto të dhëna, sado të pakta, shihet se çfarë rëndësie ka pasur metalurgjia ilire, konkretisht ari dalmatin, për Romën. Kjo pasqyrohet edhe në fjalët e L. Aenej Florit, i cili, ndër të tjera, thotë: «*Augusti urdhëroi Vibium* (sc. mëkëmbësin e Dalmacisë, Z. M.) që t'i nënshtrohej tërësisht dhe ky e detyron fisin e egër të gërmojë tokën dhe ta ripastrojë arin; se ky popull ishte më i lakmueshmi nga të gjithë dhe hulumtonte arin me asi zelli dhe me aso vëmendje sa që dukej se gërmonte për nevojat e veta»<sup>228</sup>. Jeta në këto xeherore ka qenë shumë e vështirë. Për mënyrën e gërmimit dhe të nxjerrjes së xeheve na ka lënë një përshkrim shumë impresiv Plini Plak. Ai, ndër të tjera, thotë se janë hapur miniera në anët e të cilave hapeshin degët e xeheve, kurse toka mbahej me trarë druri<sup>229</sup>. Për zhvillimin e xehetarisë në lash-tësinë e vonë nuk kemi të dhëna të posaçme. Në bazë të ediktit të Theodosit, dërguar Eusingnit, prefektit të prefekturës së Ilirikut, i cili ka drejtuar me të në vitin 386 e.s., shihet se xeherorët ishin nën mbikqyrjen e prokuratorëve, të cilët zgjidheshin nga radhët e kurialëve. Madje nga ky edikt gjithashtu mësojmë se prokuratorët e xeherorëve të Maqedonisë, Dakisë së brendshme, Mezisë dhe Dardanisë, që kanë qenë të detyruar të mbledhin edhe tagrat vjetore, e braktisnin këtë detyrë, nga frika, dhe për këtë arsye u është urdhëruar që këtë detyrë ta ushtrojnë deri në fund<sup>230</sup>. Një gjendje e tillë mund të shpjegohet si pasojë e dyndjeve të pandërprera të barbarëve, që kanë shkaktuar pasiguri. Por megjithatë interesi për pasurinë nëntokësore nuk është shuar. Kështu, në shek. VI. e.s. te Mark

227 P. Papinius Statius, *Silvarum libri quinque*, I 2, 13; III 3, 86.

228 Flor. I, III, 25; «*Sed Augustus perdomandos Vibio mandat qui efferum genus foder terras coegit aurumque repurgare; quod aliquin gens omnium cupidissima eo studio, ea diligentia auquirat, ut illud in usus suos eruere videntur*».

229 Plin. NH XXXII, 25.

230 Cod. Theod. I. 32, 5 (386 Jul. 29): «*...Cum procuratores metallorum i(n)tra Macedoniam Daciam mediterraneam Moesiam seu D(ar)daniam soliti ex curialibus ordinari, per quos sollempnis pr(o)fligetur exaction simulato hostili metu huic se necessita (ti) subtraxerint, ad implendum munus retrahantur ac nulli de (in)ceps licentia laxetur prius indebitas expetere dignitate(s) quam subeundam procurationum fideli sollertique exas(tio)ne compleverint*».



Aurel Kasiodori lexojmë për xeherorët e Dalmacisë: «Madje të urdhërojmë edhe që të hulumtosh në trapet e sakta nëntokësore në Dalmacinë e përmendur dejt e hekurit, ku në tokën e butë ngashëret hekuri i fortë dhe me zjarr shkrihet që të bëhet më i qëndrueshëm.»

«Prandaj me urdhërin tonë e kemi dërguar Simeonin, njeriun shumë të shquar, besnikëria e të cilit me kohë na është e njohur dhe është sprovuar, në provincën e Dalmacisë që ta rregullojnë pagesën e tatimeve në natyrë e po ashtu të rregullojë shfrytëzimin e xeherorëve të hekurit.»<sup>231</sup>.

Ushtrimi i xehetarisë shprehet edhe në toponiminë, që është ruajtur sot e kësaj dite në trevat e Ilirikut, si p.sh. Srebërnica (Argentaria), Olovo etj. (në Bosnje). Meqë për veprimtarinë e xehetarisë ekziston një literaturë e pasur, këtu nuk do të flasim më tepër qoftë për shfrytëzimin qoftë për administrimin dhe funksionimin e saj.

Por në Notita Dignitatum, ku na paraqitet gjendja e mbarimit të shek. IV dhe e fillimit të shek. V. e.s. në Ilirik dhe në pjesët e tjera të Perandorisë së vonë romake, gjejmë mjaft të dhëna lidhur me ekonominë e këtyre viseve. Kështu, këtu flitet për *gynaeceumet*, punëtori pëlhurash, të cilat gjendeshin kudo në Dalmaci. Ajo e Splitit, të cilën e themeloi Diokleciani<sup>232</sup>, funksionon edhe në shek. VI. e.s.<sup>233</sup>. Kurse në lashtësinë e vonë ekzistojnë «*Procurator gynaeicii Ioviensis Pannoniae Aspalato*» dhe «*Procurator gynaeicii Bassanensis Pannoniae Secundae transplati Salonis*»<sup>234</sup>. Këto punëtori në shek. IV edhe V. ishin prona perandorake, punëtorët e të cilave ishin kryesisht skllëvër dhe ata në rend të parë të krishterët<sup>235</sup>. Si në veprimtaritë e tjera ekonmoike, ashtu edhe në këto *Gynaece* punëtorët nuk mund t'i braktisin punëtoritë, ose të kalojnë të ndo-

---

231 PL Ep. XXV, XXVI, 590: «*Praeterea ferrarias venas praedictae Dalmatiae cuniculo et veritatis jubemus inquirere, ubi rigorem ferri pariturit terrena mollities, et igne decoquitur, ut in duritiam transferatur. Hinc, auxiliante Deo, defensio patriae venit; huic agrorum utilitas procuratur, et in usus humanae vitae multiplici commoditate porrigitur...*»

«*Simeonem itaque virum clarissimum, cuius fidem olim nobis est cognita vel devotio comprobata, ad ordinationem aliquaticum, nec non ferrarium, ad provinciam Dalmatiam nostra ordinatione direximus*». Me që për aktivitetin xeheror të ilirëve, që prej parahistorisë e deri në antikën e vonë, është shkruar mjaft, ne këtu nuk do të ndalemi më, e veprat kryesore gjenden në listën e literaturës.

232 Not. Dignit. Or. II, 150.

233 Krh. G. Novak, HZ I/1948, 136.

234 Not. Dignit. Or. XI 45-48

235 Krh. G. Novak, HZ I/1948, 137.



një pronar privat, për arsye se ata ishin: «që prej lindjes pronë e adhuroar hyjnore»<sup>236</sup>. Veç këtyre, kanë ekzistuar edhe collegia<sup>237</sup>, apo siç thuhet sot, sindikata të profesioneve të ndryshme.

Për ta kuptuar sa më mirë çështjen e strukturave ekonomike në fiset ilire, përveç asaj që u tha deri tani, vlen të flitet edhe për veprimtarinë monetare jo vetëm të «mbretërve ilirë», por edhe të dinastëve. Përveç qyteteve, siç ishin Skodra, Lisi<sup>238</sup>, monedha kanë prerë edhe qytete të tjera si Damastioni, Rizoni<sup>239</sup>, Lihndi<sup>240</sup> etj. Përveç qyteteve, monedha mund të pritnin, siç është thënë edhe përpara, bashkësitë e qyteteve, apo ato fisnore, gjë që mund të shihet në bazë të shtypjes së siglave, si Lissitan, Labiatan, Daorson<sup>241</sup>. Genci, i nxitur nga koncepti i politikës së sundimit absolutist mbi shtetasit e vet, është orvatur të krijojë një sistem monetar të përbashkët. Kjo mund të kuptohet edhe nga fakti që në një faqe të monedhës, në vend të Zeusit, paraqitet portreti i mbretit, kurse në faqen tjetër lundra ilire, e në vend të emrit të qytetit, shënohet emri i mbretit *bazileus Genthii*. Por Lisit, labeatëve dhe daorsëve ky u ka lejuar pavarësinë e shtypjes së emrit të bashkësisë qytetare apo fisnore, duke ruajtur elementet ekzistuese standarde shtetërore siç ishin ania, portreti i mbretit dhe pesha e caktuar<sup>242</sup>. Me zhdukjen e tij nga skena politike, veprimtaria e pavarur politike, sidomos e bashkësive të qyteteve dhe të atyre fisnore gjen shprehje të plotë. Pushteti romak, që t'i nënshtrojë plotësisht këto vise të pushtuara, jo vetëm që i ka përkrahur aspiratat e tyre, por edhe i ka legalizuar. Kjo shihet nga diktati i Skodrës i L. Anicit i vitit 168. p.e.s.

\*

\*

\*

Nga gjithë kjo që u tha deri tani mirëfilli shihet se në çfarë vështirësish objektive has secili që merret me problemet e strukturës politike, sociale dhe ekonomike tek fiset ilire.

236 Cod. Theod. VII 6 15; X 20, 3, 7, 16.

237 Krh. G. Novak, HZ I/1948, 137.

238 S. Islami, *Iliria*, II/1972, 394-405, Tab. I-III.

239 K. Pink, *Lokale Prägungen aus dem Sinus Rhizonicus* në: Serta Hoffilleriana, 529-530, 533-534.

240 K. Regling, ZfNum. 35, 1925, 255-264, Tab. XIV, 5.

241 Shih shën. 82-84.

242 Krh. S. Islami, *Iliria*, III/1975, 35.



Një nga vështirësitë më të mëdha janë vetë burimet e shkruara të autorëve të lashtë. Kjo është e qartë, meqenëse preokupimi i tyre ishte politika e ditës e shteteve ku jetonin dhe vepronin, pra vetë interesi i rretheve të tyre. Pastaj si vështirësi tjetër është kozmopolitizmi i historianëve të botës helenistike e romake që, për shkak të interesit të pushtetit qendror, përpigëshin t'i arsyetonin dhe t'i përligjnin aksionet politike, prandaj të dhënat e tyre mbi ilirët janë ose të dorës së dytë, ose tendencioze. Të ballafaquar me këtë veti të autorëve të lashtë mund të kuptohet pse të dhënat e tyre janë të njëanshme. Për këtë arsye ato nuk mund të pranohen pa ndonjë qëndrim kritik. Vështirësi të posaçme për kuptimin e strukturave politiko-sociale, e deri diku edhe të atyre ekonomike të fiseve ilire, paraqet përdorimi dhe aplikimi i terminologjisë së tyre e cila është karakteristike për koncepte të botës helenistiko-romake lidhur me dukuritë politiko-sociale dhe ekonomike. Duhet pasur parasysh fakti se nocionet si *polis*, *demos*, *populus*, *civitas* në terminologjinë juridiko-politike të përmendur ishin vetëm korelat për *popull*, ose *shtet* apo *civilti* (qytetsi, — qytetari), apo *kuvendin popullor*, pastaj *demospopulus* e kanë edhe kuptimin bashkësi (*tubim*), *gjithësi* (*masë-shumë*). Po ashtu, këto nocione kanë kuptimin edhe popull si grupim etnik, bashkësi me kuptim apolitik. Duhet të kemi parasysh edhe se nocionet si *ethnos*, *gens*, *natio*, të cilat janë të karakterit shtetëroro-politik, njëkohësisht mund të kenë edhe karakterit etnografik. Madje nocioni *natio*, sidomos në shek. III. e.s. është korelat për bashkësi në kuptim të karakterit gjeografik si, p.sh., provinca, por jo edhe në kuptim etnik<sup>243</sup>.

Në dritën e kësaj që u tha deri tani, vetvetiu shtrohet pyetja a mund të aplikohen edhe në fiset ilire këto nocione me domethënie të ndryshme juridiko-politike e sociale? Me fjalë të tjera a është e plotvlefshme kjo terminologji edhe për strukturat politike, sociale e ekonomike të fiseve ilire, organizimi fisnor i të cilave, edhe përkundrejt formës së jashtme shtetëroro-politike, ishte realitet gjatë tërë kohës së historisë së tyre të shkruar? S'do mend se jo! Këtë na dëshmon edhe shqyrtimi i strukturave të tyre politike. Duke pasur këtë parasysh kuptohet pse është më se i gabueshëm çdo përgjithësim i përmbajtjes që na japin termat e sipërpërmendura.

Vështirësia tjetër e konsiderueshme qëndron në fragmenta-

243 CIL V 898; CIL VI 2933, 30609, 32605-2845, 1625, 1907, 1935, 15493, 18 190, 14234, 16310, 16247, 21569, 27198, 28624, 1803, 13328, 36217, 33867, 31651 itd.



ritetin, për nga koha të papërcaktuar, sidomos në mungesën e kriterëve të autorëve grekë e romakë në përdorimin e burimeve më të lashta. Për këtë dukuri kanë qenë të njohur edhe vetë autorët e lashtë. Kështu, ata përdorin dhe përshkruajnë material nga dora e tretë dhe e katërt. Prandaj ballafaqohemi me një vështirësi të sinkronizimit kronologjik dhe të shtresimit gjeografik të të dhënave të tyre. E kjo vështirësi bie në sy sidomos kur kemi të bëjmë me strukturat politike, sociale dhe ekonomike.

Veç kësaj një vështirësi karakteristike lidhur me shqyrtimin e strukturave të përmendura është se për disa kategori shoqërore-politike ende përdoret terminologjia shtetërore-juridike dhe konceptet e shekullit XIX. Meqenëse kjo terminologji i cilëson dukuritë shoqërore-politike dhe shpirtërore të Evropës Perëndimore, kjo nuk do të thotë se janë të plotvlefshme për të gjitha trevat dhe kohët, sidomos për Ballkanin.

Duke pasur parasysh këto momente, jemi përpjekur, në mbështetje të materialit ekzistues, të shqyrtojmë disa aspekte të strukturave politike, sociale dhe ekonomike të fiseve ilire.

Pra, në bazë të të dhënave të veprave të autorëve të lashtë dhe të analizës së tyre rreth zhvillimit dhe karakterit të strukturave politike të fiseve ilire mund të diktohen dhe të dallohen këto dukuri:

a) Forma e jashtme e këtyre organizimeve juridiko-politike, së paku për sa i përket trevës së Ilirisë së Jugut dhe asaj dardane, nuk mund të kuptohen jashtë kuadrit të botës helenistike e më vonë edhe të asaj romake. Në frymën e kësaj duhet kuptuar dhe shpjeguar tërë terminologjia juridike dhe politike, të cilën autorët antikë e përdorin kur bëjnë fjalë për organizimin politik të ilirëve. Edhe *bazileusi* edhe *rex-i*, ose *fyloi* dhe *dinasti* paraqesin shtresat e larta të bashkësive fisnore, këshillin e pleqve dhe përfaqësuesit e qyteteve autonome. Një konstelacion të tillë të strukturave politike, përveç të tjerash, e kanë kushtëzuar, nga një anë, pozita gjeografike e tërë trevës ilire, dhe nga ana tjetër, qytetet bregdetare të cilat ishin pikëtakime dhe pikëlidhje të shkëmbimit të kulturave materiale e shpirtërore me shtetet dhe me qytetërimet e botës mesdhetare, e me ndërmjetësimin e tyre dhe me trevën e gjërë të botës së lashtë. Pozita e tillë e qytetit, së bashku me rrethinën e tij, ka ndikuar jo vetëm në situatat politike që shpreheshin edhe në autonominë e tyre politike, por edhe në pavarësinë ekonomike, në rend të parë në prerjen e mone-dhës së vet.

Kjo pozitë e qyteteve është dëshmuar edhe në kohën e



dominimit romak mbi trevat ilire. Kështu, p.sh., që nga mbarimi i luftës së parë iliro-romake qytetet bëhen njëfarëlloj «socii»<sup>244</sup> me përkufizime të caktuara në politikën e jashtme, por në atë të brendshme kanë gëzuar pavarësi të plotë. Vetëm në këtë kontekst mund të kuptohet pse këto qytete kanë qenë të detyruara që ta furnizojnë ushtrinë romake qoftë me fuqi tokësore, qoftë me atë detare<sup>245</sup>. Zhvillimi i tillë i pavarur në politikë dhe në ekonomi është shprehur edhe në marrëdhëniet reciproke në mes tyre dhe në mes përfaqësuesve të strukturave të larta të pushtetit ilir. Në këtë vështrim kuptohet rezistenca kundër pushtetit qendror, madje edhe lidhja e aleancave të ndryshme kundër këtyre fuqive supreme qendrore. Kjo vjen shprehur sidomos gjatë dhe pas luftës së dytë iliro-romake. Për këtë gjerësisht na njofton edhe vetë Polibi<sup>264</sup>. Pikërisht një gjendje e tillë politike jo vetëm që u lehtëson punën romakëve që ta mundin Gencin, i cili duke dashur të qeverisë në mënyrë absolute me shtetasit e vet, ka bërë që edhe ata më të afërmit e tij ta braktisin, — por edhe e ka bërë të mundshme politikën separate të disa përfaqësuesve të parisë fisnore. Kjo tendencë separate ka qenë jo vetëm dëshirë, por edhe realitet gjatë tërë kohës së historisë së shkruar ilire. Këtë romakët jo vetëm që e kanë shfrytëzuar, por edhe e kanë sanksionuar, siç mund të shihet nga përmbajtja e diktatit të Skodrës i L. Anicit i vitit 168 p.e.s.

b) Organizimi fisnor, i cili paraqitet që në shek. V. p.e.s. dhe përforcimi i tij politik e ekonomik dhe marrëdhëniet e tij në një anë me të nënshtuarit e tij e nga ana tjetër me qytetet autonome, duke filluar prej shek. IV p.e.s., madje edhe në kohën e sundimit të Platorit, Agronit dhe Teutës merr një formë të rregullimit federativ. Kjo formë do të vazhdojë të funksionojë edhe në kohën e sundimit absolutist të Gencit. Këtë dukuri e ve në dukje edhe historiografia shqiptare<sup>247</sup>. Në këtë unitet të imagjinuar shprehet qartë jo vetëm pavarësia politike, por edhe ekonomike e «*principium gentis*». Ato jo vetëm që kanë farkuar monedha në të cilat shtypnin edhe nocionin *bazileus*<sup>248</sup>, por kanë qenë udhëheqës ushtarakë, dhe faktorë të rëndësishëm në planin politik<sup>249</sup>. Dhe, ndonëse mund

244 Krh. CAH vol. VII, chap. XXVI, 5, 837.

245 Polyb. II 12, 2; Liv. XXXI 45, 10; 21, 27; XXXIII 3, 10; XXXVI 16, 8; XLII 48, 8; XLIII 23, 6; XLIV 30, 10; XLV 43, 10.

246 Polyb. IV 29, 7; 55, 1-4; V 4, 3; 13, 5; 23, 1-10.

247 H. Ceka — N. Ceka, *L'etat illyrien*, 141 s.

248 Shih shën. 82-84.

249 Liv. XLIV 31, 9; Krh. M. Garašanin *Glas CCLX/1*, 26.



të flitet për marrëdhëniet e mbretërve ilirë, të cilët kanë qenë më tepër përfaqësues të jashtëm të politikës supreme dhe shumë të kufizuar në atë të brendshmen, siç mund të shihet nga përgjigja e Teutës drejtuar përfaqësuesve romakë<sup>250</sup>, këto marrëdhënie pra, së paku deri në kohën e sundimit absolutist të Gencit janë ngritur në bazë të lidhjeve të besueshmërisë. Me fjalë të tjera, ky relacion ka shprehur sistemin e një organizimi ushtarako-politik, për arsye se këta mbretër në një farë mase e kanë ruajtur edhe farsën e karakterit popullor<sup>251</sup>. Por, periudha e Gencit (180-168 p.e.s.) ndryshon deri diku nga ajo e paraardhësve të tij, që është shprehje e marrëdhënieve të besueshme ndaj shtetasve të vet, përfaqësuesve fisnorë dhe miqve të mbretit. Kjo mund të shihet edhe në titulaturën e tij mbretërore «*rex Illyriorum*», që dëshmon qartë se në bazë të kompetencave të veçanta ka mundur të vendosë vetë<sup>252</sup>. Dhe pikërisht në këtë vështrim na duket se M. Garashanini<sup>253</sup>, me plot të drejtë, e ka karakterizuar këtë produkt politik si organizim mbifisnor. Së fundi, nga gjithë kjo që u tha deri më tash, po ashtu na duket se me plot të drejtë ka konstatuar F. Papazoglu, kur thotë se struktura politike e shtetit ilir është «*një përbërje e qyteteve dhe e bashkësive të mëdha apo të vogla fisnore*»<sup>254</sup>.

Në këtë zhvillim të përgjithshëm politik ka ndikuar, në një anë, fqinjësia e botës hellenistike e kontaktet me të dhe, nga ana tjetër, edhe vetë pozita gjeografike e trevës ku shtriheshin fiset ilire. Kur themi kështu mendojmë për pjesën bregdetare dhe atë qendrore të Gadishullit Ballkanik. Me fjalë të tjera, megjithë kontaktet intensive me vendet fqinje mesdhetare (për çka flet edhe materiali arkeologjik), strukturat politike në brendi të trevës ilire kanë mbetur edhe këtu në kuadrin fisnor. Për këtë na flet edhe diktati i Skodrës, i L. Anicit i vitit 168 p.e.s. i cili, faktikisht, edhe e ka sanksionuar gjendjen ekzistuese dhe dëshirat e vendbanimeve fisnore.

Edhe vetë organizimi juridikō-politik i këtyre viseve në kohën e sundimit të plotë të pushtetit romak mbi ilirët ka mbetur i paprekur. Kjo është shprehur në «interpretatio romana» në format e *dekurive*, *civitates*, *konventëve*, *municipiumeve*, *vici*, *pagi* etj. Nga gjithë kjo kuptohet pse në brendi të Gadishullit Ballkanik dhe në viset e tjera në veri të Neretvës

250 Shih shën. 64.

251 Krh. C. Schneider, *vep. e cit.*, II, 580.

252 Po aty.

253 Krh. M. Garašanin, *Glas*, CCLX/1, 24.

254 Krh. F. Papazoglu, *Politička organizacija Ilira*, 19.



nuk ka pasur struktura politike dhe forma administrative të ngjashme me ato të taulantëve, dardanëve dhe të ardianëve.

Por krizës së shekullit III e.s., që e kapi Perandorinë Romake, si pasojë e konfliktit ndërmjet Senatit dhe absolutizmit ushtarak, përkatësisht ndërmjet autoritetit dhe legalitetit nuk iu shmang as treva e Illyrikut. Reformat e Dioklecianit, e më vonë ato të Konstatinit të Madh, të ndërmarra me qëllim të ruajtjes së unitetit të Perandorisë, do të jenë dhe do të mbesin si bazë e tërë organizimit shtetëror të Perandorisë deri në rënien e saj<sup>255</sup>. Sipas Notitia Dignitatum<sup>256</sup>, në krye të prefekturave qëndronin dy persona ushtarakë, të cilët ishin kryekomandantë të kalorisë dhe të këmbësisë, që quheshin «*magistri militum equitum et peditum per Illyricum*». Administratën civile e ushtronin «*vicarii*» nën të cilët në provinca ishin «*praeses*». Të tillë në Ilirik ka pasur tetë<sup>257</sup>. Në vend të dekurionëve tani prej Konstantinit të Madh paraqiten «*Curiales*». Të gjitha këto reforma administrative e shuajnë autonominë e municipimeve në dobi të pushtetit qendror, autokratik dhe burokratik, në krye të të cilit ishte perandori.

Edhe elementi i strukturave sociale, siç u pa përpara, është shumë karakteristik dhe duhet trajtuar nga një aspekt i veçantë.

Në rend të parë, një dukuri e rëndësishme është ajo e prosperatëve të ardianët dhe e dulojve të dardanët. Analizat linguistike kanë treguar se fjala *duloi* nuk është me prejardhje indoeuropiane dhe se vendformimi i saj është Azia e Vogël. Në bazë të rezultateve që nxjerrim nga analiza e nocionit *duloi*, që ka të bëjë me një kategori të strukturave sociale, të cilat paraqiten tek dardanët, në kontekstin kohor, social e ekonomik, mund të konkludohet se ky element paraqet një qiraxhi, respektivisht «anëtarët e shtëpisë» pikërisht ashtu siç e shpjegon edhe Hesychiu si *Oiketai*.

Shikuar nga prizmi i asaj kohe, elementi i skllavërisë është karakteristik vetëm për qytete, të cilat merreshin me zeje të ndryshme. Por kjo ka qenë karakteristike edhe për xehtarinë si p.sh., në Greqi, konkretisht në xeheroret e Laurionit, ku punonin skllavër, kurse në fshat, ku sistemi i bujqësisë lyp një punim intensiv të tokës, e cila punë nuk mund të kërkohet prej skllavit dhe punët e të cilit nuk i rekomandonte

255 Ferluga, *Uprava Dalmacije*, 24.

256 Not. Dignit., Or. III 117-125.

257 Po' aty.



as Hesiodi<sup>258</sup> dhe M. T. Varroni<sup>259</sup>, nuk ka ekzistuar skllavëria. Situata ndryshon pas pushtimit romak të shteteve të Azisë së Vogël, e sidomos ndërmjet viteve 171-64 p.e.s, kur fillon skllavërimi me dhunë i popullsive të këtyre viseve dhe transportimi i tyre. Kështu, në vitin 102 p.e.s. Nikomedi III i Bitinisë i akuzon qiramarrësit (publikanët) romakë të këtyre viseve për arsye se të gjithë meshkujt e popullsisë së vendit të tij i kanë marrë si skllavër. Ndërkohë, Tit Livi, duke përshkruar ngjarjet e vitit 200 p.e.s. dhe fushatat luftarake të konsullit Sulpic, thotë se ai u nis nga Celetria dhe me sulm të papritur pushtoi Pelionin, ku përveç plaçkave ka marrë me vete një shumicë njerëz, ndërsa përta u përket ilirëve, pasi u shpënguan, i la së bashku me një garnizon të fortë, për arsye se e lupte pozita që kishte pasur qyteti<sup>260</sup>. Prandaj mund të thuhet se qoftë fjala për *dulojtë* e dardanëve ose për *prospelatët* e autariatëve, të cilët identifikohen me helotët, fjala është për bashkësitë e gjera klanorofisnore, për «anëtarët e shtëpisë» me karakter të «qiramarrësve», kurse në kohën e luftës ata kanë shkuar së bashku me zotërit e tyre në luftë. Dhe përta i përket numrit të madh, për të cilin na flasin autorët e lashtë, mund të shpjegohet vetëm si mosnjohje e marrëdhënieve politike, sociale e ekonomike të këtyre strukturave klanorofisnore. Nga ana tjetër, mendimi i A. Mócsyt<sup>261</sup>, lidhur me *prospelatët*, se këtu kemi të bëjmë me autariatët e jo me ardianët, është i pranueshëm dhe i përligjur. Me fjalë të tjera, fragmenti i Theopompit, të cilin na përcjell Atheneu<sup>262</sup>, ku përmenden *ariaoiët*, ndaj dhe është menduar se me këtë duhen nënkuptuar ardianët në shek. IV p.e.s. Është e arsyeshme të besohet se fjala është për autariatët, kur dihet se pikërisht këta ishin në këtë kohë një nga fiset më të mëdha ilire<sup>263</sup>. Një përfundim i tillë del kur merret parasysh shtrirja gjeografike e ardianëve, të cilët në shekullin IV p.e.s. shtriheshin përgjatë bregdetit adriatik, ku bujqësia nuk ka qenë degë e rëndësishme e ekonomisë, siç ishin blegtoria dhe piratëria.

Përta i përket strukturës sociale të atyre që njihen si *obaerati* dhe të cilët i përmend M. T. Varroni<sup>264</sup>, s'do mend se kemi të bëjmë me struktura të cilat kanë rënë në borxhe,

258 Shih shën. 120.

259 M. T. Varronis I 17.

260 Liv. XXXI 40 4.

261 Krh. A. Mócsy, *Zur Geschichte*, 86.

262 Athen. X. 443 ab 60.

263 Strab. VII 5, 11.

264 Shih shën. 262.



e për t'i paguar ato, kanë qenë të detyruar të punojnë me anëtarët e familjes.

Në kuadrin e politikës së përgjithshme tradicionale romake, strukturat e fiseve ilire janë ruajtur edhe gjatë sundimit romak në format e tyre, pavarësisht a është fjala për *peregrinet*, *civitates*, *dekuritë*, *konventet*, *vici*, *pagi* dhe format e tjera administrativo-politike. Ndryshimi është vetëm në formë, d.m.th. në interpretimin romak, e jo në përmbajtjen juridiko-politike e sociale. Edhe pse këtu nuk kemi pasur për qëllim të bëjmë analiza krahasuese, prapëseprapë po theksojmë se sipas K. Paçit<sup>265</sup> e shumë të tjerëve, shumica e këtyre strukturave administrativo-juridike dhe sociale janë ruajtur edhe në kohët e vonshme të jetës fisnore të shqiptarëve. Dhe, me që gjithë strukturat e përmendura janë të varura ndërmjet tyre, ato janë edhe refleksi i kushteve ekonomike dhe i mënyrave të prodhimit siç janë blegtoria, bujqësia, xehetaria, etj. E gjithë kjo shumëllojshmëri e mënyrës së prodhimit shpjegon edhe diferencimin e strukturave politike-sociale dhe ekonomike. Kjo shumëllojshmëri në disa vise të fiseve ilire ka qenë aq e madhe sa që vështirë është të përgjithësohen. Një dukuri e tillë është e kuptueshme kur dihet se në shumëllojshmërinë ndikon jo vetëm pozita gjeografike dhe ambienti i caktuar i fiseve përkatëse, por edhe mundësia e ndikimeve dhe e kontakteve me botën e huaj. S'do mend se ndikimi i qytetit në diferencimin e strukturave politike, sociale dhe ekonomike është i konsiderueshëm. Madje edhe vetë sistemi i kolonizimit që e pat kapluar botën greke duke filluar që prej shek. VIII. e deri në shek. VI p.e.s. ka ndikuar në shpejtimin e ndarjes së punës dhe në specializimin e veprimtarisë ekonomike. Një gjendje e tillë është shprehur edhe në kulturë në mënyrën e të veshurit, në doke e zakone e ato sidomos në qendra të rëndësishme<sup>266</sup>. Por gjuha greke e më vonë ajo latine, kanë qenë të përhapura jo vetëm në qendrat urbane, edhe pse, siç mund të shihet në bazë të të dhënave të materialit epigrafik, me ta ka bashkëekzistuar në mënyrë të barabartë edhe gjuha e popullsisë vendase. Por në oborrin mbretëror është folur greqishtja, edhe pse në marrëdhënie diplomatike është përdorur edhe përktyesi. Kjo është karakteristike sidomos për ilirët<sup>267</sup>. Por në sajë të hapësirës gjeografike, ku jetonin fiset ilire, janë ruajtur tërë kohën e historisë së tyre

265 Krh. C. Patsch. GZM X/1898, 362.

266 Krh. O. Neurath, *vep. e cit.* 56.

267 Polyb. XXVIII 8, 9; C. Schneider, *vep. e cit.* I, 344-348.



të shkruar strukturat fisnore. Një diferencim i formave në kulturën materiale e deri diku edhe në atë shpirtërore ndodhi që në parahistori, siç na njoftojnë rezultatet e gjurmëve arkeologjike të gjysmës së dytë të shekullit tonë. Duke pasur parasysh të gjitha këto që u thanë më sipër, është e kuptueshme pse fiset në brendi të Ballkanit dhe ato mbi Naronë (Neretvë), nuk kanë qenë të organizuara në formën shtetërore, siç ishin, p.sh. ardianët.

Shumë, forma të strukturave politike, sociale dhe ekonomike të fiseve ilire, në afërsi të zonës të kulturës helenistike, nuk mund të kuptohen pa njohjen e ndikimit të botës mesdhetare. Kur themi kështu, mendojmë që format e caktuara të strukturave të përmendura janë fryt i botës greko-romake. Por në mungesë të materialit adekuat në rend të parë atij arkeologjik, shumë shkencëtarë deri kah vitet 60-të të shekullit tonë, kanë menduar se ilirët nuk kanë arritur një jetë të organizuar politiko-shoqërore. Nga ana tjetër, një mendim i tillë ka qenë edhe rezultat i trajtimit të ilirëve si një njësi e botës greko-romake. Por në qoftë se një shoqëri nuk është e aftë të japë diçka, aq më pak është e aftë t'i absorbojë të mirat e huaja kulturore. Sikur kjo të ishte karakteristike për ilirët, ata do të zhdukeshin nga arena historike, siç ka ndodhur edhe me shumë fise dhe grupe etnike të tjera. Në histori shembuj të tillë nuk janë të panjohur. Pikërisht në një reciprocitet kulturor, i cili shihet në kulturën materiale të ilirëve, siç na bëjnë të njohur gjurmimet arkeologjike në gjysmën e dytë të shekullit tonë, është i dukshëm tërë vitaliteti i tyre, kur në procesin e dhënies dhe të marrjes së elementeve kulturore të të huajve ruajnë dhe fuqizojnë individualitetin, entitetin dhe identitetin etnik. Kështu duket ta kuptojmë edhe ndikimin e botës helenistiko-romake. Vetëm në dritën e kësaj që u tha deri më tash duhet kuptuar terminologjia politiko-juridike dhe sociale-ekonomike e botës helenistike dhe romake, të cilën e përdorin autorët e lashtë kur flasin për strukturat politike, sociale dhe ekonomike të fiseve ilire.

Përsa u përket strukturave ekonomike të trevës ilire në lashtësinë e vonë, ato janë fryt i një ecurie të përgjithshme në Perandorinë e vonë romake, që ishte karakteristike gjatë tërë kësaj periudhe<sup>268</sup>.

---

268 Krh. G. Alföldy, *Römische Sozialgeschichte*, 165-169; Po ai: *Gymnasium*, 83 Jg. 1/2, 1976, 20. Përveç tij rreth kësaj çështjeje kanë shkruar edhe shumë të tjerë, disa nga veprat e të cilëve gjenden të shënuara në listën e literaturës.



Dhe, në fund, jemi të vetëdijshëm se për çështjet që u bë fjalë është shkruar shumë. Prandaj as që kemi pretenduar të japin ndonjë zgjidhje përfundimtare të ndonjë çështjeje. Por mendimet, supozimet dhe përfundimet e ndryshme që mund të gjenden në literaturën shkencore na japin dorë që edhe ne të merremi me këto çështje. S'do mend, disa qëndrime dhe konstatime ndoshta do të jenë edhe provokative, gjë që është jo vetëm normale, por e nevojshme në shkencë. Dihet fare mirë se historia e një vendi apo kohe, nuk mund të shkruhet njëherë e përgjithmonë. Por, duke pasur parasysh literaturën e pasur shkencore dhe duke i shfrytëzuar rezultatet arkeologjike, të cilat kohës së fundit për disa vise të trevës ilire janë më se të pasura dhe të lakmueshme, pastaj duke shfrytëzuar edhe metodën e caktuar për të cilën u bë fjalë, shpresojmë se kemi hedhur pak dritë në disa çështje shumë të ndërlikuara, po edhe shumë të rëndësishme të strukturave sociale dhe ekonomike të fiseve ilire, rreth identitetit etnik të të cilëve, megjithë rezultatet e konsiderueshme të disiplinave të ndryshme, ende dhe diskutohet<sup>269</sup>. Një situatë e tillë është edhe pasojë e mos-pajtimit në interpretimin e çështjeve të cekura ndërmjet parahistorianëve dhe historianëve, arkeologëve dhe filologëve. Kjo është edhe shprehje e përdorimit joadekuat të nocioneve juridiko-politike dhe sociale e ekonomike, që janë karakteristike për botën helenistiko-romake dhe të cilat autorët e lashtë i përdornin në përshkrimin e strukturave politike, sociale dhe ekonomike të fiseve ilire.

Në qoftë se kemi arritur qëllimin që çështjet e cekura së paku t'i paraqesim në gjendjen e sotme të shkencave arkeologjike, filologjike e historike, edhe pse zgjidhja e tyre ndoshta nuk do të jetë ashtu siç duhet pritur, kurse disa nga supozimet janë edhe shumë të guximshme, prapëseprapë shpresojmë se është arritur njëfarë suksesi gjatë trajtimit të çështjeve të cekura.

---

269 Krh. A. Benac, *Godišnjak CBI XI/9, 1973, 93-108.*



### III. RRETH ÇËSHTJES SË LOKALIZIMIT DHE TË IDENTIFIKIMIT TË DISA VENDBANIMEVE DARDANE NË KOHËN PARAROMAKE

Që në fillim parashtrohet pyetja: a mund të flitet për sistemin e urbanizimit të trevës dardane në kohën pararomake? Rëndësia, por edhe vështirësia, e çështjes del në pah kur mbahet parasysh që me fjalën urbanizim nuk duhet të kuptojmë vetëm anën materiale të saj, ngritjen e objekteve publike dhe të gjitha infrastrukturaturat lidhur me to, por edhe marrëdhëniet shoqërore dhe politike të saj. Rreth kësaj çështjeje (në kuadrin e gjerë të territorit ilir), në literaturën shkencore ka mendime të ndryshme, të cilat mund të sistemohen në ato që e mohojnë sistemin e urbanizimit si të tillë, e sidomos «në kuptimin e krijimit të marrëdhënieve të reja»<sup>1</sup>, dhe prej tyre që këtë e pranojnë<sup>2</sup>. Problemi është tepër i vështirë, sidomos kur kemi të bëjmë me trevën qendrore të Gadishullit Ballkanik, ku shtriheshin dardanët. Dhe, ndërsa për trevat e tjera të Gadishullit Ballka-

1 Shih Djurdjev Bošković, *Diskusija*, në: Simpozium II, 161; Th. Mommsen, *Römische Geschichte*, V, edit. 182.; D. Mustilli, *La conquista romana della sponda orientale adriatica*, 25; A. Gitti, *La politica dei re illiri e la Grecia*, 13.

2 Krh. F. Papazoglu, *Diskusija*, në: Simpozium II, 168.; Emil Čerškov, *po aty*, 165.; A. Benac, *po aty*, 166.



nik, sidomos për Maqedoninë<sup>3</sup>, Trakinë<sup>4</sup>, Ilirinë e Jugut<sup>5</sup>, kemi punime me karakter teorik, duke përfshirë tërë trevën ndër-mjet Danubit dhe Detit Egje, për zanafillën, karakterin dhe zhvillimin e sistemit të vendbanimeve urbane<sup>6</sup>, për trevën dardane duhet thënë se nuk kemi punime të tilla<sup>7</sup>. Veç kësaj materiali arkeologjik i kësaj treve nuk është i mjaftueshëm dhe i konsiderueshëm për arsye se gërmimet përkatëse nuk janë të të njëjtit intensitet në tërë trevën dardane. Pastaj edhe materiali arkeologjik ekzistues nuk është i mjaftueshëm, jo vetëm për të njohur ndërtimin e brendshëm të ndonjë vendbanimi, por as përmasat, karakteristikat dhe funksionin e tij. Kjo mungesë nuk është karakteristike vetëm për trevën dardane, por edhe për territorin e gjerë të Ilirisë<sup>8</sup>. Megjithatë, përsa i përket trevës dardane në bazë të pak njohurive që kemi, duhet thënë se materiali ndërtimor ka qenë pothuaj gjithnjë druri. Kjo shihet në Gadimjen e Epërme, 27 km në juglindje të Prishtinës, ku është dëshmuar edhe banesa nën dhe në trajtë eliptike<sup>9</sup>. Sidoqoftë, me gjithë materialin e mangët dhe të

3 Krh. F. Papazoglu, *Makedonski gradovi u rimsko doba*, 37-44.

4 Krh. D. P. Dimitrov, *Das Entstehen der thrakischen Stadt und die Eigenart ihrer städtebaulichen Gestaltung und Architektur*, 379-387.; Velizar Vekov, *Der Urbanisationsprozess auf dem Balkan bis Ende der Antike*/zu Betracht der Urbanisation in Thracien/. Corapport. IIIe Congres international d'etudes du Sud-est Européen, Bucaresti 4-10 septembre 1974, 4-9.

5 Krh. Selim Islami, *Naissance et développement de la vie urbaine en Illyrie*, in: *Iliria*, II, 1972, 7-23.

6 Krh. Alexandar Fol, *Le développement de la vie urbaine dans les pays entre le Danube et la mer Egée jusqu'à la conquête romaine*, in: EB. t. II-III 1965, 309,317; Po ai: *La vie urbaine dans les pays Thrace, Macedoniens et Illyriens avant la conquête romaine*, in: *Actes du I-ère*, II, 91-99; P. St. Koledarov, *The initial type differentiation of inhabited localities in the central Balkan Peninsula in Ancient Times*, EH. III, 1966, 31-52.; Velizar Velkov, *Die Stadt und das Dorf in Südsteuropa. Die Antike*. /Rapport/, Athènes 1970; in: II-ème Congres international des études du Sud-est Européen, Athènes 1970, 311.; Georgi Mihailov, *Le processus d'urbanisation dans l'espace balkanique, jusqu'à la fin de l'antiquité*, III-ème Congres international d'études du Sud-est Européen, Bucaresti, 4-10 septembre 1974, 1-23.

7 Por edhe përkundrejt të gjitha këtyre punimeve, shihet se ende nuk janë të mjaftueshme, siç konstaton edhe G. Mihailov, «Bref, il nous manque des études fondamentales traitant de l'origine et du développement de la ville et de l'urbanisation en Thracie, en Macédoine, en Illyrie etc. avant l'époque romaine». /G. Mihailov, *vep. e cit.* 2./

8 Shih A. Benaç, *vend. i cit.*

9 Ky lokalitet ka filluar të gërmohet në vitin 1973, 1974, gjatë së cilës kohë me mirësinë e udhëheqësit të gërmimeve, kustosit të Muzeumit Krahinor në Prishtinë, dr. Jovan Glišić, kam asistuar disa herë. Materialet ende nuk janë botuar.



pakët, në bazë të kërkimeve përnjohëse shihet se treva dardane ka qenë e dendur me vendbanime të tipit të «qytezave»<sup>10</sup>, vërtet të vogla, por të cilat për nga forma dhe pozita e tyre, sidomos në trevën klasike të dardanëve, në KSA të Kosovës, e shumta përputhet me fshatrat e sotme<sup>11</sup>. Të gjitha këto tregojnë se sistemi i urbanizimit ka ekzistuar edhe në këtë trevë, prandaj kurrsesi nuk mund të shpjegohet si ndikim romak<sup>12</sup>.

Për praninë e qendërbanimeve në trevën dardane, përveç materiali arkeologjik, na dëshmojnë edhe të dhënat e autorëve të lashtë. Por nga emërtimet e vendbanimeve që na i sjellin këta, siç janë: *Komé, tursis, teichos, horion, polichnion, polismation, polis* në greqisht dhe *locus, vici, villa, castellum, oppidum, urbs* në latinisht<sup>13</sup>, është vështirë të përcaktohen. Nuk duhet dyshuar se këto emërtime (edhe pse autorët antikë shpeshherë për të njëjtin lokalitet përdorin disa prej tyre), janë të ndryshme jo vetëm për nga koha, por edhe për nga karakteri dhe funksioni i vendbanimeve përkatëse. Prandaj, të gjitha vendbanimet në trevën dardane, që përmenden si *urbes*, nuk i përkasin thjesht karakterit të *urbis*. Bile e shumta e këtyre qendërbanimeve, të cilat te autorët e lashtë paraqiten si *urbes*, nuk janë gjë tjetër veçse vendbanime të fortifikuara<sup>14</sup>. Kjo është karakteristikë sidomos për brendinë e Gadishullit Ballkanik. Madje kjo është karakteristikë edhe për treva si Panonia, e cila shumë herët ka rënë në kontakt me romakët. Për këtë mësojmë nga Appiani i cili thotë se te Segestasi «ndodhet një qytet i fortifikuar»<sup>15</sup>. Emri i përbashkët i këtyre vendbanimeve të fortifikuara është qyteza. Megjithatë, qytezat dallohen nga njëra-tjetra si për nga funksioni, ashtu edhe për nga ndërtimi dhe karakteri i tyre<sup>16</sup>. Kështu, bie fjala, tipi i qytezave në Duvanjsko Polje me tumën në pikën më të lartë të kodrinës<sup>17</sup> nuk gjendet as në Shqipëri, as në trevën e dardanëve. Nga ana tjetër, sistemi

10 Krh. Milutin Garašanin, *Praistoria Serbije*, I., 361.

11 Krh. Emil Čerškov, *Diskusija, Simpozijum II*, 165.

12 Krh. E. Čerškov, *vend i cit.*

13 Krh. A. Fol, *La vie urbaine...* 92.

14 Krh.G. Mihailov, *Le processus d'urbanisation...* 21.

15 Appian. *Ilyr.* 22.

16 Krh. Borivoje Čović, *Osnovna karakteristika materijalna kulture Ilira na njihovom centralnom području*, 87 ss., Po ai: *Uvod u stratigrafiju i hronologiju praistorijskih gradina u Bosni*, GZM u Sarajevu, N. S., sv. XX. 1965, 29-32., Č. Truhelka. *Povijest hrvatskih zemalja Bosne i Hercegovine*, 90., Ante Škoba lj, *Obredne Gomile, Sveti Križ* na Čiovu, 1970, 146-175.; 335-383. sidomos 147, n. 19.

17 Lidhur me karakterin e tumës në pikën më të lartë të gradinës shih. A. Škoba lj, *vep. e cit.* 393-451, sidomos 401.



i qytezave në trevën e dardanëve paraqitet që në kohën e neolitit siç është Valaçi<sup>18</sup>. Është për t'u theksuar se në disa «qyteza», siç është ajo e Domorovcit në Moravën e Ulët, Vlashnje në Prizren, Hisari afër Suha Rekës dhe në Gadimjen e Epërme, bie në sy një vazhdimësi kulturore duke filluar me grupin Bubanj-Hum, halshtato-La Tène dhe me ato të mëvonshme<sup>19</sup>. Sikur të donim t'i klasifikonim këto «qyteza» në trevën qendrore të Dardanëve, ato mund t'i ndanim në dy grupe. Në grupin e parë do të hynin ato që gjenden në 1000 m mbi nivelin e detit. Në këtë grup hyjnë qytezat në Domorovc, Suka e Cërmjanit, Gradishte në Orllat (Komorani), Veletini në Janjeva<sup>20</sup>, dhe kalaja në Jug Bogdani, afër stacionit hekurudhor Vrani Dol, kundruall rrugës Lupçi i Ulët. Në këtë grup do të hynte ndoshta edhe Zatriçi (afër Rahovecit), kurse në grupin e dytë gradishta e Koprivnicës ndërmjet Kamenicës së Kosovës dhe Ogoshtit, Gadimja e Epërme, Cernica (në Gjilan), Strezovc, Binça, Vërboci, Samadrazha (në Vuçitërn), Hisari dhe Belaçevci afër Fushë-Kosovës<sup>21</sup>. Ndërsa ato të grupit të dytë gjenden pranë terracave të lumenjve, menjëherë pranë fushave pjellore, në të cilat, siç u cek, dëshmohet edhe materiali i kulturave më të hershme, ato të grupit të parë gjenden në pika strategjike, të karakterit strehim, por nuk kanë dëshmi të materialit kulturor të kohërave të tërë trevës qendrore të Gadishullit Ballkanik, të cilat janë dëshmi të një situatë jo të sigurt, të marrëdhënieve armiqësore që shpreheshin në konflikte ndërfisnore<sup>22</sup>, e edhe të dyndjeve dhe invadimeve të shpeshta.

Duke mos hyrë në çështjen e poaleogjenezës së qendërba-

18 Krh. N. Tasić, *Praistorisko naselje kod Valača*, në: GMKM, II 41957/3-41, sidomos 4-7.; B. Jovanović, *Stratigrafija kod Kosovske Mitrovice*, në: GMKM VI/1961/, 51.

19 Krh. Ljubomir Dašić, *Praistorisko naselje na Štrokom*, në: GMKiM II/1957/, 249-256.; E. Čerškov, *Kosovo i Metohije u Rimsko doba*, Beograd 1969, 15.

20 Krh. E. Čerškov, *Kosovo i Metohija...* 15.

21 Natalija Djurić, *Gradina kod Belačevca*, në: GMK X/1970/, 282.

22 Meqë ende nuk ekziston një sintezë lidhur me çështjen e qendërbanimeve të tipit qyteza të trevës qendrore të Gadishullit Ballkanik, si për çështjen e klasifikimit ashtu edhe të karakterit të saj jam konsultuar me kustosin e Muzeumit Krahinor të Prishtinës, dr. Jovan Glišićin.

23 Krh. M. Garašanin, *vep. e cit.* 361.



nimeve të trevës ilire<sup>24</sup> në përgjithësi, dhe të trevës dardane në veçanti, duhet theksuar se tipi i përgjithshëm i vendbanimeve në këtë trevë ka qenë fshati, i cili, siç mund të shihet në sajë të materialit epigrafik, është ruajtur edhe në kohën romake: *miles ex Dardania ex vico Tito*<sup>25</sup>, *Aurelius Mosa natus in Dardania vico Zatidis*<sup>26</sup>, *miles ex vico Perdica*<sup>27</sup> dhe *vicus Cavadinus*<sup>28</sup>, i cili i vetmi që mund të identifikohet dhe të vendoset me saktësi në lokalitetin Kavgalija<sup>29</sup>, afër Shkupit. Tipi i tillë i vendbanimeve nga ajo që mësojmë te Ksenofoni ka qenë një karakteristikë e përgjithshme e Ballkanit. Tipi i tillë shihet qartë edhe në shtyllën e Trajanit, kopjet e së cilës ruhen në *Muzeul de Istorie* të Bukureshtit, e cila është e shek. II të e.s., por paraqet një gjendje që nuk ka ndryshuar aspak nga periudha e pararendimit romak. Për ekzistimin e fshatit si tip i përgjithshëm mësojmë edhe prej Appianit, i cili duke folur për operacionet ushtarake të Cezarit në Panoni, ndër të tjera, thotë: «pajonët (Panonët, Z. M.) në fjalë nuk banonin në tjetete, por nëpër fusha dhe fshatra»<sup>30</sup>, kurse pak më poshtë në të njëjtin vend, thotë se «nuk ua prishi fshatrat». Diçka të ngjashme, por që ka të bëjë me jetën dhe me mënyrën e banimit të dardanëve e gjejmë edhe te Straboni<sup>31</sup>, Por në të njëjtin vend ai tregon se «dardanë janë edhe galabrët, tek të cilët (...) (mungon teksti) është një qytet i vjetër (...)»<sup>32</sup>. Nga kjo shihet se dardanët kanë qenë të organizuar në jetën politike, ekonomike dhe shoqërore, dhe si duket ky «polis arhaia» ka qenë një qendër e rëndësishme e fisit dardan, të njohur me emrin *galabroi*, të cilin, pa një përcaktim të saktë K. Paçi<sup>33</sup> e lokalizon. Vështirë është

24 Lidhur me këtë çështje, përveç të tjerëve /shih. n. 3, 4, 5/, ka shkruar edhe Mate Suić, *Problemes de paleogenese et d'urbanisation des centres illyriens*, in: ST ALB, 2/1973, 105-116; Idem; *Approche scientifique et methodes de recherche des habitats autochtones sur le territoire illyrien*, në: Utvrđjena ilirska naselja, 9-35.

25 CIL, VI 32605-2845.

26 CIL V 898.

27 CIL VI 32606-2845.

28 Borka Josifovska; *Dva latinska nadgrobnata natpisa iz Kavgalije-Scupi*, ZA XVI/1966/, 266 ss.

29 Anab. VII 2, 1; VIII 3.

30 Appian. Illyr. 22: «hu poleis okoun hoi Paiones oide all'agrus he komas».

31 Strab. VII 5, 7/c. 316/: *Agrioi d'hontes ho Dardanioi teleos, osth' ypo tais kopriais oriksantes spelaia entautha diaitos poiesthai*.

32 Strab. VII 5, 7/c. 316/: «Ton de Dardaniation heisi kai hoi Galabroi, par hois... polis arhaia».

33 PWRE VII col. 512-513.



për të përcaktuar karakterin e këtij vendbanimi, meqenëse i njëvlefshmi i polisit do të ishte oppidum-i<sup>34</sup>, dhe, sipas M. Suiqit<sup>35</sup>, do të ishte një qendër e një bashkësie territoriale, gjë që shihet qartë edhe nga vetë fjalët e Strabonit. Dhe si i tillë nuk duhet kuptuar në konceptin e thjeshtë grek me karakteristika urbane<sup>36</sup>. Identifikimin dhe vendosjen më të përafërt (edhe pse ndofta ende herët), duket se e ka dhënë Ivan Mikulčići, të cilin, megjithëqë me rezervë, e merr edhe F. Papazoglu<sup>37</sup>, duke e lokalizuar këtë në Skopsko kale. Kjo është mjaft e besueshme kur dihet se nga aspekti kohor zanafilla e polisit në Iliri është e karakterit protourban, d.m.th. si vendbanim i fortifikuar<sup>38</sup>.

Megjithatë, nga kjo që u tha më sipër identifikimi dhe lokalizimi i vendbanimeve është shumë i vështirë, së pari për shkak të identifikimit joadekuat të emërtimeve greko-romake të vendbanimeve bregdetare me ato në brendi të Gadishullit Ballkanik, dhe për shkak se për një vendbanim përdoren dy ose tre emërtime me domethënie dhe karakter të ndryshëm. Veç kësaj, kjo vështirësi vjen edhe nga mungesa e materialit arkeologjik të këtij karakteri, që është pasojë e krizës së botës helenistike<sup>39</sup> dhe invadimit të keltëve, i cili ka ndikuar mjaft në pengimin e procesit urbanistik të trevës dardane, e më në fund edhe për shkak të shkatërrimeve romake gjatë pushtimeve të këtyre krahinave.

Edhe përkundrejt të gjitha vështirësive që u cekën, do të jipen disa propozime lidhur me identifikimin dhe vendosjen e disa vendbanimeve, qofshin ato pa emra ose me emra.

Në përshkrimin e luftërave romako-maqedone Tit Livi tregon edhe një episod të konfliktit ndërmjet dardanëve dhe bastarnëve që ndodh në vitin 175 p.e.s. ku, ndër të tjera, thotë: «(...) dardanët vendosën të ndërmarrin diçka edhe në qoftë se rrezikojnë dhe u mblodhën nga të gjitha anët në një qytet (oppidum), i cili nuk ishte larg kampit të bastarnëve... dhe dardanët të mundur u dëbuan në qytet i cili ishte larg kampit

34 Krh. A. Fol. *Le développement...* 313.

35 Krh. M. Suić. *Approche scientifique...* 9, 16.

36 Krh. G. Mihailov, *Le processus d'urbanisation...* 4-5.

37 Krh. F. Papazoglu, *Srednjobalkanska plemena u predrimsko doba*, 367, n. 153.

38 Krh. G. Mihailov, *Le processus d'urbanisation...* 21.

39 Krh. H. Bengston, *Griechische Geschichte von den Anfängen bis in die römische Kaiserzeit*, 495.



të bastarnëve gati 12 mila»<sup>40</sup>. Identifikimi dhe lokalizimi i këtyre dy vendbanimeve është shumë i vështirë. Përveç largësisë prej XII milia pasuum (rreth 17,766 km) asgjë tjetër nuk kemi. Madje lidhur me këto dy lokalitete deri më tani askush nuk është marrë. Por gjatë gërmimeve arkeologjike, të bëra kohët e fundit në krahinën e Preshevës dhe të Vranjës, janë zbuluar vendbanime të rëndësishme të periudhës helenistike: njëri në fshatin Kërshevisa, që gjendet 12 km në jug të Vranjës dhe 2 km në lindje të stacionit hekurudhor Ristovac, kurse tjetri në fshatin Rahovica në Preshevë, afro 20 km në jugperëndim të Kërshevicës. Në qoftë se merret largësia prej 12 milia pasuum e qytetit, që gjendet larg kampit të bastarnëve, në një anë, dhe materiali arkeologjik i këtyre dy lokaliteteve, i cili siç kanë theksuar dhe drejtuesit e këtyre gërmimeve, Ivan Mikulçiq dhe M. Jovanović, se: «(...) një serë karakteristikash specifike në qeramikë e lidhin ngushtë (Kërshevicën, Z. M.) me grupin e vendbanimeve të pellgut të Kumanovës dhe të Shkupit dhe të cilët, as që mund të dyshohet, paraqesin oppidum-et dardane»<sup>41</sup>. Dhe në qoftë se merret parasysh përshkrimi i lëvizjes së trupave, që jep Tit Livi dhe materiali arkeologjik që përputhet me të dhënat historike, kushdo që ka parë këtë territor vjen në këtë përfundim: oppidum-i ku kanë qenë të dëbuar ushtarët dardanë: «*victique Dardani compelluntur in urbem, quae fere duodecim milia ab castris Bastarnarum aberat*»<sup>42</sup>, megjithëqë më lart këtë lokalitet e emërton me oppidum: «*(...) omnes undique armato ad oppidum quod proximum castris Bastarnarum erat*»<sup>43</sup> (që nuk luan rol, si u tha më sipër, se autorët e lashtë për të njëjtin vendbanim përdorin emërtime të ndryshme me karakter të njëjtë)<sup>44</sup>, mund të identifikohet me Rahovicën kurse kampi i bastarnëve me Kërshevicën, por që të dy vendbanimet janë të dardanëve. Dihet se bastarnët janë

40 Tit. Liv. XLI 19, 7-10: «*Dardani cum Bastarnas non modo non excedere finibus suis, quod speraverant, sed gravioris fieri in dies cernerent, subnixes Thracum accolarum et Scordischorum auxiliis, audendum aliquid vel temere rati, omnes undique armati ad oppidum quod proximum castris Bastarnarum erat conveniunt... Ceterum priusquam circumire castra hostium possent, pugnatum est; victique Dardani compelluntur in urbem, quae fere duodecim milia ab castris Bastarnarum aberat*».

41 Shih. Dr. Ivan Mikulčić i Milah Jovanović, *Helenistički oppidum iz Krševice kod Vranja*, in: *Vranjski Glasnik* IV/1968/, 371.

42 Liv. XLI 19, 10.

43 Liv. XLI 19, 7.

44 crf. G. Mihailov, *Le processus d'urbanisation...* 4-5.



të ardhur në trevën e dardanëve me nismën e Filipit V, mbretit maqedon, në vitin 179 p.e.s. Siç konstatojnë arkeologët e përmendur: «diku në fund të shekullit V dhe në fillim të shekullit IV menjëherë ngritën vendbanime të mëdha dardane të fortifikuara në luginën e Shkupit (...)»<sup>45</sup>.

Tit Livi duke përshkruar fushatat e Filipit V thotë se në vitin 211 p.e.s.: «pasi i pushtoi vendet fqinje me Ilirinë, u kthye me të njëjtën shpejtësi kundër Pelagonisë, prej andej e pushtoi qytetin e dardanëve, Sintinë, nëpër të cilin dardanët hynin në Maqedoni»<sup>46</sup>. Nikolla Vuliqi<sup>47</sup> me të drejtë konstaton se nga këto fjalë nuk është e mundshme që së paku përafërsisht të lokalizohet ky vendbanim. A. Mayer-i<sup>48</sup> thotë se ky duhet të kërkohet diku në kufi me Maqedoninë, por ku, as ai nuk përcakton. Mendohet se Sintia duhet të gjendej diku në trevën e lumit Strymon, përkatësisht te Petriqi i sotëm<sup>49</sup>, kurse J. V. A. Fin<sup>50</sup> Sintinë e vendos në kufirin verior të Pelagonisë, ose diku më larg në perëndim<sup>51</sup>.

Megjithatë, sipas mendimit tonë, Sintia duhet të kërkohet diku në trekëndëshin e Dardanisë, të Maqedonisë dhe të Trakisë. Straboni përmend popullin trak, Sintët, që jetonte në Lemnos<sup>52</sup>. Homeri i përmend po ashtu Sintët: «Atëherë Sintët më bartën prej vendit ku kam pasë ra»<sup>53</sup>.

F. Papazoglu<sup>54</sup> mendon se ky identifikim i Sintisë, si qytet dardan, është i gabueshëm. Ajo këtë e arsyeton duke e lidhur me fisin Sinta, fisin «më verior» të Stroymonit, i cili në vitin

45 Shih. Dr. Ivan Mikulčić i Milan Jovanović, *vep e cit.*, 371.

46 Liv. XXVI 25, 3: «*Vastatis proximis Illyrici, in Pelagoniam eadem celeritate verti iter; inde Dardanorum urbem Sintiam, in Macedoniam transitus Dardanis facturam, cepit*».

47 Krh. Nikola Vulić, *Geografija Južne Srbije*, in: GSND XIX/1938, 6.

48 Krh. A. Mayer, *Die Sprache der alten Illyrier*, I, 306; PWRE XIV, col. 748.

49 Krh. H. Kiepert, FOA XIV, pag. 4a.; W. Walbank — u mendon se ky lokalizim është i gabuar, por as ai nuk jep kurrfarë përcaktimi bile as aproksimativ/ cfr. F. W. Walbank, Philip V of Macedon, 85, n. 4/.

50 Krh. J. V. A. Fin, *Macedon, Illyria and Rome*, 220-219 B. C., in: JRS XXVI/1936, 25 karta 27.

51 PWRE V-A5, cel. 258.

52 *Chrestomathiae ex Strabonis VII 81, 580.*

53 II I 594: «*entha me Sinteis andres afar konmisante pesonta*»

54 Steph. Byzant. s.v.: «*Sinita polis Makedonias pros te Thrake, os Eudoksos en tetarto, ges periodu, Hoi oikuntes. Sinto ozytonos*».



167 p.e.s. i ka takuar Maqedonisë<sup>55</sup>. Megjithatë, nuk është e pamundshme që kjo Sinta, e cila prej vitit 167 p.e.s. i takonte Maqedonisë, përpara të ketë qenë qytet dardan, meqenëse Tit Livi<sup>56</sup>, në vitin 211 p.e.s., ata shprehimisht i konsideron për «*urbs dardanorum*». Një mbështetje për një mendim të tillë e gjejmë edhe te Stefan Byzantini, i cili e konsideron vërtet si qytet maqedon te trakët, por që dikur ky ka qenë qytet dardan<sup>57</sup>. Pikërisht ky shënim i Stefan Byzantinit i ka shtyrë disa që këtë qytet ta vendosin në trekëndëshin kufitar të Dardanisë, Maqedonisë dhe Trakisë, gjë që na duket shumë e arsyeshme. V. Tomashek u është munduar ta përmirësojë tekstin, duke lexuar në vend «Sintiam», «finitimam». Kështu, pra, sipas mendimit të tij, teksti duhet lexuar: «*inde Dardanorum urbem finitimam, in Macedoniam transitum Dardanis facturam, cepit*»<sup>58</sup>. Edhe pse me rezervë, këtë supozim e përkrahin C. Truhelka<sup>59</sup>, F. Papazoglu<sup>60</sup> dhe D. Deçevi<sup>61</sup>. Sidoqoftë, edhe përkundrejt të gjitha orvatjeve, redaktimi i V. Tomashekut për një kohë të gjatë do të mbetet vetëm supozim.

Në përshkrimin e mëtejshëm të ngjarjeve luftarake të vitit 169 p.e.s., Tit Livi përmend edhe disa vendbanime me emrat e tyre. Kështu, duke përshkruar operacionet ushtarake të Perseut të birit të Filipit V., Tit Livi thotë: (...) pasi i shiti uskanasit dhe ilirët, menjëherë e ktheu ushtrinë kundër penestëve nga qyteti Oaeneu me qëllim që ta pushtonte, i cili, përveç që e kishte pozitën të mirë, ishte edhe një kalim për te labeatët, ku sundonte Genci»<sup>62</sup>. Nga vetë analiza e këtij teksti shihet se Oaeneu duhet të kërkohet jo në trevën e penestëve, siç men-

55 Krh. F. Papazoglu, *Srednjobalkanska plemena...* 117, n. 70.

56 Krh. F. Papazoglu, *Makedonski gradovi...* 68.

57 Liv. XXV 25, 3.

58 Krh. W. Tomashek, *Die alten Thraker*. I, 61.; Idem: *Wolag Scupi, die metropolis von Dardania?* Zur Kunde der Hämus-Halbinsel, 14.

59 Krh. Č. Truhelka, *Arheološke beleške iz Južne Srbije. Grobnice iz Halstatškog doba u Vučjem Dolu. Dardanci*, në: GSND V/1929/, 66. n. 57.

60 Krh. F. Papazoglu, *Srednjobalkanska plemena...* 71, 192, 367 n. 150.

61. Krh. D. Detschew, *Die Thrakischen Sprachreste*, 446-447.

62 Liv. XLIII 19, 2-3: «*...Uscanensibus Illyriisque venditis, in Penestas exercitum reducit ad Oaeneum oppidum in potestatem redigendum et alioqui opportune situm et transitus ea est in Labeates, ubi Gentius regnebat*».



dojnë F. Papazoglu<sup>63</sup>, T. Tomovski<sup>64</sup> dhe Hilmi Sadiku<sup>65</sup>, por në trevën e dardanëve. Kështu mendojnë edhe shumë të tjerë si p.sh. R. Mack<sup>66</sup> dhe N. Vuliq<sup>67</sup>, i cili e identifikon këtë me Tetovën. Por Tit Livi thotë se ka qenë i fortifikuar mirë, i mbrojtur në një anë nga lumi Artat, kurse në anën tjetër nga male të larta<sup>68</sup>. Që Oaeneu mund të identifikohet me Tetovën<sup>69</sup>, ka disa arsye. Së pari, fakti që nëpër të ka kaluar rruga për te labeatët «(transitus ea est in Labeates)», nëpër të cilën kanë shkuar përfaqësuesit e Perseut për te Genci, mbreti i ilirëve.

Dihet se Perseu në vitin 169 p.e.s. përsëri pushtoi Uskanën, pastaj Draudakun dhe Oaeneun. Që ta shfrytëzojë këtë sukses për qëllime më të vonshme, ai mundohet të lidhet me Gencin, prandaj dërgon delegatë, të cilët kanë kaluar nëpër malet e Sharit, nëpër luginën e Prizrenit nga kanë arritur në Shkodër, në krahinën e labeatëve. Lidhur me këtë udhëtim na njofton Polibi, të cilin e përshkruan edhe Tit Livi. Te Polibi lexojmë: «Perseu dërgoi si përfaqësues te mbreti Genc, ilirin Pleurat, i cili ishte mërguar tek ai, dhe Adeun nga Beroja... Ata kaluan malin e Skardit dhe përshkuan krahinën që quhej «Iliria e shkretuar», këtë vend pak më parë e kishin prishur maqedonët për të penguar dardanët që të dyndeshin në Iliri (dhe Maqedoni); ata që ishin me Adeun, pas shumë mundimesh, arritën në Skodra. Këtu mësuan se Genti ndodhej në Lis dhe e

---

63 Krh. F. Papazoglu, *Makedonski gradovi...* 66, n. 6; 218 n. 22.

64 «...dass das Land der Penesten mit den Städten Uscana, Oaeneum, und den anderen Orten sich zwischen Lychnidus/Dem heutigen Ohrid/und Studera/dem heutigen Dorf Cepigove/befand». T. Tomovski, ZA XII/2, 340.

65 «...la ville d'Oene... se trouvait dans le village actuel de Qidhne de la Basse-Dibra, ou se trouvent-aussi des ruines d'une forteresse de cette époque». Hilmi Sadiku, *Essai d'identification de forteresses et cites illyriens des Penestes*, in: *Les Illyriens et la genese des Albanais*. 251.; A. Mayer, vep. e cit. 245.

66 Cfr. R. Mack, *Grenzmarken und Nachbarn Makedoniens im Norden und Westen*, Diss. Göttingen, 1951, 177/ në dorëshkrim.

67 Krh. N. Vulić, Glas SKA CLX/82, Beograd 1934, 39; Po ai GSND XIX/1938, 4.

68 Liv. XLIII 19, 7: «Deinde Oaeneum perventum est, quod sine iusta oppugnatione capi non poterat. Et maiore aliquanto, quam cetera, iuventute, et validum oppidum moenibus erat. Et hinc amnis Artatus nomine, hinc mons praealtus et aditu difficilis cingebat».

69 Krh. F. Papazoglu, *Makedonski gradovi...*; 218, n. 22; T. Tomovski, ZA XII/2/1963, 341.



lajmëruan për ardhjen e tyre»<sup>70</sup>; kurse te Tit Livi: «Te Genci dërgoi përfaqësuesit, ilirin Pleurat, i cili ishte mërguar tek ai, dhe maqedonin Adeun nga Beroja... Këta kaluan qafën e malit Skard, nëpër shkretëirat ilire, të cilat maqedonët i kishin shkretuar me qëllim që dardanëve t'ua bëjnë kalimin e vështirë në Iliri dhe Maqedoni dhe, pas shumë mundimesh arritën më në fund në Skodra. Mbreti Genc ishte në Lis. Këtu i ftoi delegatët dhe me shumë dashamirësi kanë qenë të dëgjuar»<sup>71</sup>.

Shtrohet pyetja nëpër çfarë visesh ka kaluar kjo rrugë nëpër të cilën kanë shkuar delegatët e Perseut, të cilët kanë arritur së pari në Skodra. Lidhur me këtë çështje ekzistojnë dy mendime të kundërta. Njëri që mendon se rruga ka shkuar nga Stybera — /Cepigova e sotme/<sup>72</sup> nëpër Uskanë e cila, sipas këtyre, duhet të gjendej diku te Dibra, nëpër luginën e Drinit të Zi për në Skodra<sup>73</sup>. Kjo rrugë vërtetë është më e lehtë por edhe pak më e gjatë. Mandej është e arsyeshme që përfaqësuesit sikur të shkonin nëpër këtë rrugë, së pari do të mbërrinin në Lis, ku gjendej në atë kohë Genci, gjë që është edhe e natyrshme se vetë rruga çon në këtë drejtim. Por ata, siç mësojmë nga Polibi dhe Tit Livi, së pari mbërrinë në Skodra, e pastaj në Lis. Mungesa tjetër e këtij propozimi lidhur me drejtimin e udhëtimit të delegatëve të Perseut është se ata që e përcaktojnë drejtimin e kësaj rruge nëpër luginën e Drinit të Zi, Uskanën e lokalizojnë diku te Dibra. Por mendimi i përgjithshëm është se Uskana duhet të lokalizohet në Kërçovë<sup>74</sup> dhe

70 Polyb. XXVIII 8, 1-5: «Oti Perseus pros Genthion ton basilea apesteile presbeutas Pleuratou te ton Illyrion, onta fygada par auto, kai ton Beroiaion Adaion (...) hoi kai peiesameonen poreian hyper to Skardon oros dia tes Heremu kalumenes Illyridos, hen on pollois hrontois anoteron anastaton epoiesan Makedones eis to dysergus poiesai tois Dardaneusi tas eis ten Illyrida (kai Makedonion) eisbolas. Plen hoi ge peri ton Adaion dia tuton ton topon meta polles kakopatheas elthon eis Skodran kai pythomenoi ton Genthion en Lisso diatribein diepempasanto pros auton».

71 Liv. XLIII 19, 13; 20, 1-2: «...ad Gentium legatos Pleuratum Illyrium, exulantem apud se. et Adaeum Macedonem a Beroea mittit... Hi transgressi iugum Scordii montis, per Illyrici solitudines, quas de industria popullando Macedones fecerant, ne transitus faciles Dardanis in Illyricum aut Macedonium essent, Scodram labore ingenti tandem pervenerunt. Lissi rex Gentius erat, eo acciti legati, qui mandata exponentes benigne auditi sunt».

72 Krh. F. Papazoglu, *Makedonski gradovi...*, 216-221.

73 cfr. P. Meloni, *Perseo e la fine dello monarchia macedone*, 276.

74 Krh. N. Vulić, *Glas SKA CLX/82*, 38; F. Papazoglu, *Makedonski gradovi...*, 66.



pak është e pakuptueshme që prej Styberes<sup>75</sup> të kalojë nëpër grykën e Radikës për në Dibër deri në Skodra, e cila i bie rrotull, që mund të bindet secili që ka udhëtuar edhe sot nëpër këtë rrugë.

Mendimi tjetër i cili është edhe më i logjikshëm, drejtimin e kësaj rruge e përcakton, duke u nisur prej Styberes, Uskana (Kërçova), Draudaku (Gostivar), Oaeneu (Tetovë) nëpër malin Skard për të dalë në tokën e labeatëve siç thotë Livi: «*transituis ea est in Labeates*». /XLIII 19 3/. Në favor të këtij, mendimi flet fakti se kjo vetëm që ka qenë rruga më e shkurtër, çka e arsyetonte nevoja e strategjisë ushtarake, që pasqyrohej edhe në planet e Perseut, por edhe se këta kanë kaluar nëpër «shkretira ilire»<sup>76</sup>. Ku gjendej kjo trevë e shkretuar? Nga ajo që lexojmë te Tit Livi: «*Hi transgressi iugum Scodri montis, per Illyrici solitudines... Scodram Labore ingenti tandem pervenerunt*»<sup>77</sup> respektivisht te Polibi: «*...Hyper to Skardon oros dia tes Eremon kolumenes Illyridos*»<sup>78</sup> del se kjo krahinë e shkretëruar duhet të kërkohet në malet e Sharrit. Një mbështetje për një mendim të tillë e gjejmë edhe në faktin se Perseu, në vitin 170/169, ka ndërmarrë një ekspeditë ushtarake: «*Dardanos recens domuisset bellum*»<sup>79</sup> kundër dardanëve të cilët shtriheshin pikërisht në malet e Sharrit. Prandaj edhe krahina «*illyrici solitudines*» duhet të kërkohet në këto vise të cilat kanë qenë gjithmonë të dardanëve, pa marrë parasysh pushtimet ose shkatërrimet e përkohshme të mbretërve maqedonë.<sup>80</sup> Duke pasur parasysh, se «*illyrici solitudines*» gjendejnë në malet e Sharrit dhe rruga nëpër të cilën kanë shkuar delegatët e Perseut kalonte prej Oaeneut nëpër këto shkretëtira,

---

75 Krh. F. Papazoglu, *Makedonski gradovi...*, 216-221.

76 Nga fjalët e Polybit XXVIII 8, 5; «...ata që ishin me Adeun, pas shumë mundimesh arritën në Skodra/ Plen hoi ge peri, ton Adaion dia tuton ton topon meta polles kakopatheias elthon eis Skodran.../ të cilat nuk i gjejmë te Tit Livi, por as edhe te gjithë të tjerët, që janë marrë me këtë çështje, mund të mendohet se delegacioni ka qenë i përbërë prej dy pjesëve. Njëra pjesë në krye me Adeun, që ka shkuar nëpër Shar dhe ka arritur, pas shumë mundimesh, në Skodra, dhe tjetra në krye me Pleuratin, e cila ndoshta ka shkuar nëpër luginën e Drinit të Zi për të arritur së pari në Lissus, ku ishte edhe Genci.

77 Liv. XLIII 20, 1.

78 Polyb. XXVIII 8, 3.

79 Liv. XLIII 18, 2.

80 Krh. Z. Mirdita, *Dardanci i Dardanija u antici*, 135-137.



është e arsyeshme që Oaeneu duhet të lokalizohet te Tetova e sotme<sup>81</sup>. Për një vendosje të tillë na dëshmon edhe përshkrimi i pozitës së Tetovës që na jep Tit Livi, duke thënë se në një anë mbrohej nga lumi Artat (Vardari)<sup>82</sup> dhe në anën tjetër nga malet e larta. Kjo pajtohet plotësisht me pozitën gjeografike të Tetovës, e cila gjendej në pjesën e luginës së Pologut dhe rrëzë maleve të Sharit. Me vendosjen dhe identifikimin e Oaeneut me Tetovën zgjidhet njëherit edhe çështja e drejtimin të rrugës nëpër të cilën kanë shkuar delegatët e Perseut, e të cilët janë nisur nga Stybera, nëpër Uskana, Draudak (Gradec afër Gostivarit), për të cilin do të bëhet fjalë më poshtë, Oaeneum (Tetovë) nga shkon në drejtim të fshatit Slipkovicë, ku shihen gjurmët e kësaj rruge. Prej këtu vazhdon në drejtim të fshatit Brodec, nëpër Veshala, Bozovac, Kobilicë, lëshohet në luginën e Bistricës së Prizrenit për në Kukës dhe Shkodër, ku shtriheshin labeatët<sup>83</sup>. Është e njohur që kjo rrugë ka qenë rrahur edhe në mesjetë.

Në përshkrimin e operacioneve luftarake të romakëve kundër Perseut, Tit Livi përmend tri lloje të vendbanimeve të fortifikuara «urbes», «oppida» dhe «castella». Në kategorinë e fundit të vendbanimit të fortifikuar, i cili gjendej në territorin e dardanëve është edhe Draudaku. Lidhur me këtë Tit Livi thotë: «Duke kaluar pranë një fortese të quajtur Draudacum, mjaft të populluar, njëri nga ata që e njihnin vendin tha se pushtimi i Oaeneut s'ka kurrfarë dobie, po të mos pushtohej edhe Draudaku, i cili ka një pozitë më të përshtatshme nga çdo pikëpamje»<sup>84</sup>. N. Vuliq<sup>85</sup> këtë lokalitet e vendos diku afër Gostivarit të sotëm. A. Mayer<sup>86</sup> sikurse edhe H. Krahe<sup>87</sup>, etimologjinë e fjalës e shpjegon me «dru», «pyll». Në këtë vend e kërkon edhe F. Papazoglu<sup>88</sup>, megjithëqë mendon për trevën

81 Krh. N. Vulić, *Glas SKA CLX/82*, Beograd, 1934, 39.; PWRE XVII-2, col. 1673-1674.

82 Lumin Artat W. Tomasheku /PWRE II, col. 1308/ e identifikon me Radikën, kurse H Kiepert /FOA XVII/ me Matin në Shqipëri. T. Tomovski /ZA XII, 2, 1963, 342/ e identifikon me lumin Sateska. Por më i saktë është identifikimi me Vardarin /N. Vulić, *Glas SKA CLX*, 82, 39/.

83 Krh. N. Vulić, *Glas SKA CLX*, 82, Beograd 1934, 38 ss.

84 Liv. XLIII 19, 3: «Praetereunti frequens castellum, Draudacum nomine, peritorum quidam regionis eius nihil Oaeneo capto opus esse ait, nisi in protestate et Draudacum sit; opportunius etiam ad omnia positum esse».

85 Krh. N. Vulić, *Glas SKA CLX/82*, 39.

86 Krh. A. Mayer, *Die Sprache der alten Illyrier*, I, 128.; II, 39.

87 Krh. H. Krahe, *Balkanillyrische geographische Namen*, 23, 72,

87.

88 Krh. F. Papazoglu, *Srednjobalkanska plemena...* 191.



e penestëve, kah Galiçniku dhe Dibra<sup>89</sup>. Në trevën e penestëve e kërkon edhe Hilmi Sadiku<sup>90</sup>, duke e identifikuar këtë me gjermadhat e kështjellës së Grazhdanit, në rrjedhën e mesme të Drinit të Zi. Por nga ajo që u tha rreth identifikimit dhe lokalizimit të Oaeneut dhe lidhur me përcaktimin e drejtimit të rrugës, nëpër të cilën kanë shkuar delegatët e Perseut për te Genci, shihet se Draudaku duhet të kërkohej në trevën ndërmjet lokalitetit Uskana dhe Oaeneut, nëpër të cilin ka kaluar edhe rruga e përmendur. Bile më saktësisht, sipas mendimit tonë, mund të identifikohet me Gradecin e sotëm, që gjendet në afërsi të Gostivarit, në anën e majtë duke shkuar për në Tetovë<sup>91</sup>.

Rreth lokalizimit të qytetit Damastion janë shprehur disa mendime të kundërta. Në mungesë të materialit arkeologjik, lokalizimi i tij është përcaktuar në sajë të monedhave të gjetura, që janë prerë në shekullin IV-III p.e.s. Sipas tipit, stilit dhe emrit të monedhës, Imhoof-Blumers dhe Gaebler<sup>92</sup> (*Zeitschrift für Numismatik* 1, 1874, 99 ss dhe *Zeitschrift für Numismatik* 37, 1927, faqe 245 ss) kanë menduar se ky qytet duhet të jetë diku afër Paionisë. Bile Dyestoi, sipas Gaeblerit, dinastët do të jenë paione<sup>93</sup>. Më vonë Imhoof-Blumers-i e kërkuan diku në jug të Shqipërisë, te Antigoneja, respektivisht te vendi Damës, nja 10 km në veri të Tepelenës, te lumi Vjosa<sup>94</sup>. Philipson është i mendimit që Damastioni mund të identifikohet me Gjirokastrën e sotme<sup>95</sup>. K. Paçi<sup>96</sup> po ashtu men-

89 Krh. F. Papazoglu, *Makedonski gradovi...* 218, n. 22.

90 Krh. H. Sadiku, *vep. e cit.*, 251.

91 Në ngjarjet e vitit 171 p.e.s. Tit Livi /XLIII I/ i përmend dy qytete: Ceronia dhe Carnuntum. Lidhur me këtë të dytin ka mendime se mund të identifikohet me Sarnunto /J. A. Evans/ *Antiquarian researches in Illyricum*, IV, 48, 1884, 89, që e përmend si të tillë Comes Marcellini, (Cron ad annum 518, 100 MGHAA XI, 1), të cilin mendim e merr edhe A. Mayer *Die Sprache der alten Illyrier*, I, pag. 179-178. Por mendojmë se F. Papazoglu me plot të drejtë e mohon këtë supozim, duke konstatuar se: «Intervali i kohës, i cili i ndan të dhënat mbi Sarnuntin ilir... dhe të dhënat e Marcellinit mbi castellum dardan Sarnunto, si edhe fakti se Dardania kurrë nuk është shtrirë në jug deri te via Egnatia, e bëjnë këtë hipotezë të papranueshme edhe përkundrejt ngjashmërisë së emrit». F. Papazoglu, *Makedonski gradovi...* 196, n. 51.

92 Krh. A. Mayer, *Die Sprache der alten Illyrier*, I, 106.

93 *Po aty.*

94 *Po aty.*

95 PWRE IV, co. 2051-2052.

96 Krh. K. Patsch, *Ilirët*, Tiranë, 1923, 55.



don se duhet të gjendej në jug të Shqipërisë. V. Tomashek<sup>97</sup> këtë qytet e kërkon diku në trevën e pirustëve, respektivisht në Mirditë, ku ka qenë e njohur mjeshtëria e xehetarisë. Të njëjtin mendim, por më të saktë, ka edhe R. L. Beaumont<sup>98</sup>, sipas të cilit ai duhet të kërkohej diku në Mirditë ose në Dukagjin. Megjithatë, duhet theksuar që me sa dihet deri në vitin 1939, në Shqipëri janë gjetur vetëm tri copë monedha të Damastionit, gjë që është e pakuptueshme të pranohet hipoteza e vendosjes të këtij vendbanimi kudo qoftë në Shqipëri. Vetë fakti se lokalizimi i këtij vendbanimi ka nxitur interes të madh dhe shëtitja e tij prej një vendi në një tjetër tregon jo vetëm rëndësinë, por edhe vështirësinë e problemit. Kështu K. Jireček<sup>99</sup> mendon se vendi i tij duhet të kërkohej diku në veri të Dibrës. Mendimit të K. Jirečekut i afrohet ai i A. Mayerit<sup>100</sup>, i cili këtë e kërkon diku në veri të liqenit të Ohrit.

Meqenëse monedhat e Damastionit janë gjetur në vise të ndryshme, edhe vendi i tij ka lëvizur prej Linkestidës e deri në Moravën Jugore /Vranja, Kutina e Leskovci/, pastaj edhe në Kosovë. R. Mack<sup>101</sup>, në sajë të ngjashmërisë dhe afërisë së monedhës së Damastionit me ato të Paionisë dhe në sajë të asaj që monedha e Damastionit është gjetur shumë në trevën e Shkupit dhe të Kumanovës, ai, megjithëse karakteri dardan i kësaj treve është më se i qartë, këto i konsideron si pjesë të Paionisë. Kështu, pra, edhe Damastionin e vendos në trevën e përmendur, respektivisht ndërmjet Kumanovës dhe Kratovës. Në fakt ky pothuaj fjalë për fjalë e merr mendimin e J. M. E. May<sup>102</sup>, i cili po ashtu mendon se Damastioni duhet të gjendej diku në Paioni në trevën veriore të Maqedonisë. F. Papazoglu<sup>103</sup>, duke përfillur konceptin e vet rreth nocionit «ilir», të cilin ekskluzivisht e lidh vetëm me trevën shtetërore të Ilirisë së Jugut, gjë që si i tillë ky mendim është mjaft i paargumentuar<sup>104</sup>, nga ky nocion ai përjashton

97 Krh. W. Tomashek, *Die vor-slawische Topographie der Bosna, Hercegowina, Crna Gora und angrenzender Gebiet*, 551.

98 Krh. R. L. Beaumont, *JHS* 61/1936, 181-183.

99 Krh. K. Jireček; *AEM* X/1898/, 205.

100 Krh. A. Mayer, *Položaj Damastiga*, in: *Numizmatika*, 1-2 1934-1936, 17-25; Po ai: *Die Sprache der alten Illyrier*, I., 105-107.

101 Krh. R. Mack, *vep. e cit.*, 106.

102 Krh. John M. F. May, *The Coinage of Damastion and the lesser Coinages of the Illyro-Pesnian Region*, 110 ss.

103 Krh. F. Papazoglu, *Historia*, XIV — 2/1965/, 150.; Po ai: *Poreklo i razvoj ilirске државе*, in: *Godisnjak CBIV/3*, 1967. 128.

104 Krh. Zef Mirdita, *Les Origines des Dardaniens*, në: *St. Alb.* 2/19-73, 114-145.



dardanët, Damastionin e vendos jashtë Paionisë dhe Dardanisë, duke konstatuar se: «sikur të ishin në këto vende, nuk kishte për t'u dhënë për të /Damastioni Z. M./ se është ilir»<sup>105</sup>. Kohëve të fundit A. Stipčević<sup>106</sup>, edhe pse nuk e saktëson vendin e këtij qyteti, e lokalizon në Ilirinë e Jugut. Por edhe ngjashmëria tipologjike e monedhës së Damastionit me atë të Olyntit e vështirëson pak a shumë përcaktimin e vendit të tij. Kjo ngjashmëri e tyre shpjegohet me faktin se, si duket, mjeshtrit e parë të prerjes së monedhave të Damastionit kanë qenë nga Olynti<sup>107</sup>. Mandej, në monedhat e Damastionit gjenden edhe emrat e magjistratëve antikë, që edhe më tepër e ndërlikon çështjen. F. Papazoglu supozon se, ndoshta, në dyestët /Dyestai/ për të cilët Straboni<sup>108</sup> thotë se kanë sunduar me xeherorët e Damastionit, duhet konsideruar se janë nga fisi prej të cilit ka rrjedhur dinastia e Bardhyllit, nuk mund të pranohet, meqenëse këtë e trajton në kontekstin politik të nocionit «ilir»<sup>109</sup>.

Nga gjithë kjo që u tha shihet se sa është vështirë lokalizimi i tij. Dëshmi arkeologjike nuk kemi. Por edhe nga ajo që na thotë Straboni, asgjë saktësisht nuk mund të thuhet lidhur me këtë lokalizim. Ai, në fakt, duke dhënë shtrirjen gjeografike të fiseve ilire të cilat shtriheshin pas Epidamit, Apolonisë dhe maleve Keraune, thotë se këto kanë: «...bulinët, taulantët, partinët dhe brygët; aty afër janë xeherorët e argjendit në Damastion, rreth të cilave dyestët vendosën sundikaniit<sup>111</sup>, që është i shekullit V-VI të e.s., i cili Damastionin e vendos në Iliri, rreth xeherorëve të argjendit.

Me gjithë mendimet e kundërta rreth vendit të këtij qyteti, duke ndjekur metodën e rrahur deri më tani, mendojmë se Damastionin duhet ta kërkojmë në trevën qendrore të dardanëve; respektivisht në trevën e sotme të KSA të Kosovës. Në vitin

105 Krh. F. Papazoglu, *Simpozijum*, II, 11.; Idem. *Srednjobalkanska plemena...* 355, n. 97.

106 Krh. A. Stipčević, *vep. e cit.* 154.

107 Krh. Benko Horvat, *Tetradrahme «grada» Damastiona iz nalaza u Risnu/Rhizonu/*, Numizmatika, 2-4, 1934-1936, 26-64, sidomos 37.

108 Strab. VII 7, 7, c. 326.

109 Krh. F. Papazoglu, *Politička organizacija...*, 17.

110 Strab. VII 7, 7/c. 326/: «Bulliones te kai Taulantion kai Parthenoi kai Brygoi plesion de pou kai ta argyreia te en Damastio, peri, ha Dyostai synestesanto ten dynasteian.

111 Palimp. Vatic. 2306: «...hai dé de fyga des metá Mendaion Damastion, okesan, tes Illyridas peri ta argyreia liou emesthemen en tois «Illyrikois» cit. ap. A. Mayer, *op. cit.*, I 105.



1961 në jugperëndim të Janjevës, në vendin e quajtur «Bijela Zemlja», janë zbuluar mbeturina të një vendbanimi antik dhe meqenëse e tërë kjo trevë me Novobërdën e Kishnicën, është e njohur si vend xeheror, i cili është shfrytëzuar edhe para pushtimit romak, rreth galerive të xeherorëve, me siguri është ndërtuar vendbanimi për xehetarët. Pastaj, duhet theksuar se pikërisht në këtë trevë janë gjetur më shumë monedha të Damastionit<sup>112</sup>, kur si Straboni ashtu edhe Palimpsesti i Vatikanit i përmendin xeheroret e argjendit, të cilat gjendeshin në afërsi të Damastionit. Pikërisht këto të dhëna na bëjnë të mendojmë se Damastionin duhet ta kërkojmë në afërsi të Kishnicës, të Janjevës apo të Prishtinës<sup>113</sup>. Veç kësaj, për një lokalizim të tillë na flasin edhe mbeturinat arkeologjike në Kishnica, ku edhe sot shihen rrënojat e ndërtesave<sup>114</sup>. Sidoqoftë, mendojmë se propozimin tonë, për një lokalizim të tillë të qytetit Damastion, nuk mund ta dobësojë as fakti që në monedhat e këtij qyteti gjenden emrat e magjistratëve antikë. Këta emra nuk janë element i mjaftueshëm që Damastioni të kërkohet jashtë trevës së dardanëve, sepse është e njohur se edhe këtu është prerë monedhë barbare<sup>115</sup>. Veprimtaria e prerjes së monedhave të këtij qyteti shkon prej vitit 400-280<sup>116</sup>.

Vetë fakti që Damastioni ka prerë monedha të argjendta, bile edhe të cilësisë së mirë<sup>117</sup>, tregon se ai ka gëzuar një autonomi dhe nuk ka qenë mbrapa qyteteve të përparuara të Ilirisë, si bie fjala, Apolonisë dhe Dyrrachut në këtë kohë. Me fjalë të tjera, ka pasur një ekonomi të përparuar e cila, siç pamë nga fjalët e Strabonit, është bazuar nga xeherorët e pasura të argjendit dhe është shprehur në zejtari, siç mund të shihet nga simbolet në monedhën e tij, që paraqesin çekanin dhe kërcyt metalike<sup>118</sup>.

112 Krh. E. Pegan, *Argo*, I/1, 1962, 25-26.

113 Edhe pse tani për tani nuk kemi një mbështetje arkeologjike, sidomos numizmatike, përveç pasurisë nëntokësore dhe shfrytëzimit të saj që në parahistori /E. Čerškov, *Municipium DD kod Šocanice, Priština-Beograd*, 1970 55 69 ss./, duke u mbështetur në atë që na jep Straboni lidhur me pasurinë e xeherorëve të argjendit, na shtyn ta kërkojmë këtë në këtë lokalitet.

114 Krh. Emil Čerškov, *Zanafillet e xehetarisë në parahistori*, in: Përparimi 1-2/1964/, 76.

115 Krh. B. Saria, *Starinar*, III/1924-1925/, 99, n. 1.; Po ai: në *Starinar*, IV/1926-1927/, Glas.; VI. Liščić, *Nalazi barbarskog novca u selu Ribnjača*, in: Numizmatičke vijesti IV, 8-9, 1957, 3.

116 Krh. B. Horvat, *vep. e cit.* 26-64.

117 Krh. A. Stipčević, *vep. e cit.* 159.

118 Krh. J. H. F. May, *vep. e cit.* tab. XI-XII.



Në fund, duhet të themi që jemi të vetëdijshëm se kjo që u tha lidhur me çështjen e lokalizimit dhe të identifikimit të disa vendbanimeve dardane në kohën pararomake, në mungesë të materialit të duhur, është vetëm një supozim, d.m.th. një orvajtje për hulumtimin dhe për ndriçimin e mëtejshëm lidhur me çështjen që është objekt i studimit tonë. Duhet theksuar se për një ndriçim sa më të plotë dhe për «zgjidhje definitive» të çështjes së lokalizimit dhe identifikimit të vendbanimeve dardane në kohën pararomake, kërkohet një bashkërendim i punës ndërdisiplinor në fushat e arkeologjisë, filologjisë dhe linguistikës. Por edhe në qoftë se në këtë synimin tonë kemi arritur, në mos gjë tjetër, së paku të futemi afërsisht në rrugën e zgjidhjes së çështjes, mendojmë se kjo përbën një sukses modest.



#### IV. ÇËSHËTJA E URBANIZIMIT TË DARDANISË NË KOHËN E PUSHTIMIT ROMAK

Çështja e urbanizimit të Dardanisë si dhe e çdo province të Perandorisë Romake është me rëndësi nga shumë aspekte. Para së gjithash, njohja e sistemit të urbanizimit, dhe e vendbanimeve urbane, bën të mundshëm ndriçimin e shumë problemeve nga historia e Perandorisë Romake, të strukturës së saj sociale, të zhvillimit ekonomik dhe të sistemit administrativ-politik në provinca<sup>1</sup>. Kjo është e kuptueshme po të kemi parasysh se qëllimi thelbësor i politikës së urbanizimit në periudhën e Perandorisë së hershme ka qenë jo vetëm krijimi i pikënisjes së zbatimit të politikës «Pax romana» në vendet e pushtuara, por edhe ruajtja e bazës ekonomike, e cila pasqyrohej në mbajtjen e elementit autokton me të gjitha infrastrukturën e tij, madje dhe të vetë fshatit autokton. Përveç kësaj, problemi i urbanizimit të provincave nuk mund të trajtohet pavarësisht nga kriza që pat përfshirë Perandorinë Romake kah fundi i shekullit II, sidomos gjatë tërë shekulli III të e.s. gjë që u pasqyrua, në një anë, në konfliktin ndërmjet senatit dhe elementit ushtarak, e në anën tjetër, në dyndjet e pandërprera të popullsisë barbare në Perandorinë Romake.

Në ruajtjen e kufijve jo të sigurtë u aktivizua gjithnjë e më tepër elementi autokton, i cili u rekrutua në mesin e pe-

---

<sup>1</sup> Krh. Fanula Papazoglu, *Makedonski gradovi u rimsko doba*, 2, 8.



regrinëve në kohën kur qytetari romak, jo vetëm që i shmangej detyrimit ushtarak, por as që e konsideronte më për nder të luftonte për Perandorinë e vet<sup>2</sup>. Vërtet, vetëm në dritën e këtij fakti mund të kuptohet pse vendbanimet urbane, qofshin ato të ngritura nga ana e kampeve ushtarake, apo nga kanabët, gjenden më shumë në brigjet e Danubit, kurse në brendi të provincës së Mezisë<sup>3</sup>, d.m.th. në Dardani janë ruajtur vendbanime autoktone. Mandej gjatë trajtimit të problemit të lartëpërmendur duhet të kemi parasysh se pushtimi romak i Evropës Juglindore dhe sidomos i Ballkanit, në trevat e të cilat janë themeluar provincat Moesia Superior, Moesia Inferior, Macedonia, Dacia etj., i ka gjetur këto treva në nivel të ndryshëm të zhvillimit ekonomik-politik, gjë që është pasqyruar edhe në sistemin e urbanizimit që u zbatua në mënyrë të ndryshme, tashmë sipas interesave politiko-ekonomike të pushtuesit të këtyre trevave<sup>4</sup>.

Përveç këtyre vërejtjeve të përgjithshme, karakteristike për të gjitha provincat e Perandorisë Romake, është e nevojshme të theksohen edhe disa vështirësi objektive tipike për trevën e Dardanisë<sup>5</sup>.

Kështu, ndryshe nga provincat e tjera fqinje, për të cilat ekzistojnë tashmë monografi të mira, bile lidhur edhe me problemin e urbanizimit, si p.sh. për Macedonia<sup>6</sup> dhe Moesia Superior<sup>7</sup>, çështja e urbanizimit të Dardanisë; aq sa na është e njohur përveç disertacionit të autorit të këtij punimi<sup>8</sup>, nuk

<sup>2</sup> Zef Mirdita, *A propos de la romanisation des Dardaniens*, në: St. Alb. IX/21972 294, sidomos n. 42.

<sup>3</sup> Krh. Miroslava Mirković, *Urbanisierung und Romanisierung Obermesiens*, në: ZA. XIX/2/1969, 239-262, sidomos 246.

<sup>4</sup> Krh. Velizar Velikov, *Die Stadt und das Dorf in Südosteuropa*. Die Antique Rapport II<sup>eme</sup> Congrès international des études du Sud-est Europeen. Athènes 1970, 11.

<sup>5</sup> Edhe pse ekzistojnë vështirësi rreth përcaktimit të saktë të kufijve të «Dardanisë sidomos atyre të veriut dhe të perëndimit», dhe dihet se në kohën romake kurrë nuk janë përputhur kufijtë etnikë me ata administrativë, prapëseprapë mund të thuhet se me gjithë ndryshimet territoriale në situatat e caktuara historike, Dardania shtrihej në trevën e derdhjes së epërme të Vardarit deri te fshati Vodne, më në jug të Bylazorës (sot Titov Velesi), gjatë tërë rrjedhës së Moravës jugore dhe Ibrit deri te Morava Perëndimore dhe Timoçka Krahinës, respektivisht në Knjazhevc.

<sup>6</sup> Krh. F. Papazoglu, *Makedonski gradovi u rimsko doba*, Skopje 1957.

<sup>7</sup> Krh. M. Mirković, *Rimski gradovi na Dunavu u Gornjoj Meziji*, Beograd, 1968.

<sup>8</sup> Krh. Z. Mirdita, *Dardanci i Dardanija u antici*, Zagreb, 1972, 318-417 (Disertacion në dorëshkrim).



është trajtuar veçmas. Por edhe në qoftë se është punuar diçka, atëherë kjo është bërë në kuadër të provincës Moesia Superior<sup>9</sup>. Arsyeja e një mungese të tillë me siguri duhet kërkuar në faktin se Dardania, deri në mbarim të shekulli III të e.s., ka qenë përfshirë në Moesia Superior, dhe që në shekullin IV të e.s. është formuar si provincë më vete<sup>10</sup>.

Njëra nga vështirësitë më të mëdha qëndron pa dyshim në faktin e karakterit fragmentar të burimeve të shkruara, për nga koha jo të përcaktuara dhe, sidomos në dualitetin e prejardhjes së tyre: greke e romake; mandej në faktin, që manifestohet qartë në identifikimin e papërshtatshëm të nocioneve greke e romake lidhur me emërtimin e vendbanimeve në brendi të Gadishullit Ballkanik<sup>11</sup>, e veç të tjerash, edhe në faktin e njohur se autorët e lashtë nuk e kanë njohur brendinë e Gadishullit Ballkanik nga autopsia, prandaj edhe ata kanë konsultuar dhe kanë shfrytëzuar më shumë vepra të autorëve të tjerë të lashtë. Kështu p.sh. Straboni, edhe pse i takon kohës së Augustit, madje dihet se pjesa më e madhe e veprës së tij ka humbur, e ka shfrytëzuar Polibin dhe shumë vepra të tjera të autorëve të lashtë. Por megjithatë është vështirë të lokalizohen me saktësi dhe të njihen strukturat dhe karakteri i pozitës juridike të çdo vendbanimi. Përsa i përket Ptolemeut, që i përmend vendbanimet në Dardani, është e vlefshme të përmendet se ai jep të dhëna për vendbanimet sipas krahinave, edhe pse nuk interesohet për situatën administrative të vendbanimit përkatës. Prandaj nga të dhënat e tij nuk mund të dihet në se kemi të bëjmë me një *polis* apo me një *civitas*<sup>12</sup>.

Për njohjen e sistemit të urbanizimit dhe të lokalizimit të vendbanimeve në shekullin III-IV të e.s., me rëndësi dhe

---

9 Krh. Andreas Mocsy, *Untersuchungen zur Geschichte der römischen Provinz Moesia Superior*, në: AAASH XI (1959), 283-307; Po ai: *Munizipale Gemeinde und ihre Territorien in Moesia Superior*, në: Godišnjak CBI. VI 3, 151-167; Po ai: *Gesellschaft und Romanisation in der römischen Provinz Moesia Superior*, 45-46, 164-177, 254; M. Fluss, *Moesia*, në PWRE XIV (1928), col. 2392-2393. Aspak nuk është situata më e mirë në literaturën e vjetër (Krh. Albert Forbiger, *Handbuch der alten Geographie*, II, 747-753 ss). Sidoqoftë këtu duhet diferencuar F. Kanitz, *Römische Studien in Serbien*, 1892. Por edhe vepra e tij duhet të shfrytëzohet me një kujdes të posaçëm dhe me sy kritik, për arsye se duke e lexuar veprën e tij, fitohet bindja, se në çdo gërmadhë ai ka parë një lokalitet romak.

10 Krh. M. Fluss, *Moesia*, PWRE XIV (1928), col. 2389-2390.

11 Krh. V. Velkov, *vep. e cit.* 7.

12 Krh. F. Papazoglu, *Makedonski gradovi...* 17-23.



me vlerë të madhe janë Itinerarët<sup>13</sup>, meqë dihet fare mirë se rrugët romake kalonin nëpër vendbanime, në aspektin gjeografik të përshtatshme, kurse në aspektin strategjik dhe ekonomik, shumë të rëndësishme. Por për njohjen e gjendjes juridike të çdo vendbanimi veçmas, vetëm Itinerarium Burdigalense jep të dhëna në bazë të të cilave mund të dihet se cili vendbanim është *civitas*, *mansio* apo *mutatio*<sup>14</sup>. Për shekullin V të e.s. është me rëndësi pa dyshim Synecdemi i Hieroklit<sup>15</sup> i përpiluar në bazë të dokumenteve provinciale. Përveç burimeve të përmendura për njohjen e intensitetit të urbanizimit, por jo edhe të topografisë së ndonjë vendbanimi, është më se i rëndësishëm materiali epigrafik. Por meqenëse ky material i përket shekullit I dhe II të e.s. mund të na shërbejë vetëm për kohën e Perandorisë Romake të hershme.

Madje edhe përsa i përket materialit arkeologjik, situata nuk është më e mirë kur mbahet parasysh së pari, territori i gjerë i Dardanisë, e pastaj intensiteti i pamjaftueshëm i hulumtimeve arkeologjike të bëra në trevën e Dardanisë, gjë që shkakton vështirësi të mëdha në njohjen e sistemit të urbanizimit të kësaj treve. Duhet theksuar se gjurmimet arkeologjike dhe materiali i tyre nuk na e bëjnë të mundshme njohjen e topografisë së vendbanimeve<sup>16</sup>, pavarësisht se të çfarë kategorie janë ato.

Nga sa u tha deri tani shihet qartë se para çfarë vështirësish gjendet ai që merret me problemin e shtruar. Me gjithë këto vështirësi, është e njohur se urbanizimi i trevës dardane, deri në kohën e Hadrianit, i ka papaprirë Mezisë së Epërme (Moesia Superior)<sup>17</sup>. Natyrisht një konstatim i tillë nuk e shpjegon sa duhet problemin e parashtruar. Me fjalë të tjera, vetvetiu shtrohet çështja se të çfarë karakteri kanë qenë ato vendbanime urbane, dhe pse topografia e tyre, në bazë të materialit që disponojmë, nuk mund të njihet. Mandej, nuk njohim as intensitetin dhe as faktorët që kanë ndikuar në një territor të

13 Krh. J. W. Kubitschek, *Eine römische Strassenkarte*, në JOA I VI/1902, 20-90. Po ai: *Itinerarien*, në: PWRE IX (1914) col. 2308 ss.; K. Müller, *Itineraria Romana*, Stuttgart 1916.

14 Krh. Otto Cuntz, *Itineraria Antonini Augusti et Burdigalense*.

15 Krh. Hieroclis Symecdemus, XVI 655, 7-8; 656, 1-2.

16 Të vetmen topografi të punuar të një vendbanimi në trevën klasike të Dardanisë (sot KSA e Kosovës), e ka dhënë Emil Čerškov, *Municipium DD te Sočanica*, Priština-Beograd, 1970, 10-12.

17 Krh. M. Fluss, *Moesia*, PWRE XIV/1928, col. 2392.



caktuar. Përveç çështjeve të parashtruara më lart<sup>18</sup>, të cilat do të përpiqemi t'i shpjegojmë në kuadër të mundësive dhe të materialit që kemi, është më se e domosdoshme të kemi të qartë përkufizimin e qytetit antik.

Njohësit e mirë të qytetit gjatë historisë theksojnë se qyteti është vend i cili përmbledh në vete të gjitha elementet e funksioneve publike që janë të përbashkëta dhe karakteristike e përgjithësuar e të gjitha qendrave urbane, siç janë: tempulli, elementi administrativ-politik (bazilika urbana, kuria), faktori ekonomik (forumi me taberna), rekreative etj.<sup>19</sup>.

Është interesante të përmendet, se të gjitha elementet e lartpërmendura ndeshen edhe në vendbanimet e popullatave autoktone, elementet e të cilave kanë qenë karakteristike në kohën romake<sup>20</sup>. Por përveç elementeve mbizotëruese të parashtruara, karakteristike për qytetin gjatë historisë, pa dyshim është edhe ai më i rëndësishmi-siguria, që u është dhënë banorëve përmes elementeve fortifikuese natyrore apo përmes fortifikimeve të bëra nga dora e njeriut. Mandej, qyteti në vetvete përfshin edhe disa funksione të rëndësishme, siç janë ndarja e punës dhe veprimtaritë shoqërore; pastaj roli i qendrës në relacion me bashkësitë territoriale fisnore — civitates, qofshin ato të mëdha apo të vogla, respektivisht rolin e organizimit të jetës së qendrës «qytet» ndaj fshatit në kuptimin e plotë të fjalës<sup>21</sup>.

Është interesante të dihet se dominantat e përmendura më parë të qendrave urbane janë që prej kohërave pararomake dhe se kjo traditë e elementeve autoktone jo vetëm ekziston, por është edhe një nga faktorët më thelbësorë në politikën e urbanizimit dhe të vendbanimeve urbane në provincat. Këtë na provojnë edhe elementet urbanogjene të qendrave ilire, të cilat në kohët e fundit më së miri i ka përpunuar Mate Suiç<sup>22</sup>, e që janë të përbashkëta për të gjithë ilirët, ndaj edhe për dardanët

18 Në këtë punim nuk do të trajtohen veçmas çështjet të cilat janë të lidhura ngushtë me problemin e romanizimit, pasi për këto flas në një vend tjetër (cfr. Z. Mirdita, *Studia albanica*, IX (2), Tirana 287-298; Po ai: *Dardanci i Dardanijs...* 208-301).

19 Krh. Mate Suiç, *Autohtoni elementi u urbanizmu antičkih gradova našeg primorja*, (Autohtone tradicije u lociranju urbanističke dominante), në: *Godišnjak* knj. III CBI 3/1, 164-165.

20 Krh. M. Suiç, *Po aty!* Lewis Mumford, *Grand u historiji. Njegov postanak njegovo mijenjanje, njegovi izgledi*, 38-41, 70-79.

21 Krh. M. Suiç, *Autohtoni elementi...* 171; L. Mumford, *vep.* e cit. 21, 70, 105, 120.

22 Krh. M. Suiç, *Problemes de Paleogenese et d'urbanisation des centres illyriens*, në: *St. Alb.* X (2) 1973, 105-116.



dhe Dardaninë, sigurisht, duke marrë parasysh se edhe dardanët i takojnë trungut etnik ilir<sup>23</sup>.

Mate Suiq urbanizimin e lokaliteteve ilire e ndan në tri faza: 1. — paraurbane, ku ende nuk mund të identifikohen elemente karakteristike të qendrave urbane; 2. — protourbane, kur duken disa elemente karakteristike të vendbanimeve urbane në popullsitë endogjene dhe sidomos elementet kohezive të qendrës «urbane» dhe të zonës së saj dhe 3. — faza e vërtetë urbane, e cila krijohet në kontaktet e drejtpërdrejta të elementeve urbane endogjene me elementet e vendbanimeve klasike greke dhe romake. U muar vesh se ky periodizim i urbanizimit që jep Mate Suiq ka të bëjë me bregun lindor të Detit Adriatik. Por megjithë këto specificitete të caktuara, dihet se vendbanimet karakteristike të ilirët në përgjithësi janë të karakterit OPPIDUM, apo, qyteza kështjella, të cilat autorët antikë i përmendin me emrin CASTELLUM. Këto vendbanime kryesisht i kanë banuar grupet homogjene, të lidhura në mes tyre me gjak, farefisni, apo që jeta e tyre është zhvilluar në marrëdhënie fisnore rreth qendrave të lartëpërmendura<sup>24</sup>. Te Tit Livi ndeshim tri lloje të vendbanimeve të fortifikuara, siç janë: *urbes*, *oppida* dhe *castella*<sup>25</sup>. Megjithë vështirësitë që krijohen me transponimin e termineve të vendbanimeve greke apo romake në trevën ilire, pa marrë parasysh intensitetin dhe ekstensitetin e hulumtimeve arkeologjike, prapëseprapë këto gjermime arkeologjike, në trevën dardane dëshmojnë ekzistencën e vendbanimeve të lartëpërmendura<sup>26</sup>. Gjithashtu është provuar se ekzistenca e këtyre vendbanimeve të fortifikuara në trevën e Dardanisë është dëshmuar edhe në kohën e «pax romana»<sup>27</sup>. Vazhdimësinë e vendbanimeve romake në territorin e dardanëve me ato pararomake e kanë dëshmuar hulumtimet arkeo-

23 Krh. Z. Mirdita, *Les origines des Dardaniens*, në: St. Alb. X (3) 1973, Tirana, 177-149.

24 Krh. M. Suić, *Problemes...* 106.

25 Liv. XXVI 25, 3; XLIII 19, 2-3; XLI 19, 10. Strabo VII 5, 7 (c. 316). Sipas M. Suiq (Problemes... 106) nocioni castellum të autorët romakë i përgjigjet nocionit «gradina» edhe pse diferencimi në mes castellum dhe oppidum është vetëm i karakterit formal dhe i rastit. Me fjalë të tjera këto diferencime nuk shprehen aq në përmasa sa në format e organizimit shoqëror.

26 Krh. Z. Mirdita, *Dardanci i Dardanija...* 318-337.

27 Krh. Z. Mirdita, *A propos de la romanisation...* 290.



logjike, si bie fjala në Suha Rekë, Municipium DD në Soçanicë<sup>28</sup>, gjermimet arkeologjike të bëra në Ulpianë në vitin 1973, gjatë të cilave kam asistuar disa herë etj. Kjo vazhdimësi mund të shihet, siç thekson Mate Suiç<sup>29</sup>, në vazhdimësinë topike dhe në atë etnokulturore të pandërprerë.

Nga kjo që u tha deri më tash, vetvetiu lind pyetja: prej kur mund të flitet për urbanizimin e trevës së Dardanisë? Cilët ishin faktorët që ndikuan në urbanizimin e kësaj treve dhe çfarë karakteri ka ky urbanizim?

Sidoqoftë, zanafilla e urbanizimit, duhet kërkuar në kohën kur elementet autoktone të vendbanimeve protourbane shkrihen në kohën e kontakteve të drejtpërdrejta me elementet e huaja dhe kështu marrin trajta urbane në brendi të mureve me të drejtën qytetare romake dhe me vetëqeverisjen municipale<sup>30</sup>. Përsa u përket faktorëve themelorë, që kanë ndikuar në këtë urbanizim, përveç atyre të brendshëm, në rend të parë, atyre natyrorë (kushtet gjeografike, rëndësia ekonomike dhe strategjike), kanë ndikuar edhe elementet e jashtme si p.sh. tregtarët, veteranët (milites deducti), kampet ushtarake, canabae, llixhat. Të gjitha këto elemente urbanogjene mund të dëshmojnë edhe në trevën e Dardanisë.

Por, ndryshe nga provincat fqinje e sidomos nga ato që gjenden jashtë trevës së Ballkanit, urbanizimi i territorit të dardanëve shpreh qartë politikën romake në këtë territor. Është e njohur, tashmë, se provincat danubiane, në kuadër të të cilave vend të posaçëm zë territori i dardanëve, duke marrë parasysh në një anë pasurinë ekonomike, sidomos burimet xehe-rore, dhe në anën tjetër, krizën që kishte pushtuar Perandorinë Romake, ndryshe nga provincat perëndimore (Galia, Hispania etj.), që në këtë kohë kishin humbur gjithë vlerën ekonomike, këto gjithnjë e më shumë luanin rol të konsiderueshëm në politikën globale të Perandorisë Romake. Kjo shihet qartë në faktin e zhvillimit të sistemit të vendbanimeve të tipit *castella*, *urbes*, *stationes*, *villae*, *canabae* (Timacum minus e Timacum maius në Knjezhevc), që ka qenë i lidhur me qëllimet

---

28 Krh. N. Sllavkovic — Djurić, *Ilirski tumuli kod Suve Reke*, në: GMKiM. IX/1964. 537-549; E. Čerškov, *Municipium DD kod Soçanice*, Priština-Beograd, 1970, Esad Pašalić, *Period rimske vladavine do kraja III vijeka nase ere*, në: *Kulturna istorija Bosne i Hercegovine*, 186-187.

29 Krh. M. Suić, *Autohtoni elementi...* 165; Po ai: *Prolegomena urbanizma antičke Liburnije*, në: Radovi FF. u Zadru II, sv. 1, Zadar, 1963, 90 ss.

30 Krh. M. Suić, *Problemes...* 109.



ekonomike dhe strategjike. Por, meqë materiali arkeologjik, sidomos ai i karakterit ndërtimor, është i pakët dhe i pamjaf-tueshëm, gjë që është karakteristike edhe për një numër të madh të provincave, në rend të parë të provincave danubiane, është shumë vështirë të thuhet diçka, së paku për afërsisht, li-dhur me strukturën dhe me popullsinë e vendbanimeve<sup>31</sup>. Megjithatë karakteristika themelore e urbanizimit të trevës së Dardanisë, së paku përsa i përket shekulli III dhe IV të e.s., shihet në faktin se vendbanimet, siç mësojmë nga të dhënat e itinerarëve, janë të përqëndruara gjatë rrugëve dhe në kra-hinat e pasura me xeherore (si p.sh. Ulpiana, Municipium DD në Soçanicë), kurse nga ana tjetër vetë themelimi i tyre, duke përjashtuar koloninë Skupi, nuk është bërë në bazë të de-duksionit. Të vetmin përjashtim e bën si duket Municipium DD në Soçanicë, në përmendoret e të cilit «duken nocionet muni-cipium dhe colonia»<sup>32</sup>, edhe pse disa nuk pajtohen<sup>33</sup> me këtë. Prandaj nga ajo që u tha, dhe në mungesë të kufizimit «agri et oppidi civium romanorum», sidomos në trevën klasike të terri-torit dardan, d.m.th. në KSA të Kosovës, por edhe në pjesën më të madhe të trevës dardane, është shumë vështirë të ndiqet procesi i konfrontimit të institucioneve endogjene me ato të ro-makëve që janë shprehur gjatë urbanizimit të një territori të pushtuar, të ndarë me *ager publicus*, *ager privatus* dhe *ager compascus*<sup>34</sup>. Meqenëse institucionet *ager publicus* dhe *ager colonia* kanë penguar që vendbanimet autoktone të zhvillohen në qendra klasike urbane, ato kanë mbetur, për nga aspekti i pozitës juridike, si *pagi* ose *vici*<sup>35</sup>. Një fakt i tillë është dëshmuar edhe në Dardani, si p.sh. *vicus Titis*<sup>36</sup>, *vicus Zatidis*<sup>37</sup>, *vicus Perdica*<sup>38</sup> dhe *vicus Cavadinus*<sup>39</sup> që gjendej në zonën e kolonisë Scupi. Pa dyshim, në këtë fakt duhet të gjendet përgjigja pse territori dardan është i varfër me qendërbanime qytetare të tipit klasik, që na befason, duke pasur parasysh fqinjësinë me Maqedoninë.

31 Str. E. Pašalić, *Antička naselja i komunikacije u Bosni i Hercegovini*, 83.

32 Cfr. E. Čeršković, *Municipium DD...* 62, nr. 3; 65, nr. 11. 76.

33 Cfr. Slobodan Dušanić, *Novi Antinojev natpis i metalla municipii Dardanorum*, në: *ŽA XXI* (1) 1971, 247-251.

34 Cfr. M. Suić, *Problemes...* 110.

35 Cfr. M. Suić, *Problemes...* 115.

36 CIL VI 32 605-2 845.

37 CIL V 898.

38 CIL VI 322 606-2 846.

39 Cfr. B. Josifovska, *Dva latinska natpisa iz Kavgalije Scupi*, në: *ŽA. XVI* (1966), Skopje, 266 ss.



Është interesante se Ptolomeu<sup>40</sup>, në veprën e të cilit pasqyrohet situata e Perandorisë së hershme, në trevën dardane përmend vetëm katër vendbanime qytetare: *Naissus*, *Arribantion*, *Ulpiana* dhe *Scupi*. Pavarësisht nga kjo varfëri e të dhënave të autorëve të lashtë; nuk mund të thuhet se kjo trevë ka qenë e varfër me vendbanime, për arsye se materiali epigrafik, që mund të thuhet se është i pasur, madje për nga koha i përket periudhës së hershme, dëshmon qartë ekzistencën e vendbanimeve. Por, materiali i përmendur nuk mund të na ndihmojë fare jo vetëm lidhur me pozitën juridike të ndonjë vendbanimi, por as me topografinë e tij. Më lart u theksua se vendbanimet kanë qenë kryesisht pranë rrugëve, në këtë rast pranë rrugëve Nais-Lis, respektivisht Nais-Thessalonik<sup>41</sup>. Edhe pse *Tabula Peutingeriana* nuk na jep pozitën juridike të ndonjë vendbanimi, prapëseprapë shumë prej tyre mund të konsiderohen si *stationes*, *mansiones* ose *mutationes*.

Kurrëgjë, më shumë nuk na jep as Hierokli me veprën e tij *Synecdemi* ku paraqitet situata e mesit të shekullit V të e.s. Përsa i përket provincës së Dardanisë, ku sundojnë tre hegjemonë, ai thotë se ekzistojnë tri qytete: *Skupometropolis*, *Merion* dhe *Ulpiana*<sup>42</sup>. Duke pasur parasysh sa më sipër, shihet se Dardania, edhe pse procesi i urbanizimit e kishte përfshirë shumë më parë sesa Moesia Superior, mbetet provincë pa vendbanime urbane të tipit klasik. Bile duhet thënë se i tërë procesi i urbanizimit të Dardanisë është zhvilluar në kuadër të territoreve të bashkësive municipale. Dihet se popullsia qytetare e Moesia Superior ka qenë e përbërë prej veteranëve (legjionarëve dhe ausiliarëve), të ardhurve nga provinca të tjera dhe të elementit autokton, që kishin fituar qytetarinë me të drejtën romake. Përveç kësaj është theksuar se në territorin klasik të Dardanisë, sot KSA e Kosovës, nuk ka ekzistuar asnjë vendbanim i themeluar me sistemin e deduksionit siç është rasti me koloninë *Scupi*. Në veri *Timacum minus* bile edhe *Nais*<sup>43</sup> janë ngritur pranë kampeve ushtarake, kurse *Ulpiana* dhe *Municipium DD* në *Soçanicë* janë vendbanime thjesht urbane të karakterit xeheror me të gjitha karakteristikat e arkitekturës së lashtë; por, megjithatë, me organizim

40 Ptolem. III 9, 4.

41 K. Miller, *Itineraria Romana*, Stuttgart 1916, col. 555-559, 571-573.

42 Hieroc. *Synecdemus* 655, 7-8; 656, 1-2.

43 Cfr. M. Mirković, *Urbanisierung...* 46; Po ai: *Municipale Gemeinde...* 165.



municipal. Me të drejtë A. Mócsy<sup>44</sup> thekson se Moesia Superior në shekullin IV të e.s. ka qenë plotësisht e urbanizuar, siç e tregon me një grafik dhe përfundon se vendbanimet xeherore të municipalizuara transformohen në qytete, duke u mbështetur në një edikt perandorak të vitit 386 të e.s. sipas të cilit kërkohet që prokuratorët e xeherorëve në Maqedoni, Dacia Mediterranea, Moesia (Prima) dhe në Dardani duhet të zgjidhen, sipas zakonit të lashtë, nga rendi i kurialëve<sup>45</sup>.

Por vështirë mund të pranohet se i tërë territori i Dardanisë ka qenë i përfshirë në kuadër të tri bashkësive municipale (Ulpiana, Municipium DD në Soçanicë, Naisius) dhe të territorit të kolonisë Scupi. Në saje të materialit epigrafik, të zbuluar jashtë qendrave të lartpërmendura, dëshmohet ekzistenca e *civitates peregrinorum* me kufij territoriale mjaft të përcaktuar. Këto njësi territoriale fisnore me një qendër të caktuar — *Oppidum*, që përpara figuronte si *castellum*, kanë pasur pushtetin qendror në formë të *ordo decurionum*, që ushtronin pushtetin suprem në mes oppidumit, si qendër kryesore e kësaj bashkësie, dhe *pagus-it*, respektivisht *vicusit*<sup>46</sup>. Dhe dihet fakti se shndërrimi i këtyre vendbanimeve është pasuar me risi administrative në organet e pushtetit, në të cilat gjendeshin përfaqësuesit fisnorë, respektivisht përfaqësuesit e aristokracisë vendase, lidhjet e të cilëve tashmë nuk janë farefisni e gjakut, po në saje të interesave të përbashkëta, paraqesin administratën fisnore municipale. Bashkësi të tilla fisnore municipale, respektivisht *civitates*, në saje të materialit epigrafik, janë dëshmuar dy në Rrafshin e Dukagjinit, njëra në trevën e fshatrave Sopinë Popovljan — Mushitishtë, 18 km në verilindje të Prizrenit<sup>47</sup>, dhe tjetri në Dërsnikun e Ulët, në afërsi të Klinës<sup>48</sup>. Në rrafshin e Kosovës një qendër municipale me karakter *civitas* ka qenë diku në afërsi të Klokotit, jo larg Vitisë, burimet termale të të cilit kanë qenë të njohura që në kohë të lashtë. Me siguri se *civitates* të tilla ka pasur edhe në viset e tjera të Dardanisë. I. Mikulčić<sup>49</sup> flet për tri qendra territoriale fisnore, njëra në trevën e Leshokut të sotëm, e tjetra në luginën e Kumanovës, kurse e treta në

44 Cfr. A. Mócsy, *Gesellschaft und Romanisation...* 39.

45 Cfr. A. Mócsy, *Gesellschaft und Romanisation...* 39.

46 Cfr. M. Suić, *Problemes...* 108.

47 E. Čerškov, *Rimljani na Kosovu i Metohiji*, Beograd, 1969, 40-41.

48 Po aty.

49 Krh. Ivan Mikulčić, *Teritorija Skupa*, në: ZA XXI (2) 1971 Skopje, 463-482.



trevën e Moravës Jugore me qendrën kryesore te fshati Davidovac (Srpska kuqa).

Nga gjithë sa u tha deri më tash vetvetiu vërehet një fakt interesant. Dardania, edhe pse, siç u tha më sipër, ka qenë e përfshirë në politikën e urbanizimit shumë më përpara se sa Moesia Superior, prapëseprapë ajo nuk ka asnjë qendër urbane të tipit klasik. Përveç tri qendrave municipale (Ulpiana, Municipum DD në Soçanicë), kolonisë Scupi dhe Timacum minus dhe Timacum maius si vendbanime ushtarake, ekzistojnë qendra të shumta të bashkësive fisnore — civitates me të gjitha organet administrativo-juridike (ordo decurionum duoviri iure dicundo) në të cilat ka jetuar popullsia vendase larg ndikimit romanizues. Ç'do të thotë kjo? Pa dyshim, këtu shprehet politika e planifikuar e qeverisjes romake në këto vise. Mandej këtu shihet edhe fakti se sistemi i romanizimit nuk i ka përfshirë të gjitha shtresat e popullsisë së trevave të përmendura<sup>50</sup>, gjë që e dëshmon qartë materiali onomastik dhe struktura etnike me karakter autokton<sup>51</sup>. Përveç kësaj, mungesa e qendrave urbane të tipit klasik antik tregon se Dardania ka qenë jashtë ndikimit kulturor grek<sup>51a</sup>. Kjo edhe më tepër nëna habit kur dihet se Maqedonia e ka njohur organizimin e sistemit të polisit. Por kjo kurrsesi nuk do të thotë se ky element etnokulturor, i cili ka qenë në një shkallë aq të ulët, do të ketë qenë aq i paaftë për absorbimin e të mirave kulturore të huaja dhe se organizimi i tij shoqëroro-politik dhe struktura kanë qenë në një shkallë të ulët kulturore dhe tepër primitive, pikëpamje nga të cilat përshkohen disa punime të kohës sonë<sup>52</sup>. Në fakt, lidhur me qarkullimin e të mirave kulturore kemi të dhëna që nga koha helenistike<sup>53</sup>.

Prandaj, vetë fakti i ekzistencës së *civitates peregrinorum* si struktura politike-shoqërore me një qendër të caktuar, përfaqësues të të cilave janë shtresat e më të pasurve të aristokracisë autoktone, e këto organe në kontakt me institucionet romake transformoheshin në ordo decurionum<sup>54</sup>, që ushtronin

50 Krh. Z. Mirdita, *A propos de la romanisation...* 287-298.

51 Krh. Z. Mirdita, *Dardanci i Dardanija...* 204-262 *Gemeinde...* 165.

51a Kur themi kështu nuk mendojmë në mënyrë absolute (shih, shën. 44).

52 Krh. R. Mackr, *Grenzmerken und Nachbarn Makedoniens in Norden und Westen*, Göttingen 1951, 180 (Disertacion në dorëshkrim).

53 Krh. Dj. Mano — Zisi — Lj. Popović, *Novi Pazar, Ilirsko-Grčki nalazi Narodni Muzej*, Beograd, 1969; M. Parović-Pešikan, *Les Illyriens au contacts Grecque*, në: Al. V (1964), 61-68.

54 Është mendim i përgjithshëm se dekursionët ilirë janë «vëllezërit» autoktone. Krh. Gabričević, *Dviije ilirske općines područia Vrlike*, në: VAHI LV/1953, 103; M. Suić, *Problemes...* 106, n. 8.



funkcionin e princepsit, kurse në kohën e pushtimit romak ekziston një tog shembujsh që e provojnë përzierjen e këtyre dy sistemeve, d.m.th. kur princepsi është në funksionin duoviral të një municipiumi<sup>55</sup>, flet qartë se ky element etnokulturor është ruajtur edhe në kohën e «romanizimit intensiv». Kjo politikë bëhet e kuptueshme po të mbajmë parasysh momentin ekonomik dhe në radhë të parë, pasuritë nëntokësore të Dardanisë e në anën tjetër, gjendjen e vështirë që e kishte pushtuar Perandorinë Romake sidomos prej shek. V-II p.e.r. si pasojë, së pari, e krizës së brendshme, që shprehej në konfliktin midis elementit ushtarak dhe autoritetit të senatit e pastaj edhe si pasojë e dyndjeve të pandërprera të popujve barbarë. Për mbrojtjen e kufijve të Perandorisë nevojitej gjithnjë e më tepër elementi ushtarak, i cili tani rekrutohej prej elementit vendas. Në dritën e këtyre të dhënave duhet parë dhe mungesa e qendrave urbane të tipit klasik në Dardani, që ishin karakteristike për botën e lashtë greke e romake.

---

55 Krh. M. Suić, *Problemes...* 108.



## V. RRETH ÇËSHTJES SË «ROMANIZIMIT» TË DARDANËVE

Ndër fiset më të organizuara, që shtriheshin në pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik, kanë qenë dardanët. Si të gjitha fiset e tjera ilire, ashtu edhe dardanët janë konsoliduar në trevën ku i identifikon kultura materiale (për të cilët flasin referencat e autorëve të lashtë). Nga aspekti i strukturës sociale dhe politike, dardanët, me nocionin e të cilëve nënkuptohet aleanca e shumë fiseve siç janë: thumatët, galabrët e shumë të tjerë të paidentifikuar, — se emri dardan është emër i përbashkët i shumë fiseve ilire që shtriheshin në zonën qendrore të Gadishullit Ballkanik, — na paraqiten shumë të shtresuar, ushtarakisht të organizuar, në marrëdhënie ndërfisnore me një autonomi të gjerë në kuptimin e plotë të fjalës, kurse në marrëdhëniet e jashtme apo në marrëdhëniet me fqinjët përfaqësoheshin nga mbretërit (*reges, reguli dhe bazilejtë*) ose kryekrerët apo kapidanët (*principes*)<sup>1</sup>. Megjithatë këto terma të institucioneve politike për dardanët na i kanë sjellë autorët grekë dhe romakë, ne nuk dimë se sa mund të identifikohen në mënyrë adekuate me institucionet ilire në përgjithësi, pra, edhe të dardanëve. Sidoqoftë, këta përfaqësues të institucio-

<sup>1</sup> Krh. Polyb. XXIX 13, 1-2 ss; XXIV, 4, 11; XXX 28, 1-2; XLIV 30, 4 etj.



neve politike nuk mund të konsiderohen as si dinasti me kuptimin e plotë të fjalës, siç mendojnë disa autorë<sup>2</sup>, për dy arsye të thjeshta: së pari se vështirë të kuptohet që një dinast ka qenë në gjendje të rekrutojë një ushtri të madhe si ajo prej 20.000 ushtarësh, të cilën një mbret i dardanëve, i paidentifikuar, ia ofron si ndihmë mbretit maqedonas, Ptolomej Keraunit, të cilën ndihmë ky e përbuz<sup>3</sup> dhe madje këta përfaqësues kanë lidhur edhe aleanca siç është ajo e vitit 200. p.e.s., të cilën në emër të dardanëve e lidh mbreti i tyre, Batoni, i biri i Longarit<sup>4</sup>. Pikërisht për këtë arsye mund të kuptohet pse edhe Roma ka qenë e detyruar të llogarisë praninë e tyre në këtë trevë qendrore të Ballkanit dhe pse është ruajtur emri i tyre në administratë dhe në trajtën etnografike deri në lashtësinë e vonë në aktet administrative kishtare deri në shekullin XVII<sup>5</sup>. Kjo shihet edhe nga fakti se romakët bëjnë kontrata diplomatike siç na bën të njohur Tit Livi<sup>6</sup> kur flet për ndihmën që i ofrojnë konsullit Sulpic Galbi në koalicionin antimaqedon të formuar prej popujve fqinj të Maqedonisë dhe nga përgjigja e konsullit romak të përmendur, që na jep Tit Livi: «Konsulli iu përgjigj atyre që premtonin ndihmën se do të shërbehet me ndihmën e dardanëve dhe të Pleuratit, posa ta qesë ushtrinë në Maqedoni»<sup>7</sup>.

Roma në pushtimet e veta, duke ruajtur format e rendit shoqëror të të nënshtruarve dhe madje duke i imprenjuar dukuritë e tyre fetare dhe kulturore në ato të vetat me qëllim që popujt e nënshtruar t'i bëjë për vete, nuk ka kursyer t'u japë të drejtat municipale qyteteve dhe rrethinave të tyre.

2 Krh. Fanula Papazoglu, *Politička organizacija Ilira u vreme njihove samostalnosti*, 4; Po ajo: *Les origines et la destiée de l'etat Illyrien*, në: «Historia» XIV — 2 (1965); Po ajo: *Poreklo i razvoj ilirske države*, në: *Godišnjak V/CBL3*, 1967.

3 Justin. XXIV 4, 9-10.

4 Liv. XXXI 28, 1-3: «*Hac satis felici expeditione (invadimi i Sulpicit në Iliri, 3. M.) bello commisso reguli ac principes accolae Macedonum in castra Romana veniunt, pleuratus Scerdilaidi filius et Amynder Athamanum rex et ex Dardanis Bato Longari filius! Bellum suo nomine Longarus cum Demetrio, Philippi patre, gesserat. Pollicentibus auxilia respondit consul, Dardanorum et Pleurati opera, cum exercitum se in Macedoniam induceret, se usurum*».

5. *Historia e Shqipërisë, I, Tiranë, 1959, f. 393.*

6 Liv. XXXI 28, 1.

7 Liv. XXXI 28, 3: «*Pollicentibus auxilia respondit consul, Dardanorum et Pleurati opera, cum exercitum se in Macedonian induceret, se usurum*».



Edhe vetë problemi i romanizimit duhet të shqyrtohet dhe të trajtohet në dritën e këtyre momenteve që u cekën më sipër. Në realitet, shtrohet pyetja: e ka pasur Roma synim që ta realizojë politikën e romanizimit me kuptimin e plotë të fjalës në Ballkan, në kohën kur ndihet intensivisht shpopullimi i Perandorisë dhe sidomos në kohën kur Romës i kërcënohej rreziku prej dyndjeve të pandërprera të barbarëve, kur i nevojitej elementi ushtarak, i cili nuk plotësohej më prej qytetarëve romakë, e sidomos në kohën e krizës së përgjithshme politike, shoqërore dhe ekonomike? Me siguri që jo! Pyetje themelore është se çfarë duhet të nënkuptohet me fjalën romanizim. A duhet të nënkuptohet shkrirja e plotë e popullatës endogjene dhe asimilimi i saj me romakët<sup>8</sup>, apo procesi i romanizimit duhet të kuptohet «si proces i mohimit të disa dukurive të tjera themelore të kulturës shpirtërore, e cila është formuar me shekuj në traditat e trevës së vet... të cilat kanë pasur më tepër aspektin shoqëror-kulturor se sa politik, ose madje etnik»<sup>9</sup>? Mund të thuhet se ilirët prej këtij lloji të romanizimit nuk kanë shpëtuar. Në anën tjetër, karakterin e veçantë të romanizimit të viseve bregdetare nuk mund ta përgjithësojmë edhe për viset në brendi të Gadishullit Ballkanik, pra edhe për territorin e dardanëve, ku është ruajtur karakteri rural i konservativizmit sidomos në përdorimin e gjuhës brenda në shtëpi dhe në marrëdhëniet e gjera shoqërore. Elementi endogjen — fshatarët, edhe këtu mbesin «incolae» dhe «peregrini» të cilët e punojnë tokën dhe i plotësojnë në njësitë ndihmëse<sup>10</sup> Prandaj, romanizimi, si aspekt i sjelljes kozmopolite, është një dukuri e përgjithshme në tërë trevën ku kanë jetuar fiset që janë të njohura me emrin e përbashkët ilir. Megjithatë, duhet të theksohet se intensiteti i kësaj dukurie nuk ka qenë i njëjtë as në ato vise që kanë qenë të afërta për kontaktet romake dhe që kanë rënë më parë nën

8 Krh. K. Jireček — J. Radonić, Istorija Srba, I, Beograd 1952, 22; Po ai: Die Romanen in den Städten Dalmatiens während des Mittelalters, 12-13.

9 Krh. Dujo Rendić — Miočević, Problem romanizacije Ilira s osobitim obzirom na kultove i onomastiku, Simpozijum II, 141; M. Suić, Antički Nin i njegovi spomenici, Radovi Instituta JAZU u Zadru 16-17 (1969), Zadar, 65.

10 Krh. I. M. Rostowtzew, Gesellschaft und Wirtschaft der Römische Staat, I, 190-193; II. 70-105.



sundimin e tyre<sup>11</sup> e jo më në viset e thella në brendi të Gadhullit Ballkanik.

Intensiteti i romanizimit të ndonjë province të Perandorisë romake mund të shqyrtohet nga aspekti i dy komponentëve: 1. me anën e problemit të urbanizimit dhe 2. me anën e materialit onomastik. Veç këtyre dy momenteve, në përcaktimin e intensitetit të romanizimit duhet të merret parasysh diferencimi i jetës së qendrave urbane dhe të rrethinës së tyre të afërt e të largët. Megjithë ndikimin e jetës urbane nëpër fshatra edhe tutje ka vazhduar jeta rurale e elementit autokton<sup>12</sup>. Një gjë e tillë vihet re edhe sot. Megjithatë, duhet të theksohet se romanizimi i trevës dardane, e më gjerësisht i provincës së Mezisë, me gjithë praninë e qendrave urbane me rëndësi, siç janë: Scupi, Ulpiana, Naissusi etj., jo vetëm që ka qenë i vonshëm<sup>13</sup>, por dhe shumë i përciptë. Kjo shihet edhe nga prania dhe funksionimi i mëtejshëm i shumë «castella» dhe «oppida» dhe pikërisht në kohën e «pax romana».

Sipas disave, «castella» dhe «oppida» në këtë kohë nuk kanë qenë të nevojshme<sup>14</sup>. Por dihet se romakët pa ndonjë nevojë të jashtëzakonshme nuk kanë ngritur qytete, gjegjësisht «oppida» dhe «castella», të cilat më së shumti kanë shërbyer si pikëmbrojtje ose edhe si lokalitete me karakter ekonomik, depo të ndryshme. Lokalitete të tilla ka pasur edhe në Dardani dhe ato kanë qenë në pikat qendrore dhe strategjike të komunikacionit. Nga kjo rrjedh edhe fakti se romakët me këto i kanë ruajtur dhe i kanë mbikqyrë komunikacionet me rëndësi dhe qendrat strategjike<sup>15</sup>. Nga kjo që u tha mund të kuptohet edhe politika «securitatis populi romani», e cila ka pasur për qëllim mbrojtjen e kufijve shtetërorë dhe sigurimin

11 «Cio dimostra che questa zona assai vicina all'Italia occupata fin del primissimi tempi da trupe romane, colonizzata già da Tiberio, subito assimilò il costume romano della stele funeraria, ma anche che la romanizzazione non distrusse l'elemento indigeno che continuò a vivere integro per lo meno per più di un secolo dalla conquista, pur nella progressiva acquisizione della cittadinanza romana». M. Pavan, *La provincia romana della Pannonia Superior*, 481-482, sidomos n. 1.

12 Krh. M. Suić, *Antički Nin...*, 65; D. Rendić — Miočević, *Simpozijum*, III, 296 (Diskutimi).

13 Krh. V. Pàr van, *Dacia*, Bucuresti 1967, 139; I. M. R. Egger, *Balkan pod Rimljanima*, në: *Knjiga o Balkanu II*, Beograd 1937, 79.

14 Krh. A. Schöber, *Die Römerzeit in Österreich und in den angrenzenden Gebieten vom Slowenien*, 2. Aufl. Wien 1953, 55; E. Niescher, *Die Römer in Gebiete der ehemaligen Österreich-Ungarn*, Wien 1923, 105.

15 Krh. E. Pašalić, *Antička naselja i komunikacije u Bosni i Hercegovini*, Sarajevo 1969, 82.



e rendit të brendshëm të Perandorisë dhe të provincave<sup>16</sup>. Madje, me gjithë pacifikimin e Perandorisë, praktika e transferimit të popullsisë nga rrafshnaltat në fusha ka qenë e njohur edhe në viset e tjera të Perandorisë Romake, sidomos në ato vise që kanë qenë vatra të kryengritjeve të pandërprera dhe të turbullirave e të pasigurisë. Ashtu siç ka ndodhur në Gadishullin Iberik, me fiset e gale, në të njëjtën mënyrë kanë vepruar edhe me fiset e Ilirisë<sup>17</sup>, edhe në trevën e Dardanisë. Duke pasur parasysh këtë që u tha më sipër, mund të kuptohet edhe ekzistimi i rrjetit të gjerë të stacioneve policore, gje-gjesisht beneficiare, rrjeti i të cilave ka qenë më i dendur në pjesën qendrore të Dardanisë: në fshatin Zhur afër Prizrenit<sup>18</sup>, në veriperëndim të Mitrovicës<sup>19</sup>, në Kaçanik<sup>20</sup>, etj. Ndër të tjera procesi i romanizimit i është nënshtruar faktorit të zhvillimit të viseve të caktuara etnografike ku pasqyrohet edhe diferencimi i strukturës shoqërore të popullsisë dardane. Kjo gjë mund të shihet qartë nga mënyra e administrimit në këto vise, e cila ka qenë i kushtëzuar nga tradita specifike, duke zbatuar sistemin administrativ romak në mënyrë kompromise<sup>21</sup>. Edhe pse procesi i nivelimit urban nuk i ka përfshirë edhe fshatrat për shkak të zhvillimit specifik të disa viseve dhe për shkak të planeve fiskale shtetërore që u janë imponuar fshatrave nga pushteti municipal<sup>22</sup>, romakët për t'i bërë për vete shtresat aristokrate të popullsisë endogjene i kanë përkrahur dhe bërë për vete më parë se t'i jepej e drejta romake organit vetëqeverisës të bashkësive endogjene të njohura si «*civitates*», në krye të të cilave gjendej kryeplaku apo «*princeps*» i popullsisë endogjene<sup>23</sup>. Një politikë e tillë që ka pasur për qëllim që popullsinë dardane ta përçajë dhe që shtresën e privilegjuar të shoqërisë ta bëjë për vete në mënyrë që politika pushtuese e romakëve të realizohej sa më mirë.

16 Krh. Hans Ulrich Istinsky, *Sicherheit als politisches Problem des römischen Keisertums*, Baden-Baden 1952, 11 ss; F. Miltener, *Römerzeit in österreichischen Landen*, Innsbruck 1948, 42 ss.

17 Krh. M. Rostowtzev, *Gesellschaft...* I, 190-193.

18 *Spomenik* SKA LXXI (1931), n. 321.

19 *Spomenik* SKA LXXI, n. 208-211.

20 CIL III 8184 «Mund të jetë — thekson N. Vulić — se arsyeja (sc. për ekzistencën e këtyre stacioneve policore, Z. M.) janë banorët endogjenë jo të qetë». N. Vulić, *Spomenik* SKA LXXI, 91.

21 Krh. Duje Rendić — Miočević, *Problemi romanizacije...*

142.

22 Krh. I. M. Rostowtzev, *Gesellschaft...* I, 158-205; II, 1-69.

23 Krh. Duje Rendić — Miočević, *Problemi romanizacije...*



Ekzistenca e këtyre «civitates», karakteri municipal i të cilave ka qenë i ngjashëm me shumë me «municipia latine»<sup>24</sup>, është dëshmuar në disa vende të territorit të ngushtë të Dardanisë, d.m.th. në Kosovë. Edhe J. A. Evansi<sup>25</sup> ka supozuar se në Rrafshin e Dukagjinit, ka ekzistuar një municip, mendimin e të cilit e kanë përligjur kërkimet arkeologjike në vitet 60-të të shekullit tonë. Janë zbuluar komplekse të tëra vendbanimesh të lashta bashkë me materialin epigrafik. Një qendër karakteristike urbane me trajtat municipale të karakterit vetëqeverisës të popullsisë endogjene gjendej në Dërsnikun e Ulët, afër Klinës, jo larg Drinit të Bardhë. Në tra të derës së Kishës së Shënkollit është murosur një pllakë ku lexohet: *L. Aelius Cosinus, decurion*<sup>26</sup>. Dëshmi të tilla janë gjetur në fshatrat e sotme Pograxhë<sup>27</sup>, Studenicë<sup>28</sup>, Çiflak, ku është gjetur një pllakë në të cilën përmendet njëfarë decurio Aurelius Cassinus<sup>29</sup>. Duke pasur parasysh këto që u thanë, E. Çerškovi, i prirur nga koncepti se zhvillimi i vendbanimeve në tërë Kosovën ka qenë i kushtëzuar nga tërësitë antropogjeografike të përcaktuara, e pranon supozimin e J. A. Evansit, që në Dërsnikun e Ulët ka ekzistuar një bashkësi e popullatës endogjene me karakter të administratës municipale. Në grupin e këtyre llojeve «civitates» pa dyshim hyjnë, përveç lokalitetit të lashtë që shtrihej në zonën e fshatrave Mushtishtë, Popovljan, Sopinë, ku janë gjetur shumë gërmadha të kohës antike, dhe që shtrihej në verilindje të Prizrenit, edhe shumë lokalitete në tërë Kosovën. Megjithatë, duhet theksuar se përveç njerëzve që ushtronin administratën dhe detyrën e dekurionit, pjesa tjetër e popullsisë nuk ka gëzuar kurrfarë të drejtash qytetare<sup>30</sup>. Prandaj, prania e këtyre vendbanimeve me format e administrimit vetëqeverisës konfirmon politikën e kompromisit të romakëve ndaj popullatës endogjene. Këtë politikë romakët e kanë përdorur edhe në kohën kur Roma fillon ta zgjerojë territorin e saj në tërësi të fqinjëve të vet<sup>31</sup>.

Njëherësh duhet theksuar se sistemi i urbanizimit i territorit të dardanëve nuk është zhvilluar në të njëjtën mënyrë

24 Krh. E. Čerškov, *Rimljani na Kosovu i Metohiji*, Beograd 1969 37 ss.

25 Krh. I. A. Evans, *Antiquarian researches in Illyricum*, 167.

26 *Spomenik SKA LXXI* n. 204.

27 *Spomenik SKA LXXXV* n. 160.

28 *Spomenik SKA LXXXV* n. 161 — *Spomenik SAN XCVIII* n. 104.

29 Krh. E. Čerškov, *Rimljani...* 85 n. 92.

30 Po aty. 40.

31 Krh. Gino Luzatto, *Ekonomska povijest Italija*, I. Zagreb, 1960, 43.



dhe në të njëjtat faza sikurse edhe në pjesën tjetër të Moesia Superior, siç janë: kolonitë deduktive, kanabët, që janë formuar përreth kampit ushtarak të qytetit, ku janë vendosur civilët me prejardhje të huaj, familjet e personave ushtarakë. Një shembull i tillë është Timacum minus, fshati i sotëm Ravne, në Knjazhevcin e sotëm<sup>32</sup>. Por, megjithatë, vetë ekzistenca e këtyre bashkësive «civitates» flet qartë se romanizimi nuk ka qenë intensiv. I. M. Rostovcevi<sup>33</sup> thekson se popullata endogjene ka mbetur jashtë ndikimit të urbanizimit, në traditat e lashta të jetës së përditshme, në organizatat e tyre autonome, të cilat shfaqen edhe në kufijt territorialë të rajoneve të përcaktuara. Prandaj mund të thuhet lirisht se edhe Dardania, megjithë ekzistencën e gjatë të bashkësive të popullsisë endogjene, pra të këtyre «civitates», ka ruajtur karakterin rustik të jetës së përditshme edhe në ato vise që u kanë qenë aneksuar qyteteve e kasteleve dhe kështu i ka ruajtur doket dhe traditën. Kjo gjendje flet për një romanizim të dobët të këtyre viseve. Në realitet për një romanizim intensiv as që mund të flitet pas reformave ushtarake të Dioklecianit në mbarrim të shekullit III dhe të atyre të Konstantinit të Madh në fillim të shekullit IV të e.s. Në këtë kohë ushtria jo që nuk flet, por as nuk di të flasë më latinisht. Kjo shihet nga ajo që thotë Eusebi<sup>34</sup> se Konstantini i urdhëron ushtarët që me zë ta recitojnë një uratë në gjuhën romake apo latine. Kjo dukuri që i kaplon pjesët e Moesia Superior, me siguri nuk ka mundur ti shmanget edhe Dardania. Për romanizimin e dobët të rajonit të Dardanisë flet edhe stilizimi i stelave mbi varret, i cili është karakteristik për territorin e Dardanisë. Elementi karakteristik dekorativ i këtyre stelave është amfora që gjendet në qendër të pjesës së poshtme të stelës, nga del rremi i hardhisë me gjethe dhe kavalesh rrushi ose rremi i urthit, duke u ngjitur nga të dy anët e skajeve të stelës deri në majë. Mbi epigramin që gjendej në pjesën qendrore të pllakës, është edikuli ku janë skalitur figurat e personave që u dedikohet stela e caktuar dhe epigrami në të. Mbi edikul, po ashtu në mes, shpeshherë gjendet edhe rozeta e në anën e majtë dhe të djathtë janë rremat e hurmës. Ky stilizim karakteristik i pllakave mbi varret, i cili paraqitet që nga Prizreni dhe Peja në perëndim e në jug deri në Shkup, kurse në veri deri te Timacum minus, respektivisht Naissusit, flet qartë për një

32 Krh. M. Suić, Antički Nin... 67-68, sidomos 65.

33 Krh. I. M. Rostovtzeff, *The social and economic history of the Roman Empire*, I, 2 edit, Oxford 1957, 243.

34 Krh. Eusebius, *Vita Constantini*, IV 19.



strukturë të ruajtur dhe nga pasojat e romanizimit të pacënuar, në një anë, dhe në anën tjetër për shtrirjen e elementit etnokulturor dardan.

Për zgjidhjen e problemit të romanizimit, material me rëndësi që përdoret është pa dyshim ai epigrafiku. Para së gjithash duhet theksuar se rezultatet dhe përfundimet që nxirren në sajë të këtij materiali për romanizimin e trevës së dardanëve i përkasin periudhës së shekullit II dhe III të e.s. për arsye se për shekujt IV-VI të e.s. materiali përkatës mungon. Kjo dukuri mund të shpjegohet më një anë se popullsia e këtyre viseve, më saktësisht në tërë trevën e Moesia Superior shndërrohet sidomos në qytete dhe kanabe, ku shtresat e kulturuara, të arsimuara, me fjalë të tjera ato qytetare, shndërrohen në ato të fshatrave, të ardhacakëve dhe të pakulturuarve<sup>35</sup>, e në anën tjetër nga dominimi i varrimit krishter, kur varrezat e thjeshta zëvendësohen me varreza familjare të mëdha (me dhoma të ndryshme), ku strehoheshin sarkofagët në të cilët shkronjat skaliteshin që prej kohës së Severëve. Këto lloje varrezash quheshin *Celiae memoriae*<sup>36</sup>. Në analizën e mëtejshme të këtij materiali duhet të kemi parasysh edhe karakterin e tij, me fjalë të tjera, kush i ka vënë këto stela ose përmendore e të tjera. P.sh. dihet se publikanët, qiramarrësit dhe oficinarët gjendeshin në viset e xeherorëve, dekurionët në qendrat municipale, kurse beneficiarët më së shumti kanë ngritur altarët dhe shumë pak epitafe. Pastaj është interesant për t'u theksuar se në Naisi dhe Ulpiana kanë lënë më tepër altarë, kurse në Skupi përmendoret e dekurionëve janë shumë të rralla<sup>37</sup>. E tërë kjo tregon strukturën sociale të ndonjë rajoni, por jo edhe strukturën etnike.

Për hir të së vërtetës, duhet të theksohet se emri romak i ndonjë individi nuk tregon se edhe bartësi i tij ka qenë me të vërtetë i romanizuar, apo me prejardhje romake<sup>38</sup> dhe as që gjuha e tij amtare duhet të jetë patjetër gjuha latine<sup>39</sup>. Sidoqoftë, kjo tregon se duhet pasur kujdes të madh në qoftë se duam që, me anë të materialit të përmendur, të përcaktojmë përkatësinë etnike të bartësit të ndonjë emri. Sepse,

35 Krh. R. Marić, *Stanovništvo Gornjomezijskog limesa od rimskog osvajanja*, në Glas SAN CCL, N. S. X (1961), 84.

36 Krh. A. Mócsy, *Romanisation und Gesellschaft der römischen Provinz Moesia superior*, Budapest 1970, 198-212.

37 Po aty.

38 Krh. B. Saria, *Pozorište u Stobima*, në: GMJS I (1937), 56; C. Patsch, *Bosna i Hercegovina u Rimsko doba*, Sarajevo 1912, 28-29.

39 Krh. G. Alföldy, *Die Personennamen in der römischen Provinz Dalmatia*, Heidelberg 1964, 17.



siç thotë me të drejtë A. Mócsy<sup>40</sup>, individët, të cilët në mbi-shkrime paraqiten me emra thjesht romakë, nuk janë njerëzit endogjenë të romanizuar, por pasardhësit e tyre ose peregrinët. Prandaj shpeshherë mund të ndodhë që ndonjë «...tregtar sirián me gjuhë amtare greke është bartës i emrit latin. Gjithashtu nuk duhet thënë se bartësi i ndonjë emri vetjak grek ka pasur patjetër prejardhje nga treva e gjuhës greke. Pra, nuk duhet të merret kurrësi si tezë e aprovuar që përkatësia gjuhësore e ndonjë emri duhet të tregojë patjetër edhe prejardhjen etnike të bartësit të atij emri»<sup>41</sup>, Madje nuk mund që të mos merret parasysh fakti se ushtarët janë rekrutuar që në kohën paraflaviane nga peregrinët dhe «*civitas romana*» nuk është ndarë ose në qoftë se është ndarë, atëherë kjo ndarje ka qenë, shumë e dobët. Dihet se kjo fillon të ndahet në kohën e Flavëve e të Antoninëve dhe në përgjithësi duke filluar me Trajanin<sup>42</sup>.

Lokalitetet e mëdha urbane në të cilat individët me prejardhje të huaj i kanë ngritur përmendoret, të gjetura në vendbanimet e vogla në tërë trevën e Dardanisë, tregojnë prarinë e popullatës endogjene. Përmendore të tilla gjenden sidomos në pjesën qendrore të Dardanisë, d.m.th. në Kosovë<sup>43</sup>. Me fjalë të tjera, kjo tregon edhe romanizimin e dobët të këtyre viseve<sup>44</sup>. Për një romanizim të dobët flet ekzistenca e fshatarësisë së lirë dhe vetë konfigurimi i trevës së dardanëve<sup>45</sup>. Fakti që disa emra epihorikë paraqiten edhe jashtë trevës së Dardanisë, në territorin e gjerë të Ballkanit, viset e të cilit i kanë banuar fiset ilire, tregon qartë se popullsia endogjene ka ekzistuar edhe në kohën kur paraqitet ky material epigrafik, pra në shekullin II dhe III të e.s. Edhe në qoftë se flitet për ndonjë romanizim të sipërfaqshëm, kjo gjendje duhet

40 Krh. A. Mócsy, *Untersuchungen zur Geschichte der römischen Provinz Moesia superior*, në: AAASH XI (1959) fasc. 1-2, 283-297.

41 Krh. G. Alföldy, *Die Personennamen...* 17-18.

42 Krh. K. Kraft, *Zur Rekrutierung der alen und Kohorten an Rhein und Donau*, 70-100. G. Forni, *Il reclutamento delle legioni da Augusto a Diocleziano*, 122-123) mendon se provincializmi i legjioneve ka filluar shumë më parë dhe nuk është varur prej dëshirës së vetë Vespazianit, por në realitet nga rivaliteti që ka ekzistuar ndërmjet pretorianëve dhe legjionarëve, dhe pastaj ndërmjet vetë legjioneve për të cilën flet edhe vetë fakti se kohortat e pretorianëve, sipas një principati qytetar, kanë qenë të rekrutuar në Itali, kurse legjionarët në përgjithësi kanë qenë të rekrutuar nëpër provinca (Gali, Hispani dhe në Ballkan).

43 Krh. A. Mócsy, *Romanisation...* 200 ss.

44 Krh. E. Čerškov, *Rimljani...* 58.

45 Po a t y. 60.



të lidhet me «Constitutio Antoniana», kur Karakalla, në vitin 212 të e.s., shpall se të gjithë banorët e Perandorisë Romake në të drejta janë të barabartë<sup>46</sup>. Pikërisht me fitimin e të drejtave qytetare romake fillojnë të zhduken edhe emrat epihorikë<sup>47</sup>, e emrat latinë bëhen modë në Perandorinë Romake<sup>48</sup>.

Nga përmbledhja e materialit onomastik, që paraqitet në përmendoret e ndryshme të trevës dardane, të cilin e kemi ndarë në dy pjesë, në atë thjesht ilir dhe në atë joilir, ose me karakter ballkanik<sup>49</sup>, vërtet shihet se elementi epihorik në krahasim me antroponiminë e ardhësve është mjaft i pakët. Një gjendje e tillë mund të shpjegohet nga fakti se pjesa më e madhe e përmendoreve është ngritur prej të huajve, veteraneve, kurse nevoja për mbishkrime dhe për përmendore në popullsinë endogjene shprehet vetëm për epitafe<sup>50</sup>. Por është interesant të theksohet se materiali dardano-ilir epihorik është më i pasur në pjesët perëndimore dhe jugperëndimore të Dardanisë, kurse në pjesët verilindore dhe në skajet e pjesëve lindore, d.m.th. në kufijtë me Trakinë është më i pasur materiali onomastik trak<sup>51</sup>, që nuk do të thotë se bartësit e këtyre emrave trakë kanë qenë patjetër trakë. Dhe pikërisht kjo pakicë e materialit onomastik epihorik tregon se romanizimi i trevës dardane ka qenë fare i sipërfaqshëm. Por për kuptimin e një gjendjeje të tillë duhet që materiali onomastik të shqyrtohet dhe analizohet nga aspekti i kohës dhe i përhapjes gjeografike të tij në një territor të caktuar. Një shqyrtim i tillë na bën të mundshme të kuptojmë se shumë emra kanë qenë karakteristikë për një kohë të caktuar dhe në një trevë të përcaktuar, ose disa emra në vende të ndryshme dhe në kohëra të ndryshme kanë pasur karakter të ndryshëm. Një rezultat i tillë na lehtëson përcaktimin e prejardhjes dhe të karakterit të ndonjë emri, siç thotë Geza Alföldy: «Në qoftë se tani një emër në provincë, në një kohë të caktuar dhe në një zonë të trevës së përcaktuar, tregon karakterin endogjen, atëherë mund ta marrim me një probabilitet të madh për përcaktimin e prej-

46 Krh. Karl Ritter von Czychlar, *Lehrbuch der Institutionen der römischen Rechtes*, 7. Aufl. Wien 1920, 55.

47 Krh.D. Garašanin, *Iliri*, 29.

48 Krh. G. Alföldy, *Die Personenamen...* 17.

49 Krh. Z. Mirdita, *Dardanci i Dardanija u antici*, Zagreb 1972, 218-253. (Dissertatio-manuscript).

50 Krh. A. Mócsy, *Romanisation...* 208-212.

51 Krh. F. Papazoglu, *Dardanska onomastika*, në: ZEF VIII-1 (1964), 49 ss; Po ajo: *Srednjobalkanska plemena u predrimsko doba*, 172-185; A. Mócsy, *Romanisation...* 208 ss.



ardhjes së tij»<sup>52</sup>. Nga kjo që u tha dhe nga rezultatet e shumë hulumtuesve të kësaj treve rreth këtij problemi del se romanizimi me të vërtetë ka qenë i sipërfaqshëm<sup>53</sup>.

Prandaj, në qoftë se duam që me anë të materialit epigrafik ta përcaktojmë intensitetin e romanizimit të trevës së Dardanisë, do të gabonim sikur të mos mirrnim parasys, veç asaj që u tha, edhe faktin që në shndërrimin e antroponimisë ka ndikuar shumë edhe krishterimi<sup>54</sup>. Madje në fondin e materialit epigrafik janë të shpeshtë emrat me gentilicijet perandorake siç janë Claudius<sup>55</sup> dhe Ulpus<sup>56</sup> bartësit e të cilëve kanë qenë shtresat e ulta të popullsisë endogjene. Pra, siç shihet, personat me këto gentilicije nuk kanë ushtruar detyrën e dekorionit dhe janë përcjellur me emra me prejardhje ilire. Në këtë grup hyjnë edhe emrat me gentilicin Aelius<sup>57</sup>. Nga kjo shihet qartë se megjithë emrat latinë, bartësit e gentilicijve Ulpus, Aelius dhe Claudius në jetën e përditshme dhe në marrëdhëniet publike kanë mbetur në traditat endogjene<sup>58</sup>. Këtë e vërteton edhe fakti se mbishkrimet e bartësve të përmendur janë gjetur më tepër në periferi të zonave urbane. Pastaj edhe pse qëllimi kryesor i themelimit të municipiumeve ka qenë shkaktërimi i organizatave fisnore në treva të caktuara, prapëseprapë kjo nuk do të thotë se romanizimi është bërë me sukses<sup>59</sup>, se elementet e kulturës autoktone, siç është, bie fjala, marham, që paraqitet si element etnografik në një territor të gjerë të ilirëve: në Bosnje, në Maqedoni (Tito-Velesi, Kavardarc dhe Prilep)<sup>60</sup>, në Sanxhak (Prijeplje dhe Priboji)<sup>61</sup>, në

52 V. G. Alföldy, *Die Personennamen...* 19.

53 Krh. R. Egger, *Balkan pod Rimljanima*, në: Knjiga o Balkanu II, Beograd 1937, 82.

54 Krh. Duje Rendić — Miočević, *Problemi romanizacije...*

151. 55 CIL III 8184, 8209, 8211; JÖAI XIII (1910), n. 218; *Spomenik XCVIX SAN*, n. 219.

56 CIL III 8204, 14549; *Spomenik SKA LXXI* n. 182, 562; *Spomenik SKA LXXV* n. 212; *Spomenik SKA LXXVII* n. 31, 36; *Spomenik SAN XCVIII* n. 262.

57 *Spomenik SKA LXXI* n. 552, 579. *Spomenik SKA LXXV* n. 156; *Spomenik SAN XCVIII*, 435, 346; CIL III 8221.

58 Krh. Duje Rendić — Miočević, *Diskusija*, Simpozijum III, Sarajevo 1969, 298.

59 Krh. I. M. Rostoftceff, *The social and economic history...* 242-243.

60 *Spomenik SKA LXXI* n. 59, 62, 136, 432; *Spomenik SAN XCVIII* n. 69, 73, 109.

61 *Spomenik SKA LXXI* n. 285, 316, 326, 313; *Spomenik SAN XCVIII* n. 291, 292.



rethinën e Nishit<sup>62</sup> dhe në tërë territorin e Dardanisë, kurse, interesant, në Dalmaci është shumë i rrallë, tregon qartë se popullsia autoktone e Dardanisë është ruajtur edhe në gjysmën e shekullit III të e.s. Është karakteristik busti i gruas i gjetur në Klokot, afër Vitisë, në Kosovë, në të cilin shihen elementet karakteristike etnografike: marhama, gjerdani i madh me medaljon<sup>63</sup>.

Për një romanizim të dobët të këtyre trevave flet edhe vetë struktura sociale dhe kundërthëniet ndërmjet tyre. Më shndërrimin e marrëdhënieve në prohim në dëm të shtresave fshatare, të cilat deri vonë kanë gëzuar një pozitë të volitshme, shkaktohet rrënimi i fshatit dhe, për shkak të gjendjes ekonomike shumë të vështirë, fshatarët vijnë nëpër qendra urbane. Pauperizimi i fshatarësisë shkakton edhe dukurinë e kaçakëve — «latrones». Ekzistenca e këtyre «latrones», e cila është karakteristike e Moesia Superiore, njëherësh dhe pasqyrim i strukturave shoqërore, tregon jo vetëm për shkallën e ulët të romanizimit të këtyre vendeve, por sipas A. Mócsy shihet edhe «izolimi i popullsisë së paromanizuar prej asaj të romanizuar»<sup>64</sup>. Nga ky fakt mund të kuptohet edhe mungesa e materialit epigrafik me emra të popullsisë endogjene dhe pikërisht sepse ky material është gjetur më shumë nëpër qendra urbane. Madje edhe vetë sistemi ekonomik i Dardanisë në kohën e Perandorisë Romake dhe asaj të Bizantit të hershëm, i cili mbështetej në prohimin e popullsisë endogjene, e cila ka qenë bartëse kryesore e tërë ekonomisë, tregon se është ruajtur elementi autokton. Në këtë pasqyrohet politika e «pax romana», qëllimi i së cilës nuk ka qenë vetëm sundimi i plotë mbi pellgun mesdhetar, por edhe vetëqeverisja e plotë e bashkësive fisnore, fshatarët e të cilave kanë qenë boshti i prohimin si në bujqësi ashtu edhe në shehëtar. Pastaj edhe ekonomia e lashtësisë së vonshme tregon bindshëm për ekzistencën e elementit autokton ende të ruajtur, siç janë fshatarët e lirë (in colae), dhe të shtresave të pauperizuara. Mjafton të lexohen reskriptet e

62 Spomenik SKA LXXI n. 249. Spomenik SAN XCVIII n. 262.

63 «Edhe pse kanë qenë nën ndikimin e fortë të skulpturës romake, këto përmendore e kanë ruajtur thelbin e atij realizmi naiv të skematizuar aq karakteristik për krijimtarinë e popullsisë endogjene të vendit tonë në periudhën e lashtësisë». E. Čerškov, *Antička bista žene iz Klokota*, në: GMKM III (1958), 192.

64 «Die Ursache der Unruhen lagen gewiss in den Spannungen einzelner Bevölkerungsgruppen; es liegt an der Hand, an die erwähnte Isolierung der unromanisierten Bevölkerung von der romanisierten zu denken». A. Mócsy, *Untersuchungen zur Geschichte...* 306.



mbretërve Valentinianit I, Gracianit dhe Valensit<sup>65</sup> për t'u parë roli dhe nevoja e këtij elementi autokton në ekonominë e këtyre viseve në këtë kohë.

Nga gjithë sa u tha mund të konkludohet se për romanizimin, si faktor të asimilimit dhe të shkapërderdhjes së popullsisë endogjene të trevës së Dardanisë, as që mund të flitet. Edhe ata emra romakë të vendbanimeve, që janë ruajtur deri vonë në përdorim dhe që kanë mbijetuar edhe në Perandorinë Romake, nuk është e thënë të tregojnë ekzistencën e popullsisë së romanizuar<sup>66</sup>. Më në fund, edhe emrat e huaj mund të jenë vetëm provë e ndikimit të huaj kulturor e nuk provojnë ekzistencën e elementit të huaj. Mjafton të përmendet antropomimia e shqiptarëve, e cila përbëhet prej asaj arabe, persiane, hebreje, krishtere etj.

---

65 Cod. Just. IV 41, 1-2; 63; 2; XI 53, 1.

66 Krh. R. Marić, Glas SAN CCL N. S. (1961), 89.



## VI. ÇËSHTJA E LOKALIZIMIT DHE E IDENTIFIKIMIT TË DISA VENDBANIMEVE NË DARDANI DHE NË DACIA MEDITERRANEA NË KOHËN BIZANTINE TË HERSHME

Duke folur për çështjen e hulumtimit të territorit të Ballkanit Qendror dhe për burimet që janë sot, lidhur me të, Nikolla Vuliq, ndër të tjera, konstaton: «Për fat të keq, burimet tona për këtë pjesë të Ballkanit janë shumë të mangëta, dhe të zbëta. Ato nuk na tregojnë asgjë për shumë çështje, të cilat vetvetiu na imponohen dhe jemi të detyruar të supozojmë se ç'ka qenë. Hipotezat këtu janë të domosdoshme. Për çdo hipotezë ka në vete diçka subjektive dhe nuk mund të provohet. Andaj do të gjenden edhe skeptikë të cilët nuk kanë për t'i pranuar të gjitha ato që janë thënë në punimet e mia»<sup>1</sup>.

Ky mendim, edhe pse është shprehur para dyzet vjetësh, për shkak të gjendjes së shkencës së sotme arkeologjike të këtij territori, vlen edhe sot. Megjithëkëtë, edhe ato pak dëshmi të materialit arkeologjik, të nxjerra në dritë, flasin në mënyrë bindëse se elementi etnik dardan është ruajtur dhe ka vazhduar të jetojë edhe më tutje në vendbanime të cilat ishin të shkëputura nga vendi nënë, ose i detyruar nga dyndjet e përsëritura të barbarëve dhe të sllavëve të tërhiqen në vende të paarritshme prej tyre. Prandaj, pa marrë parasysh se në

<sup>1</sup> Shih N. Vuliq, JIČ, 1-4 (1937), Beograd, 322.



kohë të caktuara kufijt e territorit të dardanëve u ngushtuan ose u zgjeruan, (duhet pa tjetër të theksohet se disa kufij për periudhën në fjalë ishin të karakterit fiktiv me qëllim administrimi sa më të lehtë, si është rasti me kufirin lindor të Dacia Mediterranea, e cila krijohet në fund të shekullit të IV të e.s.) territori i dardanëve në sajë të pozitës së volitshme gjeografike, ka qenë që prej kohëve më të lashta i banuar dhe nga ky territor kanë qenë të njohura vendbanimet e mëdha, si në kohën e sundimit romak ashtu edhe në kohën e hershme bizantine.

Për këtë periudhë dhe për çka thamë më parë na dëshmojnë të dhënat që flasin për punët ndërtimore të Justinianit I (527-565). Siç mësojmë nga Prokopi i Cezaresë<sup>2</sup>, perandori Justinian kishte ndërtuar në Dardani tetë kastro të reja dhe kishte përtërirë gjashtëdhjetë e një të tjerë. Edhe pse në listën e vendeve të ndërtuara rishtas dhe të atyre të përtërirura nuk përmenden edhe këto për të cilat e kemi fjalën këtu, ai megjithatë, «flet gjerësisht në përshkrimin gjeografik të dardanëve» evropianë, «te pjesës bizantine të Ballkanit»<sup>3</sup>.

Kështu Prokopi, në veprën e tij «De aedificiis», ndër të tjera thotë: «Diku tek dardanët evropianë, të cilët jetojnë përtej kufijve të epidamnasve, pranë fortesës së quajtur Bederiana, gjendet fshati Taurisium... dhe pranë këtij vendi një qytet madhështor që e quajti Justiniana Prima»<sup>4</sup>.

Nëse merret parasysh se kjo vepër është e vitit 588 të e.s. në të përmenden shumë emra të kasteleve të kastrave dhe të qyteteve pa të dhëna të sakta gjeografike që na mësojnë për integritetin e kufijve të provincave, atëherë është e qartë se në çfarë vështirësish has secili që merret me problemin në shqyrtim.

Me çështjen e lokalizimit dhe të identifikimit të Justinianës së Parë janë marrë shumë shkencëtarë tash e dy shekuj, duke filluar nga qindvjetshi XVIII dhe XIX. Atë e kanë lokalizuar në Prizren, Ohër, Çustendil, Lipjan, Cariçin Grad, Skupin e lashtë etj. Kohëve të fundit lidhur me lokalizimin e Justiniana Prima janë shfaqur dy mendime të kundërta. Franja Barishiq, duke i përmbledhur mendimet e deritanishme, që janë shfaqur në veprat e shkencëtarëve gjatë këtyre tre shekujve, përfundon se ajo duhet të jetë shtrirë në «një krahinë

2 Krh. Procopi Caesarensis, *De aedificiis*, IV (1-2).

3 Krh. VIZINJ, I, SAN, Knj. CCXLI/3, 54.

4 Procop. *De aedifi*, IV 1. 17-19.



*kufitare trako-ilire*»<sup>5</sup>, dhe «*qyteti-gjendej në Dacia Medite-rranea*»<sup>6</sup>, kurse Tome Tomovski<sup>7</sup> konsideron, dhe sipas mendimit tonë me të drejtë, se Justiniana Prima duhet të lokalizohet në Taurisium, në fshatin e sotëm Tavor, jo larg Skupit të lashtë. Kujtojmë do të ishte e tepërt të parashtroheshin të gjitha mendimet e deritanishme rreth këtij problemi, për arsye se mund të gjenden në punimin e përmendur të Fr. Barišiqit e gjetkë<sup>8</sup>.

Ndonëse na duket që mendimi i Toma Tomovskit është më i arsyeshëm dhe më i pranueshëm, për shkak se autori është njohës i shkëlqyeshëm i terrenit, prapëseprapë, për hirë të së vërtetës, duhet të theksohet se materiali arkeologjik për një lokalizim të këtillë është jo vetëm i mangët, por edhe ai që kemi në dispozicion është shumë i pakët.

Në bazë të materialit arkeologjik, ka pasur përpjekje që Justiniana Prima të identifikohet me Cariçin Gradin, lokalitet në të cilin kanë filluar gërmimet arkeologjike qysh në vitin 1912 dhe rezultatet e të cilit janë shumë madhështore e mund ta bindin secilin që e ka parë ndonjëherë këtë lokalitet<sup>9</sup>. Por, në bazë të autopsisë së terrenit dhe të analizës së tekstit të Prokopit, i cili thotë: «Ai themeloi një qytet tjetër fqinj (Ulpianës, Z. M.) që e quajti Justinopol, me emrin e ungjit të tij (Justini I/518-527, Z. M.)»<sup>10</sup> mund të arrihet në përfundimin se Cariçin Gradi mund të identifikohet lehtë me Justinopolin. Për një identifikim të tillë na shtyn edhe fakti se largësia në mes Ulpianës, që gjendet te Graçanica, 7 km në Juglindje të Prishtinës, në afërsi të fshatit të sotëm Llapje Sellë, dhe Cariçin Gradit, i cili gjendet 7 km në veri të Lebanit, në zonën e fshatit Shtulca, 27 km në jug të Leskovcit, nuk është aq e madhe dhe për këtë mund të bindet çdokush që do të udhëtonte rrugës Prishtinë-Medvexhë-Tullarë-Leban. Për ekzistencën e një rruge të tillë që në kohën romake, na flasin dëshmitë epigrafike të gjetura në kohën e fundit. Ndër të tjera,

5 Shih Fr. Barišić, *Dosadašnji pokušaji ubikacije Justiniana Prima* në: 139 ss ZEF VID (1936), Po ai: VIZINJ, I, 55 n. 118.

6 Krh. Fr. Barišić, po aty.

7 Shih Tomo Tomovski, *Taorskoto gradište (Taurisium-Beriana-Justiniana Prima)*, në: ZA XVII 1967, 233 ss.

8 Krh. Zef Mirdita, *Dardanci i Dardanija u anticij*, Zagreb 1972, 419-433 (Dissertatio në dorëshkrim).

9 Krh. Vl. Petković, *Les fouilles de Tsaritchin Grad*, Cahiers Archeologiques III (1946), 40-48, me gjithë literaturën e lashtë Dj. M a n o — Zisi, *Iskopavanja u Caričnom Gradu*, në *Starinar* n. s. III-IV (1952-1953), V-VI (1954-1955).

10 Procop. *De aedif*, IV 1, 30.



edhe vetë materiali arkeologjik i zbuluar në Cariçin Grad, i cili mund të na fliste për identifikimin dhe vendosjen e Justinianës Prima, nuk është i qartë e as i mjaftueshëm. Sepse, siç thekson me të drejtë J. Kovačević, edhe pse lidhur vetëm për një detaj, por mjaft të rëndësishëm: «*Kapiteli i zbuluar rishitas me monogramin në të cilin më e besueshme është se fshihet emri i perandorit Justinian (edhe pse monogrami mund të lexohet si Anastasius ose Justinus)*»<sup>11</sup>, është tepër i mangët. Veç kësaj, sa është e njohur, emri i Justinianit kudo që të jetë i skalitur, kryesisht gjendet së bashku me emrin e bashkëshortes së tij, Teodorës, gjë që këtu nuk e kemi.

Cila është gjendja arkeologjike dhe a e bën të mundshëm vendosjen e Bederianës dhe të Taurisiumit në vendbanimet e lokaliteteve të sotme Bardovc dhe Tavori, që gjenden në afërsi të Shkupit, për të cilët Prokopi tregon se kanë qenë afër njëri-tjetrit.

Në zonën e fshatit të sotëm Bardovc janë zbuluar mbeturina arkeologjike qysh nga mbarimi i Luftës së Parë Botërore, ndër të tjera mbeturina të një bazilike të shek. IV. të e.s., varreza dhe dy sarkofagë të shek. III dhe IV<sup>12</sup>. Qiro Truhelka<sup>13</sup> konstaton se në vitin 1928 është zbuluar një pjesë e banjës së vogël të qytetit të shek. IV të e.s. Por hulumtimet e mëvonshme kanë treguar se këto mbeturina nuk mund të lidhen më me banjën e vogël të qytetit, por fjala është për një «villa rustica», kurse objekti i përmendur i përket kësaj villae e jo banjës së qytetit<sup>14</sup>. Besojmë, se po të vazhdonin gërmimet arkeologjike në këtë vend kishin për të nxjerrë në dritë shumë materiale edhe për kohërat e mëvonshme.

Përsa i përket Taurisiumit dhe jetës së tij në kohën romake, bile edhe pararomake, nuk mund të dyshohet aspak. Për këtë na flet qartë materiali arkeologjik i njohur për të gjithë hulumtuesit e deritanishëm<sup>15</sup>. I tërë territori i Skupit juglindor në kohën e pushtimit romak vërtet nuk ka ndonjë vendbanim të rëndësishëm, përveç *vicus-ave* të vegjël; kurse

---

11 Shih J. Kovačević, *Arheološki prilog preciziranju hronologije slovenskog naseljavanja Balkana*, në Simpozijum IV 72.

12 Krh. R. Grujić, *Skopska Mitropolija*, në: *Spomenica pravoslavnog hrama. Čv. Bogorodice u Skoplju*, 1935, 5.

13 Krh. Č. Truhelka, *Arheološke beleške iz Južne Srbije*, në: GSND V/2, 78 ss.

14 Krh. A. Mócsy, *Gesellschaft und Romanisation in de römischen Provinz Moesia Superior*, 6; I. Mikulčić, *Teritorija Scupia*, në: ZA XXI (2) 1971, 474.

15 Krh. J. A. Evans, *Antiquarian researches in Illyrricum*, 144 ss; J. G. v. Hahn, *Reise von Belgrad nach Salonik*, 157; T. Tomovski, ZA XVII (1967) 233-239.



në rrjedhën e poshtme të lumit Pqinja dhe ngushticës së Vardarit mbizotëronin tre oppida në fshatrat Studençani, Taor dhe Haxhilar (Mladenovc), kurse këto «dy të fundit jetën e kanë vazhduar si vendbanime me karakter vicus-i»<sup>16</sup>. Sidoqoftë, duke pasur parasysh pozitën gjeografike të ngushticës së Taorit, është e pamundshme që ajo të ketë mbetur e pashfrytëzuar edhe në kohën e Justinianit I. Megjithatë, nga e gjithë kjo që u tha del qartë se materiali arkeologjik është më së i pamjaftueshëm dhe nuk bën të mundshme të jepet një përgjigje e saktë lidhur me problemin e vendosjes të lokaliteteve të përmendura në kohën për të cilën bëhet fjalë këtu. Tani mbetet analiza e fragmenteve të autorëve bizantinë të cilët flasin për lokalitetet e përmendura dhe shqyrtimi i peshkopatës së sotme katolike të Shkupit, në të cilën, në sajë të dokumenteve, mund të shihet trashëgimia dhe vazhdimësia e Metropolisë dhe kryepeshkopatës së Justiniana Prima që i merr mbi vete të gjitha ingerencat politike dhe kish-tare të cilat i kishte pasur Skupi.

Nga teksti i Prokopit që u përmend më lart, e i cili është i përgjithshëm, vështirë se mund të nxirret ndonjë përfundim. Madje ka mjaft rëndësi fakti se Prokopi i Cezaresë, njohës i mirë i perandorit Justinian I dhe sekretar i ministrit të tij të shquar Belizarit, është aq i cekët rreth përcaktimit dhe tregimit për vendlindjen e perandorit sa që kënaqet vetëm me konstatimin se ai është Taurisiumi, që gjendej afër Bederianës, ku «...ka lindur perandori Justinian, themelues i perandorisë botërore»<sup>17</sup>. Por, megjithë këtë të dhënë të cekët të Prokopit, në krahasim me autorët e tjerë bizantinë, që e përmendin Justinianën Prima, ky është më i pranueshëm, siç do të shihet në trajtimin e mëtejshëm.

Analiza e fragmenteve të veprave të autorëve bizantinë të dhënat e tyre na i paraqet mjaft kontradiktore.

Agathia, duke folur për Hunët Kutrigurë në vitin 559 dhe për mbrojtjen e Hersonesë, të cilën e kishte organizuar Germani, i biri i Doroteut, gjeneral i shkëlqyer i Justinianit, ndër të tjera thotë: «atdheu i tij (sc. i Germanit, Z. M.) ka qenë qyteti ilir i cili që prej kohërave është quajtur Bederiana, e më vonë emri iu shndërrua në Justiniana Prima»<sup>18</sup> për të cilën thonë se ka qenë një vend i panjohur, të cilin e ka zbukuruar me ndërtesa madhështore. Malala, një autor tjetër

16 Shih I. Mikulčić, ZA XXI (2) 1971. 465.

17 Procop. *De aedif.* IV 1, 17.

18 Agathia, *Hist.* V 21.



bizantin, Bederianën e përmend si vendlindje të Justininit dhe të Justinianit, që kanë prejardhje trake. Bederianën si vendlindje të Justininit e përmend edhe Prokopi<sup>19</sup> dhe autorë të tjerë.

Të dhënat e fragmenteve të përmendura rreth problemit të Justinianës Prima janë tepër të pasakta. I vetmi që disi dallohet është Joani i Antiohisë. Ai, në realitet, shprehimisht thotë se kështjella Bederiana, vendlindja e perandorit të Justininit, gjendej në afërsi të qytetit ilir Nish: «...Justini, nga Bederiana, kështjella e cila i afrohet Nishit ilir»<sup>20</sup>.

Si mund të kuptohet kjo kontradiktë te këta autorë të përmendur? Në të vërtetë, të gjithë njohësit e mirë të këtyre autorëve, si të Agathisë ashtu edhe të Malalës, theksojnë se nuk janë aq të besueshëm dhe se nuk i kanë shfrytëzuar dokumentet e shkruara. Kanë shkruar jo në bazë të autopsisë, por në bazë të tregimit gojor, dhe, në qoftë se kanë shfrytëzuar ndonjë burim, atë e kanë bërë nga dora e tretë ose e katërt dhe pa ndonjë vështrim kritik. Dija e tyre është mjaft e cekët dhe jo e qartë<sup>21</sup>. Përkundrazi, kjo nuk mund të thuhet për Prokopin. Veç kësaj, duhet ta kemi parasysh edhe situatën historike dhe perspektivën e kohës së autorëve të përmendur në shkrimin e veprave të tyre se Joani i Antiohisë, që rreth vitit 610 të e.s. shkruan për kohën kur dyndjet barbare bëhen të shpeshta dhe të rrezikshme, dhe kjo kohë është mbarimi i shekullit të VI të e.s. Prandaj është edhe e kuptueshme pse Bederiana, vendlindja e perandorit, vendoset në afërsi të Nishit, i cili në këtë kohë është pararojë e Perandorisë Bizantine<sup>22</sup>.

Por këso kontradiktash nuk ka ndërmjet Prokopit të Cezaresë dhe të Justinianit, i cili në aktet e tij juridike ka qenë i detyruar të shprehet në mënyrë të saktë. Tekstin e Prokopit duhet ta kuptojmë në konceptin etnografik kur thotë «në tokën e dardanëve» në krahasim me Novelën XI të Justinianit, në të cilën flitet në aspektin administrativ, ku thotë në «Dacia Mediterranea». Sidoqoftë, kjo divergjencë në mes të Prokopit dhe Justinianit nuk do të thotë që Justiniana Prima të kërkohet në vende të ndryshme. Çfarë na ofrojnë lidhur me këtë tekstet juridike të Justinianit?

Është e ditur se para ardhjes së Justinianit në pushtet,

19 Joannis Malac, *Chronographia*, 410, 1-3.

20 Joannis Antiochei, *Chronici fragmenta*, 339.

21 Krh. VIZINJ, I, 1955, 74, 82.

22 Krh. T. Tomovski, ZA XVII (1967), 238.



Iliriku, në aspektin administrativ-kishtar, paraqet një tërësi. Duke lexuar Novelën XI të datës 14.IV.535 të e.s., që në thelb është dekret i karakterit institucional, thuhet: «Meqenëse aq fort dëshirojmë të lartësojmë me mënyra të ndryshme vendlindjen tonë... dëshirojmë që edhe për sa i përket pushtetit kishtar ai të rritet në shkallën më të lartë, kështu që drejtuesi shpirtëror i sotëm dhe i ndritshëm i qytetit tonë Justiniana e Parë të bëhet jo vetëm metropoli, por edhe kryepeshkopata dhe nën pushtetin e tij të jenë disa provinca e pikërisht si vetë Dacia e Brendshme, ashtu edhe Dacia Analmase, gjithashtu edhe Myzia e parë, Dardania, provinca Prevalitane, Maqedonia e Dytë dhe një pjesë nga Panonia e Dytë, e cila është në krahinën e qytetit të Bacensit»<sup>23</sup>. Shihet qartë se Justiniana Prima bëhet qendër administrative-kishtarë e pjesës perëndimore të Ilirikut Lindor, kurse pjesa lindore e tij, Maqedonia, mbetet nën pushtetin shpirtëror të Thesalonikut<sup>24</sup>. Akti i Justinianit, siç mund të konkludohet në sajë të reagimit të papës së Romës, Agapetit I (535-536), ka qenë kryer në mënyrë të pavarur prej Kishës së Romës. Papa në realitet, dërgon një delegacion që ta shqyrtojë situatën në vend<sup>25</sup>. Në fakt me këtë akt Kisha e Romës gjendej para një fakti të kryer, për arsye se nuk dihej aspak se çfarë rezultati kishin arritur përfaqësuesit e papës. E njëjta gjë kishte ndodhur edhe në kohën e pasardhësit të Agapetit, papës Silverit (536-537).

Ndryshe nga Novela XI, Novela CXXXI e datës 18.III.545

23 Nov. XI: «*Multis et variis modis nostram patriam augere cupient... et circa sacerdotalem censuram eam volumus maximis incrementis ampliari, ut Primae Justinianae patriae nostrae pro tempore sacrosanctus Antistes non solum Metropolitanus sed etiam Archiepiscopus fiat, ut caeterae provinciae, sub eius sint auctoritate id est tam ipsa Mediterranea Dacia, quam Dacia Ripensia nec non Mysia Prima, Dardania et Praevalitana Provincia et secunda Macedonia et pars secundae, etiam Pannoniae, quae in Bacensi est civitate*». Bacensi këtu duhet të lexohet Bassianensi, qytet në Pannonia Inferior, në rrugën Sirmium-Taurunum, gjegjësisht ndërmjet fshatrave Putci dhe Petrovci në Srem. (Krh. J. Zeiller, *Les origines chretiennes dans les provinces Danubiennes de l'Empire Romaine*, 388; B. Granić në: *GSND I* (1925), 127 n. 45; W. Tomaschek, *PWRE*, II, col. 105.

24 Krh. L. Duchesene, *Autonomies ecclesiastiques*. 230 ss.

25 «*De quo simul negotio, sed et de Justiniana civitate, gloriosi natalia vesteri conscia, necnon de nostrae sedis vicibus injugendis, quid, plenius deliberari contigerit, per eos quod ad vos dirigimus legatos (Deo propitio) celeriter intimamus*», Agapeti pape, ep. 4. Licet de Sacerdotii, Ad Justinianum, në: Pl. LXVII col. 38-41; D. J. Mansi, VIII, 850-852.



të e.s. gjendjen e përmendur e sanksionon përfundimisht. Por, nga teksti mund të vërehet se kjo është bërë me lejen e papës së Romës, Vigilit<sup>26</sup>. Në bazë të këtij akti juridik, territori i cili gjendej nën pushtetin e kryepeshkopit, siç thotë vetë Justiniani «*Primae Justinianae nostrae patriae*», ka qenë ndërruar. Sufraganë të kësaj kryepeshkopate kanë qenë peshkopatat e provincave të Dacia Mediterranea, Dacia Ripensis, Praevalitane, Dardanisë, Myzisë së Epërme dhe Panonisë, por jo edhe të Maqedonisë Salutaris<sup>27</sup>, e cila tani gjendej sigurisht nën vikariatit e Thessalonikës. Nga Novela CXXXI mund të përfundohet se Kateliani, kryepeshkopi i Justinianës Prima ka qenë edhe përpara drejtues i kësaj administrate integrale. Kjo shihet nga fakti se në koncilin Vekumenik, të mbajtur në Konstantinopojë në vitin 553, të gjithë peshkopët e Dardanisë paraqiten si sufraganë të kryepeshkopit të Justinianës Prima<sup>28</sup>.

Duke pasur parasysh sa u tha më sipër, del se Justiniani me të dy novelat e bën të pavarur Justinianën Prima në aspektin kishtar-juridik, si mitropoli ashtu edhe kryepeshkopata me të gjitha ingerencat, që i kishte përpara Sirmimumi si vikariat i papës së Romës për tërë Ilirikun, që më vonë, me ndarjen e Ilirikut i merr Thessaloniku, kalojnë në Justiniana Prima.

Megjithatë, Justiniana Prima në këto periudha të vrullshme, plot turbullira dhe pasiguri, si pasojë e dyndjeve të pandërprera të popujve të ndryshëm barbarë dhe të sllavëve, nuk do të qëndrojë gjatë. Ajo përmendet për herë të fundit në aktet kishtarë në vitin 602, kur Gjonin arqipeshkvin e saj përpigjet ta ndërrojë perandori Maurik (582-602). Kundër dëshirës autokratike të këtij perandori angazhohet papa i Romës, Grigori i Madh<sup>30</sup>. Nga kjo shihet qartë se Justiniana e Parë, prandaj edhe i tërë territori administrativ i Metropolisë dhe i kryepeshkopatës, gjendet nën juridikcionin e Kishës së Romës. Kjo mund të shihet qartë nga korrespondenca e papës Grigorit i Madh, letrat e të cilit adresohen për Gjonin, kryepeshkopin e përmendur, dhe kanë të bëjnë me mosmarrëveshjen në mes

26 Novell. CXXXI, c. 3: «...et in subiectis sibi provinciis locum obtinere eum sedis apostolicae Romae secundum ea quae definita sunt a sanctissimo papa Vigilio».

27 Krh. J. Zeiller, *Les origines...* 146.

28 Mansi IX 199-200.

29 Gregorius papa, ep. Scripsit mihi «Anatolio diacono Constantino-politano. në: Gregorii papae registrum epistolarum MGHAA, vol. II, 503, n. 277.

30 Gregorius papa, ep. «Quando mala» Iohani episcopo Primae Justiniane, n. 280; ep «Quae dilectissimus» Constantino episcopo Scodritano, në MGH AA, 512-513.



peshkopëve Palit dhe Nemesiut përkitazi me selinë peshkopale të Diokletianës. Nga kjo korrespondencë kuptohet se ai mbetet ende drejtues shpirtëror i këtyre vjeseve, me gjithë kundërshtimin e perandorit Maurik. Veç kësaj, ai është edhe peshkopi i fundit, që përmendet si kryepeshkop i Justinianës Prima<sup>31</sup>. Pas kësaj që u tha, shtrohet me të drejtë çështja e vazhdimësisë kishtare-administrativ të peshkopatës së Skupit të lashtë e Justinianës Prima dhe vazhdimësia e këtyre të dyjave në peshkopatën e sotme të Shkupit. Në qoftë se kjo mund të provohet, gjë për të cilën, në bazë të materialit dokumentar që disponojmë, nuk ka arsye dyshimi, atëhere edhe vendet e lokaliteteve, siç janë: Justiniana Prima, Taurisium, Bederiana dhe Justinopolisi, nuk është vështirë të provohen.

Prandaj pyesim, a mund të flitet për trashëgiminë kishtare-administrative dhe shpirtërore të Justinianës Prima me atë të Skupit të lashtë? Në sajë të materialit që kemi, çdo dyshim është i tepërt. Për hir të së vërtetës, duhet të theksohet se për Skupin e lashtë, pas tërmetit katastrofal të vitit 518 të e.s., nuk flitet më. Comes Marcelini, duke folur për tërmetin e përmendur, thotë se «menjëherë u shkatërruan në provincën e Dardanisë 24 kështjella ndër të cilat ishte edhe Skupi, banorët e të cilit, në sajë të faktit se po ikin para armikut, shpëtuat»<sup>32</sup>. Edhe të gjitha burimet që flasin për Skupin dhe ekzistencën e tij, edhe pas tërmetit kryesisht tregojnë për gjendjen para tij<sup>33</sup>. Në këto kohëra tragjike, nga një anë katastrofat elementare e nga ana tjetër dyndjet e pandërprera barbare në frontin peshkopal të Skupit përmendet Gjoni, peshkop, për fatin e të cilit nuk dihet asgjë. Por, mund të thuhet me siguri se në vitin 515 të e.s. ai ka marrë pjesë në koncilin ilir, ku u mblodhën rreth 400 peshkopë nga Iliriku dhe Greqia dhe në të cilin u vendos që ta braktisnin kryepeshkopatën e Thessalonikut, në bashkësinë e së cilës kanë qenë të detyruar të mbesin nga ana e perandorit Anastas I (491-518). Ata iu drejtuan papësisë Romës<sup>34</sup>. Megjithatë duhet të theksohet se uniteti i peshkopatave të provincës së Dardanisë me Kishën e Romës as që mund të vihen në dyshim, edhe përkundër presionit të peran-

31 Krh. J. Zeiller, *vep. e cit.* 393; B. Granić, *vep. e cit.* 132.

32 «...In provincia Dardaniae assiduo terrae motu XXIV castella unomomento collapsa sunt quorum duo suis habitatoribus demersa... Scopus namque metropolis licet sine civium suorum olim hostes fugientium clade, fonditus tamen ruit». Marcelin, V. Comitibus, *Chronicon ad an. 518*, në: MGH AA, 100.

33 Krh. Z. Mirdita, *vep. e cit.* 432, n. 605.

34 Krh. PG CVIII col. 378; Mansi VIII, 537-538.



dorëve të Konstantinopojës. Prandaj, për një ndarje heretike dhe mospajtim doktrinal të Kishës së provincës së Dardanisë me Kishën e Romës nuk mund të flitet<sup>35</sup>. Edhe nëse kishte ndodhur diçka e tillë, atëherë kjo ishte pasojë e presionit të perandorit Anastas I. Edhe ky presion ka qenë vetëm i përkohshëm, për arsye se ndryshe nuk mund të kuptohen fjalët e peshkopit të Vjenës, Avites, i cili në letrën e dërguar papës Hormisdit (514-523), flet për kthimin e Dardanisë në gjirin e Kishës së Romës<sup>36</sup>.

Veç kësaj edhe vetë fakti që Justiniani e ndërton Justinianën Prima dhe e ngriti atë në aspektin kishtar në rang të kryepeshkopatës dhe të mitropolisë me të gjitha prerogativat e përmendura, bile pas më pak se 27 vjet pas, tërmetit katastrofal, besojmë se ai do të ketë pasur një bazë në saje të së cilës ka qenë i detyruar të vepronte. Vërtet, papa, me aktet institucionale të Justinianit, që i ballafaquar me një fakt të kryer. Megjithatë, Justiniani ishte i vetëdijshëm që për një organizim administrativ të tillë, ishte e domosdoshme leja e papës. Kjo, ndër të tjera, shihet edhe nga vetë përmbajtja e papës. Kjo, ndër të tjera, shihet edhe nga vetë përmbajtja e paria shpirtërore e së cilës ishte gjithnjë në unitet me Kishën e Romës. Në fakt, të gjithë njohësit e mirë të këtij problemi njëzëri pohojnë se Justiniana Prima është trashëgimtaria e peshkopatës së Skupit të lashtë<sup>38</sup>.

Por, a mund të flitet për vazhdimësinë e Justinianës Prima me atë të peshkopatës së sotme të Shkupit?

35 «Dans la Dardanie, il n'y avait en rupture, mais peut-être seulement des rapports plutôt qu'union proprement dite». H. Leclercq, *Illyricum*, në: Dictionnaire d'archeologie chretienne et de liturgie VII/1. Paris 1926, col. 177.

36 Krh. S. Aviti, *Vinnensis Hormisadae papae*, ep. 87, në: PL LIX, col. 288; S. Aviti, *Epistolarum ad diverses XLII*, në: MGH AA, VI 11-72; S. Hormisdae P. ep. X, në PL LXII, col. 396; PG. LXIII, col. 432.

37 Novell. X CXXXI. c. 3: «...dhe ato të udhëhiqen prej tij. Por ai vetë të jetë i drejtuar nga sinodi i tij dhe në provincat që i nënshtrohen atij të jetë zëvendës i fronit apostolik romak, sipas përcaktimit të papës së shenjtë Vigilit».

38 Krh. J. Zeiller, *vep. e cit.* 385 ss; N. Vulić, *Justiniana prima*, në: Glas SKA CLV 60.



Që më lart u theksua se Justiniana Prima për herë të fundit përmendet në vitin 602 të e.s. Pas kësaj, në kohën e dyndjeve të pandërprera të barbarëve dhe të sllavëve, për tërë këtë trevë fillon një periudhë e vështirë. Qytetet dhe fshatrat shkretohen. Vështirësohet situata si në prodhim ashtu edhe në aspektet e tjera të jetës. Në «Miracula s. Demetrii» II, duke folur për ngjarjet e vitit 618, ndër të tjera mund të lexohet: «Kurse të tjerët përsëri, prej atyre nga Nishi dhe Serdika, pasi u rrethua qyteti nga ata (avaro-sllavenët), tregonin me lotë: ikëm nga andej dhe arritëm këtu që të vdesim me ju; se një e qëlluar e gurit të tyre ka për t'i shkatërruar muret»<sup>39</sup>. Interesant është për t'u shënuar se në listën e këtyre qyteteve nuk përmendet Justiniana Prima. Disa mendojnë se kjo tashmë gjënde nën sundimin e bullgarëve<sup>40</sup>, dhe disa të tjerë janë të mendimit se atë e kishin shkatërruar dhe rrënuar sllavët. Përkundër këtyre mendimeve të kundërta dhe mospajtimeve, është interesant që në concilin VII ekumenik, që është mbajtur në Nice në vitin 787, i cili trajtonte problemin e ortodoksisë së ikonoklazmit në mesin e peshkopëve që ishin «lindur, rritur dhe edukuar në këtë herezë»<sup>41</sup>, marrin pjesë edhe peshkopët e Dardanisë<sup>42</sup>. Sidoqoftë, për kishën e peshkopatës së Shkupit kjo periudhë është e errët dhe për një kohë të gjatë nuk kemi lajme lidhur me të. A mund të mendohet se ajo nuk ka ekzistuar në këtë kohë?!

Në sajë të të dhënave të autorëve të ndryshëm shihet se këto vise i kishin pushtuar fiset e ndryshme sllave. Me siguri se edhe për kishën e Shkupit fillon një periudhë e vështirë, plot rreziqe. Të krishterët fillojnë të tërhiqen në vende të fshehta<sup>43</sup>, e me siguri se pas tyre kanë shkuar edhe priftërinj dhe hierarkia tjetër kishtarë. Në këto çaste të vështira, me siguri edhe hierarkia do të ketë kaluar momente jo të mira. Do të jetë detyruar që jetën pastorale të ia përshtasë kohës. Sipas Konstantin Porfirogenetit<sup>44</sup>, në trevën e Dardanisë në

39 Fr. Barišić, *VIZINJ*, I, 196, n. 24.

40 Krh. Farlati, *Illyrici sacri*, I, 77.

41 Mansi XII 1031.

42 Krh. E. Golubinskogo, *Kratki očerk istorii Pravoslavnih cerkvej Bolgarskoj, Serbskoj i Rumunskoj ili Moldo-Valašskoj*, 549, n. 16.

43 Presbyterus Diocleatus «*At Christiani, videntes se in magna tribulatione et persecutio aut construere, ut vel sic euaderent manus eorum...*» *Regnum Slavorum*, c. 7. në: *Scriptorum Hungaricarum, Dalmaticarum, Croaticarum et Sclavonicarum veteres ac genuini*, II ed. 479.

44 Const. Porfirogeniti, *De administrando imperio*, c. 32, në: PG. CXIII col. 291. Krh. edhe E. Golubinskogo, *vep. e cit.* 444.



